

# RAPORTI VJETOR 2023

*Raporti Vjetor është miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 13, datë 6.3.2024, ndërsa Pasqyrat Financiare të Bankës së Shqipërisë, janë miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.18, datë 20.3.2024.*

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.

Botuar nga: Banka e Shqipërisë,

Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë

Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419409/10/11

Faks: + 355 4 2419408

E-mail: [public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)

[www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)

Tirazhi: 240 kopje



# P Ë R M B A J T J A

BAZA LIGJORE E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË	7
FJALA E GUVERNATORIT	9
GJATË VITIT 2023...	11
1. KËSHILLI MBIKËQYRËS I BANKËS SË SHQIPËRISË	15
2. VEPRIMTARIA E BANKËS SË SHQIPËRISË	21
2.1. Politika monetare	21
2.2. Operacionet monetare	56
2.3. Stabiliteti financiar dhe politika makroprudenciale	58
2.4. Mbikëqyrja bankare	65
2.5. Ndërhyrja e jashtëzakonshme	74
2.6. Emetimi i monedhës	79
2.7. Sistemet e pagesave	82
2.8. Administrimi i rezervës valutore	94
2.9. Statistikat	99
2.10. Puna kërkimore	103
2.11. Integrimi evropian dhe bashkëpunimi ndërkombëtar	106
2.12. Transparenca dhe komunikimi me publikun	112
2.13. Edukimi financiar	115
3. BURIMET NJERËZORE DHE KAPACITETET INFRASTRUKTURE	118
3.1. Burime njerëzore	118
3.2. Përmirësime në infrastrukturë	119
4. AUDITIMI I BRENDSHËM	121
4.1. Zhvillime të rëndësishme në aktivitetin e auditimit të brendshëm	121
4.2. Tregues të përgjithshëm mbi Departamentin e Kontrollit	122
4.3. Angazhimet e kryera gjatë vitit 2023 dhe problematikat kryesore të evidentuara	123
5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT OPERACIONAL	125
6. STRATEGJIA AFATMESME E ZHVILLIMIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË 2024 – 2026	128
PAËSQYRAT FINANCIARE MË DHE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2023 (SË BASHKU ME RAPORTIN E AUDITUESVE TË PAVARUR)	129



## HAPËSIRA INFORMUESE

Hapësisirë Informuese 1:	Ecuria aktuale dhe perspektiva afatgjatë e tregut të punës në Shqipëri	34
Hapësisirë Informuese 2:	Ecuria e kursit të këmbimit: faktorët, implikimet dhe reagimi i Bankës së Shqipërisë	45
Hapësisirë Informuese 3:	Ecuria e kredisë përballë nevojave të zhvillimit dhe krahasimi me rajonin	51
Hapësisirë Informuese 4:	Financa e gjelbër	63
Hapësisirë Informuese 5:	Ligji i ri "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike"	71
Hapësisirë Informuese 6:	Burimet e financimit të kërkesës MREL gjatë vitit 2023	76
Hapësisirë Informuese 7:	Pjesëmarrja e Shqipërisë në SEPA	91
Hapësisirë Informuese 8:	Flukset që ndikuan rezervën valutore, gjatë vitit 2023	98
Hapësisirë Informuese 9:	Aktivitetet brenda vendit	113

## PËRMBAJTJA E TABELAVE

2.1.	<i>Politika monetare</i>	
Tabelë 1.	Kontributet sektoriale në rritjen ekonomike	27
Tabelë 2.	Rritja ekonomike dhe tregues të tregut të punës në vite	34
Tabelë 3.	Kontributi i kategorive kryesore në inflacionin vjetor	38
Tabelë 4.	Ecuria e treguesve kryesorë të bilancit të pagesave dhe të borxhit të huaj	42
Tabelë 5.	Tregues kryesorë makroekonomikë dhe financiarë	55
2.2.	<i>Operacionet monetare</i>	
Tabelë 6.	Struktura e operacioneve injektuese të likuiditetit nga Banka e Shqipërisë	56
2.3.	<i>Stabiliteti financiar dhe politika makroprudenciale</i>	
Tabelë 7.	Tregues të aktivitetit të sistemit financiar	59
Tabelë 8.	Harta e nxehësisë për disa nga treguesit e rreziqeve sistemike sipas objektivave të ndërmjetëm	61
2.4.	<i>Mbikëqyrja bankare</i>	
Tabelë 9.	Numri i ekzaminimeve sipas tematikës për vitin 2023	66
Tabelë 10.	Struktura e pronësisë së bankave, numri i bankave	69
Tabelë 11.	Numri i bankave, subjekteve financiare jobanka, shoqërive të kursim-kreditit dhe zyrave të këmbimit valutor të licencuara nga Banka e Shqipërisë	70



## PËRMBAJTJA E GRAFIKËVE

<b>2.1.</b>	<b>Politika monetare</b>	
Grafik 1.	Ecuria e inflacionit, atij bazë e pritjeve afatmesme dhe norma bazë	24
Grafik 2.	Ecuria e aktivitetit ekonomik sipas sektorëve	26
Grafik 3.	Ndryshimi vjetor i kërkesës së brendshme sipas komponentëve	27
Grafik 4.	Ecuria e konsumit dhe e investimeve	28
Grafik 5.	Ecuria e eksporteve neto	29
Grafik 6.	Kontributet vjetore të kategorive kryesore të eksportit dhe importit të mallrave	29
Grafik 7.	Impulsi fiskal dhe natyra e politikës fiskale	30
Grafik 8.	Deficiti buxhetor dhe financimi dhe borxhi publik ndaj PBB-së	31
Grafik 9.	Të ardhurat dhe shpenzimet	32
Grafik 10.	Ecuria e treguesve të tregut të punës dhe e pagës në sektorin privat	33
Grafik 11.	Rëndësia e faktorit “Mungesë e fuqisë punëtore” dhe rritja e pagave	35
Grafik 12.	Treguesit të tregut të punës sipas dy nënperiudhave, dekompozuar me kontributet sipas grup-moshave dhe struktura e popullsisë në moshë pune sipas grup-moshave	36
Grafik 13.	Inflacioni vjetor dhe objektivi; inflacioni në vend, në vendet e rajonit dhe në BE	37
Grafik 14.	Struktura e artikujve të shportës së IÇK-se sipas intervaleve të inflacionit	38
Grafik 15.	Tregues të gjendjes ciklike	39
Grafik 16.	Inflacioni sipas komponentëve bazë dhe jobazë; të brendshëm dhe të importuar	39
Grafik 17.	Ecuria e pritjeve të agjentëve ekonomikë për inflacionin	40
Grafik 18.	Normat kryesore të interesit në lekë dhe interesat në tregun ndërbankar	43
Grafik 19.	Ecuria e kursit të këmbimit dhe treguesi i anshmërisë për mbiçmim/nënçmim mbi kursin eur/lek	44
Grafik 20.	Ecuria mujore dhe vjetore e kursit eur/lek	45
Grafik 21.	Llogaria korrente në % të PBB-së dhe vëllimet e tregimit në tregun valutor	46
Grafik 22.	Spread-et e kuotimit të kursit eur/lek dhe luhatshmëria e tij	47
Grafik 23.	Ecuria e yield-eve dhe kurba e yield-eve	48
Grafik 24.	Normat mesatare të interesit të depozitave dhe të kredisë; dhe spread-et e tyre në lekë	49
Grafik 25.	Ecuria e kredisë për sektorin privat dhe e depozitave të bankave	50
Grafik 26.	Normat vjetore të rritjes së kredisë për sektorin privat	51
Grafik 27.	Struktura e portofolit të kredisë në terma të përbërjes valutore dhe të destinacionit, si dhe treguesi i kredive me probleme	52
Grafik 28.	Dinamikat sektoriale të ekonomisë shqiptare dhe ecuria e kredisë	52
Grafik 29.	Ecuria e kredisë në Shqipëri dhe në disa vende të Evropës Lindore dhe raporti i saj ndaj PBB-së	53
Grafik 30.	Kredia për biznese dhe për familje në Shqipëri dhe në rajon	54
Grafik 31.	Ecuria e likuiditetit të sistemit bankar	56
<b>2.3.</b>	<b>Stabiliteti financiar dhe politika makroprudenciale</b>	
Grafik 32.	Pozicioni neto i korporatave financiare sipas instrumenteve dhe sipas kundërpasive	59
<b>2.5.</b>	<b>Ndërhyrja e Jashtëzakonshme</b>	
Grafik 33.	Kapaciteti MREL për periudhën 2022-2023, në përqindje të aktiveve të ponderuara me rrezik	76
Grafik 34.	Burimet e financimit të MREL për periudhën 2022-2023, për grupin e bankave që i nënshtrohen kësaj kërkesë dhe struktura e MREL, dhjetor 2023	77
Grafik 35.	Fondi për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme i plotësuar në vite dhe niveli i synuar në vitin 2027	78



Grafik 36.	Tregues të ecurisë së monedhës kombëtare dhe të kartëmonedhës në qarkullim	79
2.6.	<i>Emetimi i monedhës</i>	
Grafik 37.	Treguesi i përpunimit dhe papërshtatshmërisë së kartëmonedhave dhe koeficienti i qarkullimit	80
Grafik 38.	Ecuria e treguesit të falsifikimit të kartëmonedhave në qarkullim	81
Grafik 39.	Numri dhe vlera e transaksioneve të procesuara në AIPS	82
2.7.	<i>Sistemet e pagesave</i>	
Grafik 40.	Ecuria e sistemit AIPS EURO sipas numrit dhe vlerës së transaksioneve të procesuara	83
Grafik 41.	Numri, vlera totale e transaksioneve dhe ajo mesatare për transaksion të kleruar në AECH dhe raporti i transaksioneve të procesuara në AECH me popullsinë mbi moshën 15 vjeç	84
Grafik 42.	Ecuria e transaksioneve të procesuara në sistemin AFISaR dhe në përqindje ndaj PBB-së	85
Grafik 43.	Ecuria e transaksioneve në sistemin AFISaR të ndara sipas katër grup-tipeve kryesore	85
Grafik 44.	Ecuria e numrit të instrumenteve të pagesave elektronike dhe në formë letër në vite, numri i pagesave për frymë (+15 vjeç) në vite	86
Grafik 45.	Pesha e instrumenteve të pagesave sipas numrit të transaksioneve dhe përdoruesit sipas tipologjisë së instrumenteve të pagesave, gjatë vitit 2023	87
Grafik 46.	Raporti i llogarive home-banking ndaj totalit të llogarive	87
Grafik 47.	Përdorimi i kartave për pagesa kundrejt tërheqjeve cash në ATM, numri i kartave në qarkullim	88
Grafik 48.	Numri i terminaleve ATM dhe POS për 100,000 të rritur, numri i ATM-ve, POS-ve	89
Grafik 49.	Numri dhe vlera e transaksioneve cash në sportelet e bankave 2023	89
Grafik 50.	Ecuria e rezervës valutore	94
2.8.	<i>Administrimi i Rezervës Valutore</i>	
Grafik 51.	Përbërja sipas monedhave e rezervës valutore bruto	95
Grafik 52.	Shpërndarja e rezervës sipas afatit të maturimit të instrumenteve	95
Grafik 53.	Përbërja e portofolit të rezervës sipas vlerësimit dhe kundërpalës	96
Grafik 54.	Kthimi i rezervës valutore	96
Grafik 55.	Normat 2-vjeçare të interesit për emetimet e qeverive me peshë të rëndësishme në portofolin e rezervës	97
3.1.	<i>Burime njerëzore</i>	
Grafik 56.	Raporti femra/meshkuj në Bankën e Shqipërisë	118



## BAZA LIGJORE E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË

Banka e Shqipërisë (BSH) është banka qendrore e Republikës së Shqipërisë. Ky status sanksionohet në nenin 161 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe ligjin 8269/1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i cili përcakton objektivat, detyrat, marrëdhëniet me sistemin bankar dhe me shtetin, organizimin dhe drejtimin, pronësinë mbi kapitalin, pasqyrat financiare dhe shpërndarjen e fitimit.

Banka e Shqipërisë ka si objektiv kryesor arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Ajo është autonome dhe e pavarur nga çdo pushtet tjetër në realizimin e objektivit kryesor dhe objektivave e detyrave të tjera.

Banka e Shqipërisë është me kapital tërësisht shtetëror dhe përgjigjet përpara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Ajo drejtohet nga Këshilli Mbikëqyrës, i cili kryesohet nga Guvernatori, që vepron edhe si Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i saj.

Veprimtaria e Bankës së Shqipërisë mbështetet në ligjet e mëposhtme:

- Neni 161 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 133, datë 29.4.2013, "Për sistemin e pagesave";
- Ligji nr. 55/2020, datë 30.4.2020, "Për shërbimet e pagesave";
- Ligji nr. 52, datë 19.5.2016, "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre";
- Ligji nr. 133, datë 22.12.2016, "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë";
- Statuti i Bankës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr. 90, datë 2.12.2015, të Këshillit Mbikëqyrës.





*GUVERNATORI I BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. GENT SEJKO*



## FJALA E GUVERNATORIT

*Ju uroj mirëseardhjen në këtë takim të përvitshëm me Raportin Vjetor të Bankës së Shqipërisë, raport i cili ka qenë e mbetet një pasqyrë e plotë e aktivitetit dhe e rezultateve tona gjatë vitit.*

*Viti 2023 ishte një vit tjetër sfidues për ekonominë shqiptare. Rritja e ndjeshme e çmimeve në ambientin vendas dhe të huaj gjatë dy viteve të fundit, rritja e kostove të financimit, si dhe tensioni gjeopolitik, kanë qenë faktorë pengues për rritjen ekonomike dhe kanë testuar qëndrueshmërinë ekonomike dhe financiare të të gjitha vendeve të globit.*

*Megjithatë, edhe në këtë kontekst jo të favorshëm, ecuria e ekonomisë shqiptare ka qenë pozitive.*

*Vëllimi i aktivitetit ekonomik ka shënuar rritje dhe, së bashku me të, janë rritur punësimi e pagat. Njëkohësisht, bilancet financiare të bizneseve dhe familjeve kanë ardhur në përmirësim, borxhi publik dhe ai i huaj kanë ardhur në rënie, ndërsa treguesit kryesorë të shëndetit të sektorit bankar: likuiditeti, kapitalizimi dhe përfitueshmëria, kanë ardhur në përmirësim.*

*Paralelisht me to, inflacioni i çmimeve të konsumit shënoi një rënie të ndjeshme gjatë vitit, duke lehtësuar ndikimin negativ të tij në buxhetet familjare dhe duke reduktuar pasigurinë për bizneset.*

*Aktiviteti i Bankës së Shqipërisë ka pasur një kontribut të rëndësishëm në këtë tablo zhvillimesh.*

*Ne vijam të normalizojmë qëndrimin e politikës monetare gjatë vitit 2023, nëpërmjet rritjeve të normës bazë të interesit dhe në funksion të krijimit të premisave të nevojshme financiare për respektimin e objektivit tonë të stabilitetit të çmimeve. Megjithatë, shpejtësia e normalizimit u ngadalësua ndjeshëm gjatë vitit, duke u harmonizuar me reduktimin gradual të inflacionit, si dhe me kahun e politikës fiskale dhe forcimin e ndjeshëm të kursit të këmbimit. Sinjalet aktuale janë inkurajuese. Reagimi në kohën dhe në masën e duhur i politikës sonë monetare ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në reduktimin e inflacionit.*

*Bazuar në trendet aktuale, politika monetare duket se po përmbush me sukses misionin e saj: kthimin e shpejtë të inflacionit në objektiv me kosto minimale mbi aktivitetin ekonomik.*

*Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka vijuar punën për mbikëqyrjen dhe rregullimin e kujdesshëm të sektorit bankar, për zhvillimin e tregjeve financiare dhe të sistemeve të pagesave, si dhe për forcimin e rrjetave të sigurisë në sistem. Investimi i vazhduar që kemi bërë në vite ka forcuar rezistencën e këtij sektori ndaj goditjeve dhe i ka mundësuar atij të vijojë të plotësojë kërkesat për fonde të ekonomisë.*

*Në veçanti gjatë vitit të shkuar, sektori financiar shqiptar shënoi edhe tre arritje të rëndësishme: daljen e Shqipërisë nga lista e juridiksioneve nën monitorim të shtuar, njohur ndryshe si "lista gri" e vendeve sa i takon zhvillimit të infrastrukturës*



për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën ndaj terrorizmit; aplikimin në Autoritetin Bankar Evropian për njohjen e ekuivalencës me standardet evropiane të mbikëqyrjes dhe rregullimit bankar, si dhe nisjen e punës për anëtarësimin e Shqipërisë në Tregun Unik të Pagesave në Euro (SEPA), si pjesë integrale e agjendës së procesit të Berlinit.

Të gjitha këto arritje i hapin rrugë zhvillimit sasior e cilësor të gamës së instrumenteve financiare në ekonomi, uljes së kostove dhe rritjes së eficiencës së tyre, duke e afruar më shumë vendin me standardet më të mira bashkëkohore.

Së fundi, nuk mund të le pa përmendur dhe punën dhe rezultatet jo të pakta që kemi arritur në fusha të ndryshme të aktivitetit tonë, si furnizimin e ekonomisë me monedha e kartëmonedha cilësore, administrimin e rezervës valutore, mbështetjen e proceseve të integritetit evropian, rritjen e edukimit financiar të publikut, zgjerimin e dijeve mbi ekonominë dhe sistemin financiar shqiptar, si dhe dialogun e vazhdueshëm me partnerë të brendshëm e të huaj.

Në këtë kontekst, dëshiroj të veçoj dy projekte të rëndësishme të hartuara dhe miratuara nga Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2023: Strategjinë e Gjellbër Afatmesme 2023-2025 për "Administrimin dhe Mbikëqyrjen e Rreziqeve Financiare të Lidhura me Klimën në Sektorin Financiar" në bashkëpunim me Bankën Botërore, si dhe "Strategjinë e Bankës së Shqipërisë për Edukimin dhe Përfshirjen Financiare", e cila synon të promovojë edukimin financiar të publikut dhe të rrisë përfshirjen financiare të tij.

Të dashur lexues,

Puna e Bankës së Shqipërisë mbështetet në një vizion të qartë: përmbushjen e detyrave tona ligjore nëpërmjet adoptimit të praktikave më të mira të fushës së bankingut qendror. Ky vizion dokumentohet në Strategjinë Afatmesme të Bankës së Shqipërisë dhe vihet në zbatim nga një staf i talentuar dhe i përkushtuar.

Jam i bindur se kjo përjasje, koherente dhe konsistente, do të na ndihmojë në përmbushjen e misionit tonë dhe adresimin me sukses të të gjitha sfidave të ardhshme.

Me respekt,

Gent Seiko  
GUVERNATOR



## GJATË VITIT 2023...

- *Ekonomia shqiptare pati një ecuri pozitive gjatë vitit 2023, pavarësisht sfidave të shumta të brendshme e të huaja. Aktiviteti ekonomik në vend u rrit me 3.3% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit, duke mundësuar rritje të punësimit e të pagave dhe rënien në minimumet historike të normës së papunësisë. Paralelisht me to, treguesit kryesorë të stabilitetit ekonomik e financiar të vendit: borxhi privat, borxhi publik dhe ai i huaj, shënuan rënie të ndjeshme dhe mbeten nën kontroll.*
- *Inflacioni erdhi në rënie gjatë vitit 2023, duke zbritur nga niveli 7.4% në fillim të vitit, në nivelin 4% në fund të tij. Kjo ecuri u ndikua nga rënia e inflacionit në tregjet e huaja, mbiçmimi i kursit të këmbimit dhe efekti i kahut normalizues të politikës sonë monetare. Megjithatë, presionet e brendshme inflacioniste mbetën relativisht të forta, në pasqyrim të kërkesës relativisht të lartë për mallra e shërbime dhe të rritjes së shpejtë të pagave e të kostove të prodhimit.*
- *Në përgjigje të inflacionit mbi objektiv, Banka e Shqipërisë rriti dy herë normën bazë të interesit gjatë vitit 2023, duke e çuar atë nga 2.75% në 3.25%. Ky ritëm normalizimi ishte më i ngadaltë se ai i vitit paraardhës, si pasojë e kahut konsolidues të politikës fiskale dhe e forcimit të kursit të këmbimit. Normalizimi i politikës monetare gjatë dy viteve të fundit ndihmoi ankorimin e pritjeve për inflacionin, mundësoi një balancë më të mirë midis kërkesës dhe ofertës, si dhe krijoi premisa për kthimin e inflacionit në objektiv.*
- *Tregjet financiare u shfaqën relativisht të qeta gjatë vitit 2023. Normat ende stimuluese të interesit dhe përfaqja pozitive e bankave ndaj kreditimit nxiti një rritje të shpejtë e të qëndrueshme të kredisë gjatë vitit. Nga ana tjetër, kursi i këmbimit të lekut ndaj euros shënoi një forcim të ndjeshëm, si pasojë e përmirësimit të shpejtë të bilancit të shkëmbimeve tregtare e financiare me jashtë dhe rritjes së ofertës së euros në tregun e brendshëm valutator.*
- *Spektori bankar shqiptar e mbylli vitin 2023 me një rezultat financiar pozitiv, me një nivel të lartë të treguesve të likuiditetit e të kapitalizimit të veprimtarisë, dhe me tregues të përmirësuar të cilësisë së kredisë. Ai shfaqet rezistent ndaj goditjeve dhe me rreziqe të kontrolluara.*
- *Banka e Shqipërisë vijoi progresin në drejtim të plotësimit të mëtejshëm të kuadrit rregullator të mbikëqyrjes bankare, me synim përafrimin e tij me legjislacionin e BE-së dhe dokumentet e Bazelit; të kuadrit rregullator në zbatim të ligjit "Për shërbimet e pagesave"; si dhe të kuadrit të hartimit të statistikave financiare. Gjithashtu, janë miratuar metodologji dhe udhëzime të reja në funksion të fuqizimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe plotësimit të kuadrit të politikës makroprudenciale.*
- *Shqipëria u hoq nga lista e juridiksioneve nën monitorim të shtuar, ose "lista gri", nga FATF në muajin tetor të vitit 2023. Ky vlerësim i rëndësishëm erdhi si rrjedhojë e angazhimit dhe reformave e politikave të ndërmarra për përbushjen e kritereve të nevojshme nga institucionet në Shqipëri përfshi edhe Bankën e Shqipërisë.*
- *Në vitin 2023 nisi puna për anëtarësimin e Shqipërisë në Tregun Unik të Pagesave në Euro (SEPA), pjesë integrale e agjendës së procesit të Berlinit.*



*Ky anëtarësim është një mundësi për të integruar platformat tona të kryerjes së pagesave dhe tregtinë elektronike me tregun evropian.*

- *Infrastruktura e sistemeve të procesimit të pagesave AIPS, AIPS EURO dhe AECH ka gjetur përdorim më të gjerë gjatë vitit 2023. Paralelisht me të, përmirësimet rregullatore dhe infrastrukturore të pagesave kanë sjellë rritjen e përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave.*
- *Banka e Shqipërisë ka zhvilluar Strategjinë e Gjellbër Afatmesme 2023-2025 për "Administrimin dhe Mbikëqyrjen e Rreziqeve Financiare të lidhura me Klimën në Sektorin Financiar" në bashkëpunim me Bankën Botërore (FinSAC).*
- *Këtë vit u hartua "Strategjia e Bankës së Shqipërisë për Edukimin dhe Përfshirjen Financiare", dokumenti i parë institucional që promovon edukimin financiar, në nxitje të përfshirjes financiare, mirëqenies dhe qëndrueshmërisë. Disa nga objektivat kryesorë të kësaj strategjie janë miradministrimi i financave personale dhe huamarrja e shëndetshme, planifikimi dhe kursimi për të ardhmen, si dhe mbrojtja e konsumatorit.*



## KËSHILLI MBIKËQYRËS I BANKËS SË SHQIPËRISË



*Në foto, në rresht të parë, nga e majta në të djathtë:*

*Zj. Suela Popa, Anëtare  
Zj. Natasha Ahmetaj, Anëtare  
Z. Gent Sejko, Kryetar  
Zj. Luljeta Minxhozi, Zëvendëskryetare  
Z. Anastas Angjeli, Anëtar*

*Në rresht të dytë, nga e majta në të djathtë:*

*Z. Artan Hoxha, Anëtar  
Z. Ridvan Bode, Anëtar  
Zj. Edlira Luçi, Anëtare  
Zj. Violeta Staka, Anëtare*



## 1. KËSHILLI MBIKËQYRËS I BANKËS SË SHQIPËRISË

*Këshilli Mbikëqyrës është organi më i lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Këshilli: (i) miraton politikën monetare dhe atë të kursit të këmbimit, si dhe politikën e stabilitetit financiar dhe atë makroprudenciale; (ii) mbikëqyr procesin e buxhetimit, raportimit financiar, kontrolleve të brendshme dhe të auditimit në Bankën e Shqipërisë; (iii) miraton të gjitha aktet normative që nxirren nga institucioni; si dhe (iv) miraton strategjinë afatmesme, emërimin e drejtuesve të departamenteve dhe strukturën organizative të Bankës së Shqipërisë.*

*Këshilli i ushtron kompetencat e veta në mënyrë të pavarur dhe transparente, në përputhje me ligjin organik dhe me rregullat e brendshme procedurale.*

*Monitorimi i procesit të raportimit financiar dhe i sistemit të kontrollit të brendshëm i është deleguar Komitetit të Auditit.*

Sipas programit të miratuar për vitin 2023, Këshilli zhvilloi 15 mbledhje. Tetë prej tyre iu dedikuan politikës monetare dhe katër stabilitetit financiar dhe mbikëqyrjes. Në mbledhjet e tjera u trajtuan: (i) programi vjetor i Këshillit; (ii) raporti vjetor i Bankës së Shqipërisë; dhe (iii) strategjia, buxheti vjetor dhe ai afatmesëm.

Gjatë vitit, Këshilli është informuar në vazhdimësi mbi: (i) politikat e administrimit të institucionit; (ii) ecurinë e administrimit të rezervës valutore; dhe (iii) gjetjet e rekomandimet e auditit të brendshëm dhe të jashtëm mbi efektivitetin dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, administrimit të rrezikut dhe drejtimit të institucionit.

Gjithashtu, Këshilli është njohur me raportin vjetor të mbikëqyrjes, i cili analizon veprimtarinë e sistemit bankar dhe mbikëqyrjen e tij nga Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2022, ofron statistika dhe informacione mbi subjektet e licencuara, si dhe analizon çështje të ecurisë së sistemit bankar.

Në zbatim të detyrimeve si institucion i pavarur kushtetues, Banka e Shqipërisë ka raportuar rregullisht në Kuvend për përmbushjen e rekomandimeve të lëna në rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së saj.

### **KËSHILLI SI ORGANI MË I LARTË VENDIMMARRËS I BANKËS SË SHQIPËRISË**

*Këshilli ka kompetencë miratimit e të gjitha vendimeve, rregulloreve dhe udhëzimeve me zbatim të përgjithshëm që nxirren nga Banka e Shqipërisë.*



Këshilli miratoi 53 vendime, prej të cilave, 39 ishin akte të reja dhe 14 ndryshime aktesh ekzistuese.

Vendimet janë nxjerrë në përmbushje të detyrave ligjore të Këshillit, si: (i) stabiliteti monetar; (ii) licencimi, rregullimi dhe mbikëqyrja e bankave dhe institucioneve të tjera financiare; dhe (iii) ofrimi i infrastrukturës financiare (emisioni i kartëmonedhës dhe monedhës; tregu ndërbankar); dhe (iv) stabiliteti i sistemit financiar.

### **Drejtimi dhe organizimi i brendshëm**

*Ligji për Bankën e Shqipërisë përcakton se Këshilli është përgjegjës për: (i) miratimin e Statutit dhe rregulloreve të brendshme të Bankës së Shqipërisë; (ii) përcaktimin e strukturës organizative; dhe (iii) miratimin e drejtuesve të departamenteve dhe përcaktimin e kushteve të punësimit në Bankën e Shqipërisë.*

Këshilli miratoi Strategjinë Afatmesme të Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë 2024-2026, në nëntor, duke ruajtur të pandryshuar misionin, vizionin dhe vlerat e Bankës. Strategjia afatmesme ishte një përditësim i strategjisë ekzistuese, përmes së cilës u zgjat afati i zbatimit të këtij dokumenti përtej vitit 2025 dhe u përcaktuan objektivat për periudhën afatmesme në vijim. Buxheti i Bankës së Shqipërisë hartohet në përputhje me objektivat e strategjisë.

Në maj, u miratua Plani i Veprimit “Për administrimin dhe mbikëqyrjen e rreziqeve financiare të lidhura me klimën në sektorin financiar gjatë 2023-2025” (shih, Hapësirën Informuese 4). Detyrat e përcaktuara në këtë dokument lidhen me disa nga drejtimet kryesore të veprimtarisë së institucionit, si: mbikëqyrja bankare, stabiliteti financiar, politika monetare, statistikat financiare dhe kërkimi shkencor.

### **Buxheti**

*Ligji “Për Bankën e Shqipërisë” e ngarkon gjithashtu Këshillin me miratimin e buxhetit dhe të politikave të administrimit dhe procedurave të përdorimit të mjeteve financiare për realizimin e veprimtarisë operative të institucionit.*

Këshilli miratoi buxhetin vjetor 2024 dhe buxhetin orientues afatmesëm për vitet 2025-2026. Buxheti u hartua në përputhje me objektivat e Strategjisë Afatmesme të Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë, si dhe në parashikimet e departamenteve në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën afatmesme.

Buxheti synon zhvillimin normal të veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë dhe përmbushjen, në mënyrë të pavarur, të detyrave të përcaktuara në ligjin organik, si: (i) menaxhimin e kujdesshëm të rezervës valutore; (ii) ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së parasë në qarkullim; (iii) forcimin e rolit katalizator të sistemeve të pagesave; dhe (iv) sigurimin e burimeve njerëzore efektive dhe konkurruese.





Shpenzimet kapitale dhe projektet e përfshira në buxhet u miratuan paraprakisht në Komitetin e Shpenzimeve Kapitale.

### **KËSHILLI SI ORGANI MË I LARTË MBIKËQYRËS I BANKËS SË SHQIPËRISË**

Këshilli është informuar rregullisht nga hallkat e kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm për sigurimin e respektimit korrekt të ligjit dhe të akteve të tjera që rregullojnë veprimtarinë e përditshme të institucionit.

#### **Kontrolli i brendshëm**

Kontrolli është një veprimtari e pavarur nga administrimi që ofron vlerësim, raportim dhe siguri objektive, dhe përfshin funksionet e administrimit të rrezikut, përputhshmërisë dhe auditimit të brendshëm.

#### **1. Kontrolli mbi administrimin**

Çdo muaj, Këshilli Mbikëqyrës merr informacion nga administratorët lidhur me zhvillimet ekonomike, financiare dhe monetare, në përmbushje të detyrimeve ligjore.

Këshilli është informuar gjithashtu mbi politikat e administrimit të institucionit dhe përdorimin e mjeteve financiare për realizimin e veprimtarisë operative të Bankës së Shqipërisë. Guvernatori përgjigjet përpara Këshillit për zbatimin e vendimeve të miratuara, si dhe për drejtimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen mbi administrimin dhe operacionet e institucionit.

Inspektori i Përgjithshëm ka paraqitur në Këshill informacione tremujore mbi detyrat e kryera nga Departamenti i Kontrollit dhe mbi rezultatet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në Bankën e Shqipërisë.

#### **2. Veprimtaria e Komitetit të Auditit**

Komiteti ka mandat të ndihmojë në përforcimin e linjave të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm, në funksion të përmirësimit të vendimmarrjes së Këshillit Mbikëqyrës dhe administratorëve të Bankës.

Në funksion të rritjes së eficiencës dhe thellimit në fusha specifike, funksionet e auditimit të brendshëm i janë deleguar Komitetit të Auditit, i cili ushtron detyrat e tij në mbështetje të linjave të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm. Komiteti është përgjegjës për: (i) procesin e raportimit financiar; (ii) sistemin e kontrollit të brendshëm; (iii) auditimin e brendshëm dhe të jashtëm; si dhe (iv) përputhshmërinë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Komiteti përbëhet nga tre anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës, përkatësisht: zj. Suela Popa (Kryetar), z. Ridvan Bode dhe zj. Edlira Luçi. Anëtarët emërohen nga Këshilli për një periudhë katërvjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Administratorët e Bankës së Shqipërisë nuk mund të jenë anëtarë të Komitetit. Kryetari i Komitetit zgjidhet prej anëtarëve.



Gjatë vitit 2023, Komiteti zhvilloi 9 mbledhje, ku trajtoi: (i) planifikimin e punës dhe analizimin e veprimtarisë së Komitetit; (ii) veprimtarinë e auditimit të brendshëm; (iii) rezultatin financiar të Bankës së Shqipërisë; (iv) pasqyrat financiare dhe opinionin e auditorit të jashtëm; (v) sigurinë kibernetike në Bankën e Shqipërisë dhe në sektorin bankar, si dhe ecurinë e programit të vijueshmërisë së veprimtarisë; (vi) letrën për drejtimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022; (vii) buxhetimin vjetor e afatmesëm dhe realizimin e buxhetit; dhe (viii) veprimtarinë e administrimit të rrezikut operacional.

Komiteti ka informuar rregullisht Këshillin mbi veprimtarinë e tij dhe zbatimin e përgjegjësiave të veta.

### 3. Auditimi i brendshëm

*Inspektori i Përgjithshëm dhe Departamenti i Kontrollit, në mënyrë periodike dhe të pavarur: (i) vlerësojnë llogaritë dhe regjistrat kontabël, procedurat e administrimit dhe operacionet e Bankës së Shqipërisë, me qëllim sigurimin e zbatimit të ligjeve dhe të akteve nënligjore; dhe (ii) ofrojnë siguri të arsyeshme për efektivitetin e sistemit të kontrollit, administrimit të rrezikut dhe proceseve të drejtimit, në funksion të përmbushjes së objektivave institucionale.*

Inspektori i Përgjithshëm ka raportuar rregullisht në Këshill për realizimin e planit vjetor të punës së Departamentit të Kontrollit dhe rezultatet e angazhimeve të auditimit. Plani mbështetet në standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm dhe në vlerësimin e përditësuar të rrezikut për funksionet e identifikuar në universin e rishikuar të auditimit.

### 4. Administrimi i rrezikut operacional dhe vijueshmëria e veprimtarisë

Këshilli ka miratuar politikën për administrimin dhe monitorimin e rrezikut operacional në Bankën e Shqipërisë dhe nivelin e tolerancës ndaj këtij rreziku. Përgjegjësia për trajtimin e rrezikut operacional, në përputhje me kuadrin e mësipërm, u përket administratorëve.

Komiteti i Auditit luan një rol mbështetës, duke diskutuar rregullisht me Inspektorin e Përgjithshëm dhe me auditorin e jashtëm, mbi rreziqet e identifikuar dhe veprimet për trajtimin e tyre, si dhe duke i rekomanduar Këshillit masa për përmirësimin e sistemeve të kontrollit.

Gjatë vitit 2023, Këshilli i ka kushtuar një vëmendje të veçantë në këtë drejtim, rreziqeve të sigurisë kibernetike për vijueshmërinë e veprimtarisë së përditshme të Bankës së Shqipërisë dhe për funksionimin e sistemit bankar dhe financiar në vend.

Për këtë qëllim, Këshilli është informuar rregullisht nga: (i) Inspektori i Përgjithshëm dhe Njësia e Administrimit të Rrezikut Operacional mbi ecurinë e zbatimit të programit për menaxhimin e vijueshmërisë së veprimtarisë; (ii) Komiteti i Sigurisë së Informacionit, në lidhje me zbatimin e politikës së sigurisë së informacionit;



dhe (iii) funksioni mbikëqyrës mbi adresimin e rrezikut kibernetik nga bankat dhe institucionet e tjera financiare të mbikëqyrura nga Banka e Shqipërisë.

### **Kontrolli i jashtëm**

*Ligji organik parashikon se llogaritë dhe regjistrat e Bankës së Shqipërisë mund të kontrollohen nga auditorë të jashtëm të institucioneve audituese të njohura në arenën ndërkombëtare që caktohen nga Këshilli. Auditori i jashtëm shpreh opinionin e tij nëse raportet e përgatitura nga Banka e Shqipërisë paraqesin, në mënyrë të plotë dhe të drejtë, situatën financiare të institucionit, në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të pranuarra gjerësisht.*

Pasqyrat financiare të Bankës së Shqipërisë auditohen për të ofruar siguri të arsyeshme se ato nuk kanë pasaktësi, si rezultat i gabimeve apo mashtrimit. Kjo i mundëson auditorit të jashtëm një rol kyç në ruajtjen e besimit të tregjeve financiare dhe publikut në raportimin financiar të Bankës së Shqipërisë.

Komiteti i Auditit shqyrton pasqyrat financiare të Bankës dhe vlerëson nëse ato janë hartuar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe në përputhje me opinionin e auditorit të jashtëm.

Përpara dorëzimit të opinionit mbi pasqyrat financiare, Komiteti takohet me auditorin e jashtëm, pa praninë e administratorëve, ku diskutohet ecuria e procesit të auditimit.

### **LLOGARIDHËNIA DHE TRANSPARENCA**

*Ligji organik i jep Këshillit, kompetencën për të miratuar të gjitha raportet dhe rekomandimet që Banka e Shqipërisë i paraqet Kuvendit ose Këshillit të Ministrave, si dhe të miratojë raportet vjetore dhe raportet financiare të institucionit. Pas miratimit nga Këshilli, raportet publikohen.*

### **Miratimi i Raportit Vjetor**

Në muajin mars, Këshilli miratoi dhe dërgoi në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave, Raportin Vjetor 2022, i cili përshkruan gjendjen ekonomiko-financiare të vendit dhe veprimtarinë e institucionit gjatë vitit.

Pjesë përbërëse e Raportit Vjetor janë edhe pasqyrat financiare të audituara nga auditori i jashtëm (Ernst & Young Albania). Sipas opinionit të Ernst & Young, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Bankës së Shqipërisë më 31 dhjetor 2022, të performancës së saj financiare dhe të flukseve të saj të parasë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Në zbatim të kërkesave të Manualit të Monitorimit Vjetor dhe Periodik, raporti u shoqërua nga një informacion mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit për vitin 2021, si dhe nga një informacion i detajuar mbi zbatimin e rregullave të përcaktuara në manual për raportimin e institucioneve të pavarura kushtetuese, në përgjithësi, dhe të Bankës së Shqipërisë, në veçanti.



### **Raportime të tjera për Kuvendin dhe Këshillin e Ministrave**

*Sipas ligjit organik, Banka e Shqipërisë publikon: (i) çdo tre muaj, një opinion të detajuar mbi gjendjen e ekonomisë, dhe (ii) çdo gjashtë muaj, një deklaratë për kërcënimet mbi stabilitetin e sistemit financiar.*

Këshilli ka përmbushur rregullisht detyrimet e llogaridhënies së Bankës së Shqipërisë ndaj Kuvendit dhe detyrimet e transparencës ndaj publikut, sistemit financiar dhe mediave përmes përgatitjes dhe publikimit të raporteve tre dhe gjashtëmuajore.

Në muajt shkurt, maj, gusht dhe nëntor, Këshilli ka miratuar raportet tremujore të politikës monetare që përbëjnë instrumentin kryesor të llogaridhënies dhe transparencës në fushën e politikës monetare. Këto raporte paraqesin zhvillimet e fundit makroekonomike dhe faktorët që ndikojnë në ecurinë e çmimeve të konsumit në vend.

Në muajt prill dhe shtator, Këshilli ka miratuar deklaratat dhe raportet gjashtëmuajore të stabilitetit financiar, që përmbajnë vlerësimin e përgjithshëm të rreziqeve dhe kërcënimeve ndaj sistemit financiar shqiptar dhe infrastrukturës së tij, si dhe vlerësimin për aftësinë e sistemit për t'i bërë ballë këtyre rreziqeve.

Raportet i janë dërguar Kuvendit, Këshillit të Ministrave dhe institucioneve të tjera qendrore.



## 2. VEPRIMTARIA E BANKËS SË SHQIPËRISË

### 2.1. POLITIKA MONETARE

*Në përputhje me Ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”, politika jonë monetare formulohet dhe zbatohet në funksion të arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Dokumenti i Politikës Monetare, i cili detajon objektivat, shpjegon parimet dhe formaton strategjinë e politikës monetare, e përkufizon stabilitetin e çmimeve si një rritje vjetore të çmimeve të konsumit prej 3% në afatin e mesëm. Nëpërmjet përmbushjes së këtij objektivi, Banka e Shqipërisë kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë, në promovimin e stabilitetit financiar dhe në rritjen e mirëqenies së shoqërisë shqiptare.*

*Vendimet e politikës monetare merren nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Ato bazohen në një kuadër bashkëkohor analize e parashikimi, i cili shfrytëzon të gjithë gamën e informacionit të disponuar, mbështetet në modele bashkëkohore ekonometrike, si dhe në praktikatat më të mira të bankingut qendror.*

*Ekonomia shqiptare pati një ecuri pozitive gjatë vitit 2023. Përballë një konteksti të huaj ende sfidues, aktiviteti ekonomik, punësimi dhe pagat vijuan të rriten, ndërsa inflacioni erdhi në rënie. Paralelisht me to, treguesit kryesorë të shëndetit ekonomik dhe financiar të ekonomisë shënuan përmirësim.*

*Politika monetare luajti një rol të rëndësishëm në këtë ecuri. Normalizimi i kujdesshëm i qëndrimit të saj gjatë dy viteve të fundit kontribuoi në uljen e inflacionit, në reduktimin e pasigurive dhe në krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm monetar. Në veçanti, reduktimi progresiv i inflacionit u arrit pa cenuar trendin pozitiv të rritjes ekonomike dhe pa dëmtuar stabilitetin financiar të vendit.*

#### 2.1.1 POLITIKA MONETARE GJATË VITIT 2023

Ekonomia botërore shënoi një pikë kthese në luftën e saj ndaj inflacionit gjatë vitit 2023, por sfidat ndaj rritjes dhe stabilitetit mbeten prezente. Inflacioni ra nga nivelet e larta të një viti më parë, i ndikuar nga stabilizimi i çmimeve të lëndëve të para dhe nga shtrëngimi i sinkronizuar i politikës monetare në rang global. Nga ana tjetër, rritja e pasigurisë dhe e kostove të financimit, pati ndikim frenues në aktivitetin ekonomik dhe në veçanti në atë të Eurozonës. Megjithatë, ngadalësimi i ekonomisë së Eurozonës, partnerit tonë kryesor ekonomik dhe financiar, ka pasur – deri tani – pasoja minimale në tregjet e saj të punës dhe në treguesit e stabilitetit financiar.



Viti 2023 ishte një vit pozitiv për ekonominë shqiptare. Vëllimi i aktivitetit ekonomik erdhi në rritje, inflacioni i çmimeve të konsumit shënoi rënie të ndjeshme, ndërsa tregu i punës dhe treguesit kryesorë të shëndetit ekonomik e financiar të vendit u përmirësuan.

**Inflacioni shënoi rënie progresive gjatë vitit 2023, duke zbritur nga niveli 7.4% në fillim të vitit në nivelin 4.0% në fund të tij.** Kjo rënie pasqyroj reduktimin e çmimeve të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare, normalizimin e qëndrimit të politikës sonë monetare dhe forcimin e kursit të këmbimit. Rënia e inflacionit u përqendrua fillimisht në çmimet e ushqimeve dhe të naftës, por ajo gjeti në vijim një bazë relativisht të gjerë në kategoritë e artikujve të shportës së konsumit. Megjithatë, edhe pse në reduktim, inflacioni shfaqti një qëndrueshmëri në rritje gjatë gjysmës së dytë të vitit, duke ilustruar si kërkesën e lartë për mallra e shërbime, ashtu dhe pasojat e rritjes së pagave dhe të kostove të prodhimit.

**Aktiviteti ekonomik, punësimi dhe pagat shënuan rritje gjatë vitit 2023.** Sipas të dhënave të INSTAT-it, prodhimi i brendshëm bruto (PBB) u rrit me 3.3% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit, punësimi u rrit me 2.8%, ndërsa shkalla e papunësisë zbriti në minimumin e ri historik prej 10.5% gjatë tremujorit të tretë. Rritja ekonomike u mbështet kryesisht nga zgjerimi i aktivitetit në sektorin e shërbimeve - si pasojë e rritjes së shpejtë të të ardhurave nga turizmi - dhe në atë të ndërtimit. Kjo ecuri pasqyroj rritjen e kërkesës së huaj për shërbime, ndërkohë që rritja e konsumit dhe e investimeve ishte disi më e ngadaltë, ndërsa politika fiskale pati një ndikim neutral. Në përputhje me profilin e aktivitetit ekonomik, rritja e punësimit gjatë kësaj periudhe u përqendrua kryesisht në sektorin e shërbimeve.

**Rritja e kërkesës për punë nga bizneset dhe mungesat në rritje në tregun e punës, u pasqyruan në një rritje të shpejtë dhe me bazë të gjerë të pagave.** Gjatë tre tremujorëve të parë të vitit, paga mesatare në sektorin privat u rrit me 13%. Kjo rritje vijoi të mbështesë të ardhurat dhe konsumin e familjeve, por ajo u pasqyrua në rritjen e shpejtë të kostove të prodhimit dhe mbajtji të larta presionet e brendshme inflacioniste.

**Treguesit kryesorë të shëndetit ekonomik e financiar të vendit erdhën në përmirësim, ndërsa primet e rrezikut të vendit u reduktuan.**<sup>1</sup> Në veçanti:

- **Pozicioni i huaj i vendit shënoi përmirësim të ndjeshëm,** të pasqyruar në regjistrimin – për herë të parë në historinë post-tranzicion – të një suficiti në llogarinë korrente. Ky suficit pasqyroj rritjen e shpejtë të të ardhurave nga turizmi gjatë tre tremujorëve të parë të vitit. Ai u vlerësua në nivelin 0.2% të PBB-së, duke shënuar një përmirësim prej rreth 6 pikësh përqindjeje ndaj së njëjtës periudhë të një viti më parë. Paralelisht me të, borxhi i huaj i vendit zbriti poshtë nivelit 50% të PBB-

<sup>1</sup> Në muajin shtator, agjencia Standard & Poor's (S&P) rikonfirmoi vlerësimin e rrezikut të borxhit sovran të vendit, në "B+", por rishikoi për lart perspektivën e këtij treguesi, nga "e qëndrueshme" në "pozitive".



së, ndërkohë që niveli i rezervave valutore të Bankës së Shqipërisë regjistroi një rekord historik prej 5.8 miliardë eurosh, duke përmirësuar ndjeshëm aftësinë paguese të vendit.

- **Pozicioni fiskal i vendit shënoi, po ashtu, përmirësim,** të pasqyruar në reduktimin e njëkohshëm të deficitit buxhetor dhe të borxhit publik, të cilët zbritën në nivelet minimale të më shumë se një dekadë, respektivisht në 1.4% dhe 59.2% të PBB-së. Ky përmirësim reflektoi kursin konsolidues të politikës fiskale, vijimin e trendit rritës të ekonomisë, si dhe mbiçmimin e kursit të këmbimit. Reduktimi i borxhit publik rrit hapësirat fiskale për reagim ndaj goditjeve të ardhshme, si dhe ndihmon në uljen e primeve të rrezikut dhe të kostove të financimit të të gjithë operatorëve të ekonomisë shqiptare.
- **Së fundi, sektori bankar – i cili ka qenë dhe mbetet segmenti dominues i tregut tonë financiar – vijoi të shfaqë parametra solidë të aktivitetit.** Ky sektor ruajti parametra të shëndoshë likuiditeti, përmirësoi më tej treguesit e kapitalizimit dhe të përfitueshmërisë, si dhe vijoi progresin në drejtim të përmirësimit të cilësisë së portofolit të kredive, duke e zbritur treguesin e kredive me probleme në nivelin 4.7%. Këto trende pozitive zhvillimi i mundësojnë sektorit bankar të furnizojë – me eficiencë dhe në vazhdimësi – ekonominë shqiptare me fonde financiare dhe instrumente pagese e kursimesh.

**Rezistenca e lartë e ekonomisë ndaj goditjeve të viteve të fundit u mbështet nga një sërë faktorësh.** Së pari, bilancet solide të sektorit privat, nivelet e larta të besimit, tregu i fortë i punës dhe rritja e kredisë bankare, mundësuan absorbimin e goditjeve dhe nxitën rritjen e konsumit e të investimeve, si të familjeve ashtu edhe të bizneseve. Së dyti, rritja e interesit ndërkombëtar për Shqipërinë si destinacion turistik mbështeti rritjen e ekonomisë dhe forcoi perspektivën e saj në të ardhmen. Së treti, politikat fiskale, monetare e financiare, patën një reagim të koordinuar, në kahun, kohën dhe masën e duhur, ndaj goditjeve.

**Politika monetare vijoi kursin normalizues gjatë vitit 2023, duke synuar kthimin e inflacionit në objektivin 3%, në një kohë sa më të shpejtë dhe me kosto sa më të ulët mbi aktivitetin ekonomik.** Ky normalizim u realizua nëpërmjet rritjes së normës bazë të interesit dhe vijimit të orientimit të tregut mbi kahun e pritshëm të saj në të ardhmen. Norma bazë e interesit u rrit dy herë gjatë vitit, nga niveli 2.75% në nivelin 3.25%. Paralelisht me të, komunikimi mbi kahun e politikës monetare në të ardhmen ruajti tiparet e një viti më parë, duke e kushtëzuar shpejtësinë dhe shkallën e normalizimit me informacionin e ri dhe me ecurinë e faktorëve me ndikim parësor në inflacion.

**Banka e Shqipërisë e ngadalësoi ritmin e normalizimit të qëndrimit të politikës monetare gjatë vitit 2023, duke e rritur normën bazë të interesit me 0.5 pikë përqindjeje nga rritja me 2.75 pikë gjatë vitit 2022.** Ky ngadalësim u diktua nga kahu konsolidues i politikës fiskale dhe forcimi i kursit të këmbimit. Në veçanti, konsolidimi fiskal ndihmoi në frenimin e presioneve të brendshme, ndërsa mbiçmimi i shpejtë i kursit të këmbimit ndihmoi në zbutjen e presioneve




të huaja inflacioniste, duke krijuar hapësira për një shtërngim më të moderuar të kushteve të brendshme monetare.

**Transmetimi i vendimeve të politikës monetare, në tregjet financiare dhe në ekonomi, ka qenë i kënaqshëm.** Rritja e normës bazë gjatë dy viteve të fundit ka sjellë një rritje të përgjithshme të nivelit të normave të interesit në vend, ndonëse kushtet e brendshme financiare mbeten ende stimuluese për zgjerimin e konsumit dhe të investimeve. Po ashtu, normalizimi i qëndrimit të politikës monetare ka ndihmuar rënien e primeve të rrezikut në tregun financiar dhe ka mundësuar një ambient të brendshëm financiar të qetë.

**Kredia për sektorin privat vijoi të rritet, duke mbuluar nevojat për fonde të bizneseve dhe familjeve.** Paralelisht me të, ecuria e aktivitetit kreditues gjatë vitit 2023 shfaqti disa tipare pozitive. Së pari, rritja e kredisë ishte e diversifikuar, duke financuar nevojat e individëve dhe të bizneseve për konsum, kapital qarkullues dhe investime. Së dyti, rritja e kredisë në monedhën kombëtare ishte më e shpejtë, çka solli rritjen e peshës së portofolit në lekë në kredinë totale, duke zgjeruar hapësirën e veprimit të politikës monetare dhe duke zvogëluar rreziqet ndaj stabilitetit financiar. Së treti, cilësia e kredisë u përmirësua, sikurse ilustron nga rënia e treguesit të kredive me probleme në nivelin më të ulët prej vitit 2008. Këto zhvillime sugjerojnë rritje të qëndrueshme dhe të shëndetshme të kredisë edhe në të ardhmen.

**Normalizimi i qëndrimit të politikës monetare ndihmoi në rënien e inflacionit gjatë dy viteve të fundit, pa cenuar – në të njëjtën kohë – trendin pozitiv të rritjes ekonomike.** Kontributi pozitiv i politikës monetare u materializua nëpërmjet tre kanaleve. Së pari, sinjalizimi i vullnetit dhe marrja e masave konkrete për respektimin e objektivit të stabilitetit të çmimeve, ndihmoi ankorimin e pritjeve për inflacionin dhe reduktimin e pasigurive të agjentëve ekonomikë. Së dyti, rritja e kujdesshme e kostove të financimit solli një ecuri më të balancuar të

Grafik 1. Ecuria e inflacionit , atij bazë e pritjeve afatmesme (majtas) dhe norma bazë (djathtas)



Burimi: INSTAT dhe BSH.





kërkesës dhe ofertës në ekonomi, duke mundësuar frenimin e presioneve të brendshme inflacioniste. Së treti, normalizimi i qëndrimit të politikës monetare ndihmoi në funksionimin e qetë të tregjeve financiare, duke mbajtur të ulëta primet e rrezikut në to.

**Parashikimet për të ardhmen mbeten pozitive.** Ekonomia shqiptare parashikohet të vijojë të rritet gjatë viteve në vijim, ndërsa inflacioni të kthehet në objektivin tonë prej 3% gjatë vitit 2024. Ky parashikim faktorizon pritjet për uljen e mëtejshme të inflacionit në partnerët tanë tregtarë, për një ecuri më të balancuar të kërkesës dhe ofertës në ekonomi, si dhe për qëndrueshmërinë e kursit të këmbimit.

**Banka e Shqipërisë do të vijojë të mbetet e përkushtuar ndaj respektimit të objektivit të saj të stabilitetit të çmimeve, duke zbatuar një politikë monetare të përshtatshme dhe të kujdesshme.**

\*\*\*

Viti 2023 ka qenë një vit tjetër sfidues për hartimin dhe zbatimin e politikës monetare. Nivelet e larta të inflacionit, kompleksiteti i faktorëve ndikues dhe rreziqet e pasiguritë e shtuara në mjedisin e jashtëm, kanë kërkuar kalibrimin e kujdesshëm të qëndrimit të politikës monetare. Megjithatë, investimi i vazhdueshëm i Bankës së Shqipërisë për të përmirësuar analizën dhe parashikimet e saj, për të avancuar agjendën kërkimore, si dhe për të përmirësuar mekanizmin e transmetimit të politikës monetare, kanë qenë elementet kritike në përmbushjen e misionit tonë.

**Duke reflektuar mbi rezultatet e arritura dhe mësimet e nxjerra nga përballja me goditjet e viteve të fundit, si dhe duke synuar adoptimin e praktikave më të mira ndërkombëtare, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të punojë në drejtim të:**

- *përmirësimit dhe zgjerimit të modeleve të parashikimit dhe analizës së politikës monetare, për të kuptuar më mirë zhvillimet aktuale dhe për të parashikuar më saktë ecurinë e ardhshme të tyre;*
- *nxitjes së zhvillimit të tregjeve të brendshme financiare dhe konvergjencës graduale të tyre me standardet e BE-së gjatë periudhës së negociatave;*
- *rritjes së koordinimit me politikat fiskale dhe makroprudenciale, në interes të rritjes së sinergjisë së politikave të brendshme ekonomike dhe të mbështetjes së procesit të integritimit evropian;*
- *rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, duke komunikuar vendimet qartë dhe në kohë.*



## 2.1.2 ECURIA E AKTIVITETIT EKONOMIK

*Aktiviteti ekonomik në vend ka pasur një trajektore pozitive gjatë vitit 2023, duke u shfaqur rezistent ndaj goditjeve të viteve të fundit. Vëllimi i aktivitetit ekonomik ka ardhur në rritje, i ushqyer nga zgjerimi i kërkesës së brendshme dhe të huaj për mallra e shërbime. Kjo dinamikë ka pasqyruar përmirësimin e besimit në ekonomi, bilancet e shëndosha financiare të sektorit privat, ambientin ende stimulues financiar, si dhe rritjen e shpejtë të kërkesës për shërbime të turizmit.*

*Megjithatë, rritja ekonomike nuk ka pasur një bazë të gjerë sektoriale. Ajo është mbështetur nga zgjerimi i aktivitetit në sektorin e shërbimeve dhe në atë të ndërtimit, ndërkohë që sektori i bujqësisë nuk ka pasur rritje dhe sektori i industrisë ka shfaqur rënie.*


*Në vlerësimin tonë, ekonomia shqiptare ndodhet në një fazë pozitive të ciklit të biznesit, e cila pasqyrohet si në mungesat e vëna re në tregun e punës ashtu edhe në presionet ende të larta inflacioniste që vijnë nga ekonomia e brendshme.*

Sipas të dhënave të INSTAT-it, prodhimi i brendshëm bruto në vend u zgjerua me 3.3% gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2023<sup>2</sup>. Në linjë me pritjet, ritmi i rritjes ekonomike shënoi ngadalësim nga dy vitet paraardhëse, duke pasqyruar efektet e bazës së lartë krahasuese dhe duke iu afruar ritmit potencial të rritjes. Në aspektin e kërkesës, zgjerimi i aktivitetit ekonomik pasqyroi rritjen e njëkohshme të shpenzimeve familjare, të investimeve të sektorit privat dhe të kërkesës së huaj për shërbime turizmi, ndërkohë që politika fiskale pati një natyrë konsoliduese dhe eksporti i mallrave shënoi rënie.

Në aspektin sektorial, rritja ekonomike pasqyroi zgjerimin e aktivitetit në sektorin e shërbimeve dhe të ndërtimit, ndërkohë që sektori i bujqësisë ruajti nivele të krahasueshme aktiviteti me vitin paraardhës dhe sektori i industrisë shënoi rënie.

Rritja ekonomike u nxit kryesisht nga sektori i shërbimeve, i cili u zgjerua me 5.4% dhe kontribuoi me rreth 2.4 pikë përqindje në rritjen ekonomike të 9-mujorit të parë. Në veçanti, zgjerimi i shpejtë i turizmit gjatë vitit pati një ndikim pozitiv në rritje, të përqendruar gjatë tremujorit të tretë dhe të pasqyruar në rritjen e aktivitetit në degën "Akomodim dhe shërbim ushqimor". Bazuar në ecurinë pozitive të treguesve indirektë, efektet nga turizmi janë shtrirë edhe gjatë tremujorit të katërt të vitit 2023, për shkak

Grafik 2. Ecuria e aktivitetit ekonomik sipas sektorëve



Burimi: INSTAT dhe BSH.

<sup>2</sup> Informacioni i publikuar nga INSTAT për produktin e brendshëm bruto sipas metodës së prodhimit dhe të shpenzimeve mbulon zhvillimet deri në tremujorin e tretë të vitit 2023, të publikuar në datën 22 dhjetor 2023.



të zgjatjes në kohë dhe të diversifikimit të aktiviteteve turistike. Paralelisht me të, edhe degët e “Administratës publike, mbrojtjes, arsimit, shëndetësisë” dhe “Pasurive të paluajtshme”, kanë pasur kontribute pozitive në rritjen e sektorit të shërbimeve gjatë vitit 2023.

**Sektori i prodhimit shënoi një rritje prej 1.7% me një kontribut prej 0.7 pikë përqindje në rritjen ekonomike të 9-mujorit të parë të vitit 2023, kundrejt 1.7 pikë përqindje një vit më parë.** Brenda këtij sektori, dega e “Ndërtimit” ka gjeneruar kontributin kryesor në rritje, por ajo ka vijuar të shfaqë luhatje të normave të rritjes gjatë tremujorëve. Nga ana tjetër, prodhimi industrial u tkurr me 0.5%, duke pasqyruar si rënien me 4.7% të aktivitetit në degën e industrisë përpunuese ashtu edhe rënien me 17.1% të aktivitetit në degën e industrisë nxjerrëse. Kjo ecuri pasqyron kërkesën e dobët në tregun e huaj për mallrat tona me destinacion eksporti, problemet specifike të zhvillimit të degëve të caktuara, si dhe humbjen e konkurrencës që ato kanë pasur si pasojë e rritjes së kostove të prodhimit dhe e forcimit të kursit të këmbimit.

Tabelë 1. Kontributet sektoriale në rritjen ekonomike (në pikë përqindje)

	2018	2019	2020	2021	2022	2023		
						T1	T2	T3
Bujqësia	0.2	0.1	0.2	0.3	0.0	0.1	0.0	-0.2
Industria, energjia, uji	1.9	0.4	-1.1	1.3	0.7	0.4	-0.1	-0.3
Ndërtimi	0.2	-0.2	0.1	1.7	1.1	0.4	1.3	0.5
Shërbimet	1.2	1.7	-1.9	3.9	2.8	2.4	2.0	3.1
Taksat neto	0.4	0.0	-0.7	1.7	0.3	-0.4	0.2	0.4
Rritja reale	4.0	2.1	-3.3	8.9	4.9	2.9	3.4	3.5

Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.


### RRITJA E KËRKESËS SË BRENDSHME ISHTE ME BAZË TË GJERË

Kërkesa e brendshme u zgjerua mesatarisht me 4.4% gjatë nëntë muajve të parë të vitit. Zgjerimi i saj rezultoi me bazë të gjerë: konsumi privat mbeti kontribuuesi kryesor, me rreth 2.2 pikë përqindjeje, konsumi publik kontribuoi me 0.8 pikë përqindjeje, ndërsa investimet kontribuuan me rreth 1.4 pikë përqindjeje.


### KONSUMI PRIVAT U RRIT ME 3.2% GJATË TRE TREMUJORËVE TË PARË TË VITIT 2023

Zgjerimi i konsumit privat vijon të mbetet kontribuuesi kryesor në rritjen e kërkesës agregate. Në këndvështrimin makroekonomik, zgjerimi i tij vijon të ushqehet nga rritja e të ardhurave të disponueshme, si pasojë e rritjes së shpejtë të punësimit e të pagave, nga besimi i përmirësuar konsumator, si dhe nga ambienti financiar ende akomodues, i cili ka sjellë një rritje të kredisë konsumatore. Paralelisht me to,

Grafik 3. Ndryshimi vjetor i kërkesës së brendshme sipas komponentëve




Burimi: INSTAT dhe BSH.



rënia progresive e inflacionit ka sjellë reduktimin e pasigurisë dhe ka ndihmuar në rritjen e fuqisë blerëse të konsumatorëve.

### INVESTIMET U RRI TËN ME 6.7% GJATË TRE TREMUJORËVE TË PARË TË VITIT 2023

Vëllimi i investimeve në ekonomi vijoi të zgjerohet gjatë vitit 2023. Sipas të dhënave indirekte, ky zgjerim është mbështetur kryesisht nga zgjerimi i investimeve private, ndërkohë që investimet publike kanë pasur një kontribut më të ulët, por gjithsesi pozitiv, në rritje. Rritja e investimeve private është nxitur nga shkalla e lartë e shfrytëzimit të kapaciteteve, e cila i ka nxitur bizneset të rrisin investimet për t'i shërbyer kërkesës së shtuar për mallra dhe, veçanërisht, për shërbime. Paralelisht me të, rritja e investimeve është favorizuar nga përmirësimi i besimit të bizneseve dhe gjendja e mirë e bilanceve të tyre, si dhe është akomoduar nga mbështetja në rritje me kredi bankare.





### DEFICITI REAL TREGTAR U ZVOGËLUA ME 34.7% GJATË TRE TREMUJORËVE TË PARË TË VITIT 2023

Përmirësimi i bilancit të eksporteve neto dha një kontribut pozitiv në rritjen ekonomike të tre tremujorëve të parë të vitit, të vlerësuar rreth nivelit mesatar prej 2.6 pikësh përqindje. Deficiti tregtar në mallra e shërbime u ngushtua me 34.7% në terma realë gjatë kësaj periudhe. Në veçanti, bilanci i shkëmbimeve tregtare me jashtë në mallra e shërbime në tremujorin e tretë të vitit kaloi – për herë të parë në historinë e tre dekadave të fundit – në suficit. Përmirësimi i tij pasqyroi zgjerimin me 8.7% të eksporteve totale reale, të nxitura nga rritja me 20.4% e eksporteve të shërbimeve, ndërkohë që eksporti i mallrave u pakësua me 20.4% në terma realë. Nga ana tjetër, importet e mallrave e shërbimeve u rritën me 2.1% në terma realë, duke pasqyruar zgjerimin me 20.7% të importit të shërbimeve dhe tkurrjen me 5.4% të importit të mallrave.



**Në terma nominalë, eksporti dhe importi i mallrave shënoi rënie gjatë vitit 2023.** Kjo ecuri u ndikua nga ngadalësimi i vëllimit të tregtisë ndërkombëtare, nga rënia e çmimeve të produkteve bazë dhe energjetike, nga probleme specifike të sektorit tonë të eksportit, si dhe nga efekti i kursit të këmbimit.

**Eksportet e mallrave** u pakësuan me 9.5% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit.<sup>3</sup> Rënia e eksportit të mallrave kishte një bazë të gjerë, me përjashtim të kategorisë “Ushqime, pije, duhan”, eksportet e të cilave shënuan rritje. Kontributet më të thella negative erdhën nga kategoritë “Materiale të ndërtimit dhe metaleve”, “Tekstile dhe veshje”, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike”.



Nga ana tjetër, importet e mallrave u reduktuan me 8.2%, me kontribute të përqendruara nga kategoritë “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike”, “Tekstile dhe veshje” dhe “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi”, ndërkohë që kontributet në rënie të kategorive të tjera ishin mjaft të ulëta.

**POLITIKA FISKALE VIJOI TË RUAJË NATYRËN E SAJ KONSOLIDUESE EDHE GJATË VITIT 2023**


**Politika fiskale pati një natyrë kundërciklike gjatë vitit 2023.** Kjo politikë i shërbeu përmirësimit të pozicionit fiskal dhe forcimit të stabilitetit makroekonomik, nëpërmjet një koordinimi më të mirë me kahun normalizues të politikës monetare. Konsolidimi fiskal u shpreh në reduktimin me 2.3 pikë përqindjeje të raportit

<sup>3</sup> Eksporti i mallrave përbën rreth 20%, ndërsa eksporti i shërbimeve përbën rreth 80% të eksporteve totale shqiptare gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2023.



të deficitit buxhetor ndaj PBB-së dhe mundësoi uljen me 5.3 pikë përqindje të raportit të borxhit publik ndaj PBB-së.

**Konsolidimi fiskal ishte diskrecionar, i shprehur në kalimin e balancës primare nga një deficit prej 1.8% të PBB-së në vitin 2022 në një suficit prej 0.7% të PBB-së në vitin 2023.** Ai u mbështet pjesërisht nga përfundimi i mbështetjes së detyruar për sektorin energjetik dhe pjesërisht nga ecuria pozitive e tregut të punës, të karakterizuar nga rritja e punësimit dhe e pagave.



**Shpenzimet primare rezultuan rreth 1.5 pikë përqindjeje më të ulëta në terma të PBB-së nga një vit më parë,** madhësi kjo thuhet se është me transfertat e kryera nga qeveria në vitin 2022, të cilat synuan shmangien e ndikimit të çmimeve të larta të energjisë tek konsumatorët fundorë në vend. Paralelisht me të, raporti i të ardhurave primare ndaj PBB-së u rrit me një pikë përqindje, ku pjesa më e madhe e këtij përmirësimi u formua nga tatimet e lidhura me punësimit, të tilla si tatimi mbi të ardhurat personale dhe kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore.

**Deficiti buxhetor për vitin 2023 rezultoi në nivelin 31.3 miliardë lekë, duke qenë ndjeshëm më i ulët se niveli i planifikuar prej 55.5 miliardë lekësh.** Në terma të PBB-së, deficitin u vlerësua rreth nivelin 1.4% të PBB-së, nga 3.7% një vit më parë. Realizimi i deficitit për vitin 2023 u përqendrua në muajin dhjetor, ndërkohë që njëmbëdhjetë muajt e parë të vitit u karakterizuan nga vlera pozitive dhe të larta të bilancit fiskal.

**Financimi i deficitit buxhetor u mbulua nga burime të brendshme dhe të huaja.** Në qershor u emetua një Eurobond 5-vjeçar, në vlerën 600 milionë euro, ose rreth 2.7% të PBB-së. Pjesa më e madhe e tij u përdor për pagesat e principalit të borxhit të marrë në vitet e mëparshme, si edhe në shlyerjen e pjesës së të parakohshme të Eurobond-it të emetuar në vitin 2018, në shumën e 133




milionë eurove. Flukset valutore për financimin e deficitit u shtuan edhe nga mbështetja buxhetore nga entitetet e huaja, në 19.2 miliardë lekë ose 0.8% e PBB-së. Një pjesë e fondeve të rezultuara të tepërta në valutë u transferuan për t'u përdorur në financimin e deficitit të vitit 2024.

**Financimi i deficitit në tregun e brendshëm ishte në nivelin e 20.7 miliardë lekëve, nga 25 miliardë lekë të planifikuara.** Ndryshe nga një vit më parë, shtesa e huamarrjes u realizua nëpërmjet titujve afatgjatë, rritja e portofolit të cilëve kompensoi reduktimin me 21 miliardë lekë të portofolit të qeverisë në bono thesari. Sektori bankar pati një rol të rëndësishëm në këtë financim, duke kontribuar me 17 miliardë lekë, ose rreth 80% të shtesës së huamarrjes së brendshme.

**Raporti i borxhit publik bruto ndaj PBB-së ra në 59.2% në fund të vitit, duke qenë rreth 5.3 pikë përqindje më i ulët se niveli i vlerësuar në fund të vitit 2022.** Më shumë se gjysma e kësaj rënieje, ose 2.7 pikë përqindje, i atribuohet efektit të mbiçmimit të lekut kundrejt euros. Paralelisht me të, efekt rënës kanë dhënë edhe: rritja e aktivitetit ekonomik në vend, me 1.9 pikë përqindje; normat negative të interesit real, me 0.8 pikë përqindje; si dhe, kahu konsolidues i politikës fiskale, me 0.7 pikë përqindje.<sup>4</sup> Në terma të strukturës, borxhi i brendshëm u vlerësua në 32.3% të PBB-së, nga 34.3% në fund të vitit 2022, ndërsa borxhi i jashtëm në 26.9% të PBB-së, nga 30.3% në fund të vitit 2022.

Grafik 8. Deficiti buxhetor dhe financimi (majtas) dhe borxhi publik ndaj PBB-së (djathtas)\*



\*Të dhënat për borxhin publik janë të disponueshme deri për tremujorin e tretë.  
Burimi: INSTAT, MFE dhe llogaritje të stafit të BSH-së.


**Shpenzimet buxhetore për vitin 2023 ishin rreth nivelit 675 miliardë lekë, të vlerësuar në 29.2% të PBB-së, nga 30.4% një vit më parë.** Në terma nominalë, rritja vjetore e shpenzimeve rezultoi rreth 3.6%. Në mungesë të efektit bazë të transfertave për sektorin energjetik gjatë vitit 2022, kjo normë rritjeje do të ishte rreth nivelit 8.3%.

<sup>4</sup> Krahas faktorëve të përmendur më sipër: norma reale e interesit, rritja reale ekonomike, balanca primare dhe kursi i këmbimit, ka edhe një zë rezidual, i cili bën të mundur barazimin e identiteteve dhe që u vlerësua në rreth 0.8 pikë përqindje të PBB-së.



**Investimet publike arritën në 120 miliardë lekë, ose rreth 5.2% të PBB-së.** Në terma vjetorë, investimet u rritën me 6.7%, duke përmirësuar strukturën e shpenzimeve buxhetore dhe duke përbërë rreth 18% të totalit të shpenzimeve. Në këtë drejtim, një efekt pozitiv ka dhënë edhe Fondi i Rindërtimit, i cili ishte pjesë e buxhetit edhe për vitin 2023. Në terma absolutë, rritja më e madhe e shpenzimeve mori formën e rritjes së pagave për punonjësit në sektorin publik, me rreth 2.4 pikë përqindje. Paralelisht me to, shpenzimet për pushtetin lokal dhe shpenzimet për skemën e pensioneve kontribuuan me nga 1.6 pikë përqindje, ndërsa shpenzimet për interesa me rreth 0.7 pikë përqindje.

**Të ardhurat fiskale arritën në 643 miliardë lekë, të vlerësuara në rreth 27.8% të PBB-së ose 1 pikë përqindje më të larta se një vit më parë.** Në terma vjetorë, të ardhurat u zgjeruan me rreth 12.3%, duke u mbështetur në tre shtylla kryesore. Së pari, rritja e punësimit, e pagës minimale dhe e pagave në sektorin publik e privat, sollën një rritje të shpejtë të të ardhurave nga tatimi mbi pagat dhe nga sigurimet sociale. Së dyti, të ardhurat nga grantet kontribuuan me rreth 2.2 pikë përqindje në rritjen e të ardhurave publike, në pasqyrim të fondeve të akorduara nga Komisioni Evropian për mbështetjen e reformave në sektorin energjetik. Së treti, të ardhurat nga tatimi mbi fitimin kontribuuan me 3 pikë përqindjeje në zgjerimin e të ardhurave publike. Ky zë pasqyroi kryesisht të ardhura shtesë të gjeneruara nga tatimi i veçantë për kompanitë private të përfshira në shitjen e energjisë elektrike, të cilat realizuan fitime të larta në vitin 2022, si pasojë e rritjes së shpejtë të çmimit të energjisë elektrike.



**Të ardhurat nga TVSh-ja rezultuan rreth 192.3 miliardë lekë, ose 8.3% e PBB-së, duke u reduktuar me 0.6 pikë përqindje nga një vit më parë.** Ecuria e të ardhurave nga TVSh-ja reflektoi çmimet më të ulëta të mallrave bazë, e kryesisht të energjisë, si dhe efektin e mbiçmimit të monedhës vendase gjatë vitit 2023. Pjesa më e madhe e TVSh-së, ose rreth 76% e saj, përftohet nga importi i mallrave. Për pasojë, të ardhurat e akumuluar nga kjo taksë kanë





varësi të lartë nga luhatjet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe nga ecuria e kursit të këmbimit.


### 2.1.3 TREGU I PUNËS

*Treguesit kryesorë të tregut të punës kanë ardhur në përmirësim gjatë vitit 2023: punësimi është rritur më tej, papunësia ka rënë në minimumin historik dhe rritja e pagave mbetet e lartë.*

Rritja e kërkesës për mallra e shërbime u pasqyrua në rritje të punësimit, rënie të normës së papunësisë dhe rritje të pagave. Sipas të dhënave të INSTAT-it, punësimi shënoi një rritje mesatare prej 2.8% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2023. Në përputhje me dinamikat e zhvillimit sektorial, zgjerimi i punësimit u përqendrua në sektorin e "Shërbimeve", ndërkohë që punësimi në "Bujqësi" dhe "Industri" shënoi rënie. Rritja e punësimit u pasqyrua në rritjen e shkallës së pjesëmarrjes në forcat e punës, si dhe në rënie të normës së inaktivitetit.

Norma e papunësisë vazhdoi të reduktohet, duke zbritur në nivelin 10.5% në tremujorin e tretë. Kjo normë është rreth 0.1 pikë përqindje më e ulët krahasuar me një vit më parë dhe përbën një minimum të ri historik për papunësinë, ndërkohë që numri i të punësuarve u ngjiti në nivelet më të larta.

Kushtet e shtrënguara të tregut të punës vazhdojnë të ushtrojnë presione të shtuara për rritjen e pagave. Paga nominale shënoi një rritje mesatare prej 14% për ekonominë në tërësi dhe 13% për sektorin privat gjatë nëntë muajve të parë të vitit. Të dhënat sektoriale sugjerojnë kontribute me bazë të gjerë nga të gjitha degët e ekonomisë. Bizneset vazhdojnë të raportojnë vështirësi në tërheqjen e fuqisë punëtore dhe rritja e pagave konsiderohet si një instrument i nevojshëm për të siguruar punonjës të kualifikuar. Rritja e pagës nominale dhe ngadalësimi i inflacionit kanë nxitur një rritje të përshpejtuar të pagës reale, në nivelin 9.0% për ekonominë në tërësi dhe 7.9% për sektorin privat.



HAPËSIRË INFORMUESE 1:

**ECURIA AKTUALE DHE PERSPEKTIVA AFATGJATË E TREGUT TË PUNËS NË SHQIPËRI**

**Tregjet e punës, në vend dhe në botë, janë karakterizuar nga kushte të shtrënguara gjatë viteve të fundit.** Ky shtrëngim diktohet si nga faktorë ciklikë ashtu edhe nga faktorë strukturorë. Nga ana e kërkesës, rritja e shpejtë e aktivitetit ekonomik – sidomos në periudhën pas pandemisë – ka shtuar kërkesën për punë. Nga ana e ofertës, trendet e pafavorshme demografike, gara ndërkombëtare për fuqi punëtore dhe ndryshimi i preferencave të shoqërisë, e kanë bërë gjithnjë e më të vështirë përmbushjen e saj. Këto dinamika janë shprehur në rënien e papunësisë dhe rritjen e shpejtë të pagave.

Hapësira informuese në vijim synon të hedhë një vështrim më të detajuar mbi zhvillimet e tregut të punës në Shqipëri, porë si në kontekstin afatshkurtër ashtu dhe në atë afatmesëm e afatgjatë.

**Tregu i punës ka pasur një ecuri pozitive gjatë dy viteve të fundit, në linjë me zgjerimin e aktivitetit ekonomik.** Ekonomia shqiptare ka krijuar 68,000 vende të reja pune gjatë dy viteve të fundit, duke rritur punësimin me 6.8%. Paralelisht me të, shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës u rrit me 8.9 pikë përqindjeje, e nxitur kryesisht nga rritja e pjesëmarrjes së femrave, ndërsa norma e papunësisë ka zbritur në minimume historike dhe shkalla e inaktivitetit ka ardhur në rënie.


Tabelë 2. Rritja ekonomike dhe tregues të tregut të punës në vite (në %).

Tregues ekonomikë dhe të tregut të punës	2019	2020	2021	2022	2023T1-T3
1. Rritja e PBB-së (v/v)	2.1	-3.3	8.9	4.9	3.3
2. Rritja e punësimit (v/v)	2.8	-1.7	0.5	4.0	2.8
3. Norma e papunësisë	11.2	11.8	11.4	10.8	10.5
-Norma e papunësisë (15-29 vjeç)	21.4	21.7	20.6	21.5	22.0
4. Norma e papunësisë afatgjatë	7.3	6.9	7.3	7.3	7.4
5. Norma e punësimit	61.2	60.6	60.9	65.0	67.4
-Norma e punësimit (15-29 vjeç)	41.2	41.2	41.5	44.0	44.6
6. Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës	69.6	69.1	69.3	73.2	75.9
-Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës (15-29 vjeç)	52.5	52.1	52.5	55.6	57.4
7. Shkalla e inaktivitetit	30.4	30.9	30.7	26.8	24.1
-Shkalla e inaktivitetit (15-29 vjeç)	47.5	47.9	47.5	44.5	42.6

Burimi: INSTAT.

**Rritja e pagave ka pasqyruar zgjerimin e shpejtë të kërkesës për punë dhe mungesat në rritje të fuqisë punëtore.** Vrojtimet e Bankës së Shqipërisë<sup>1</sup> tregojnë se bizneset evidentojnë “Mungesën e fuqisë punëtore” si një pengesë serioze dhe me rëndësi në rritje për aktivitetin e tyre. Gjatë vitit 2023, shkalla e rëndësisë së tij është rritur 5 herë në krahasim me vitin 2019, teksa mungesat në fuqinë punëtore kanë prekur të gjithë sektorët e vrojtuar. Për pasojë, pagat në sektorin privat kanë ndjekur një prirje rritëse prej fundit të vitit 2021, ku normat vjetore të rritjes kanë kërcyer nga 6.6% në vitin 2021, në 12.2% në vitin 2022, dhe 13% gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2023. Rritja e pagave është me bazë të gjerë, si në terma sektorialë ashtu dhe në terma të shkallës së kualifikimit të fuqisë punëtore. Gjithashtu, bizneset raportojnë se vendet vakante kanë ardhur në rritje, si pasojë e pamundësive për plotësimin e tyre<sup>1</sup>.





**Rritja e pagave dhe e punësimit mbështesin rritjen ekonomike, si nga ana e kërkesës dhe nga ana e ofertës, por ato nxisin gjithashtu edhe rritjen e kostove të prodhimit, si dhe krijojnë premisa për rritje të inflacionit.** Ky faktor ka qenë e do të mbetet në vëmendjen e Bankës së Shqipërisë, për të vlerësuar në kohë implikimet që ai ka për stabilitetin e çmimeve dhe qëndrimin e politikës monetare.

**Perspektiva e tregut të punës është pozitive.** Zgjerimi i aktivitetit ekonomik do të shoqërohet me rritjen e kërkesës për punë dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Nga ana tjetër, prirjet demografike, si ulja e lindshmërisë dhe plakja e popullsisë, si dhe emigrimi i vazhdueshëm si pasojë e rritjes së konkurrencës për fuqi punëtore në tregun ndërkombëtar, do të kushtëzojnë rritjen e ofertës për punë dhe mund të ushtrojnë presione për shtrëngimin e kushteve në tregun e punës në të ardhmen.

#### Disa faktorë strukturorë të tregut të punës në Shqipëri


**Situata demografike e vendit është karakterizuar nga ndryshime të shpejta strukturale gjatë dy dekadave të fundit.** Popullsia ka ardhur në rënie, e ndikuar nga faktorë si ulja e treguesve të lindshmërisë, plakja e popullsisë dhe emigracioni.<sup>III</sup> Paralelisht me rënie të popullsisë, moshë mesatare e saj në vitin 2022 vlerësohej 38.2 nga 36.7 vjeç në vitin 2019 dhe moshë mediane është rritur. Për rrjedhim, piramida e moshës së popullsisë paraqitet me bazë në ngushtim, teksa numri i të rinjve ka rënë dhe ai i të moshuarve është rritur.<sup>IV</sup>

**Në një këndvështrim më afatgjatë, ndryshime strukturale vihen re edhe sipas grup-moshave të punësimit dhe të forcës së punës (Grafik 12, majtas).** Për të dy këta tregues, kontributet pozitive të moshës së re (15-29 vjeç) në periudhën 2016-2019, janë kthyer në negative gjatë periudhës 2019-2023/T3. Ndërkohë, ritmi i tkurrjes së popullsisë në moshë pune është përshpejtuar, nga niveli 0.3% në periudhën e parë, në nivelin 2.1% për periudhën e dytë. Përcaktuese në këtë rënie janë kontributet negative nga grup-moshë më e re (15-29 vjeç) dhe nga grup-moshë 30-64 vjeç, ndërkohë që kontributet e vetme pozitive dhe lehtësisht të zgjeruara burojnë nga kategoria mbi 65 vjeç. Këto zhvillime evidentojnë një plakje relative të popullsisë në moshë pune (grafik 12, djathtas).



Në këtë këndvështrim, implikimet që trendet e pafavorshme demografike kanë për zhvillimin e vendit duhen vlerësuar me kujdes. Paralelisht me to, rëndësi primare merr vijimi i reformave strukturore, të cilat duhet të synojnë rritjen e produktivitetit dhe të konkurrueshmërisë, si instrumente për rritjen e qëndrueshme të pagave dhe të ekonomisë në afatin e gjatë.

Grafik 12. Treguesit e tregut të punës (në %) sipas dy nënperiudhave, dekompozuar me kontributet sipas grup-moshave (majtas) dhe struktura e popullsisë në moshë pune sipas grup-moshave (djathtas)



\* Ndryshimet në % dhe kontributet janë të akumuluarra për periudhën 2016T4-2019T4 dhe 2019T4-2023T3.

Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

- I Vrojtimet e Besimit të Biznesit gjatë 2023.
- II Raporti Tremujor i Politikës Monetare 2023/II, Banka e Shqipërisë, Hapësirë informuese 2, faqe 41-43.
- III Referenca: Popullsia e Shqipërisë, INSTAT, 1 Janar 2023.
- IV <https://www.instat.gov.al/al/statistikat-n%C3%AB-shkolla/piramida-e-popullsis%C3%AB-s%C3%AB-shqip%C3%ABris%C3%AB/>

## 2.1.4 INFLACIONI DHE FAKTORËT PËRCAKTUES TË TIJ

Inflacioni i çmimeve të konsumit shënoi një rënie progresive gjatë vitit 2023, duke regjistruar nivelin mesatar prej 4.8%. Në terma makroekonomikë, rënia e inflacionit u diktua nga dobësimi i inflacionit në tregjet e huaja, nga mbiçmimi i kursit të këmbimit dhe nga reduktimi gradual i presioneve të brendshme inflacioniste.

Megjithatë, ritmi i rënies së inflacionit erdhi në ngadalësim gjatë vitit, duke pasqyruar nivelet ende të larta të presioneve të brendshme mbi kostot e punës dhe çmimet e konsumit.


Normalizimi i qëndrimit të politikës monetare ka sjellë një balancim më të mirë të kërkesës me ofertën dhe në kontrollin e pritjeve për inflacionin, duke krijuar premisat e duhura për kthimin e inflacionit në objektiv gjatë vitit 2024.

Inflacioni vijoi të qëndrojë në një trend rënës gjatë vitit 2023, duke zbritur nga niveli mesatar prej 7.9% i tremujorit të katërt të vitit 2022 në nivelin mesatar



**prej 3.9% të tremujorit të katërt të vitit 2023.** Rënia e inflacionit ishte më e shpejtë në gjysmën e parë të vitit, në pasqyrim të rënies së çmimeve të ushqimeve, të energjisë e të naftës në tregjet e huaja. Nga ana tjetër, presionet e brendshme inflacioniste erdhën gjithashtu në rënie graduale, por ritmi i kësaj rënieje ishte më gradual. Për pasojë, këto presione mbetën relativisht të larta dhe u shfaqën gjithnjë e më përcaktuese në nivelin e inflacionit. Kjo dinamikë buron nga kërkesa e lartë për mallra e shërbime dhe nga tendenca rritëse e pagave dhe e kostove të prodhimit. Për pasojë, inflacioni i shërbimeve, ai i brendshëm dhe inflacioni bazë, shënuan një rënie më graduale gjatë vitit, duke sjellë edhe ngadalësimin progresiv të shpejtësisë së rënies së inflacionit total gjatë vitit.

**Ecuria e inflacionit në vend rezultoi e ngjashme me atë të inflacionit në vendet e rajonit dhe të BE-së,** e diktuar kryesisht nga rënia e çmimeve të naftës dhe produkteve ushqimore të importuara.<sup>5</sup> Megjithatë, inflacioni në Shqipëri qëndroi poshtë atij të vendeve të rajonit dhe të BE-së, për shkak të çmimeve të kontrolluara të energjisë elektrike për familjet e bizneset, si dhe për shkak të efekteve lehtësuese të forcimit të kursit të këmbimit.



**Rënia e inflacionit ishte me bazë të gjerë dhe e pranishme në të gjitha kategoritë e artikujve të grupuar sipas inflacionit.**<sup>6</sup> Për ilustrim, pesha e artikujve me normë inflacioni mbi nivelin 3% u reduktua me 10 pikë përqindjeje gjatë vitit, duke përbërë 55% të artikujve në fund të vitit.


Kjo diferencë u shpërnda në mënyrë thuajse të barabartë në peshat e intervaleve të artikujve me inflacion nën 1% dhe inflacion në intervalin 1–3%, duke i ngjitur ato në përkatësisht 25 dhe 20%.

<sup>5</sup> Artikujt e të cilës kanë përmbajtje të lartë importuese si në terma të produktit final ashtu edhe në terma të produktit të ndërmjetëm.

<sup>6</sup> Vlerësimi është bërë mbi të dhënat e inflacionit vjetor në nivel 2-shifror sipas klasifikimit COICOP të artikujve të shportës së IÇK-së, duke arritur në numrin total të 96 artikujve (mallra dhe shërbime).



Grafik 14. Struktura e artikujve të shportës së IÇK-së sipas intervaleve të inflacionit



Burimi: INSTAT, llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Trajektorja rënëse e inflacionit u diktua kryesisht nga rënia e çmimeve të naftës dhe rritja më e ngadaltë e çmimeve të produkteve ushqimore të importuara. Për pasojë, kontributet e kategorive të karburanteve dhe të ushqimeve të përpunuara në inflacion zbritën në nivelin 20% gjatë vitit 2023, nga rreth 60% gjatë vitit të kaluar. Këto kategori ndikuan në uljen me rreth 3 pikë përqindje të inflacionit, ku ndikimin më të madh e dha rënia e çmimeve të karburanteve. Nga ana tjetër, kategoria “Ushqime të papërpunuara” kontribuoi në mënyrë të konsiderueshme në inflacion gjatë vitit të kaluar, duke formuar rreth 45% të tij, kundrejt nivelit 20% një vit më parë. Brenda kësaj kategorie, nëngrupet “Fruta” dhe “Perime” demonstuan prirje rritëse të kontributeve.

Çmimet e komponentëve të tjerë më të qëndrueshëm të inflacionit, ku përfshihen shërbimet, strehimi dhe mallrat e konsumit afatgjatë, dhanë një kontribut në rritje në formimin e inflacionit. Në veçanti, çmimet e shërbimeve mbetën në nivele të larta, për shkak të kërkesës së shtuar në sektorin e turizmit dhe të shërbimeve të lidhura me të. Rritja e çmimeve u përhap edhe në kategorinë “Strehim”, përmes nëngrupit të qirave. Po ashtu, rritje të kontributit pati edhe nga çmimet e kategorisë “Mallra konsumi afatgjatë”, duke pasqyruar rritjen e mëtejshme të kostove të punës e të prodhimit. Së fundi, mbajtja e pandryshuar e çmimeve të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë i mbajti neutrale kontributet nga çmimet e rregulluara në inflacionin total.

Tabelë 3. Kontributi i kategorive kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindje)

	Kontribute mesatare sipas viteve					Kontribute mesatare sipas tremujorëve - viti 2023				Inflacioni vjetor 2023 (në %)
	2018	2019	2020	2021	2022	T1	T2	T3	T4	
Ushqime të përpunuara	0.2	0.5	0.6	0.6	2.8	2.8	1.3	0.8	0.6	6.9
Ushqime të papërpunuara	0.9	0.9	0.8	0.8	1.6	1.9	2.5	2.3	2.1	12.3
Shërbime	0.1	0.1	0.2	0.2	0.5	0.5	0.5	0.5	0.4	2.9
Mallra me çmime të rregulluara	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	1.1
Strehim (qira)	0.1	0.2	0.1	0.1	0.3	0.4	0.4	0.3	0.4	3.2
Mallra konsumi joushqimor	0.1	-0.2	0.2	0.2	1.3	0.4	-0.6	-0.4	-0.1	-1.7
Mallra konsumi afatgjatë	0.0	0.1	0.1	0.1	0.2	0.5	0.5	0.5	0.4	5.0
Inflacioni (%)	1.4	1.6	2.0	2.0	6.7	6.5	4.6	4.1	3.9	4.8

Burimi: INSTAT dhe BSH.

Nivelet ende të larta të inflacionit gjatë vitit 2023 pasqyruan gjithnjë e më shumë presionet që vijnë nga rritja e pagave, e kostove dhe e marzheve të fitimit në ekonominë vendase.

Rritja e qëndrueshme e kërkesës për mallra e shërbime e ka shtyrë ekonominë shqiptare në një fazë pozitive të ciklit të biznesit. Ajo është pasqyruar në




rritje të mëtejshme të punësimit, në nivelet minimale historike të normës së papunësisë, në rritjen e shpejtë të pagave në sektorin privat, si dhe në shkallën e lartë të shfrytëzimit të kapaciteteve të raportuar nga bizneset. Për pasojë, edhe pse në ngadalësim, inflacioni bazë ka mbetur në nivele relativisht të larta historike gjatë vitit 2023.

**Ndonëse me bazë të gjerë, ngadalësimi i inflacionit gjatë vitit 2023 nuk ishte i njëtrajshëm në kohë dhe në intensitet.** Rënia e inflacionit pasqyroi më së shumti rënien e shpejtë të inflacionit të importuar. Ndërkohë, edhe pse në rënie, presionet e brendshme morën një peshë gjithnjë e më të madhe në inflacion.


**Presionet e brendshme inflacioniste vijuan të ushqehen nga kërkesa e lartë për mallra e shërbime dhe kushtet e shtrënguara të tregut të punës.** Këta faktorë përkthehen në rritje të shpejtë të pagave e të kostove të prodhimit, si dhe në marzhe relativisht të larta fitimi. Për pasojë, ndonëse inflacioni bazë dhe ai i brendshëm erdhën në ngadalësim, duke regjistruar vlerat mesatare përkatëse 5.3% dhe 4.5%, kontributet e tyre mbetën të larta dhe formuan rreth 2/3 e inflacionit total (shih Grafikon 16). Presionet e larta nga kërkesa e brendshme, u demonstruan në pothuajse të gjitha matjet e inflacionit bazë dhe të brendshëm. Në veçanti, inflacioni bazë neto rezultoi mesatarisht rreth 3.7% gjatë vitit 2023, nga 2.7% një vit më parë.<sup>7</sup>

Grafik 15. Tregues të gjendjes ciklike



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të Bankës së Shqipërisë.

Grafik 16. Inflacioni sipas komponentëve bazë dhe jo-bazë (majtas) dhe të brendshëm dhe të importuar (djathtas)



Burimi: INSTAT, llogaritje të BSH-së.

<sup>7</sup> Inflacioni bazë neto përjashton nëngrupet e ushqimeve të përpunuara (përfshirë bukën dhe drithërat) nga matja e inflacionit bazë. Inflacioni bazë neto merr në konsideratë 44.6% të shportës të IÇK-së të vitit 2023. Kjo matje është e përafërt me inflacionin neto të publikuar nga Eurostat për vendet e BE-së dhe kandidatet, përfshirë Shqipërinë. Matja rezulton pasi përjashtohen nga llogaritja e indeksit të çmimeve, të gjitha ushqimet, mallrat energjetike (energji elektrike, karburantet etj.), pijet alkoolike dhe duhani.




Normalizimi i qëndrimit të politikës monetare gjatë periudhës 2022-2023, ndihmoi në lehtësimin gradual të presioneve nga kërkesa në ekonomi, si dhe në kontrollin e pritjeve për inflacionin.

Nga ana tjetër, inflacioni i importuar u reduktua shpejt gjatë gjysmës së parë të vitit. Rënia e tij u ndikua nga prirja rënëse e çmimeve të lëndëve të para dhe të ushqimeve bazë në tregjet e huaja, nga mbiçmimi i monedhës vendase dhe nga efektet e bazës së lartë krahasuese të vitit të mëparshëm. Inflacioni i importuar zbriti në nivelin mesatar prej 6% nga norma dyshifrore prej 14% e vitit të mëparshëm, duke kontribuar me rreth 25% në formimin e inflacionit total të vitit 2023.

### PRITJET PËR INFLACIONIN SHËNUAN RËNIE GJATË VITIT 2023

Pas vlerave më të larta historike të shënuara gjatë vitit 2022, pritjet e bizneseve dhe të agjentëve financiarë për inflacionin u ripanë për poshtë gjatë vitit 2023<sup>8</sup>. Megjithatë, ato mbeten ende të larta krahasuar me historikun e tyre dhe mbi objektivin e inflacionit. Në terma krahasues, pritjet e agjentëve financiarë për inflacionin regjistrojnë vlerat më të ulëta, për të tre horizontet kohore, në krahasim me konsumatorët dhe bizneset. Për më tepër, pritjet e agjentëve financiarë i afrohen gjithnjë e më shumë objektivit, me zgjatjen e horizontit kohor. Në fund të vitit 2023, ata presin që inflacioni pas një viti të jetë 3.8%, pas dy vitesh 3.5% dhe pas tre vitesh 3.3%. Bizneset presin që inflacioni pas një viti të jetë 6%, rreth një pikë përqindje më pak se pritjet e tyre një vit më parë. Nga ana tjetër, dinamika e pritjeve të konsumatorëve tregon për rënie të tyre në gjashtëmujorin e parë të vitit, dhe rishikim për lart në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023.

Grafik 17. Ecuria e pritjeve të agjentëve ekonomikë për inflacionin



Burimi: Banka e Shqipërisë.

<sup>8</sup> Pritjet për inflacionin maten nëpërmjet vrojtimeve të drejtpërdrejta drejtuar bizneseve, konsumatorëve dhe agjentëve financiarë.





## 2.1.5 BILANCI I PAGESAVE DHE POZICIONI I JASHTËM I EKONOMISË

*Bilanci i shkëmbimeve tregtare dhe financiare me jashtë shënoi një përmirësim të qenësishëm gjatë vitit 2023. Për herë të parë në tre dekadat e fundit, llogaria korrente regjistroi suficit gjatë tre tremujorëve të parë të vitit, të vlerësuar në nivelin 0.2% të PBB-së, duke shënuar një përmirësim të ndjeshëm nga viti 2022. Kontributi kryesor në këtë ecuri buroi nga zgjerimi i shpejtë i eksporteve të turizmit. Paralelisht me të, flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte vazhdojnë të shfaqin rritje të lartë. Së fundi, raporti i borxhit të huaj ndaj PBB-së u reduktua dhe treguesit e aftësisë ripaguese afatgjatë kanë vazhduar të përmirësohen edhe përgjatë vitit 2023.*

Bilanci i llogarisë korrente u përmirësua ndjeshëm gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2023, duke regjistruar një suficit prej 0.2% të PBB-së dhe një rritje prej 6 pikësh përqindje nga viti 2022.

Përmirësimi i llogarisë korrente u diktua nga rritja e shpejtë e eksporteve të turizmit. Për 9-mujorin e parë të vitit 2023, këto flukse shënuan nivelin 3.2 miliardë euro, çka përbën një rritje prej 47% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Si rrjedhojë, eksportet e shërbimeve totale u rritën me 38.2%.


Në ndryshim nga trendi pozitiv i shërbimeve, eksporti dhe importi i mallrave shënoi rënie gjatë vitit 2023, me përkatësisht 9.3% dhe 3.4%, kryesisht si pasojë e rënies së çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Megjithatë, eksportet e mallrave shënuan rënie edhe në sasi, si pasojë e vështirësive të hasura nga sektori industrial, qoftë nga kërkesa e ulët në partnerët tanë tregtarë qoftë dhe nga vështirësitë financiare si pasojë e rritjes së kostove nga pagat dhe e forcimit të kursit të këmbimit.

Deficiti i të ardhurave parësore u pakësua me 7.1% gjatë 9-mujorit të parë të vitit 2023. Ky reduktim u përcaktua nga ecuria pozitive e të ardhurave hyrëse nga puna, flukset e të cilave u rritën me 20.8%, duke dëshmuar rikthimin e fenomenit të punësimit sezonal të shtetasve shqiptarë jashtë vendit. Paralelisht me të, edhe të ardhurat dalëse të investimeve vijuan të rriten, duke dëshmuar ecurinë e mirë financiare të kompanive, të cilat kanë investuar në formën e IHD-ve në vend.

Së fundi, remitancat – të cilat janë dhe zëri kryesor i të ardhurave dytësore - vazhduan të shfaqin norma të larta rritjeje. Flukset hyrëse të tyre u zgjeruan me 14.2% në terma vjetorë, ndërkohë që teprica e llogarisë së të ardhurave dytësore u rrit me 9.5% gjatë kësaj periudhe.

### INVESTIMET E HUAJA DIREKTE SHËNUAN RITME TË LARTA RITJEJE

Flukset hyrëse të IHD-ve u rritën me 10.6% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit 2023. Sektorët kryesorë që kontribuuan në këtë rritje ishin "Energjia", "Shërbimet financiare" dhe "Pasuritë e paluajtshme". Një burim i rëndësishëm



i IHD-ve mbetet riinvestimi i fitimeve të kompanive, në reflektim të performancës pozitive ekonomike të tyre. Raporti i IHD-ve ndaj PBB-së llogaritet në 7.3%, duke rezultuar lehtësisht më i ulët se në vitin 2022.

### TREGUESIT E BORXHIT TË JASHTËM VAZHDUAN TË PËRMIRËSOHEN GJATË VITIT 2023

Stoku i borxhit të jashtëm në fund të tremujorit të tretë të vitit 2023 llogaritej në 10.14 miliardë Euro, me rritje vjetore 2.5%. Zgjerimi i stokut lidhet kryesisht me emetimin e Eurobond-it gjatë tremujorit të dytë të vitit. Megjithatë, raporti i borxhit ndaj PBB-së vazhdon të pakësohet në mënyrë të vazhdueshme. Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2023, ky raport zbriti në 49.8%, një reduktim ky prej 4.5 pikësh përqindje krahasuar me fundin e vitit 2022. Në terma të strukturës së maturimit, vazhdon të jetë mbizotërues borxhi afatgjatë me 91.2% të totalit, çka mban të ulët nevojën dhe rrezikun e rifinancimit.

Paralelisht me to, treguesit e aftësisë ripaguese janë përmirësuar, të ndikuar nga rritja e shpejtë e eksporteve dhe e të ardhurave fiskale. Raporti i stokut të borxhit ndaj eksportit të mallrave dhe shërbimeve zbriti në 106.6% në fund të tremujorit të tretë të vitit 2023, nga 118.1% në fund të vitit 2022. Gjithashtu, raporti i stokut të borxhit ndaj të ardhurave fiskale u pakësua në 171.1%, nga 198.7% në fund të vitit 2022.

Stoku i rezervës valutore, i vlerësuar në nivelin e 5.8 miliardë eurove në fund të vitit 2023, është i mjaftueshëm për përbalimin e 7.5 muaj importesh të mallrave dhe shërbimeve ose 507.1% të borxhit të jashtëm afatshkurtër bruto.

Tabelë 4. Ecuria e treguesve kryesorë të bilancit të pagesave dhe të borxhit të huaj (në % ndaj PBB-së)

	2010	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023 T1-T3
Llogaria korrente	-11.3	-8.6	-7.6	-7.5	-6.7	-7.9	-8.7	-7.7	-5.9	0.2
Tregtia në mallra e shërbime	-20.6	-17.3	-16.8	-15.1	-13.7	-13.7	-14.5	-13.4	-10.4	-4.1
Eksporte	28.0	27.3	29.0	31.6	31.6	31.3	22.7	31.3	37.4	41.2
Importe	48.6	44.6	45.8	46.7	45.3	45.0	37.2	44.7	47.8	45.3
Remitanca hyrëse	7.7	5.8	5.7	5.5	5.2	5.1	5.1	5.0	4.6	4.4
IHD hyrëse	9.2	8.7	8.8	7.8	7.9	7.8	7.0	6.8	7.6	7.3
Borxhi i huaj	45.6	74.4	73.5	68.7	65.0	59.9	64.2	64.3	54.3	49.8

Burimi: BSH.

## 2.1.6 TREGJET FINANCIARE DHE TREGUESIT MONETARË

Tregjet financiare kanë qenë relativisht të qeta gjatë vitit 2023. Ngadalësimi i ritmit të normalizimit të qëndrimit të politikës monetare, trendi rënës i inflacionit dhe situata e mirë e likuiditetit, u shoqëruan me rënien e kurbës së yield-eve dhe reduktimin e primeve të rrezikut.

Megjithatë, normat e interesit në tregun financiar janë më të larta se dy vjet më parë, si për instrumentet e kursimit dhe ato të kreditimit, si në lekë ashtu dhe në valutë. Gjithsesi, kushtet monetare dhe oferta e kredisë bankare paraqiten




akomoduese. Në përgjigje të tyre, kredia për sektorin privat shënoi një rritje të shpejtë e të qëndrueshme gjatë vitit, duke i shërbyer nevojave të bizneseve dhe të familjeve për financimin e konsumit dhe të investimeve.

Një veçanti e zhvillimeve në tregjet financiare gjatë vitit 2023, ishte forcimi i shpejtë i kursit të këmbimit të lekut ndaj euros. Ky forcim u diktua nga përmirësimi i ndjeshëm i bilancit të shkëmbimeve tregtare e financiare me jashtë dhe nga rritja e ofertës së valutës në tregun vendas. Ai u shoqërua me luhajtje të shtuara në tregun valutor, por nuk dëmtoi shëndetin e bilanceve të sistemit bankar.

Zhvillimet në tregun financiar gjatë vitit 2023 janë karakterizuar nga një situatë e mirë likuiditeti, prime të ulëta rreziku, përjasje pozitive të sistemit bankar ndaj kreditimit dhe forcim i kursit të këmbimit. Dy rritjet e normës bazë të interesit në muajt mars dhe nëntor, me nga 0.25 p.p secila, janë ndjekur shpejt dhe plotësisht nga tregu ndërbankar. Ndërkohë, ecuria e normave të tjera të interesit ka qenë rënëse në pjesën e parë të vitit dhe rritëse në tremujorin e katërt. Pjesërisht, kjo ecuri ka përfaqësuar korrektimin e rritjes së shpejtë që ato pësuan në gjysmën e dytë të vitit 2022. Krahas këtij faktori, perceptimi i tregut për prime të ulëta rreziku dhe pritjet optimiste për ecurinë e ekonomisë janë materializuar në *spread*-e të ngushta të *yield*-eve dhe të interesave të kredisë, kundrejt normës bazë dhe mes njëri-tjetrit. Normat e interesit janë më të larta se përpara fillimit të ciklit normalizues të politikës monetare, por rritja e konkurrencës mes bankave dhe reduktimi i *spread*-eve i ka mbajtur kushtet e përgjithshme financiare në pozita akomoduese.

Grafik 18. Normat kryesore të interesit në lekë (majtas) dhe interesat në tregun ndërbankar (djathtas)




Normat e interesit në tregun ndërbankar mbeten të ankoruara pranë normës bazë, në linjë me objektivin operacional të politikës monetare. Ato reflektojnë shpejt rritjet e normës bazë, duke ruajtur diferenca minimale prej saj, dhe shfaqën luhajtje të ulëta. Situata e likuiditetit në sistemin bankar ka qenë e



qetë, e karakterizuar nga prime të ulëta rreziku. Vëllimet e tregtimit në tregun ndërbankar kanë qenë të krahasueshme me vitin e kaluar në maturitetin 1-ditor dhe lehtësisht më të larta në maturitetin 7-ditor. Zgjjerimi i kreditimit të ekonomisë dhe rritja e financimit të sektorit publik ka diktuar nevoja lehtësisht më të larta të sistemit bankar për huamarrje nga Banka e Shqipërisë. Ato janë përmbushur duke rritur injektimet 7-ditore, ndërkohë që injektimet me maturitet 3-mujor kanë ruajtur nivele të ngjashme me një vit më parë.

**Kursi i këmbimit të lekut ndaj euros u forcua me ritme të shpejta gjatë vitit 2023.** Tendenca mbiçmuese e monedhës vendase, e nisur që prej vitit 2016 dhe e frenuar përkohësisht gjatë periudhës së pandemisë, u rishfaq e fortë gjatë vitit 2023. Kursi eur/lek rezultoi mesatarisht 108.7 lekë gjatë këtij viti nga 119.0 lekë një vit më parë, me një forcim mesatar të lekut prej 8.7%. Në mënyrë të ngjashme, dollari u kuotua mesatarisht me 100.6 lekë, ose 11.0% më pak se vitin që shkoi.



**Forcimi i kursit të këmbimit të lekut ndaj euros reflektoi përmirësimet e ndjeshme në sektorin e jashtëm të ekonomisë, të lidhura me aktivitetin e shtuar në sektorin e turizmit, si dhe me trendin rritës të investimeve të huaja direkte dhe të remitancave.** Flukset e larta valutore u përkthyen në rritje të vëllimeve të tregtimit në tregun valutore, por ky treg ka funksionuar përgjithësisht në kushte normale. Megjithatë, gjatë vitit u regjistruan edhe episode me luhatshmëri të shtuar të kursit të këmbimit, si pasojë e rritjes së pasigurive të agjentëve të tregut përballë shpejtësisë së paprecedentë të forcimit të lekut. Banka e Shqipërisë reagoi në përputhje me mandatin, politikat dhe rregulloret e saj, duke ndërhyrë në mënyrë episodike, për të shmangur shndërrimin e këtyre luhatjeve në çrregullime të mirëfillta të tregut. Hapësira Informuese 2 paraqet një trajtim më të plotë të faktorëve që kanë ndikuar ecurinë e kursit të këmbimit dhe reagimin e Bankës së Shqipërisë.




## HAPËSIRË INFORMUESE 2

## ECURIA E KURSIT TË KËMBIMIT: FAKTORËT, IMPLIKIMET DHE REAGIMI I BANKËS SË SHQIPËRISË

Monedha vendase u forcua me ritme të shpejta gjatë vitit 2023, duke theksuar trendin mbiçmues që ka karakterizuar kursin e këmbimit në vitet e fundit. Forcimi i lekut kulmoi fillimisht në muajin korrik, ku kursi eur/lek zbriti në mesatarisht 103.2 lekë, me një mbiçmim vjetor të lekut prej 12.1%. Pas dobësimit të lehtë në muajt që pasuan, Leku u forcua sërish në dy muajt e fundit të vitit teksa kursi eur/lek preku një tjetër nivel të ulët, prej 102.8 lekësh, në muajin dhjetor. Kjo hapësirë informuese trajton në mënyrë të përmbledhur arsyet e mbiçmimit të Lekut, implikimet e këtij mbiçmimi dhe reagimin e Bankës së Shqipërisë.

Grafik 20. Ecuria mujore dhe vjetore e kursit eur/lekë.

**Përse u mbiçmua Leku?**

Banka e Shqipërisë ndjek një regjim të lirë të kursit të këmbimit, çka nënkupton se kursi i këmbimit pasqyron raportin mes kërkesës dhe ofertës së valutës. Ky raport diktohet – në masën më të madhe – nga dinamikat e shkëmbimeve tregtare e financiare me jashtë.

Analizat tona sugjerojnë se trendi forcues i lekut gjatë viteve të fundit është shkaktuar nga përmirësimi strukturor i sektorit të jashtëm të ekonomisë, i manifestuar në ngushtimin e vazhdueshëm të deficitit të llogarisë korrente - si rrjedhojë e rritjes së eksporteve të shërbimeve - dhe në rritjen e vazhdueshme të investimeve të huaja direkte. Krahas këtij faktori, ecuria mbiçmuese e monedhës vendase ka reflektuar edhe rritjen e besimit ndaj monedhës sonë kombëtare në tregun valutor, si rrjedhojë e rritjes së besimit të agjentëve të tregut në qëndrueshmërinë e saj dhe e përmirësimit të ndjesisë së investitorëve të huaj për perspektivën e ekonomisë shqiptare.


Duke u fokusuar në zhvillimet e vitit 2023, forcimi i kursit të këmbimit duket se është diktuar nga një tepriçë e lartë oferte në tregun e brendshëm valutor. Të dhënat e disponuara tregojnë se kjo tepriçë oferte ka pasqyruar përmirësimin



e ndjeshëm dhe përtej pritjeve të bilancit të shkëmbimeve tregtare e financiare të Shqipërisë me jashtë. Më konkretisht, për vitin 2023:

- Balanca e llogarisë korrente shënoi një përmirësim prej 1 miliardë eurosh gjatë tre tremujorëve të parë të vitit. Ky përmirësim bëri që – për herë të parë në historinë ekonomike të pas viteve '90 – llogaria korrente të shënojë suficit, të vlerësuar në nivelin 6.4% të PBB-së në tremujorin e tretë të vitit. Për tre tremujorët e parë të vitit, suficiti rezultoi 0.2% të PBB-së, nga një deficit prej 5.9% të PBB-së në vitin 2022.
- Përmirësimi i llogarisë korrente u nxit nga rritja e lartë e flukseve hyrëse të turizmit. Për tre tremujorët e parë të vitit, të ardhurat nga turizmi prodhuan një fluks valutor prej 3.2 miliardë eurosh, me rritje vjetore prej 46.6%. Ndikime të mëtejshme pozitive kanë ardhur nga rritja e remitancave, të cilat ishin rreth 676 milionë euro në këta tre tremujorë, ose 14.2% më të larta se një vit më parë.
- Investimet e huaja direkte kanë vijuar të rriten, duke përbërë një burim tjetër oferte valute përtej suficitit të llogarisë. Ato rezultuan rreth 1.08 miliardë euro në tre tremujorët e parë të vitit, ose 10.6% më të larta se një vit më parë.

Grafik 21. Llogaria korrente në % të PBB-së (majtas) dhe vëllimet e tregimit në tregun valutor (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Këto zhvillime rezultuan në tepriçë oferte të valutës në ekonomi, e cila, në kushtet e një regjimi të lirë të kursit të këmbimit, diktoi mbiçmimin e monedhës vendase.

Paralelisht me këtë analizë, ecuria e vëllimeve të tregimit në tregun tonë valutor duket se është udhëhequr tërësisht nga ecuria e vëllimeve të shkëmbimeve tregtare më jashtë (Grafiku 21, paneli djathtas), duke qenë madje më e ulët se to dhe duke mos shfaqur evidenca të pranishme të shtuar të flukseve valutore me origjinë tjetër.

### Çfarë implikimesh ka pasur mbiçmimi i kursit në ekonomi?

Ndikimi i mbiçmimit të kursit të këmbimit në ekonomi ka qenë në tërësi pozitiv. Së pari, ai ka rezultuar në norma më të ulëta inflacioni, një gjë e dukshme kjo si në kontekstin rajonal dhe në atë evropian, duke mbrojtur konsumatorët nga gërryerja e fuqisë blerëse. Në të njëjtën kohë, normat më të ulëta të inflacionit kanë mundësuar një rritje më të ngadaltë të normës bazë, duke prodhuar



një ndikim më pak negativ në rritjen ekonomike. Së dyti, mbiçmimi i kursit ka ndikuar pozitivisht në forcimin e stabilitetit financiar. Kjo është pasqyruar në përmirësimin e aftësisë paguese të huamarrësve në valutë, çka ka ndikuar në përmirësimin e cilësisë së bilanceve të sektorit bankar. Së treti, mbiçmimi i monedhës vendase ka reduktuar borxhin e jashtëm të sektorit privat e publik, duke rritur qëndrueshmërinë e tij afatgjatë, duke u bërë premisë për uljen e kostove të financimit.


Nga ana tjetër, forcimi i kursit të këmbimit ka ndikime jo të njëtrajtshme në aspektin sektorial, në varësi të ekspozimit që këta sektorë kanë ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit, fleksibilitetit financiar dhe operacional të tyre, si dhe koniunkturës së kërkesës së huaj për sektorin. Në këtë kontekst, forcimi i lekut gjatë vitit 2023 ka rënduar pozicionin financiar dhe konkurrues të disa segmenteve të sektorit të eksportit, të cilat përgjithësisht kanë mundësi të ulëta për negociimin e çmimeve, marzhe të ulëta fitimi operacional, si dhe përballen aktualisht me një kërkesë të ulët në ambientin ndërkombëtar. Në planin afatshkurtër, goditja ndaj këtyre sektorëve është adresuar nëpërmjet lehtësive të përkohshme fiskale, si një instrument më i përshtatshëm për trajtimin selektiv të problemeve të tyre. Megjithatë, në planin afatmesëm e afatgjatë, bizneset e këtyre sektorëve duhet të rritin përpjekjet për ristrukturim, në drejtim të rritjes së produktivitetit, të gjetjes së tregjeve të reja dhe të përdorimit më të madh të instrumenteve të mbrojtjes financiare ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit.

### Cili ka qenë reagimi i Bankës së Shqipërisë?

Ndonëse gjerësisht në linjë me fundamentet, forcimi i lekut gjatë vitit 2023 u shoqërua edhe me devijime afatshkurtra me natyrë psikologjike, të cilat ishin veçanërisht të pranishme në muajin korrik. Gjatë këtyre momenteve, shpejtësia e mbiçmimit shkaktoi pasiguri tek agjentët e tregut dhe krijoi një konsensus vetëshqyës prirës për forcim të mëtejshëm të tij. Këto pritje u shprehën në përsheptim të mbiçmimit, në zgjerim të spread-eve mes kuotimeve në shitje dhe në blerje të euros dhe në rritje të ndjeshme të luhatjeve të kursit të këmbimit.

Në këto rrethana, Banka e Shqipërisë ndërmori dy veprime, të cilat rezultuan të suksesshme në përmbajtjen e faktorit psikologjik dhe stabilizimin e tregut. Së pari, në datën 2 gusht, në deklaratën mbi vendimin e radhës të politikës monetare, Këshilli Mbikëqyrës shprehu gatishmërinë e Bankës së Shqipërisë

Grafik 22. Spread-et e kuotimit të kursit eur/lek (majtas) dhe luhatshmëria e tij (djathtas)




për të ndërhyrë në tregun valutor, në rast se këto fenomene do të rrezikonin përmbushjen e objektivit të inflacionit. Kjo deklaratë uli pasigurinë në treg dhe ndihmoi në qetësimin e tij. Së dyti, duke marrë shkas nga teprica e ofertës në valutë në treg, Banka e Shqipërisë vendosi të rrisë blerjet e valutës në tregun valutor, me qëllim rritjen e rezervës valutore për vitin 2023, nga intervali fillestar prej 160 – 220 mln eurosh në intervalin 220 – 300 mln euro.

Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të jetë e vëmendshme ndaj ecurisë së kursit të këmbimit, për të kuptuar arsyet dhe pasojat e luhatjeve të tij. Kjo i shërben identifikimit sa më të saktë të ndikimit të kursit në inflacion, duke ndihmuar kështu në formulimin sa më të përshtatshëm të qëndrimit të politikës monetare.

Kurba e *yield*-eve të letrave me vlerë të qeverisë u ankorua pranë normës bazë në segmentin afatshkurtër dhe u sheshua në segmentin afatgjatë të saj. Pas mbireagimit ndaj normalizimit të qëndrimit të politikës monetare gjatë vitit 2022, si rrjedhojë e pasigurisë mbi fortësinë dhe kohëzgjatjen e presioneve inflacioniste, kurba e *yield*-eve shënoi një rënie në pjesën e parë të vitit 2023. Megjithatë, rënia e saj shkoi përtej korrektimit të mbireagimit. Interesi i lartë i tregut për të investuar në letra me vlerë dhe kërkesa e ulët e qeverisë për financim rezultoi në diferenca minimale të *yield*-eve ndaj normës bazë.

Grafik 23. Ecuria e *yield*-eve (majtas) dhe kurba e *yield*-eve (djathtas)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Yield*-et shënuan sërish rritje në tremujorin e katërt të vitit, në ndjekje të lëvizjeve të politikës monetare, por *spread*-et e tyre ndaj normës bazë të interesit mbetën të ulëta. Në terma mesatarë, niveli i *yield*-eve gjatë vitit 2023 nuk ndryshoi në mënyrë të qenësishme ndaj vitit të mëparshëm, por kurba e tyre u sheshua, duke reflektuar pritjet e tregut për rënie të inflacionit në të ardhmen. Krahasuar me periudhën përpara fillimit të ciklit normalizues të politikës monetare, *yield*-et janë 2.0 p.p. më të larta për maturitetet 1-5 vjet dhe 1.4 p.p. më të larta për ato 7-15 vjet, ndërkohë që norma bazë u rrit me 2.75 p.p.





Normat e interesit të kredisë në lekë janë rritur për bizneset dhe kanë mbetur të pandryshuara për kreditë hipotekare e ato konsumatore të individëve. Interesi për kreditë për biznese vijoi rritjen graduale të nisur vitin e kaluar. Për vitin 2023, ai rezultoi mesatarisht 6.7%, duke qenë 0.5 p.p. më i lartë se në vitin 2022 dhe 1.1 p.p. më i lartë se në vitin 2021. Ndërkohë, interesat mesatarë të kredive për individë mbetën të pandryshuar gjatë vitit 2023 në të dy segmentet kryesore të tij, përkatësisht 9.5% për kreditë konsumatore dhe 4.2% për kreditë hipotekare. Këto nivele janë 1.2 p.p. dhe 0.5 p.p. më të larta se në vitin 2021.



Në tërësi, sikurse edhe *yield*-et e letrave me vlerë të qeverisë, interesat e kredive janë rritur më pak se sinjalet e politikës monetare, si pasojë e reduktimit të primeve të rrezikut dhe e konkurrencës së rritur. Nga njëra anë, situata e mirë e likuiditetit në sistemin bankar ka diktuar rritje të ngadaltë të normës së interesit të depozitave, duke përcjellë presione të dobëta nga ana e kostove tek normat e interesit të kredive. Interesi i depozitave me afat ka shfaqur një ecuri graduale rritëse dhe rezultoi mesatarisht 1.6% në vitin 2023, ose 0.9 p.p. më lart se përpara fillimit të rritjes së normës bazë. Nga ana tjetër, përmirësimi i besimit të sektorit bankar dhe konkurrenca e shtuar në të, kanë rezultuar në reduktim të marzheve të rrezikut të kredisë. Në reflektim të kësaj, përgjatë gjithë vitit 2023 kanë mbizotëruar nivele të ulëta të diferencave të interesit të kredisë ndaj *yield*-it 12-mujor.

Interesat për kreditë në euro janë rritur ndjeshëm, në ndjekje të ecurisë së normave referencë për euron në tregun ndërkombëtar dhe të ciklit të politikës monetare në Eurozonë. Në vitin 2023, interesi mesatar për kreditë në euro u rrit me rreth 1.3 p.p., si për bizneset, ashtu edhe për kreditë hipotekare të individëve. Rritja më e shpejtë e interesave në euro ka sjellë ngushtimin e diferencës mes tyre dhe interesave në lekë, çka ka shërbyer si shtysë e rëndësishme në rritjen e kreditimit në monedhën vendase.




Kredia për sektorin privat u rrit me ritme të larta, e nxitur si nga një kërkesë e lartë për financim ashtu edhe nga kushtet financiare ende akomoduese<sup>9</sup>.

Portofoli i kredisë për sektorin privat u rrit me 9.9% gjatë vitit 2023, rritje kjo e ngjashme me atë të shënuar në dy vitet e fundit. Zgjerimi i kredisë gjatë vitit 2023 ka qenë në linjë me rritjen e kërkesës për fonde nga bizneset e familjet, në pasqyrim të zgjerimit të aktivitetit ekonomik, besimit të përmirësuar dhe nevojës së zgjerimit të kapaciteteve prodhuese. Paralelisht me kërkesën e shtuar, edhe oferta e kredisë bankare ka qenë përgjithësisht akomoduese. Ajo është nxitur nga likuiditeti i lartë, nga rreziku i ulët i perceptuar për kredinë, nga konkurrenca e shtuar dhe nga pozitat e shëndetshme të balanceve dhe të kapitalit.

Në terma të monedhës, viti 2023 është karakterizuar nga një interes i shtuar për kredinë në lekë, portofoli i së cilës është rritur me 15.6%, ndërkohë që kredia në valutë është rritur vetëm me 3.6%. Zgjerimi i ndjeshëm i kredisë në lekë ka reflektuar edhe zhvendosjen e financimit nga euro në lekë, si pasojë e mbiçmimit të fortë të lekut dhe e ngushtimit të diferencës së normave të interesit të kredisë në lekë ndaj atyre në euro. Këto dinamika janë reflektuar në një rritje të peshës së portofolit në lekë ndaj totalit në 56%, ose 5 p.p më shumë se një vit më parë.

Grafik 25. Ecuria e kredisë për sektorin privat dhe e depozitave të bankave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në terma sektorialë, rritja e kredisë ka qenë e pranishme si në segmentin e familjeve ashtu edhe në atë të bizneseve. Kredia për biznese u rrit me 8.0% gjatë vitit 2023, duke shfaqur njëkohësisht një orientim të rritur drejt kredisë në lekë dhe asaj për investime. Kredia për individë u rrit me 13%, duke pasqyruar zgjerimin me 13.3% të kredisë për blerje banesash dhe zgjerimin me 12.5% të kredisë për konsum.

<sup>9</sup> Të dhënat më të fundit të publikuara nga Departamenti i Statistikave i Bankës së Shqipërisë në datën 3 mars të vitit 2024.



### HAPËSIRË INFORMUESE 3

#### ECURIA E KREDISË PËRBALLË NEVOJAVE TË ZHVILLIMIT DHE KRAHASIMI ME RAJONIN

Sektori bankar është segmenti më i rëndësishëm i sektorit financiar në Shqipëri, duke zotëruar më shumë se 90% të aktiveve të këtij sistemi. Për këtë arsye, si administrues i kursimeve të familjeve dhe si furnizues me fonde i ekonomisë, ai ka një rol mjaft të rëndësishëm në dinamikën e zhvillimit të vendit dhe stabilitetin e përgjithshëm ekonomik e financiar të tij. Kjo hapësirë informuese synon të japë një këndvështrim të përgjithshëm mbi ecurinë e kreditimit në vend, të parë si në dimensionin kohor ashtu dhe në kontekstin rajonal.


**Kredia për sektorin privat ka pasur një trend pozitiv zhvillimi gjatë viteve të fundit, si në aspektin sasior edhe në atë cilësor.**

Në aspektin sasior, ritmi i rritjes së kredisë ka ardhur në përmirësim progresiv, duke shënuar norma dyshifrore rritjeje gjatë dy viteve të fundit. Ky trend është më i dukshëm pas vitit 2013, periudhë e cila përkon me fillimin e reduktimit të pasojave që la kriza financiare globale (2008-2009) dhe kriza e borxhit sovran në Evropë (2011 – 2013). Këto pasoja patën formën e rritjes së shpejtë të kredive me probleme, të rishikimit të modelit të biznesit të industrisë bankare, si dhe të shtrëngimit të kërkesave rregullatore, në vend dhe në botë. Adresimi i tyre kërkoi një reformë të përgjithshme të aktivitetit të sektorit bankar, ku, përveç rishikimit të kërkesave rregullatore në funksion të përmirësimit të proceseve të administrimit të rrezikut nga vetë bankat, një fokus të veçantë pati programi kombëtar për reduktimin e kredive me probleme dhe konsolidimi i sektorit bankar në Shqipëri. Këto reforma ishin esenciale për reduktimin e rrezikut të kreditit dhe rritjen e konkurrencës në sektorin bankar, si premisa të rëndësishme për përmirësimin e ofertës së kredisë.

Në aspektin cilësor, portofoli i kredisë bankare ka shfaqur: (i) një orientim në rritje ndaj kreditimit në lekë (Grafiku 27, paneli majtas), duke rritur qëndrueshmërinë e tij ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit dhe duke përmirësuar efektivitetin e transmetimit të politikës monetare; (ii) një rritje të peshës së kredisë për investime të bizneseve dhe të peshës së kredisë për banesa (Grafiku 27, paneli qendror); si dhe, (iii) një përmirësim të shpejtë të cilësisë së portofolit të kredisë, të ilustruar nga reduktimi progresiv dhe nivelet minimale të raportit të kredive me probleme (Grafiku 27, paneli djathtas).

Paralelisht me këto zhvillime, dinamikën e kreditimit në vend sugjerojnë se sektori bankar ka qenë një faktor i rëndësishëm mbështetës i procesit të ristrukturimit të ekonomisë. Dinamikën sektoriale të zhvillimit të vendit gjatë dekadës së fundit tregojnë një rritje më të shpejtë të peshës së sektorit të industrisë dhe të shërbimeve, e në veçanti të turizmit, dhe një rritje më të ngadaltë të sektorit të ndërtimit dhe të bujqësisë (Grafiku 28, paneli majtas). Në mbështetje të këtyre


Grafik 26. Normat vjetore të rritjes së kredisë për sektorin privat (në %)



Burimi: Banka e Shqipërisë.




Grafik 27. Struktura e portofolit të kredisë në terma të përbërjes valutore (majtas, në mld. lekë) dhe të destinacionit (qendër, në mld. lekë), si dhe treguesi i kredisë me probleme (djathtas, në përqindje)



zhvillimeve, portfoli i kredisë bankare ka shfaqur, po ashtu, një orientim në rritje drejt kreditimit të sektorit të shërbimeve dhe atij të turizmit, dhe një rritje më të ngadaltë të kredisë për sektorin e ndërtimit dhe atë të tregtisë (Grafiku 28, paneli djathtas).


Grafik 28. Dinamikat sektoriale të ekonomisë shqiptare dhe ecuria e kredisë (indeks, 2010 = 100)



Në kontekstin rajonal, ecuria e kredisë në Shqipëri shfaq një dinamikë të ngjashme me atë të vendeve të rajonit, si në terma të ritmit të rritjes (Grafiku 29, paneli majtas) ashtu edhe në terma të raportit të kredisë ndaj PBB-së.



Grafik 29. Ecuria e kredisë në Shqipëri dhe në disa vende të Evropës Lindore (paneli majtas, indeks 2010 = 100) dhe raporti i saj ndaj PBB-së (paneli djathtas, në %)




Kjo analizë grafike sugjeron dy konkluzione të rëndësishme.

- Së pari, ritmi i rritjes së kredisë në Shqipëri shfaq një dinamikë të ngjashme kohore me atë të rajonit (paneli majtas). Në përgjithësi, ritmi i rritjes së kredisë ishte i ngadaltë në periudhën 2011 – 2015 dhe më i shpejtë në atë pasuese. Kjo dukuri diktohet nga problemet e ngjashme që patën ekonomitë e rajonit, në përballjen e tyre me goditjet e forta financiare të fillimit të dekadës së kaluar. Në veçanti, ai ilustron rolin e rëndësishëm që ka ambienti i përgjithshëm financiar në Eurozonë dhe oreksi për rrezik i investitorëve të këtij rajoni, të cilët zotërojnë kuota të konsiderueshme të sektorit bankar e financiar në vendet e Evropës Qendrore e Lindore.
- Së dyti, raporti i kredisë ndaj PBB-së ka qenë në rënie për të gjitha këto vende (paneli djathtas). Kjo ecuri sugjeron nevojën e diversifikimit të mëtejshëm të sistemit financiar, në vend e në rajon, me segmente të tjera të tregut të kapitalit, të cilat përmirësojnë strukturën e ofertës së fondeve.

Gjithashtu, raporti i kredisë ndaj PBB-së në Shqipëri paraqitet më i ulët se ai në vendet e rajonit. Një analizë më e detajuar e këtij konstatimi sugjeron se shkalla e kreditimit të bizneseve në Shqipëri është e krahasueshme me atë të vendeve të rajonit, madje ajo është mbi mesataren e tyre (Grafiku 30, paneli majtas). Nga ana tjetër, kredia për individë është ndjeshëm më e ulët se ajo e vendeve të rajonit (Grafiku 30, djathtas), duke sjellë dhe peshën relativisht më të ulët të raportit total. Ky tipar i fundit mund të shpjegohet me shkallën e lartë të informalitetit që ka pasur historikisht tregu i punës në Shqipëri, faktor i cili redukton aksesin në kredi të familjeve shqiptare.



Grafik 30. Kredia për biznese (paneli majtas) dhe për familje (paneli djathtas) në Shqipëri dhe në rajon (në % të PBB-së)



Burimi: Banka e Shqipërisë, Eurostat, banka qendrore të vendeve të rajonit.

*Në mbyllje të kësaj hapësire informuese, mund të dalim në përfundimin se kredia bankare në Shqipëri është në një fazë pozitive zhvillimi, të diktuar nga përmirësimi i ofertës së kredisë bankare, të orientuar në mbështetje të ristrukturimit të ekonomisë, të karakterizuar nga përmirësime cilësore të portofolit të kredisë, si dhe me një profil të ngjashëm zhvillimi me kredinë në vendet e rajonit.*

*Këto trende pozitive, si dhe bilancet e shëndetshme të sektorit bankar dhe rritja e konkurrencës në të, japin sinjale pozitive për rritjen e mëtejshme të saj, në mbështetje të zhvillimit të shpejtë e të qëndrueshëm të vendit.*

Zgjerimi i depozitave në banka ka qenë në nivele të larta, duke qenë më se i mjaftueshëm për mbulimin e nevojave për fonde të sektorit privat dhe publik.

**Depozitat bankare u rritën me 11.5% gjatë vitit 2023.** Zgjerimi i tyre pasqyroi ciklin pozitiv të ekonomisë, si dhe rritjen e interesit për të depozituar kursimet në banka, si pasojë e normave më të larta të kthimit të tyre. Rritja e depozitave u mbështet – në masën më të madhe – në zgjerimin e depozitave në valutë, të cilat shënuan norma të qëndrueshme rritjeje, rreth nivelit 15%, gjatë gjithë vitit. Nga ana tjetër, depozitat në lekë u rritën me 7.5%, duke pasqyruar thellimin e ndërmjetësimit në lekë dhe zhvendosjen e kursimeve të individëve, nga tregu i letrave me vlerë në depozita bankare.

**Në aspektin sektorial, rritja e depozitave ka qenë e pranishme si në segmentin e individëve dhe në atë të bizneseve.** Depozitat e bizneseve u rritën me rreth 20% gjatë vitit 2023, të nxitura nga përmirësimi i likuiditetit të tyre, si pasojë e rritjes së përgjithshme të vëllimit të aktivitetit dhe e sezonit të mirë turistik. Paralelisht me to, depozitat e individëve u rritën me 9.6%.



**Sipas afatit të maturimit të depozitave**, vihet re një rritje e afatit mesatar të maturimit të depozitave, si pasojë e rritjes më të shpejtë të normave të interesit në horizontet më të gjata kohore. Norma vjetore e rritjes së depozitave me afat arriti në nivelin 12.8%, duke qenë ndjeshëm më e lartë se ajo e shënuar dy vjet më parë, para fillimit të ciklit normalizues të politikës monetare. Zhvendosja ka qenë më e dukshme për depozitat mbi dy vjet, pesha e të cilave ndaj totalit arriti në 17.3% rreth 2.1 p.p më shumë se një vit më parë. Kjo zhvendosje është konfirmuar si në depozitat në lekë ashtu edhe në ato në valutë.

Tabelë 5. Tregues kryesorë makroekonomikë dhe financiarë

	2019	2020	2021	2022	2023*
<b>Inflacioni (mesatar)</b>					
Inflacioni total (në %)	1.4	1.6	2.0	6.7	4.8
Inflacioni bazë (në %)	0.7	1.4	1.7	6.5	5.3
<b>Rritja ekonomike</b>					
Rritja reale e PBB-së (vjetore në %)	2.1	-3.3	8.9	4.9	3.3
<b>Tregu i punës<sup>1</sup></b>					
Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës	69.6	69.1	69.3	73.2	75.9
Norma e papunësisë (15+)	11.6	11.7	11.5	11.0	10.7
<b>Sektori fiskal</b>					
Balanca buxhetore (me grantet, % të PBB)	-1.9	-6.7	-4.6	-3.7	-1.4
Të ardhurat buxhetore (në % të PBB-së)	27.2	25.9	27.5	26.8	27.8
Shpenzimet buxhetore (në % të PBB-së)	29.1	32.6	32.1	30.4	29.2
Borxhi publik (në % të PBB-së)**	65.8	74.3	74.5	64.5	59.2
<b>Sektori i jashtëm</b>					
Llogaria korrente (përfshirë transfertat zyrtare, në % të PBB-së)	-8.4	-8.5	-8.0	-6.1	0.1
Importet në mallra (fob, në % të PBB-së)	29.4	28.4	33.6	34.5	29.9
Eksportet në mallra (fob, në % të PBB-së)	6.6	6.0	8.3	10.7	8.6
Investimet e huaja direkte (% PBB-së)	7.8	7.0	6.8	7.6	7.3
<b>Sektori monetar e financiar</b>					
Norma e repo-s (fund periudhe)	1.00	0.50	0.50	2.75	3.25
Agregati M3 (rritje vjetore, fund periudhe)	4.3	10.5	8.6	5.2	2.0
Kredia për sektorin privat (rritje vjetore, fund periudhe) <sup>2</sup>	8.4	9.0	10.2	10.6	9.9
Depozita/PBB-së <sup>3</sup>	70.1	77.7	75.9	70.0	68.2
Kredi/PBB-së <sup>3</sup>	31.5	35.2	33.9	31.5	30.6
Yieldi 12-mujor (mesatar)	1.6	1.9	1.8	3.2	3.7
Kursi i këmbimit, lek/usd (mesatar)	109.9	108.7	103.5	113.0	100.7
Kursi i këmbimit, lek/euro (mesatar)	123.0	123.8	122.5	119.0	108.7
Kursi nominal efektiv, NEER	92.0	89.9	86.4	78.6	67.9
<b>Sektori Bankar</b>					
Raporti i kredive me probleme/kredi total (%)	8.4	8.1	5.6	5.0	4.7

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE).


\*Të dhënat për rritjen ekonomike, për tregun e punës dhe për sektorin e jashtëm i përkasin 9-mujorit të parë të vitit 2023.

\*\* Të dhënat e borxhit publik për vitin 2023 i përkasin 9-mujorit të parë të vitit.

1/ "Rezultate të Anketës së Forcave të Punës", publikim i INSTAT.

2/ Bazuar në të dhënat e flukseve monetare publikuar nga Departamenti i Statistikave. Të dhënat janë të rregulluar për efektin e kursit të këmbimit dhe të kredive të nxjerra nga bilanci.

3/ Vlerësim i PBB-së për vitin 2023. Të dhënat në raport me PBB-në janë llogaritur mbi këtë vlerësim, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.



## 2.2. OPERACIONET MONETARE

Zbatimi i politikës monetare nga Banka e Shqipërisë realizohet nëpërmjet instrumenteve të grupuara në: operacionet e tregut të hapur, lehtësirat e përhershme dhe rezervën e detyruar. Operacioni kryesor i tregut është marrëveshja e riblerjes dhe e anasjelltë e riblerjes me maturim shtatëditor, norma e interesit të së cilës përcaktohet nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë dhe referohet si norma bazë e interesit.


### OPERACIONET NË TREG TË HAPUR DHE ADMINISTRIMI I NEVOJAVE PËR LIKUIDITET

Në tërësinë e operacioneve të tregut të hapur bëjnë pjesë operacioni kryesor i rifinancimit, në formën e marrëveshjes (së anasjelltë) të riblerjes me kohëzgjatje 7-ditore, operacione rregulluese me kohëzgjatje 1-ditore ose 8 ditë deri 3 muaj, si dhe operacionet strukturore të shitblerjes me të drejta të plota të titujve në tregun sekondar. Këto operacione shërbejnë për përmbushjen e objektivit operacional të Bankës së Shqipërisë: orientimin e normave afatshkurtra të interesit të tregut ndërbankar pranë normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë dhe minimizimin e luhatjeve të tyre.

Përgjatë vitit 2023, pjesëmarrëse në injektimet javore kanë rezultuar mesatarisht 5 banka - nivel i njëjtë me një vit më parë. Vëllimi mesatar i likuiditetit të

përkohshëm të injektuar ka rezultuar me rritje në nivelin 45.60 mld lekë kundrejt 40.80 mld lekëve një vit më parë. Vëllimi është përqendruar në 65% me kohëzgjatje javore dhe 35% me kohëzgjatje 3-mujore.

Norma mesatare e injektimit javor është luhatur në bandën +2 pikë bazë deri +24 pikë bazë nga norma bazë, dhe ka rezultuar mesatarisht +7.37 pikë. Diferenca maksimale është parë në muajt janar e shkurt, ndërsa banda më afër mesatares historike ka rezultuar në tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit 2023.



Tabelë 6. Struktura e operacioneve injektuese të likuiditetit nga Banka e Shqipërisë

	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Instrumenti kryesor	55%	80.7%	61.6%	54%	61%	56%	59%	63%	65%
Injektimet afatgjata	45%	19.3%	39.4%	46%	39%	44%	41%	37%	35%

Burimi: Banka e Shqipërisë.





### LEHTËSITË E PËRHERSHME

Lehtësitë e përherëshme – depozita njëditore dhe kredia njëditore pranë Bankës së Shqipërisë – i shërbejnë bankave të nivelit të dytë për të administruar likuiditetin në bazë ditore. Këto lehtësi përcaktojnë një korridor në të cilin luhaten normat e interesit në tregun ndërbankar. Në vitin 2023, Banka e Shqipërisë ndryshoi dy herë normën bazë dhe paralelisht me të dhe normën e depozitës dhe kredisë njëditore në nivelin aktual 3.25%, 2.25% dhe 4.25%, përkundrejt 2.75%, 1.75% dhe 3.75% në fillim të vitit.

Korridori ka vijuar të jetë simetrik me +/- 100 pikë, i pandryshuar përgjatë vitit. Instrumenti i depozitës njëditore ka gjetur përdorim në 519 raste, me vëllim mesatar ditor prej 8.86 mld lekësh, krahasuar me mesataren prej 9.1 mld lekësh në 2022 dhe niveleve 4.60-6.60 mld në periudhën 2018-2021. Kredia njëditore është përdorur me frekuencë në rritje në 54 raste, përkundrejt 22 rasteve përgjatë vitit 2022.

### REZERVA E DETYRUAR

Rezerva e detyruar është instrument me anë të së cilit Banka e Shqipërisë synon të rregullojë gjendjen e likuiditetit të sistemit, si dhe të ndihmojë në stabilizimin e normave të interesit në tregun ndërbankar. Në vitin 2023 nuk ka pasur ndryshime rregulative sa i përket përqindjes së detyrimeve në lekë dhe valutë që bankat duhet të mbajnë si rezervë të detyruar në Bankën e Shqipërisë. Ndryshimi i fundit rregullator ishte në vitin 2018, në kuadër të programit të deeuroizimit, ku norma e rezervës së detyruar u ul për detyrimet në monedhën vendase dhe u rrit për monedhat e huaja<sup>10</sup>.

Përgjatë vitit 2023, bankat kanë shfrytëzuar mundësinë e mesatarizimit të gjendjes së llogarisë në nivelin e rezervës së detyruar në lekë, duke ruajtur nivelin minimal ditor prej 30% të rezervës së detyruar, me frekuencë të ngjashme me vitin 2022. Bankat tregtare kanë vijuar të remunerohen për rezervën e detyruar në lekë në vlerën 100% të normës bazë. Sa i përket rezervës së detyruar në valutë, bankat janë remuneruar me 0% si për dollarin amerikan ashtu edhe për euron.

Përgjatë vitit nuk ka pasur ndryshime në normat e remunerimit të rezervave të tepërta në lek, euro dhe dollar amerikan, të cilat vijuan të ishin 0%.

<sup>10</sup> Në vija të përgjithshme, norma e rezervës së detyruar u ul në 7.5% për monedhën lekë dhe u rrit në 12.5% për monedhën Euro nga niveli i padiferencuar 10% i aplikuar më parë.



## 2.3. STABILITETI FINANCIAR DHE POLITIKA MAKROPRUDENCIALE

Sipas kuadrit ligjor në fuqi, Banka e Shqipërisë ndjek dhe kujdeset për mbarëvajtjen e sistemit bankar dhe sistemit financiar, duke i shërbyer ruajtjes së stabilitetit financiar në vend. Për të arritur këtë objektiv, Banka e Shqipërisë harton dhe zbaton politikën makroprudenciale, e cila synon të identifikojë, vlerësojë, parandalojë dhe zbusë rreziqet sistemike në sistemin financiar. Objektivat e ndërmjetëm, treguesit e rreziqeve, si dhe instrumentet që mund të përdoren për secilin rrezik përshkruhen në mënyrë të hollësishme në Strategjinë e Politikës Makroprudenciale. Së bashku me Ministrinë e Financave, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, Banka e Shqipërisë është anëtare e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar - një strukturë ndërinstytucionale me natyrë këshillimore, e cila asiston në ruajtjen, stabilitetin dhe zhvillimin e tregjeve financiare në Republikën e Shqipërisë.

Në raportet e rregullta dhe analizat e vrojtimeve që publikon Banka e Shqipërisë ofrohet informacion mbi zhvillimet në sektorin bankar dhe në sistemin financiar. Aty shtjellohen rreziqet potenciale dhe ato të evidentuara gjatë analizave, instrumentet e zbatuara për të zbutur dhe parandaluar rreziqet, situata financiare e bizneseve dhe familjeve, rezultatet e ushtrimeve të provës së rezistencës së sektorit bankar ndaj skenarëve të pafavorshëm makrofinanciarë, si edhe ndikimin e masave makroprudenciale në fuqi.

### 2.3.1. ZHVILLIMET KRYESORE NË SISTEMIN FINANCIAR DHE SEKTORIN BANKAR

Vëllimi i aktivitetit të sistemit financiar ka ardhur në zgjerim gjatë vitit 2023, në të gjitha segmentet e tij<sup>11</sup>. Rritja më e shpejtë është regjistruar në aktivet<sup>12</sup> e fondeve të pensionit (14%), fondeve të investimit (8%) dhe shoqërive të sigurimit (7%). Nga ana tjetër, aktivet<sup>13</sup> e sektorit bankar dhe të institucioneve financiare jobanka u zgjeruan me rreth 5% në terma vjetorë. Treguesit e lidhur me cilësinë e aktiveve dhe me përfitueshmërinë e subjekteve financiare u përmirësuan gjatë vitit 2023. Nivelet e ekspozimit neto brenda sistemit financiar dhe në raport me sektorët e tjerë rezidentë dhe jorezidentë mbeten të kontrolluara. Mjetet e sistemit financiar mbizotërohen nga investimet në letra me vlerë të borxhit dhe nga huatë. Rreth 80% e detyrimeve përfaqësohen nga depozitat e bizneseve dhe të individëve rezidentë pranë bankave. Në raport me sektorët e tjerë, sektori financiar është huamarrës neto ndaj individëve dhe huadhënës neto ndaj sektorit jorezident, ndaj bizneseve dhe ndaj qeverisë.


<sup>11</sup> Pësha e aktiveve të sistemit financiar në raport me PBB-në arriti në 93% nga 97% në fund të vitit 2022. Kjo ecuri lidhet me rritjen më të shpejtë të PBB-së nominale në krahasim me zgjerimin e aktiveve të sistemit financiar, në kushtet kur zgjerimi i bilanceve financiare është frenuar nga efekti statistikor i mbicimit të kursit të këmbimit gjatë dy viteve të fundit.

<sup>12</sup> Për periudhën dhjetor 2022 – shtator 2023.

<sup>13</sup> Për periudhën dhjetor 2022 – dhjetor 2023.



Grafik 32. Pozicioni neto i korporatave financiare sipas instrumenteve (majtas) dhe sipas kundërpasive (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sektori bankar rezultoi i qëndrueshëm dhe me parametra të mirë të shëndetit financiar gjatë vitit 2023. Ky sektor ka një rezultat financiar pozitiv, një nivel të lartë të treguesve të likuiditetit e të kapitalizimit të veprimtarisë, dhe me tregues të përmirësuar të cilësisë së kredisë. Gjithashtu, ai shfaqet rezistent ndaj goditjeve dhe me rreziqe të kontrolluara.

Rezultati financiar ishte pozitiv dhe ndjeshëm më i lartë se një vit më parë. Nivelet e kapitalizimit vlerësohen të mira dhe raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit shënoi vlerën 19%. Totali i aktiveve të sektorit bankar zë mbi 90% të aktiveve të sistemit financiar dhe, gjatë vitit 2023, ai u rrit me rreth 5%. Këtu, kontributin kryesor e dhanë investimet në tituj të borxhit dhe kreditimi, të cilët u financuan nga një rritje e mirë e depozitave. Tek këto të fundit, kontributin kryesor e dhanë depozitat me afat, kryesisht të individëve, dhe llogaritë rrjedhëse. Sipas monedhës, rritjet e depozitave në lek dhe në valutë ishin të përafërta.

Tabelë 7. Tregues të aktivitetit të sistemit financiar

	2019	2020	2021	2022	2023
<b>Tregues të shëndetit financiar (sektori bankar)</b>					
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të peshuara me rrezik (%)	18.7	18.7	18.5	18.8	19.4
Huatë me probleme bruto ndaj totalit të huave (%)	8.4	8.1	5.7	5.0	4.7
Kthimi nga kapitali (bazë vjetore, %)	13.0	10.4	12.6	11.8	17.3
Shpenzime jointerese ndaj të ardhurave bruto (%)	57	55	55	60	53
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (%)	49	47	46	41	43
Depozita/Kredi (%)	207	211	214	212	217
Hua në valutë të huaj ndaj totalit të huave (%)	51	50	51	51	46
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit rregullator (%)	7.4	7.9	8.9	4.8	6.1
<b>Pesha e aktiveve ndaj PBB-së (%)*</b>					
Sektori bankar	87.2	97.8	93.9	87.8	84.5
IFJB	3.9	4.2	4	3.8	3.8
SHKK dhe Unioni	0.6	0.7	0.7	0.7	0.6
Shoqëri sigurimi	2.0	2.4	2.2	2.0	2.0
Fonde pensioni	0.2	0.2	0.2	0.3	0.3
Fonde investimi	4.0	4.2	4.1	1.9	2.0
<b>Sistemi financiar</b>	<b>97.9</b>	<b>109.5</b>	<b>105.1</b>	<b>96.5</b>	<b>93.1</b>

Burimi: Banka e Shqipërisë. \*Shtator 2023



Cilësia e kredisë bankare ka vijuar të përmirësohet edhe gjatë vitit 2023. Rënia në 4.7% e raportit të kredive me probleme nga 5.0% një vit më parë, ishte rezultat i rritjes së kredisë së përgjithshme dhe i zvogëlimit të stokut të kredive me probleme, kryesisht gjatë gjysmës së dytë të vitit. Fluksi i kredive me probleme të shlyera dhe me status të përmirësuar gjatë vitit ishte rreth 20 mld lekë, ose sa 54% e stokut të kredive me probleme në fillim të vitit.

Gjatë vitit 2023, sektori bankar gjeneroi një fitim prej 32 mld lekësh ose 1.5 herë më të lartë në krahasim me një vit më parë. Kjo ecuri lidhet me një rritje më të shpejtë të të ardhurave nga veprimet me klientët, nga investimet në letra me vlerë, nga veprimet me thesarin dhe ndërbankare, si dhe nga investimet në mjete financiare, në krahasim me rritjen e shpenzimeve të bankave për interesat e paguara për depozitat e klientëve dhe për kostot operacionale. Tek kredia, aktiviteti i bankave në lek ka siguruar më shumë të ardhura në krahasim me atë në valutë, ndërsa tek veprimet me thesarin dhe ato ndërbankare, aktiviteti në valutë ka rezultuar më fitimprurës. Shpenzimet për provigjione për kreditë me probleme ishin disi më të larta në krahasim me një vit më parë. Raporti i shpenzimeve operacionale ndaj të ardhurave bruto të sektorit bankar ra në 53%, nga 60% në fund të vitit 2022.

### 2.3.2. VLERËSIMI I RREZIQEVE SISTEMIKE DHE MASAT MAKROPRUDENCIALE

Gjatë vitit 2023, Banka e Shqipërisë ka vijuar punën për zgjerimin e bazës rregullative dhe metodologjike për kontrollin e rreziqeve sistematike, të përcaktuara në dokumentin e Strategjisë së Politikës Makroprudenciale, dhe ka shtuar vëmendjen drejt identifikimit dhe analizës së rreziqeve financiare më të reja që shoqërojnë zhvillimet teknologjike dhe ndryshimet e klimës. Në të njëjtën kohë, është monitoruar rregullisht ecuria e treguesve të përzgjedhur për vlerësimin e rreziqeve sistematike dhe ndikimin e masave makroprudenciale të zbatuara. Për këto qëllime, është vijuar me kryerjen e vrojtimit të posaçme dhe, në zbatim të Memorandumit të vitit 2017<sup>14</sup>, është publikuar rregullisht raporti gjashtëmujor "Mbi ecurinë e treguesve që monitoron Banka e Shqipërisë në kuadër të procesit të deeuroizimit".

#### VLERËSIMI I RREZIQEVE SISTEMIKE

Banka e Shqipërisë përdor një sërë treguesish, modelesh dhe vrojtimesh për vlerësimin e rreziqeve sistematike. Analizat e brendshme si "Raportet mujore mbi treguesit e shëndetit financiar për sektorin bankar", raporti mbi "Zhvillimet në treguesit e Hartës Makroprudenciale të Rreziqeve Sistematike" dhe analizat e rezultateve të ushtrimeve të provave të rezistencës informojnë diskutimet dhe vendimmarrjen makroprudenciale. Materialet publike, si Raporti i Stabilitetit Financiar dhe analizat e vrojtimit, përveç vendimmarrjes, mbështesin njëkohësisht transparencën dhe llogaridhënien e Bankës së Shqipërisë.

<sup>14</sup> Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Financave, Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare "Për zgjerimin e Përdorimit të Monedhës Kombëtare në Sistemin Financiar dhe në Ekonominë Shqiptare".



Rreziqet sistemike në sektorët bankar dhe financiar analizohen sipas katër objektivave të ndërmjetëm të politikës makroprudenciale. Ato monitorohen në bazë të treguesve të Hartës Makroprudenciale të Rreziqeve Sistemike, ecuria e të cilëve sugjeron se rreziqet sistemike gjatë vitit 2023 kanë qenë të kontrolluara.

Tabelë 8. Harta e nxehtësisë për disa nga treguesit e rreziqeve sistemike sipas objektivave të ndërmjetëm<sup>15</sup>

Objekti i ndërmjetëm	Treguesi i rrezikut sistematik	2019	2020	2021	2022	2023															
Objekti 1: Zbutja dhe parandalimi i rritjes së tepruar të kreditimit dhe raporti i levës financiare.	Hendeku i kredisë për ekonominë ndaj PBB-së, p.p.	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1			
	Ndryshimi vjetor në tepricën e kredisë, %	5	5	5	5	7	7	7	7	7	5	7	7	8	8	8	8	7	5	5	5
	Ndryshimi vjetor i kredisë në valutë të pambrojtur nga kursi i këmbimit, %	8	7	7	5	5	5	5	7	7	8	9	7	5	5	5	10	11	9	8	8
	Ndryshimi vjetor i kredisë për blerje banesash - individë, %	7	7	7	7	8	8	8	8	8	9	9	9	10	10	10	9	9	8	8	8
Objekti 2: Zbutja dhe parandalimi i mospërputhjes së tepruar në maturitet dhe mungesës së likuiditetit në treg.	Hendeku aktive - pasive deri në 30 ditë, % e aktiveve	7	7	8	10	9	12	12	12	12	13	13	14	14	14	14	14	13	14	10	10
	Aktive likuide ndaj pasiveve afatshkurtra, %	2	2	1	1	3	3	2	3	3	3	3	3	9	8	8	7	5	5	5	5
	Pozicioni i hapur ndaj kapitalit rregullator, %	7	5	11	11	10	7	10	12	11	5	11	13	14	11	13	5	9	7	11	11
Objekti 3: Kufizimi i përqendrimeve të ekspozimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthorë.	Mjetet ndërkufitare ndaj totalit të aktiveve, %	9	8	9	9	11	7	7	5	5	7	8	5	5	5	5	5	4	5	5	5
	Detyrimet e SHKK+FJB ndaj sektorit bankar, % e aktiveve SHKK+FJB	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
	Ekspozimi i bankave ndaj 5 vendeve kryesore, % e aktiveve	12	11	12	13	13	5	5	5	4	5	5	5	3	2	2	1	2	1	3	3
Objekti 4: Kufizimi i ndikimit sistematik të stimujve të keqorientuar dhe i konfliktit të interesit.	Detyrimet e bankave ndaj jorezidentëve, % e detyrimeve	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
	Ekspozimi ndërbankar ndaj totalit të aktiveve, %	10	10	9	10	10	5	5	5	4	5	5	4	3	3	4	2	2	1	1	1
	Indeksi Herfindahl për Madhësinë (sektori bankar)	3	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	7	7	8	7	5	5	4	4
	Totali aktiveve bankare ndaj PBB-së, %	4	3	4	4	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5	4	3	3	3

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Treguesit që lidhen me rritjen e kredisë, pozicionin e likuiditetit, luhatjet në tregun valutor, përqendrimin e ekspozimeve dhe të aktivitetit të sistemit financiar, flasin për rreziqe të kontrolluara. Zonat më të nxehta të Hartës Makroprudenciale të Rreziqeve Sistemike lidhen me treguesit e kredisë në valutë, të hendekut negativ të likuiditetit midis aktiveve dhe detyrimeve për maturitetet afatshkurtra dhe të kredisë për blerje pasurish të paluajtshme. Këto rreziqeve janë zbutur nga rënia e kredisë në valutë të pambrojtur nga lëvizjet në kursin e këmbimit, ruajtja e niveleve të larta të aktiveve likuide të bankave, ruajtja e standardeve të përshtatshme të kreditimit për bizneset dhe individët nga ana e bankave, dhe nga rritja e normave të interesit të kredisë gjatë dy viteve të fundit. Bazuar në këto analiza, Banka e Shqipërisë nuk ka caktuar masa të reja makroprudenciale apo ndryshuar masat ekzistuese.

### MASAT MAKROPRUDENCIALE

Kuadri i masave makroprudenciale të zbatuara nga Banka e Shqipërisë aktualisht vijon të jetë i përqendruar tek shtesat makroprudenciale të kapitalit siç parashikohen në rregulloren nr. 41, datë 5.6.2019, "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit" (Rregullorja 41/2019). Pëmbushja e këtyre

<sup>15</sup> Ngjyra e gjelbër e hapur tregon nivele të ulëta të rrezikut; ngjyra e verdhë – portokalli nivele të mesme të rrezikut dhe ngjyra e kuqe e fortë tregon akumulim të rrezikut sistematik dhe shmangie të vlerës së treguesit me 1.5 ose më shumë devijime standarde ndaj vlerës – kufi ose të synuar.



kërkesave nga sektori bankar ndiqet nëpërmjet raportimeve tremujore dhe, në rastet kur konstatohet mospajtueshmëri, Banka e Shqipërisë kërkon përmbushje të shpejtë të kërkesave.

Deri në fund të vitit 2023, të gjitha bankat që kryejnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë ishin subjekt i kërkesës për shtesën konservuese të kapitalit (KONS) në nivelin 2.0%. Katër banka, të shpallura si sistemike në muajin mars të vitit 2022, kanë përmbushur një shtesë kapitali midis 0.5% dhe 1.5% të emërtuar si shtesa e kapitalit për rëndësinë sistemike (SIST). Shtesa kundërciklike e kapitalit (KUNC) zbatohet në përmbushje të Objektivit 1 dhe përdoret për të zbutur rritjen e tepërt të kredisë dhe për të rritur rezistencën e bankave gjatë periudhave të mbinxehjes së tregut të kredisë. Pavarësisht se ky instrument është aktiv, norma e shtesës për Shqipërinë, e cila shpallet në fund të çdo tremujori, ka mbetur e pandryshuar në vlerën 0%. Ky qëndrim lidhet me faktin që treguesit paraqesin nivele joshqetësuese të kreditimit aktual kundrejt peshës historike ndaj PBB-së. Në tërësi, sektori bankar, i ndihmuar nga një pozicion i mirë fillestar i nivelit të kapitalizimit, ka qenë i aftë për të përmbushur kërkesat makroprudenciale të kapitalit. Banka e Shqipërisë vlerëson që zbatimi i tyre, i ndërthurur me zbatimin e kërkesave të reja të lidhura me funksionin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, do të forcojë më tej rezistencën dhe shëndetin e sektorit bankar në vend.

### 2.3.3. KUADRI REGULLATIV DHE METODOLOGJIK

Gjatë vitit 2023, Banka e Shqipërisë ka hedhur disa hapa të rëndësishëm drejt plotësimit të kuadrit të politikës makroprudenciale. Baza rregullatore e institucionit është plotësuar me rregulloren mbi treguesit që mbështesin zbatimin e masave makroprudenciale me objekt kredimarrësin, ndërsa bashkësia e dokumenteve metodologjike është plotësuar me një variant më të plotë dhe të përmirësuar të metodologjisë së ushtrimit të provës së rezistencës për mjaftueshmërinë e kapitalit. Më konkretisht:

- Në muajin tetor të vitit 2023, hyri në fuqi rregullorja nr. 44, datë 04.10.2023, "Për raportimin e të dhënave, identifikimin dhe monitorimin e treguesve mbi kredidhënien dhe investimet për prona të paluajtshme". Kjo rregullore ka për qëllim të standardizojë mënyrat se si bankat përcaktojnë, monitorojnë dhe raportojnë treguesit për standardet e huadhënies dhe për ekspozimet e tyre në prona të paluajtshme. Ajo gjithashtu përcakton mënyrat se si bankat mund të zbatojnë vlerat kritike dhe nivelet-kufi për treguesit e vlerës së huasë ndaj të ardhurave, të vlerës së huasë ndaj vlerës së pronës dhe të vlerës së shërbimit të huasë ndaj të ardhurave. Rregullorja parashikon të drejtën e Bankës së Shqipërisë për t'i përdorur këta tregues si instrumente të politikës makroprudenciale, duke aplikuar, në rast nevojë, kufij të sipërm ose të poshtëm mbi nivelet e tyre. Subjekt i raportimit janë institucionet e licencuara nga Banka e Shqipërisë që japin hua për blerje apo investim në prona të paluajtshme, apo hua për të cilat kolaterali i përdorur



është një pronë e paluajjtshme. Miratimi dhe zbatimi i këtij akti nënligjor përafron më tej kuadrin makroprudencial të vendit me atë të Bashkimit Evropian. Rregullorja shoqërohet me 8 forma raportimi për kreditë e reja dhe për tepricën e kredive të akorduara nga bankat në nivel subjekti kredimarrës, për prona rezidenciale dhe tregtare. Konsolidimi i këtyre të dhënave me të dhëna nga burime të tjera do të mundësojë një bazë të dhënash cilësore, të detajuar dhe të plotë mbi ekspozimet e sektorit bankar në tregun e pronave të paluajjtshme.

- Në përputhje me strategjinë “Për administrimin dhe mbikëqyrjen e rreziqeve financiare të lidhura me klimën në sektorin financiar gjatë 2023-2025”, në kontekstin e stabilitetit financiar dhe me mbështetje teknike nga Qendra Këshillimore për Sektorin Financiar e Bankës Botërore, gjatë vitit 2023, puna u përqendrua në ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve analitike për vlerësimin dhe identifikimin e rreziqeve të klimës dhe plotësimin e mungesave në të dhënat e Panelit të Gjelbër për Shqipërinë. Strategjia parashikon ndërtimin e një ushtrimi të posaçëm të provës së rezistencës së sektorit bankar ndaj ndikimit të ndryshimeve klimatike dhe vlerësimin e kostove të mundshme të lidhura me zbatimin e një agjende të gjelbër në aktivitetin e sektorit bankar.

## HAPËSIRË INFORMUESE 4

### FINANCA E GJELBËR

*Ndryshimet klimatike janë një sfidë globale që nuk njeh kufij dhe prek të gjitha vendet. Nga këndvështrimi i Bankës së Shqipërisë, ndikimet e ndryshimeve klimatike mund të përkthehen në rezultate financiare që rrezikojnë qëndrueshmërinë e institucioneve financiare dhe sektorit privat, e si rrjedhojë prekin stabilitetin financiar dhe makroekonomik. Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë, në rolin e saj si mbikëqyrës dhe rregullator bankar, ka marrë angazhimin të japë kontributin e saj për të vlerësuar dhe menaxhuar rreziqet që rrjedhin nga ndryshimet klimatike, ku përfshihen ndryshime të mundshme strukturore në sistem financiar dhe në ekonomi, të cilat ndikojnë kryerjen e misioneve themelore të bankës lidhur me stabilitetin e çmimeve dhe stabilitetin financiar.*

*Si një hap konkret drejt adresimit të kësaj sfide, Banka e Shqipërisë ka zhvilluar dhe miratuar Strategjinë e Gjelbër Afatmesme 2023-2025 për “Administrimin dhe Mbikëqyrjen e Rreziqeve Financiare të Lidhura me Klimën në Sektorin Financiar”. Kjo strategji e hartuar në bashkëpunim me Bankën Botërore (FinSAC) dhe e miratua nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në maj të vitit 2023, synon të integrojë në mënyrë sistematike dhe të qartë rreziqet klimatike në dimensionet makroekonomike dhe financiare të bankës, bazuar mbi praktikatat më të mira ndërkombëtare dhe në përputhje me Planin e Veprimit të Komisionit të BE-së.*



Strategjia përcakton një plan të detajuar veprimi që përfshin ndërtimin dhe zgjerimin e kapaciteteve, hulumtimin dhe shpërndarjen e njohurive, vlerësimin dhe matjen e rrezikut, si dhe forcimin e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar. Plani i veprimit synon të përfshijë të gjitha aspektet dhe politikatat e Bankës së Shqipërisë, duke kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në menaxhimin efektiv të rreziqeve klimatike në sektorin financiar.

Banka e Shqipërisë po punon gjithashtu për rritjen e disponueshmërisë së të dhënave, përmirësimin e modeleve dhe vlerësimin e rreziqeve të lidhura me klimën. Element thelbësor i kësaj strategjie është dhe angazhimi për të hartuar një udhëzues rregullator për rrezikun klimatik. Qëllimi është të nxisë bankat t'i integrojnë ato në kuadrin e tyre të menaxhimit të rrezikut. Udhëzuesi do të shërbejë si bazë për dialogun me bankat, duke kërkuar nga ato të vlerësojnë, matin dhe menaxhojnë rreziqet klimatike. Procesi do të marrë parasysh harmonizimin me iniciativat e Bankës Qendrore Evropiane dhe praktikatat më të mira botërore.

Nëpërmjet strategjisë së gjelbër afatmesme dhe veprimeve konkrete, Banka e Shqipërisë synon të promovojë një qasje të integruar dhe të koordinuar. Kjo qasje përforcon rolin e Bankës së Shqipërisë si një institucion që ndikon pozitivisht në stabilitetin financiar dhe ekonomik të vendit, në përputhje me objektivat e qëndrueshmërisë globale.

| [https://www.bankofalbania.org/Rreth\\_Bankes/Financa\\_e\\_gjelber/](https://www.bankofalbania.org/Rreth_Bankes/Financa_e_gjelber/)





## 2.4. MBIKËQYRJA BANKARE

*Funksioni mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka si objektiv kryesor identifikimin e hershëm dhe marrjen e masave për reduktimin e rreziqeve të aktivitetit të sektorit bankar: rrezikut të kredisë, rrezikut të likuiditetit, rrezikut operacional, rrezikut të normës së interesit, rrezikut të kapitalit dhe të përfitueshmërisë, atij të reputacionit dhe pastrimit të parave etj. Gjithashtu synon dhe vlerësimin e efektivitetit të kontroleve të brendshme dhe të qeverisjes korporatave, si faktorë të rëndësishëm të zbutjes së rreziqeve në të gjithë sferën e veprimtarisë së bankave në veçanti, por edhe të subjekteve të tjera jobanka, të cilat licencohen nga Banka e Shqipërisë.*


*Veprimi në kohën e duhur, marrja e masave rregulluese efektive nëpërmjet mbikëqyrjes së vazhdueshme dhe zbatueshmëria e tyre, mbeten hallkat më të rëndësishme për të finalizuar me sukses qëllimin fundor që është ruajtja e shëndetit të subjekteve financiare.*

Sektori bankar u shfaq i mirëkapitalizuar, fitimprurës, me likuiditet të bollshëm dhe i karakterizuar nga një rrezik i ulët i ekspozimit ndaj kredisë gjatë vitit 2023. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit ishte 19%, kthimi nga kapitali u rrit në 17.3% në nivel vjetor, aktivet likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra u rritën në 43%, dhe treguesi i kredive me probleme ra në 4.74%. Në tërësi, portofoli i kredisë u rrit me 3.43%<sup>16</sup> gjatë vitit 2023. Bankat me kapital vendas e rritën peshën në totalin e aktiveve me rreth 1.8p.p. Kjo tendencë evidentohet në strukturën e burimit kryesor të financimit, të depozitave, me rreth 1.17%, si dhe të portofolit të kredisë me rreth 1.26%.

### 2.4.1. EKZAMINIMET NË VEND

Gjatë vitit 2023 janë kryer 8 ekzaminime në vend: 4 ekzaminime të plota në banka, 3 ekzaminime të plota në institucione financiare jobanka dhe një ekzaminim i plotë në shoqëri kursim-kreditit (SHKK).

<sup>16</sup> Në këtë përlogaritje është përjashtuar efekti i ndjeshëm i kursit të këmbimit, kur në mungesë të tij rritja e portofolit të kredisë do të ishte rreth 8%. Gjithashtu, ky tregues i referohet portofolit total të kredisë dhe jo asaj pjese që i takon sektorit privat, i cili analizohet në seksionin 2.1.6 të këtij raporti.



Tabelë 9. Numri i ekzaminimeve sipas tematikës për vitin 2023

Inspektime të kryera në subjekte	Rreziku Strategjik	Rreziku Organizativ	Rreziku i Kredisë	Rreziku i Likuiditetit	Rreziku i Normës së Interesit	Rreziku i Tregut	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit	Rreziku Operacional	Rreziku Reputacional	Përfitshmëria	Kapitali
2021	7	7	12	7	7	7	8	8	109*	6	6
2022	8	9	12	12	8	8	8	8	82**	8	12
2023	8	8	8	8	4	8	7	7	61***	8	8

\* Në vitin 2021 janë kryer ekzaminime në 90 zyra të këmbimit valutor për Rrezikun Reputacional dhe 19 ekzaminimet e tjera për këtë rrezik janë kryer në banka dhe institucione financiare jobanka. Ndër këto, ekzaminimet për këtë rrezik për 2 banka, 6 institucione financiar jobankë dhe 1 zyrë të këmbimit valutor janë kryer në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

\*\* Në vitin 2022 janë kryer ekzaminime në 70 zyra të këmbimit valutor për Rrezikun Reputacional dhe 12 ekzaminimet e tjera për këtë rrezik janë kryer në banka dhe institucione financiare jobanka.

\*\*\* Në vitin 2023 janë kryer ekzaminime në 50 zyra të këmbimit valutor për Rrezikun Reputacional dhe 11 ekzaminimet e tjera për këtë rrezik janë kryer në banka dhe institucione financiare jobanka.

Gjatë vitit 2023 janë ekzaminuar dy banka sistemike dhe dy banka josistemike. Për të parat fokusi kryesor ka qenë monitorimi i shkallës së plotësimit të kërkesave rregullatore për kapital, përfshirë edhe kërkesat për detyrime të pranvara dhe rezervat makroprudenciale. Rëndësi e përhershme i kushtohet edhe vlerësimit të sistemeve dhe kulturës së qeverisjes, administrimit të rreziqeve (të kredisë, likuiditetit, rreziqeve të tregut, atij operacional dhe reputacional), si dhe modelit të biznesit. Në përgjithësi, bankat sistemike kanë konsoliduar sistemet e administrimit të rreziqeve, por përmirësime të mëtejshme janë të nevojshme në kuadër të shtimit të treguesve që monitorohen, harmonizimit të oreksit për rrezik me tolerancën ndaj rrezikut, parametrizimit të stres-testeve etj. Krahas përputhshmërisë me kërkesat ligjore e rregullative, evidentohet se bankat duhet të sigurojnë një kulturë të qëndrueshme për një zbatim cilësor të parimeve “të një qeverisjeje të mirë”, të cilat përfshijnë ndarjen e përshtatshme të detyrave dhe linjave të raportimit, sigurimin efektiv të pavarësisë për pozicionet kyçe të kontrollit, si dhe mbikëqyrjen efektive nga organet e larta drejtuese.

Për bankat josistemike, vëmendja mbikëqyrëse është përqendruar tek masat dhe sistemet për sigurimin e përputhshmërisë së plotë me kërkesat ligjore e rregullative, hartimin dhe ndjekjen e planeve strategjike të realizueshme në raport me kapacitetin riskmbajtës të tyre, parakushtet e krijuara për të siguruar një rritje të shëndetshme të aktivitetit etj. Shqetësimet kryesore mbikëqyrëse për to mbeten krijimi i një niveli të mjaftueshëm të fondeve rezervë për humbjet apo zhvlerësimin e aktiveve dhe reflektimi në kohë i tyre në pasqyrat financiare të bankës, si dhe planifikimi dhe sigurimi i burimeve të mjaftueshme të kapitalit për mbështetjen e aktivitetit, në kushtet kur një pjesë e mirë e tyre nuk i përkasin grupeve më të mëdha bankare.

Gjatë vitit 2023, ekzaminimet e subjekteve jobanka dhe SHKK-ve kanë mbuluar subjekte të pagesave, të kredidhënies, qirasë financiare dhe mikrokredisë.



Fokusi i ekzaminimeve ka qenë modeli i biznesit, sistemet e qeverisjes, rreziku i kredisë, rreziqet e tregut dhe operacionale, saktësia e raportimeve në Bankën e Shqipërisë, transparencën me klientët dhe rreziku i pastrimit të parave. Nga ekzaminimet evidentohet se aktiviteti i këtyre subjekteve gjeneron të ardhura të qëndrueshme që kanë mbështetur kapitalin në vazhdimësi. Në përgjithësi, kuadri i brendshëm organizativ dhe rregullativ përputhet me madhësinë dhe kompleksitetin e subjekteve që kanë pozicion të konsoliduar në treg. Tek subjektet më të reja evidentohen mangësi dhe nevoja për plotësime e përmirësime, në përputhje me nivelin aktual të veprimtarisë. Në lidhje me saktësinë e raportimeve në Bankën e Shqipërisë, transparencën me klientët dhe parandalimin e pastrimit të parave, evidentohet përputhshmëri më e mirë të subjektet e konsoliduara në treg, ndërsa subjektet e tjera kanë shfaqur mangësi dhe shkelje të kërkesave rregullatore e ligjore.

Ekzaminimet kanë evidentuar gjithashtu nevoja për përmirësim e administrimit të përgjithshëm të rreziqeve financiare, rrezikut operacional dhe të TIK-së, sigurimit të burimeve njerëzore të mjaftueshme etj. Për shkeljet e evidentuara, Banka e Shqipërisë ka marrë masat përkatëse mbikëqyrëse, konkretisht: pezullimin e aktivitetit për një periudhë 6-mujore për një subjekt; dhe lëshimin e urdhrat për ndërprerjen e shkeljeve dhe gjatë administrimit të administratorit për një subjekt tjetër.

Gjatë vitit 2023, janë kryer 3 publikime të normave të interesit maksimale efektive (NEI), përfshirë edhe një publikim të ndërmjetëm, pas ndryshimeve rregullative që u realizuan në përgjigje të kërkesave të ardhura nga subjektet e sektorit të mikrofinancës.

## 2.4.2. RISHIKIMI I KUADRIT RREGULLATIV DHE METODOLOGJIK

Banka e Shqipërisë ka vijuar punën për plotësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullativ mbikëqyrës, nëpërmjet miratimit të akteve të reja dhe rishikimit të disa akteve në fuqi, duke e përafuar më tej këtë kuadër me acquis të BE-së, si dhe duke konsideruar zhvillimet e sistemit bankar e financiar në vend. Disa nga zhvillimet kryesore të kuadrit rregullativ dhe metodologjik gjatë vitit 2023, paraqiten më poshtë:

### 1. Në zbatim të kërkesave të ligjit 55/2020 "Për shërbimet e pagesave", Këshilli Mbikëqyrës miratoi:

- rregulloren "Për ushtrimin e veprimtarisë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pagesave", e cila përcakton kërkesat për mbikëqyrjen dhe rregullimin e veprimtarisë së institucioneve të pagesave, në zbatim të dispozitave të ligjit "Për shërbimet e pagesave". Rregullorja parashikon kërkesa prudenciale, kërkesa për drejtimin e përgjegjshëm dhe efektiv të institucioneve të pagesave, kërkesa për kapital, për mbrojtjen e fondeve dhe për administrimin e rreziqeve të këtyre institucioneve, si dhe kërkesa për kontabilitetin, auditimin dhe raportimin e tyre;
- disa ndryshime në rregulloren "Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë"



sipas sistemit raportues të unifikuar”, të cilat konsistojnë në rishikimin e kërkesave raportuese për disa subjekte të rregullores dhe përfshijnë përkatësisht: i) një sistem të ri raportues për institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike, të hartuar në përshtatje me kërkesat mbikëqyrëse që rrjedhin nga dispozitat e reja ligjore dhe kërkesat rregullatore për këto subjekte; ii) disa ndryshime në format e raportimit për subjektet financiare jobanka, për të pasqyruar ndryshimet më të fundit rregullatore për këto subjekte; si dhe iii) përfshirjen në sistemin elektronik të raportimit edhe të disa formularëve për bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit.

## **II. Në kuadër të përafrimit të mëtejshëm me acquis të BE-së, gjatë vitit 2023 u miratuan:**

- disa ndryshime në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” dhe rregulloren “Për mbikëqyrjen e konsoliduar”, të cilat konsistojnë në rishikimin e anekseve të rregulloreve në lidhje me formularët e raportimit të paketës COREP, si dhe udhëzuesit shpjegues për plotësimin e tyre si mbi baza individuale dhe të konsoliduara. Formularët e rishikuar reflektojnë ndryshimet e miratuara më parë në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, në lidhje me kërkesat për kapital për rrezikun e kredisë dhe për rrezikun e tregut, si dhe për ekspozimet në titullzime.

## **III. Zhvillime të tjera për rishikimin e kuadrit rregullator gjatë vitit 2023, përmenden:**

- miratimi i disa ndryshimeve në rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”, lidhur me aplikimin e NEIt maksimal për kredinë konsumatore dhe synojnë të sigurojnë një kalibrim më të saktë të përlllogaritjes dhe përcaktimit të NEIt maksimal; dhe
- miratimi i disa ndryshimeve në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”, të cilat lidhen me rishikimin e kërkesave mbi dokumentacionin që kërkohet për pagesat e kontributeve për anëtarësim dhe pagesat apo shtesat e kapitalit të SHKK-ve.

### **2.4.3. KUADRI LICENCUES DHE MIRATIMET**

Spektori bankar vazhdon të mbizotërohet nga filialet e grupeve të huaja bankare, me origjinë të kapitalit kryesisht nga BE-ja. Numri i bankave që operojnë mbetet i pandryshuar në 11 banka.

Gjatë vitit 2023, Banka e Shqipërisë dha miratimet paraprake për zotërimin e pjesëmarrjes influencuese (të drejtpërdrejtë) të aksioneve të kapitalit të 2 subjekteve financiare jobanka, ndryshimet në statutet e 3 bankave, emetimin e borxhit të varur nga 6 banka dhe shlyerjen nga 1 bankë, miratimin e emërimit të ekspertëve kontabël të autorizuar (audituesit ligjorë) për auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2023 të të gjitha bankave. Banka e Shqipërisë dha miratimet



për 66 administratorë të bankave, 23 anëtarë të këshillave drejtues dhe 15 të komiteteve të kontrollit, 28 drejtues ekzekutivë dhe drejtues të kontrollit të brendshëm.

Gjatë vitit 2023, rrjeti i bankave u zgjerua me 1 degë të re brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe me 1 degë të re jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Bankat kanë sjellë njoftime për mbylljen e 12 degëve/ agjencive brenda vendit, duke e mbyllur vitin 2023 me 391 degë/ agjenci bankare.

Tabelë 10. Struktura e pronësisë së bankave, numri i bankave (fund i periudhës)

	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Bankat në Shqipëri, prej të cilave:	16	16	16	14	12	12	12	11	11
I. Me kapital privat me shumicën e pronësisë <sup>1</sup> të huaj	13	13	13	11	8	8	8	6	6
• nga vendet e BE-së	9	9	9	7	6	6	6	5	5 <sup>2</sup>
• nga Turqia	1	1	1	1	1	1	1	1	1 <sup>3</sup>
• nga një institucion financiar ndërkombëtar (Arabia Saudite)	1	1	1	1	1	1	1 <sup>4</sup>		
II. Me kapital privat me shumicën e pronësisë vendase	3	3	3	3	4	4	4	5	5 <sup>5</sup>

Burimi: Banka e Shqipërisë.

1 "Shumicë" është në çdo rast shumica e thjeshtë e 50% të votave plus 1 votë.

2 Bankat me origjinë të kapitalit nga vendet e BE-së janë: Banka Intesa Sanpaolo Albania (Itali), Banka Raiffeisen (Austri), Banka Procredit (Gjermani), Banka OTP Albania (Hungari), Banka e Parë e Investimeve, Albania (Bullgari).

3 Banka Kombëtare Tregtare.


4 Banka e Bashkuar e Shqipërisë.

5 Bankat me shumicë kapitali vendas janë: Banka Union, Banka Credins, Banka Amerikane e Investimeve, Banka Tirana dhe Banka e Bashkuar e Shqipërisë.

Në vitin 2023, Banka e Shqipërisë pajisi me licencë 1 institucion të parasë elektronike dhe 1 subjekt financiar jobankë për ushtrimin e veprimtarisë "Blerja e kredive me probleme" dhe revokoi licencën e një subjekti me kërkesë të tij. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë miratoi ushtrimin e veprimtarisë financiare shtesë (ndërmjetës/agjent në sigurime) të 1 banke dhe të 1 subjekti financiar jobankë. Në fund të vitit 2023, ushtronin veprimtaritë financiare 39 subjekte financiare jobanka (përfshirë dhe institucione financiare të mikrokredisë) dhe institucione të parasë elektronike.

Për subjektet financiare jobanka dhe institucionet e parasë elektronike, u dhanë miratimet paraprake për 9 administratorë, 4 kryetarë të këshillit mbikëqyrës dhe 1 kryetar të komitetit të kontrollit. Në vitin 2023, u dha miratimi paraprak për riemërimin e 1 administratori të shoqërisë së kursim-kreditit.

Gjatë vitit 2023, u licencuan 52 zyra të reja të këmbimit valutor dhe iu revokua licenca 14 zyrave ekzistuese. Në fund të vitit 2023, ushtronin aktivitetin 621 zyra të këmbimit valutor.



Tabelë 11. Numri i bankave, subjekteve financiare jobanka, shoqërive të kursim-kreditit dhe zyrave të këmbimit valutor të licencuara nga Banka e Shqipërisë (fund i periudhës)

	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Banka	16	16	16	14	12	12	12	11	11
Subjekte financiare jobanka	27	28	31	30	32	30	35	38	39
Zyra të këmbimit valutor	397	428	426	463	503	538	556	583	621
Unione të shoqërive të kursim-kreditit	2	2	1	1	1	1	1	1	1
Shoqëri të kursim-kreditit	111	13	13	13	14	14	16	16	16

Burimi: Banka e Shqipërisë.

#### 2.4.4. ZHVILLIME TË TJERA

##### *Zbatimi i rekomandimeve të raportit të vlerësimit nga Komiteti Moneyval dhe i planit të veprimit të ICRG/FATF*

Një nga zhvillimet më të rëndësishme gjatë vitit 2023 është **dalja e Shqipërisë nga lista e juridiksioneve nën monitorim të shtuar, njohur ndryshe si “lista gri” nga FATF, në plenaren e datës 27 tetor 2023**. Ky vlerësim erdhi si rrjedhojë e angazhimit, reformave dhe politikave të ndërmarra për përmbushjen e kriterëve të nevojshme nga institucionet në Shqipëri. Banka e Shqipërisë ka dhënë kontribut të konsiderueshëm në të gjithë procesin e vlerësimit të Shqipërisë nga ekspertët e Komitetit të Moneyval – Raundi i V-të i vlerësimit (2017-2018), dhe në mënyrë të veçantë në realizimin e detyrimeve që i lindnin Bankës së Shqipërisë sipas planit të veprimit të ICRG/FATF.

Heqja nga lista gri e FATF-së është një arritje e rëndësishme për vendin, ekonominë dhe reputacionin e tij. Dalja nga lista përbën një votëbesim nga komuniteti ndërkombëtar dhe tregon përkushtimin e vendit në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

##### *Vlerësimi i ekuivalencës së kuadrit mbikëqyrës rregullativ*

Me heqjen e Shqipërisë nga lista gri e FATF-së është hapur rruga për rikthimin e diskutimit me Autoritetin Bankar Evropian (EBA) mbi procesin e vlerësimit të ekuivalencës. Në fillim të vitit 2022, EBA-ja ka publikuar një metodologji të re vlerësimi dhe Banka e Shqipërisë, nëpërmjet asistencës teknike të Bankës Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim (EBRD) dhe të PricewaterhouseCoopers (PwC) Spanjë, ka kryer një vlerësim të pavarur të kuadrit mbikëqyrës aktual për bankat. Rezultatet treguan se kuadri rregullativ e procedural, si dhe praktikrat mbikëqyrëse, qëndrojnë në një nivel të lartë ekuivalence me standardet në vendet e Bashkimit Evropian, veçanërisht në drejtim të kërkesave për kapital, teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë, ekspozimeve të mëdha, likuiditetit, levës financiare, titullzimit, mbikëqyrjes makroprudenciale, sekretit profesional dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Pas paraqitjes së kërkesës zyrtare institucionit të EBA-së, pritet fillimi i diskutimeve mbi procesin e vlerësimit të ekuivalencës të Shqipërisë.



### ***Përgatitja e udhëzimit për raportimin financiar***

Në zhvillimin e proceseve mbikëqyrëse, gjatë vitit 2023 është hartuar drafti i dokumentit mbi raportimin financiar, i cili është hapi i parë i zbatimit të standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar dhe të kontabilitetit. Hartimi i dokumentit është bazuar në standardet e përcaktuara nga Autoriteti Bankar Evropian (EBA), në përmbajtje, tabela të raportit dhe udhëzime shpjeguese. Ky dokument është shpërndarë tek bankat dhe ka shërbyer si pikënisje e dialogut mbi sfidat që e shoqërojnë këtë proces, duke përcaktuar edhe detyrimet përkatëse që lindin për vënien në zbatim të tij.

### ***Hartimi i ligjit për llogarinë e pagesave me shërbime bazike***

Qëllimi i projektligjit për "Llogarinë e pagesave me shërbime bazike", i hartuar me asistencën e Bankës Botërore, është krijimi i kuadrit ligjor për të ofruar shërbimet e pagesave për të gjithë konsumatorët dhe veçanërisht për individët të cilët nuk zotërojnë llogari bankare, pa kosto ose me kosto të përballueshme prej tyre, duke garantuar dhe mundësuar të drejtën e çdo konsumatori - pavarësisht nivelit të të ardhurave, statusit të punësimit, historikut të aftësisë paguese - për të pasur akses në shërbimet bazë të llogarisë së pagesës. Kushtet dhe rregullat që krijon ky projektligj paraqiten më të detajuara në Hapësirën Informuese 5.

## **HAPËSIRË INFORMUESE 5**

### **LIGJI I RI PËR "LLOGARINË E PAGESAVE ME SHËRBIME BAZIKE"**

*Ligji 100/2023 "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike" vjen si angazhim i Bankës së Shqipërisë në nxitjen e përfshirjes financiare të popullsisë dhe modernizimit të sistemit të pagesave, në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël në Shqipëri (2018- 2023). Ligji synon rritjen e numrit të llogarive bankare të pagesave nëpërmjet afrimit drejt sistemit bankar të shtresave të konsumatorëve që nuk kanë aktualisht llogari bankare, si dhe nxitjen e përdorimit më aktiv të llogarive ekzistuese të pagesave për atë grup konsumatorësh që kanë një llogari, por e përdorin minimalisht atë.*

*Me miratimin e ligjit 100/2023 "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike" nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe rregullores së Bankës së Shqipërisë 59/2022 "Për krahasueshmërinë e tarifave të lidhura me llogaritë e pagesave dhe për shërbimin e transferimit të llogarive të pagesave", u përfundua transpozimi i Direktivës 2014/92/EU (PAD) në kuadrin ligjor e rregullativ të Bankës së Shqipërisë. Transpozimi i Direktivës 2014/92/EU shënon edhe plotësimin e detyrimeve në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2022-2024.*

*Ligji për llogarinë e pagesave me shërbime bazike ka në qendër të tij konsumatorin (klientin individ). Ai i ofron konsumatorit mundësinë për të pasur akses në shërbimet bazë bankare, nëpërmjet llogarisë së pagesave me shërbime bazike, duke mos diskriminuar konsumatorët nisur nga statusi i punësimit apo gjendja financiare. Për të mundësuar këtë, ligji vendos detyrimin për bankat që të mos refuzojnë hapjen e një llogarie pagese me shërbime bazike, me përjashtim të rasteve specifike, të tilla si cenimi i kërkesave të parandalimit të pastrimit të*



parave, si dhe disa kërkesa të tjera, me qëllim garantimin e shërbimeve bazë ndaj konsumatorëve. Gjithashtu, konsumatori ka të drejtën e ankimit pranë Bankës së Shqipërisë, në rast refuzimi nga ana e bankave për hapjen e një llogarie të tillë.

Llogaria e pagesave me shërbime bazike është një llogari që ofron një grup shërbimesh bazike, të tilla si depozitime dhe/ose tërheqje fondesh, pagesa dhe transfera të ndryshme në sportele, nëpërmjet kartave të debitit, apo platformave online. Llogaria e pagesave me shërbime bazike ofrohet vetëm në monedhën vendase (Lek) dhe shërben për ekzekutimin e transaksioneve brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Në shërbimet bazë që ofron kjo llogari, ligji përjashton transaksionet e pagesave me karta krediti, si dhe ofrimin e kredive të lidhura me shërbimet e pagesave.

Konsumatorët do të përfitojnë këto shërbime bazë me tarifa më të favorshëm se tarifatat e aplikuara për llogaritë standarde të pagesave, ndërsa për disa kategori vulnerabël është parashikuar që tarifa e ofrimit të shërbimeve të jetë zero.

Për këtë qëllim, në ligj përcaktohen kategoritë e konsumatorëve vulnerabël, për të cilët do të ofrohet tarifë zero për shërbimet e ofruara në llogarinë e pagesave me shërbime bazike. Në këto kategori janë përfshirë individët që përfitojnë nga mbrojtja dhe asistencë sociale, ekonomike dhe shëndetësore, si dhe pensionistët, studentët dhe personat me aftësi të kufizuara.

Ligji përcakton edhe mekanizmat e vendosjes së tarifave sipas llojit të shërbimit të ofruar nga kjo llogari, si dhe modalitetet për transaksionet. Në përfundim, ai parashikon kërkesa lidhur me trajtimin e ankesave dhe transparencës, si dhe kundërvajtjet administrative, sanksionet dhe të drejtën dhe procedurat për ankim.

### Financa e gjelbër

Në kuadrin e financës së gjelbër dhe strategjisë së hartuar për përfshirjen e saj në proceset mbikëqyrëse, Banka e Shqipërisë është angazhuar në drejtim të rritjes së njohurisë për procese të ngjashme të ndërmarra nga institucione të tjera homologe, si praktika më të mira ndërkombëtare, dhe evidentimit të tipologjive që do të mund të adoptohen në tregun vendas.

### Rreziku kibernetik

Për shkak të zhvillimeve gjeopolitike në rrafsh global dhe pozicionimit të Republikës së Shqipërisë në mënyrë aktive ndaj këtyre zhvillimeve, edhe përgjatë vitit 2023, sektorë kritikë - përfshirë sistemin bankar dhe me gjerë atë financiar - kanë qenë nën kërcënime të vazhdueshme kibernetike të përshkallëzuara. Kjo situatë u shoqërua me rritjen e nivelit të alarmit dhe të masave parandaluese në raport të drejtë me kërcënimet.

Sistemi financiar ka administruar në mënyrë të kujdesshme sulmet e vazhdueshme dhe të shumëllojshme të shkaktuara nga aktorë keqdashës, të cilat kanë pasur si synim fundor dëmtimin e imazhit dhe besimit ndaj institucioneve financiare dhe, veçanërisht, bankave në publikun e gjerë, më shumë sesa për qëllime





përfitimi të vlerave monetare. Për rrjedhojë, këto sulme nuk kanë arritur të përmbushin në mënyrë të suksesshme qëllimin e tyre. Gjatë vitit 2023 mund të veçojmë sulmet e mohimit të shërbimit (DoS – Denial of Service) të vërejtura gjatë tremujorit të tretë, të cilat kanë pasur si shënjestër edhe bankat e nivelit të dytë, me synim ndërprerjen e shërbimeve të ofruara nga faqet e tyre të internetit. Ndërsa në tremujorin e katërt të vitit 2023, kemi disa tentativa për smishing (impersonifikimin e faqeve zyrtareve të bankave), të cilat kanë rezultuar gjithashtu të pasuksesshme, falë masave të marra nga bankat dhe fushatave të ndryshme për ndërgjegjësimin e klientëve. Theksojmë se dallohet një vëmendje e shtuar e klientëve në rastet e aksesimit në distancë të lidhjeve me shërbimet e bankës, dhe, nga vetë klientët e bankave, janë identifikuar dhe raportuar disa tentativa për vjedhjen e kredencialeve të tyre.

Për sa më sipër, Banka e Shqipërisë ka forcuar shkallën e komunikimit dhe ndërveprimit veçanërisht me sektorin bankar dhe autoritetet rregulluese përgjegjëse të fushës, duke shtuar fokusin dhe vëmendjen në këtë drejtim, veçanërisht në procesin e inspektimeve në vend. Në këtë kontekst, me qëllim përditësimin e kuadrit rregullator me zhvillimet e sigurisë së informacionit dhe përmirësimin e proceseve mbikëqyrëse, Banka e Shqipërisë po vijon me procesin e rishikimit të kuadrit rregullator sipas standardeve dhe praktikave më të mira të Bashkimit Evropian. Ky proces, në përputhje me qasjen e kahershme të Bankës së Shqipërisë, do të finalizohet edhe me bashkëveprimin e industrisë bankare, me qëllim përfshirjen edhe të praktikave më të mira të tregut.



## 2.5. NDËRHRYJA E JASHTËZAKONSHME

*Ligji “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë” i jep Bankës së Shqipërisë kompetencën e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në vend. Ky mandat ligjor synon të sigurojë një ndërhyrje të jashtëzakonshme të organizuar në bankat në paaftësi paguese, duke minimizuar ndikimin negativ të tyre në ekonominë reale dhe në sistemin financiar, duke minimizuar përdorimin e parave të taksapaguesve, si dhe duke garantuar mbrojtje të depozitave të siguruara dhe të aktiveve të klientëve.*

Banka e Shqipërisë, në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, është angazhuar në zhvillimin e kapaciteteve të saj në drejtim të prioriteteve të parashikuara në planin e saj afatmesëm. Ajo ka përditësuar planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme për të gjitha bankat e sektorit (11), ka ndjekur marrjen e masave nga bankat në drejtim të fuqizimit të aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme dhe ka monitoruar plotësimin e nivelit të ndërmjetëm vjetor të “Kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” (MREL). Banka e Shqipërisë ka vijuar plotësimin e kuadrit rregullator dhe metodologjik për ndërhyrjen e jashtëzakonshme dhe ka kryer aktivitete për plotësimin e monitorimit të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

Në kuadër të ciklit të hartimit të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë ka mbajtur një dialog të qëndrueshëm me sektorin bankar, duke monitoruar rregullisht përmbushjen e rekomandimeve të komunikuar si pjesë e procesit vjetor të inspektimit në banka.

Në drejtim të përmbushjes së kërkesës për MREL, Banka e Shqipërisë ka qenë e përfshirë në një proces konsultimi intensiv me sektorin bankar, me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, si dhe me institucione ndërkombëtare, duke mbështetur sektorin bankar në emetimin e titujve financiarë që përmbushin kërkesat rregullative.

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar me Bordin e Përbashkët të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme – SRB, Banka e Shqipërisë është ftuar për të marrë pjesë në mbledhjet e Kolegjeve të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për dy grupe bankare evropiane me filiale që operojnë në Shqipëri.

Banka e Shqipërisë është përfshirë në projekte dhe bashkëpunime me Bankën Evropiane për Rindërtim e Zhvillim (BERZH) dhe projektin FinSAC të Bankës Botërore, në drejtim të operacionalizimit të instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.



## 2.5.1. FUQIZIMI I AFTËSISË PËR NDËRHYRJE TË JASHTËZAKONSHME

### *Planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme*

Banka e Shqipërisë harton dhe përditëson çdo vit planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme për të gjitha bankat që operojnë në Shqipëri. Gjatë ciklit të vitit 2023, Banka e Shqipërisë përditësoi planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme sipas informacionit periodik të raportuar nga bankat dhe rezultatet e informacionet më të detajuara të përfuara gjatë procesit të inspektimit në vend gjatë muajit korrik 2023.

Gjatë vitit 2023 është realizuar identifikimi dhe vlerësimi i funksioneve ekonomike me rëndësi kritike për sektorin bankar shqiptar, vlerësimi i testit të interesit publik për të gjitha bankat, strategjia e preferuar për ndërhyrje të jashtëzakonshme, si dhe masat që duhet të ndërmerret banka në drejtim të aftësisë së saj për zbatimin e kësaj strategjie. Në përfundim, secilës banke i është komunikuar përmbledhja ekzekutive e planit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke u fokusuar në vlerësimin e aftësisë që banka ka për të zbatuar në mënyrë eficiente strategjinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Banka e Shqipërisë ka kërkuar nga bankat hartimin e programit vjetor të punës mbi aftësinë për ndërhyrje të jashtëzakonshme dhe raportimin e tij në Bankën e Shqipërisë. Për ciklin e vitit 2023, bankat kanë bërë progres në drejtim të përmbushjes së objektivit për qeverisjen, për rritjen e kapaciteteve, për përthithjen e humbjeve dhe rikapitalizim të tyre, për sigurimin e vazhdimësisë operacionale dhe ruajtjen e aksesit në treg, në rast se bankat i nënshtrohen ndërhyrjes së jashtëzakonshme, përmirësimin e cilësisë së raportimit për qëllime të MREL etj. Këta objektiva do të jenë në monitorim të vazhdueshëm, deri në përmbushjen e plotë të "Programit të aftësisë për zbatimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme", brenda afatit përfundimtar të vitit 2027.


### *Kërkesa minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar (MREL)*

MREL përbën një nga elementet kryesore për përgatitjen financiare të bankave lidhur me aftësinë për ndërhyrje të jashtëzakonshme. Nëpërmjet përmbushjes së kërkesës MREL, sektori bankar ndërton në mënyrë graduale kapacitetet financiare për të përthithur humbjet dhe për t'u rikapitalizuar përmes burimeve të brendshme, në rast se i nënshtrohet ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Në zbatim të kuadrit rregullator, gjatë periudhës së ndërmjetme të përmbushjes së kërkesës MREL brenda vitit 2027, Banka e Shqipërisë u komunikoi bankave nivelin vjetor për t'u plotësuar brenda 12 muajve të ardhshëm. Gjatë vitit 2023, sektori bankar përmbushi nivelin e ndërmjetëm të kërkesës për MREL, duke përdorur instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar. Në dhjetor 2023, kapaciteti MREL arriti në nivelin 21.4% të aktiveve të ponderuara me rrezik. Objektiv i vjetor i ndërmjetëm ishte 16.4%. Në dhjetor të



Grafik 33. Kapaciteti MREL, për periudhën 2022-2023, në përqindje të aktiveve të ponderuara me rrezik



Burimi: Banka e Shqipërisë.

vitit 2023, bankave iu komunikua vendimi për nivelin e ndërmjetëm të kërkesës për MREL, i cili duhet të plotësohet për vitin 2024.

### Inspektimet në banka

Banka e Shqipërisë ka vijuar punën për fuqizimin e aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme në banka. Ajo ka kryer ekzaminimin vjetor pranë bankave, të cilat ofrojnë funksione kritike për ekonominë, duke u fokusuar në vlerësimin e përbushjes së rekomandimeve të komunikuar gjatë ciklit të vitit 2022 dhe përcaktimin e prioriteteve të reja për ciklin e planeve për ndërhyrjen e jashtëzakonshme të vitit 2024.

Në vijim të këtij cikli ekzaminimi, Banka e Shqipërisë përgatiti raportet individuale për secilën bankë, duke u mbështetur në progresin e realizuar prej tyre, me synim rritjen e aftësisë së bankës për të zbatuar ndërhyrjen e jashtëzakonshme, sipas strategjisë dhe instrumentit të përzgjedhur në planin përkatës. Banka e Shqipërisë rekomandoi një listë masash, të cilat bankat duhet t'i përfshijnë në programin e tyre të punës me fokus ndërhyrjen e jashtëzakonshme. Secila bankë me strategji ndërhyrjeje të jashtëzakonshme ka raportuar periodikisht në Bankën e Shqipërisë lidhur me ecurinë e masave që ka marrë, sipas afateve të caktuara kohore, për të rritur aftësinë e saj për zbatimin e planit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

## HAPËSIRË INFORMUESE 6

### BURIMET E FINANCIMIT TË KËRKESËS MREL GJATË VITIT 2023

Spektori bankar ka diversifikuar strategjinë e financimit të kërkesës MREL gjatë vitit 2023, duke rritur financimin përmes titujve të borxhit, të cilët plotësojnë kriteret rregullative për t'u klasifikuar si "detyrim i pranuar". Spektori bankar ka emetuar me sukses tituj financiarë në tregun e brendshëm të kapitalit, por edhe në tregjet ndërkombëtare, përmes financimit nga institucionet financiare ndërkombëtare.


Këtë vit, sektori bankar nënshkroi për herë të parë titull financiar të MREL-it me investitorë profesionistë të tregut financiar, si BERZH dhe Fondi OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar. Ky është titulli i parë financiar që emetohet në Ballkanin Perëndimor, i nënshkruar plotësisht nga investitorë të tregut financiar ndërkombëtar. Ai reflekton besimin në sektorin bankar shqiptar dhe përafrimin e kuadrit rregullator evropian nga Banka e Shqipërisë. Investimi synon të shërbejë si katalizator për të rritur interesin e investitorëve të tjerë në financimin e titujve për MREL.



Zhvillime të ngjashme pozitive janë reflektuar dhe në financimin e sektorit bankar në tregun vendas të kapitalit. Gjatë vitit 2023, u realizua me sukses, për herë të parë nga sektori bankar, emetimi i obligacioneve “të paguarantuara”, si dhe u zgjerua numri i bankave që emetojnë borxh të varur për qëllime të kapitalit rregullator.

Për rrjedhojë, gjatë gjysmës së dytë të vitit 2023, stoku i “detyrimeve të pranuar” në bilancin e sektorit bankar arriti në 10.5 miliardë lekë, nga 3.2 miliardë lekë në vitin 2022. Në vijim të forcimit të vazhdueshëm të pozicionit të kapitalit rregullator përmes rritjes së kapitalit bazë të nivelit të parë dhe emetimeve të reja të borxhit të varur, për qëllime të kapitalit të nivelit të dytë, sektori bankar shënoi një përmirësim të ndjeshëm në financimin e kërkesës MREL. Në reflektim të këtyre zhvillimeve, në fund të vitit 2023, struktura e MREL përbëhej nga rreth 93% instrumente të kapitalit rregullator dhe rreth 7% detyrime të pranuar, të përfaqësuar nga borxhi i varur jo pjesë e kapitalit rregullator, nga përkatësisht 98% e tij dhe 2% në vitin 2022.

Grafik 34. Burimet e financimit të MREL për periudhën 2022-2023, miliardë lekë për grupin e bankave që i nënshtrohen kësaj kërkesë dhe struktura e MREL, dhjetor 2023



### 2.5.2. PËRGATITJA E NJË KUADRI TË FORTË PËR NDËRHYRJEN E JASHTËZAKONSHME

Në drejtim të ngritjes së një kuadri të fortë të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë ka hartuar disa dokumente metodologjike dhe udhëzuese, të cilat mbështesin bankat në përmbushjen e rekomandimeve të Bankës së Shqipërisë. Kështu, në zbatim të dispozitave të rregullores nr.78/2020 “Për kërkesat minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar”, Banka e Shqipërisë ka përditësuar dokumentin “Mbi metodologjinë, politikat dhe mënyrën e përmbushjes së kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”, për ciklin vjetor të vitit 2023.




Gjithashtu, në kuadër të rritjes së aftësisë së bankave për zbatimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë ka publikuar udhëzuesin “Për identifikimin dhe mobilizimin e kolateralit në ndërhyrje të jashtëzakonshme”. Ky udhëzues do të orientojë bankat për të ndërtuar dhe hartuar planet e kontingjencës që lidhen me vlerësimin e kolateralit të nevojshëm për aksesin në likuiditet në ndërhyrje të jashtëzakonshme. Banka e Shqipërisë është angazhuar në analizën e kuadrit ligjor kombëtar dhe legjisllacionit evropian në fushën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, me synim përafrimin e plotë të tij.

### 2.5.3. FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Sektori bankar kontribuon çdo vit për përmbushjen e nivelit të synuar të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Niveli i synuar i Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme që duhet të arrihet deri në vitin 2027 është 0.5% e totalit të detyrimeve të sektorit bankar. Në bazë të parashikimeve më të fundit të vitit 2023, niveli i synuar i fondit shënon 8 miliardë lekë. Me pagesën e kontributit vjetor të bankave në fond gjatë vitit 2023, në nivelin 896.2 milionë lekë, Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në fund të vitit 2023, arrin në rreth 4.5 miliardë lekë, duke përbërë rreth 56% të nivelit të synuar për vitin 2027.

Grafik 35. Fondi për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme i plotësuar në vite dhe niveli i synuar në vitin 2027 (milionë lekë)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë monitoron rregullisht ecurinë e aktiveve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, bazuar në raportimet periodike të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, si Administrator i Fondit, mbështetur në politikën e investimit të miratuar nga Banka e Shqipërisë. Gjatë vitit 2023, Banka e Shqipërisë miratoi rishikimin e “Politikës së investimit të fondit” në përputhje me objektivat për miradministrimin e tij, si dhe miratoi “Manualin për Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme”, i cili ka në fokus përcaktimin e të gjitha procedurave dhe hapave që ndjek Banka e Shqipërisë për këtë fond, në zbatim të kuadrit ligjor të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.



## 2.6. EMETIMI I MONEDHËS

*Banka e Shqipërisë ka të drejtën ekskluzive të nxjerrjes dhe të qarkullimit të monedhës kombëtare "Lek". Ajo përcakton format, peshat, masat, modelin dhe karakteristikat e tjera të kartëmonedhave dhe monedhave metalike shqiptare, me kurs ligjor brenda vendit.*


Një nga përgjegjësitë kryesore të Bankës së Shqipërisë është plotësimi i nevojave të ekonomisë me para të gatshme, nëpërmjet emetimit të kartëmonedhave dhe monedhave moderne dhe cilësore, të cilat transmetojnë te përdoruesit e tyre siguri, besueshmëri dhe qëndrueshmëri.

Hedhja në qarkullim e dy prerjeve të fundit të serisë së re në vitin 2022, ndihmoi në prezantimin e plotë të saj në ekonomi. Emetimi i një serie të re kartëmonedhash dhe shtimi i saj me kartëmonedhën me prerje 10.000 lekë, kanë rezultuar të suksesshme në plotësimin e kërkesave të ekonomisë shqiptare në vlerë edhe në strukturë.

### *Kartëmonedha dhe monedha në qarkullim<sup>17</sup> dhe vlera e tyre*


Monedha kombëtare në qarkullim, në fund të vitit 2023, arriti në 408 miliardë lekë, me një rritje prej 6.8 miliardë lekësh krahasuar me fundin e vitit 2022 (+1.7%). Në fund të vitit 2023, rezultuan rreth 156 milionë copë kartëmonedha në qarkullim, me vlerë rreth 401 miliardë lekë. Në krahasim me vitin 2022, numri i kartëmonedhave në qarkullim është ulur me rreth 4.9 milionë copë (-3%), ndërsa në vlerë kemi një rritje prej 6.4 miliardë lekësh (+1.6%). Ulja e numrit të kartëmonedhave dhe rritja e vlerës së tyre në qarkullim ka ardhur për shkak të përmirësimit të strukturës në qarkullim, në favor të rritjes së numrit të kartëmonedhave të prerjeve të mëdha, kryesisht 10.000 dhe 5000 lekë. Në fund të vitit 2023, vlera mesatare e një kartëmonedhe në qarkullim arriti në 2,566 lekë, kundrejt 2448 lekëve në fund të vitit 2022.

Grafik 36. Tregues të ecurisë së monedhës kombëtare (majtas) dhe të kartëmonedhës (KM) në qarkullim (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

<sup>17</sup> Është numri dhe vlera e kartëmonedhave dhe monedhave të hedhura në qarkullim nga Banka e Shqipërisë.




Sa i takon monedhës metalike, numri i tyre në qarkullim arriti në 273 milionë copë kundrejt 257 milionë në fund të vitit 2022, me një rritje prej rreth 16 milionë copësh ose +6.2%. Vlera mesatare e një monedhe metalike në qarkullim, në fund të vitit 2023, arriti 25.2 lekë/monedhë kundrejt 25 lekë/monedhë në vitin 2022.

### Riciklimi i parasë fizike, cilësia e kartëmonedhës dhe qarkullimi i saj

Gjatë vitit 2023, u përpunuan rreth 104.5 milionë copë kartëmonedha kundrejt 100.8 milionë copësh në vitin 2022. Ato u kontrolluan njëkohësisht për autenticitet dhe përshtatshmëri për riqarkullim. Norma e sortimit rezultoi 19.3% kundrejt 20.7% në vitin 2022, ndërsa kartëmonedhat e papërshtatshme për qarkullim janë zëvendësuar rast-pas-rasti me kartëmonedha të reja të përshtatshme për qarkullim.

Grafik 37. Treguesit i përpunimit dhe papërshtatshmërisë së kartëmonedhave (majtas) dhe koeficienti i qarkullimit (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Koeficienti<sup>18</sup> i qarkullimit të kartëmonedhës për vitin 2023 rezultoi në vlerën 0.66, që do të thotë se një kartëmonedhë kthehet mesatarisht më pak se një herë në vit në sportelet e Bankës së Shqipërisë. Ky koeficient është më i lartë për prerjet 500 Lekë, 1000 Lekë (rreth 1.28 dhe rreth 1.1) dhe më i vogël për prerjet 5 000 dhe 10 000 Lekë, në përkatësisht 0.2 dhe 0.1 herë në vit.

### Mbrojtja e kartëmonedhës dhe monedhës metalike nga falsifikimi

Në vitin 2023 janë sekuestruar 195 copë kartëmonedha kombëtare të falsifikuara në qarkullim, kundrejt 343 copëve në vitin 2022, si dhe 71 copë monedha metalike. Koeficienti i kartëmonedhave të falsifikuara për 1 milion copë kartëmonedha në qarkullim vijon të ulët ndjeshëm. Në vitin 2023, ky tregues ka arritur nivelin e 1.3 copë kartëmonedha për 1 milionë në qarkullim, kundrejt 2.2 në vitin 2022.

<sup>18</sup> Është raporti i numrit të kartëmonedhave të arkëtuara në sportelet e Bankës së Shqipërisë mbi gjendjen mesatare vjetore të numrit të kartëmonedhave në qarkullim.







Sa i përket shpërndarjes strukturore të kartëmonedhave të falsifikuara, peshën kryesore e mbajnë prerjet 1000 Lekë dhe 5000 Lekë, të ndjekura nga prerja 2000 Lekë dhe 500 Lekë. Monedha metalike prerje 50 Lekë vijon të jetë e vetmja e falsifikuar, në sasi të ulët dhe të papërfillshme. Numri më i madh i kartëmonedhave false i takon serisë së vjetër 153 copë ose 78%. Kjo e fundit reflekton cilësinë e lartë dhe elementet e sigurisë të aplikuara në kartëmonedhat e serisë së re.

Nga këndvështrimi teknik i fenomenit të falsifikimit të kartëmonedhave kombëtare, ato janë riprodhime të thjeshta me pajisje digjitale komerciale, pothuajse vetëm me teknikën *ink-jet* me ngjyra, të shoqëruara me aplikim të teknikave artizanale dhe teknologjike për imitim të elementeve të sigurisë, ndërsa elementet e sigurisë të lexueshme prej pajisjeve autentifikuese nuk ndeshen në asnjë rast të imituara.

Grafik 38. Ecuria e treguesit të falsifikimit të kartëmonedhave në qarkullim



Burimi: Banka e Shqipërisë.



## 2.7. SISTEMET E PAGESAVE


Operimi, mbikëqyrja dhe reformimi i sistemeve të pagesave është një nga detyrat kryesore të Bankës së Shqipërisë. Nëpërmjet saj, garantohet siguria, qëndrueshmëria dhe efikasiteti i infrastrukturës bazë të pagesave. Ky është një parakusht i domosdoshëm për përçimin e politikës monetare, ruajtjen e stabilitetit financiar dhe zhvillimin ekonomik në përgjithësi.

Në përmbushje të këtyre funksioneve, përtej operimit të qëndrueshëm të sistemeve të pagesave, BSH-ja i ka kushtuar vëmendje të veçantë rolit mbikëqyrës dhe katalizator, në përmbushje të Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël.

### 2.7.1. ECURIA E SISTEMEVE TË PAGESAVE

Banka e Shqipërisë luan rol thelbësor në funksionimin normal të sistemeve të pagesave, nëpërmjet operimit dhe administrimit të 3 infrastrukturave kryesore për procesimin e pagesave ndërbankare dhe 1 infrastrukture për shlyerjen e titujve. Sistemi AIPS është infrastruktura e vetme për shlyerjen në kohë reale të pagesave me vlerë të madhe në lekë. Sistemi AECH mundëson klerimin e transaksioneve ndërbankare me vlerë më të vogël se 1.5 milionë lekë të individëve dhe bizneseve. Sistemi AIPS EURO bën të mundur shlyerjen bruto, në kohë reale, të transaksioneve të klientëve të bankave për pagesat në euro brenda territorit të Shqipërisë. Gjithashtu, që prej vitit 2015, Banka e Shqipërisë operon sistemin qendror të shlyerjes dhe të regjistrimit të transaksioneve me titujt e qeverisë - AFISaR. Të gjitha sistemet kanë ofruar disponueshmëri maksimale, duke funksionuar normalisht dhe në përputhje me rregullat dhe oraret e operimit gjatë vitit 2023.

Grafik 39. Numri dhe vlera e transaksioneve të procesuara në AIPS



Burimi: Banka e Shqipërisë.

#### SISTEMI I SHLYERJES SË PAGESAVE NDËRBANKARE ME VLERË TË MADHE (AIPS)

Sistemi i pagesave me vlerë të madhe është instrumental në zhvillimin e qëndrueshëm të sistemit financiar, pasi siguron qarkullimin normal të likuiditetit në tregje dhe ekonomi. Pjesëmarrëse të sistemit AIPS janë të gjitha bankat që operojnë në Shqipëri, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave (si pjesëmarrës i tërthortë). Vlera totale e likuiditetit të qarkulluar në sistem ishte 12,849 miliardë lekë gjatë vitit 2023, ose më shumë se 5-fishi i PBB-së nominale.



**Kredia brenda ditës** është një instrument i sistemit AIPS, të cilin Banka e Shqipërisë ua ofron bankave pjesëmarrëse për administrimin e likuiditetit ditor, me qëllim garantimin e vijueshmërisë normale të funksionimit ndërbankar të pagesave. Në raport me totalin e pagesave të shlyera në sistemin AIPS, vlerat e këtij instrumenti mbeten në nivele të ulëta (4%-5%), duke nënkuptuar se ekspozimi i sistemit ndaj rrezikut të likuiditetit të pjesëmarrësve është i ulët.

### SISTEMI I SHLYERJES SË PAGESAVE NË EURO BRENDË VENDIT (AIPS EURO)

Sistemi AIPS Euro u krijua për t'i mundësuar qytetarëve shqiptarë kryerjen e pagesave në euro brenda vendit me kosto më të ulëta, dhe në një kohë më të shpejtë nga procesi i kryer më parë nëpërmjet bankave korrespondente. Në këtë sistem mundësohet shlyerja e transfertave të individëve dhe bizneseve në monedhën Euro brenda vendit. Ai është në vitin e dytë të operimit. Gjatë vitit 2023, në sistemin AIPS EURO janë procesuar një vëllim pagesash prej 249,018 transaksioneve me vlerë rreth 4,134 milionë euro. Krahasuar me vitin 2022, numri i transaksioneve është rritur me 60%, ndërsa vlera e tyre me 24%. Në këtë sistem janë procesuar rreth 1,016 transaksione në ditë, me një vlerë mesatare qarkullimi ditor prej rreth 17 milionë eurosh.


Konsumatorët dhe bizneset shqiptare vlerësohen të kenë kursyer nga funksionimi i sistemit AIPS Euro rreth 37 milionë euro në vitin 2023. Zgjerimi i përdorimit të tij ndihmon nxitjen e përfshirjes financiare dhe promovimin e pagesave elektronike në vend. Me anë të këtij sistemi, pagesat në euro brenda vendit rregullohen tërësisht nga kuadri ligjor e rregullator prudencial, në kuadër të mbrojtjes konsumatore të krijuar nga ligji "Për shërbimet e pagesave", duke shmangur marrëdhëniet me bankat korrespondente.

### SISTEMI I KLERIMIT TË PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL (AECH)

Sistemi AECH bën klerimin e pagesave me vlerë të vogël. Rezultatet e klerimit shlyhen në sistemin AIPS. Përdorimi i këtij sistemi reflekton kryesisht përdorimin e transfertave bankare të individëve dhe bizneseve, kryesisht të mesme dhe të vogla<sup>19</sup>. Aktiviteti në sistem është rritur vazhdimisht dhe, gjatë vitit 2023, numri i transaksioneve të kleruara u rrit me 12.4%, ndërsa vlera totale e transaksioneve me 6.8% nga viti 2022.

Përtej rritjes së qëndrueshme të numrit dhe vlerës së transaksioneve të procesuara në vitet e fundit në AECH, vlera mesatare për transaksion është zvogëluar, në

Grafik 40. Ecuria e sistemit AIPS EURO sipas numrit dhe të vlerës së transaksioneve të procesuara




<sup>19</sup> Analiza e treguesit të shpërndarjes së pagesave sipas pjesëmarrësve evidenton se pagesat për klientët të iniciuara nga bankat vazhdojnë të zënë peshën kryesore të transaksioneve të procesuara në sistemin AECH, duke mbizotëruar ndaj transaksioneve të iniciuara nga pjesëmarrësit e tjerë (MFE-ja dhe BSH-ja).



linjë me përdorimin për procesimin e transaksioneve me vlera më të ulëta. Raporti i transaksioneve të procesuara në AECH kundrejt popullsisë ka vijuar të rritet. Kjo ecuri është mbështetur nga masat e marra nga Banka e Shqipërisë mbi diferencimin e komisioneve të aplikuara nga bankat, duke favorizuar kryerjen e pagesave me vlerë të vogël në formë elektronike<sup>20</sup>.

Grafik 41. Numri, vlera totale e transaksioneve dhe ajo mesatare për transaksion të kleruar në AECH (majtas) dhe raporti i transaksioneve të procesuara në AECH me popullsinë mbi moshën 15 vjeç\* (djathtas)



\*Nënkupton që 59.7% e popullsisë mbi moshën 15 vjeç kryen një transaksion ndërbankar në vit nëpërmjet sistemit AECH. Kjo shifër ka shënuar një rritje të vazhdueshme ndër vite.  
Burimi: Banka e Shqipërisë dhe INSTAT (për numrin e popullsisë).

### SISTEMI I SHLYERJES SË TITUJVE (AFISAR)

Sistemi AFISaR është sistemi qendror i shlyerjes dhe regjistrimit të transaksioneve me titujt e qeverisë dhe operohet nga Banka e Shqipërisë në cilësinë e agjentit fiskal. Banka e Shqipërisë, nëpërmjet sistemit AFISaR, i ofron emetuesit (Ministrisë së Financave) dhe tregut, organizimin e ankandëve të emetimit të titujve të Shtetit Shqiptar në tregun e brendshëm, në monedhën kombëtare dhe në monedhën evropiane, si dhe shlyerjen dhe regjistrimin e transaksioneve me këto titujt në tregun sekondar. Këtu kolateral janë titujt e Shtetit Shqiptar dhe marrëveshjet e anasjella të riblerjes me objekt këta tituj. Përveç sa më sipër, ofrohen edhe shërbimet e mbledhjes së taksave në burim për të ardhurat nga titujt, ngjarjet e pagesave të interesit dhe informimi i mbajtësve të llogarive në këtë sistem mbi gjendjen dhe lëvizjet në këto llogari.


Në fund të vitit 2023, sistemi AFISaR regjistron 14 institucione financiare pjesëmarrëse të drejtpërdrejta nga të cilat: 1 emetuese (Ministria e Financave) dhe 1 bankë qendrore (Banka e Shqipërisë), 7 institucione financiare pjesëmarrëse të tërthorta me llogari nëpërmjet Bankës së Shqipërisë, dhe lidhje me një 1 Bursë private të tregtimit të titujve. Në fund të vitit 2023, numri i llogarive të individëve në sistemin AFISaR të hapura nëpërmjet Bankës së Shqipërisë ishte 19,490.

<sup>20</sup> Ndryshimi rregullativ i vitit 2020, i cili parashikon eliminimin e komisioneve për pagesat me vlerë të vogël të iniciuara në mënyrë elektronike (home-banking) deri në shumën 20,000 lekë, si dhe diferencimin e tarifave për pjesën tjetër të pagesave të iniciuara elektronikisht deri në 50% të atyre të iniciuara në formë letër.



Vlera nominale totale e emetimeve të titujve të Shtetit Shqiptar në monedhën kombëtare në sistemin AFISaR, në fund të vitit 2023, ishte 732.26 miliardë lekë, duke u rritur me 2.8% nga fundviti 2022, ndërsa emetimet në monedhën evropiane janë 69.13 miliona euro, në të njëjtën vlerë me një vit më parë.


Grafik 42. Ecuria e transaksioneve të procesuara në sistemin AFISaR (majtas) dhe në përqindje ndaj PBB-së (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Përdorimi i sistemit AFISaR sipas katër grupe-tipeve të përgjithshme të transaksioneve tregon se transaksionet në tregun primar dhe transaksionet e kujdestarisë (mbledhja e taksave, pagesat e kuponëve etj.) kanë shënuar rënie me respektivisht 16.5% dhe 45%. Transaksionet e tregut sekondar kanë rezultuar me rënie me rreth 8%. Rritje të konsiderueshme kanë pasur transaksionet nga përdorimi i instrumenteve, me 31.7%, ku rolin kryesor e ka luajtur kredia ndërditore (me rritje 94%) dhe repo në treg ndërbankar (me rritje 30%). Bursa e titujve nuk ka pasur aktivitet në vitin 2023.

Grafik 43. Ecuria e transaksioneve në sistemin AFISaR të ndara sipas katër grup-tipeve kryesore




Burimi: Banka e Shqipërisë.

## 2.7.2. INSTRUMENTET E PAGESAVE

Gjatë vitit 2023 ka vijuar prirja rritëse e pagesave në formë elektronike, ndërsa pagesat në formën e letrës kanë ruajtur pothuajse të njëjtat vlera. Rreth 89% e numrit të pagesave të kryera si nga bankat, ashtu edhe nga jobankat, ka qenë në formë elektronike. Krahasuar me një vit më parë, numri i këtyre pagesave është rritur me 25.5%, ndërsa vlera e tyre është rritur me 27.1%.



Grafik 44. Ecuria e numrit të instrumenteve të pagesave elektronike dhe në formë letër në vite (majtas), numri i pagesave për frymë (+15 vjeç) në vite (djathtas)



Zhvillimet e pagesave elektronike kanë kontribuar në përmbushjen e objektivave sasiorë të Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël (2018-2023), duke arritur një nivel përdorimi prej 21 pagesash elektronike për frymë për vitin 2023, nga 10 që është objektivi i Strategjisë për vitin. Përfshirja financiare është rritur dhe objektivi prej 70% e popullsisë që zotëron një llogari pagesash është përmbushur<sup>21</sup>.

### PAGESA OFRUAR NGA SISTEMI BANKAR

Institucionet bankare janë ofruesi kryesor i shërbimeve të pagesave. Pagesat me vlera të mëdha vijojnë të kryhen në formën e transfertave në formë letër, kryesisht nga bizneset. Numri i tyre zë një peshë të vogël në numrin total të pagesave. Në terma të vlerës, ato zënë rreth 61% të totalit të vlerës së pagesave.

Përdorimi i instrumenteve të tjera të pagesave elektronike të kryera nëpërmjet bankave është rritur. Rreth 61.9% e totalit të pagesave janë kryer duke përdorur karta bankare. Krahasuar me vitin 2022, numri i pagesave me kartë është rritur me 22.2%. Nga ana tjetër, për nga vetë natyra e pagesave që kryhen me këtë instrument, vlera e tyre mbetet në nivele të ulëta, duke zënë vetëm 3.1% të të gjithë vlerës së pagesave të kryera. Përdorimin më të lartë të kartave e kanë individët (në 94.7% të numrit të pagesave me kartë).

Pagesat home-banking<sup>22</sup> zënë vendin e dytë si instrument pagese ndaj totalit të të gjithë numrit të pagesave. Trendi i shpejtë i rritjes së përdorimit të *home banking* tregon familjarizimin më të madh të publikut me këtë instrument, si dhe nxitjen e përdorimit të tij nga ana e sistemit bankar. Numri i pagesave të kryera

<sup>21</sup> Në vitin 2014, më pak se 40% e popullsisë zotëronte një llogari pagesash.


<sup>22</sup> Këto produkte mundësojnë aksesimin e llogarisë bankare në distancë, nëpërmjet një linje interneti, linje telefoni apo një software-i që banka i vë në dispozicion klientit të saj.



përmes shërbimit mobile banking arriti në 3.1 milionë transaksione dhe u rrit me 36.7% nga viti 2022. Vlera e tyre arriti në 336 miliardë lekë, me rritje vjetore prej 25.8%.

Pagesat me para elektronike në sistemin bankar janë rritur gjatë vitit 2023, por vlera e këtyre pagesave mbetet ende në nivele të ulëta (vetëm 0.1% ndaj totalit të të gjithë pagesave bankare). Pagesat me para elektronike ose me parapagim përdoren ekskluzivisht nga individët.


Grafik 45. Peshë e instrumenteve të pagesave sipas numrit të transaksioneve (majtas) dhe përdoruesit sipas tipologjisë së instrumenteve të pagesave, gjatë vitit 2023 (djathtas)



### HOME BANKING


Shërbimet "home banking" ofrohen nga të gjitha bankat dhe po gjejnë përdorim gjithnjë e më të gjerë në tregun shqiptar. Ato po përdoren jo vetëm për shërbimet bazike të informimit mbi gjendjen e llogarisë, por edhe për kryerjen e pagesave online. Në vitin 2023, numri i pagesave dhe i vlerës së transaksioneve "home banking" u rritën me përkatësisht 22.1% dhe 28.1% krahasuar me një vit më parë. Kjo ecure është nxitur nga masat e marra nga Banka e Shqipërisë për uljen e komisioneve për këtë tipologji transaksionesh<sup>23</sup>, nga zgjerimi i aksesit në internet dhe familjarizimi i klientëve të bankave me këtë instrument. Numri i llogarive të aksesueshme në distancë është rritur me 24.3% në vitin 2023, duke zënë 33.8% të totalit të gjithë llogarive të klientëve në banka.

Grafik 46. Raporti i llogarive home-banking ndaj totalit të llogarive



Burimi: Banka e Shqipërisë.

<sup>23</sup> Referuar diferencimit të komisioneve midis pagesave online dhe ato me prani fizike pranë degëve të bankave.




### KARTAT BANKARE DHE INFRASTRUKTURA PËR PËRDORIMIN E TYRE

Të 11 bankat që operojnë në treg janë të licencuara si emetuese kartash, ndërkohë që 8<sup>24</sup> prej tyre janë të licencuara edhe si pranuese kartash. Numri i ATM-ve dhe i POS-eve për 100,000 të rritur<sup>25</sup> në Shqipëri është rritur në përputhje me familjarizimin më të madh të bizneseve dhe konsumatorëve, përdorimin më të lartë të kartave nëpër pikat e shitjes dhe zgjerimin e përfshirjes financiare të popullatës.

Numri i kartave është rritur me 4.6% krahasuar me një vit më parë. Në këtë grup mbizotërojnë kartat e debitit, me 86.5% të totalit të numrit të kartave në qarkullim. Numri mesatar i pagesave me karta për frymë (popullsia mbi 15 vjeç) është rritur në rreth 11 pagesa gjatë vitit 2023 kundrejt 9 një vit më parë. Numri i POS-eve është rritur me 18.2% krahasuar me vitin 2022. Pavarësisht zgjerimit të shpërndarjes së rrjetit të POS-eve në gjithë rajonet, përqendrimi më i lartë është në qarkun e Tiranës,<sup>26</sup> ku janë instaluar 80% e tyre. Përdorimi i kartave në pikat POS është rritur me 34.9% krahasuar me vitin 2022.

Grafik 47. Përdorimi i kartave për pagesa kundrejt tërheqjeve cash në ATM (majtas), numri i kartave në qarkullim (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Numri i ATM-ve është rritur me 8.2% krahasuar me vitin 2022. Megjithëse ATM-të përdoren kryesisht për tërheqje të *cash*-it, numri i ATM-ve që mundësojnë depozitimin e *cash*-it është rritur. Përdorimi i tyre për këtë funksion është ende i kufizuar.

<sup>24</sup> Banka e Parë e Investimeve ka filluar të ofrojë edhe shërbimin e pranimit të kartave gjatë vitit 2023.


<sup>25</sup> Popullsia e rritur (mbi 15 vjeç).

<sup>26</sup> Ndarja e qarqeve bëhet sipas degëve të Bankës së Shqipërisë.





Grafik 48. Numri i terminalave ATM dhe POS për 100,000 të rritur (majtas), numri i ATM-ve, POS-ve (djathtas)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

### TRANSAKSIONET ME PARA FIZIKE

Shtimi i infrastrukturës për përdorimin e instrumenteve elektronike të pagesave është reflektuar në rënien e përdorimit të *cash*-it për transfertat. Në vitin 2023, transaksionet me para fizike të kryera nga klientët në sportelet e bankave janë zvogëluar me 2.1% në numër dhe 0.2% në vlerë, krahasuar me vitin 2022. Megjithatë, përdorimi i parasë fizike mbetet një fenomen mbizotërues në ekonominë shqiptare, i cili mbart kosto të larta për të. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj parasë likuide (M1) është 51%, nga 52.7% një vit më parë. Bashkërendimi i përpjekjeve me të gjithë aktorët relevantë, si dhe rritja e edukimit financiar për nxitjen e përdorimit të instrumenteve sa më efikase dhe me kosto të ulëta përbën një nga prioritetet e Bankës së Shqipërisë.

Grafik 49. Numri dhe vlera e transaksioneve cash në sportelet e bankave 2023 (individë dhe biznese)



Burimi: Raportimet e bankave sipas "Metodologjisë për raportimin e instrumenteve të pagesave".



### 2.7.3. INSTITUCIONET E PARASË ELEKTRONIKE

Produktet e parasë elektronike ofrohen dhe nga institucionet financiare jobanka të licencuara si institucione të parasë elektronike. Me miratimin e ligjit “Për Shërbimet e Pagesave”, numri i tyre është rritur në 10 institucione. Institucioni më i ri i parasë elektronike u licencua nga Banka e Shqipërisë në fund të vitit 2023. Këto institucione kanë kryer një volum prej 14 milionë pagesash me para elektronike me një vlerë 91.6 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej 37.6% në numër dhe 102% në vlerë krahasuar me vitin 2022<sup>27</sup>.

Përdorimi i parasë elektronike sjell lehtësira kryesisht për atë pjesë të popullsisë shqiptare që nuk zotëron një llogari bankare. Avantazhet për këtë pjesë të popullsisë konsistojnë në rritjen e fleksibilitetit për kryerjen e pagesave, duke llogaritur shtrirjen e gjerë të këtyre institucioneve në vend, por edhe në një kosto më të ulët për pagesat e kryera, sidomos për pagesat e gjobave, faturave mujore utilitare etj. Edhe pse numri i transaksioneve të pagesave me para elektronike nga institucionet e parasë ka arritur 41% të totalit të pagesave në formë elektronike, vlera e tyre mbetet e ulët në rreth 4% e vlerës së pagesave elektronike.

### 2.7.4. MBIKËQYRJA E SISTEMEVE TË PAGESAVE DHE ROLI REFORMATOR

Përtej operimit të sistemeve të pagesave, Banka e Shqipërisë i kushton vëmendje konsolidimit të rolit mbikëqyrës të këtyre sistemeve dhe të përdorimit të instrumenteve të pagesave si pjesë përbërëse e tyre. Për këtë qëllim, ajo ndërmerr masa për përmirësimin dhe forcimin e kuadrit rregullator dhe të infrastrukturës së pagesave, në përputhje me standardet evropiane.

Kuadri rregullator për zbatimin e ligjit “Për Shërbimet e Pagesave” është tashmë i plotë. Ky ligj transpozon Direktivën e BE-së për Shërbimet e Pagesave dhe hap tregun e pagesave për një sërë shërbimesh dhe institucionesh, në favor të rritjes së konkurrencës, uljes së kostove dhe rritjes së transparencës për konsumatorin. Gjatë vitit 2023 u punua për miratimin e rregulloreve të nevojshme për zbatimin e plotë të ligjit (për rregulloret e miratuara, shih 2.4.2 Rishikimi i kuadrit rregullativ dhe metodologjik).

Finalizimi dhe miratimi i ligjit “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike”<sup>28</sup> është një element i rëndësishëm në funksion të nxitjes së përfshirjes financiare (për informacion më të detajuar shih Hapësirën Informuese 5). Ai pritet të ndikojë pozitivisht përdorimin e shërbimit të pagesave dhe zgjerimin e popullsisë që zotëron një llogari pagese dhe kryen veprime me të.

Gjatë vitit 2023 ka nisur puna për **anëtarësim e Shqipërisë në Tregun Unik të Pagesave në Euro (SEPA)**, projekt ky tejet i rëndësishëm i Bankës së Shqipërisë. Procesi nisi në vitin 2021, kur Shqipëria u bë pjesë e projektit rajonal të Bankës

<sup>27</sup> Të dhënat janë deri në muajin nëntor 2023.

<sup>28</sup> Miratuar në datën 14.12.2023, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 1, datë 3.1.2024.



Botërore "Për modernizimin e sistemeve të pagesave në vendet e Ballkanit Perëndimor". Si pjesë integrale e axhendës së Procesit të Berlinit, krahas Bankës Botërore, ai mbështetet edhe nga Komisioni Evropian, CEFTA dhe RCC. Anëtarësimi i përshtetur i Shqipërisë në SEPA është një nga objektivat që duhet të përmbushen për të realizuar Planin e Ri të Rritjes 2024-2027, të miratuar nga Komisioni Evropian në nëntor të vitit 2023 (New Growth Plan for Western Balkans). Lejimi i anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në SEPA është një mundësi për të integruar platformat tona të kryerjes së pagesave dhe rrjedhimisht tregtinë elektronike me tregun evropian. Për këtë arsye, ky projekt ka marrë prioritet në strategjinë e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë (për më shumë detaje mbi kriteret, procedurat dhe përfitimet, shih Hapësirën Informuese 7).

## HAPËSIRË INFORMUESE 7

### PJESËMARRJA E SHQIPËRISË NË SEPA

Kriteret për zgjerimin e shtrirjes gjeografike të Zonës Unike të Pagesave në Euro (SEPA) janë përcaktuar nga Këshilli Evropian i Pagesave (EPC), dhe vlerësimi i përputhshmërisë me kriteret e pjesëmarrjes në SEPA ndërmerret po nga i njëjti entitet. Kriteret e pjesëmarrjes në SEPA janë zhvilluar për të lejuar komunitetin financiar në vendet jashtë Bashkimit Evropian të marrin pjesë në skemat SEPA. Më konkretisht, një bankë qendrore ose një entitet i ngjashëm mund të veprojë në emër të komunitetit financiar kombëtar për paraqitjen e kërkesës për pjesëmarrje në të cilën analizohen gjithashtu dhe pajtueshmëria ligjore e vendit me kriteret e pjesëmarrjes në SEPA. Për Shqipërinë, dosja e aplikimit do të paraqitet nga Banka e Shqipërisë.

Kriteret në lidhje me sigurimin e kushteve të barabarta ndërmjet aplikantit dhe pjesëmarrësve të tjerë të skemës SEPA fokusohen në pajtueshmërinë me legjislacionin e BE-së për pagesat. Kjo pajtueshmëri duhet të tregohet ose nëpërmjet dispozitave ligjore të përfaqësuar në mënyrë efektive ose nëpërmjet praktikave po aq detyruese në treg. Këto kritere nuk kërkojnë një zbatim të rreptë të legjislacionit përkatës të BE-së, por dispozitat përkatëse në legjislacionin vendas duhet të konsiderohen në thelb të barabarta ose funksionalisht të barabarta me legjislacionin e BE-së.

Banka e Shqipërisë po asistohet nga Banka Botërore në këtë proces, dhe tashmë ka bërë një vlerësim paraprak të nevojave për ndryshime ligjore që do të plotësojnë kriteret e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së. Ky vlerësim ka treguar se Shqipëria është ndjeshëm e avancuar në përafrimin e legjislacionit. Një zhvillim mjaft i rëndësishëm në këtë drejtim ka qenë dhe dalja e Shqipërisë nga lista gri - një kriter thelbësor ky për pjesëmarrjen në SEPA. Nëpërmjet Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave, edhe sistemi bankar është informuar mbi këtë nisëm. Angazhimi i sistemit bankar është mjaft i rëndësishëm për suksesin e këtij projekti pasi në vijim të aplikimit nga ana e Bankës së Shqipërisë dhe pranimit të mundshëm nga ana e EPC dhe Komisionit Evropian, bankat dhe jobankat do të duhet të anëtarësohen individualisht në skemat SEPA.



### **Përfitimet nga pjesëmarrja e Shqipërisë në SEPA**

Shqipëria është një vend me ndërveprim shumë të lartë ekonomik me vendet e Bashkimit Evropian, në fusha si:

- shkëmbimet tregtare import-eksport;
- të ardhurat nga puna dhe remitancat;
- turizmi, kryesisht nga vendet e Bashkimit Evropian;
- zgjerimi i kompanive evropiane në tregun shqiptar dhe anasjelltas.

Për zhvillimin me efikasitet sa më të lartë të këtyre ndërveprimeve është i nevojshëm krijimi i kanaleve të transferimit të fondeve në mënyrë sa më efektive, si në terma të kostove ashtu edhe të kohës. Një zhvillim që mund të mbështesë këtë objektiv është anëtarësimi i përshtetur në Zonën Unike të Pagesave në Euro (SEPA). Ky anëtarësim sjell një sërë përfitimesh të prekshme për aktorë të ndryshëm ekonomikë dhe për ekonominë në tërësi.

SEPA i bën pagesat ndërkufitare midis vendeve anëtare në të po aq të thjeshta dhe të lira sa pagesat brenda vendit. Me pjesëmarrjen në SEPA mundësohet zbatimi i parimit të tarifave të barabarta si për pagesat kombëtare, ashtu edhe për ato ndërkufitare të përpunuara në mënyrë elektronike në euro.

Aktualisht, transfertat dhe pagesat me vendet e Bashkimit Evropian dhe anasjelltas kryhen nëpërmjet bankave korrespondente - një kanal i kushtueshëm dhe joefikas për sa i përket kohës së ekzekutimit të transaksionit, monitorimit të finalizimit të tij, transparencës së kushteve të punës dhe mbrojtjes së konsumatorit. Për konsumatorët dhe bizneset, thjeshtësia, komoditeti dhe efikasiteti, janë tre nga përfitimet kryesore të anëtarësimit në SEPA, pasi qytetarët dhe bizneset shqiptare do të kryenin pagesa dhe transfertat brenda një tregu, duke shmangur banka ndërmjetëse.

Për zhvillimin e turizmit, anëtarësimi në SEPA u lehtëson turistëve evropianë pagesa të shpejta dhe me kosto të ulëta, sikur të ishin në Evropë apo në vendin e tyre të origjinës. Për investimet, lëvizja e fondeve dhe e pagesave midis Shqipërisë dhe vendeve të Bashkimit Evropian për qëllime investimi bëhet më e lehtë dhe më pak e kushtueshme. Së fundi, krijimi i një faciliteti të tillë do të rrisë dërgimin e formalizuar të remitancave prej vendeve e Bashkimit Evropian.

Banka e Shqipërisë ka punuar në mënyrë intensive për zhvillime infrastrukturore me anë të projektit "Up grade i sistemeve AIPS, AIPS Euro dhe AECH". Ky projekt synon implementimin e standardeve ndërkombëtare të procesimit të mesazheve (SEPA/ISO 20022), të cilat rrisin sigurinë e transaksioneve dhe sigurojnë uniformitetin në shkëmbimin e të dhënave në nivel global. Projekti nënkupton përmirësime të infrastrukturës teknike për të rritur sigurinë dhe efikasitetin e sistemeve që operohen nga Banka e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për implementimin e infrastrukturës për pagesat e shpejta (instant payment). "Pagesat e shpejta" janë shlyerje elektronike e pagesave me vlerë të vogël të disponueshme në çdo moment dhe me shlyerje pothuajse të menjëhershme ndërbankare të transaksionit.



Në rolin e reformatorit të tregjeve të pagesave dhe infrastrukturave përkatëse, Banka e Shqipërisë ka udhëhequr zbatimin e planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël (2018-2023). Viti 2023 ishte viti i fundit i implementimit në terma të përmirësimeve rregullative dhe të infrastrukturave të reja. Objektivat e matshëm (sasiorë) të Strategjisë janë arritur ose tejkaluar.



## 2.8. ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE

*Banka e Shqipërisë është autoriteti kombëtar përgjegjës për mbajtjen dhe administrimin e rezervave valutore të Shqipërisë. Ajo përdor mundësitë e saj më të mira për të arritur dhe ruajtur një nivel të caktuar të rezervës valutore, në mbështetje të qëndrueshmërisë financiare të vendit dhe në përputhje me politikën monetare.*

Gjatë vitit 2023, rezerva valutore bruto, e vlerësuar dhe e raportuar në monedhën Euro, është rritur me 890.11 milionë Eur, duke regjistruar në fund të muajit dhjetor vlerën 5,846.06 milionë Eur. Rritja e rezervave valutore dëshmon një përmirësim të ndjeshëm të aftësisë paguese të vendit.

Rregullorja “Për politikën dhe mënyrën e administrimit të rezervës valutore”, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, bën një përcaktim të qartë të objektivave parësorë të procesit të administrimit të rezervës, të tillë si likuiditeti dhe siguria. Sigurimi i të ardhurave nga administrimi i rezervës përfaqëson objektivin e tretë, për sa kohë nuk cenohen objektivat parësorë. Këshilli Mbikëqyrës miraton gjithashtu parimet dhe kriteret cilësore për zhvillimin e aktivitetit të administrimit të rezervës valutore. Në zbatim të këtyre kriterëve, Komiteti i Investimit miraton treguesit sasiorë dhe ndjek përmes raportimeve periodike vënien në zbatim të politikës së investimit.

Emrat e lejuar në të cilët investohet rezerva valutore miratohen nga Komiteti i Investimit. Këto emra përfshijnë qeveritë e SHBA-së, Japonisë, Britanisë së Madhe, Kanadasë, Australisë dhe Eurozonës, të cilat përgjithësisht janë të


renditura të paktën A- (për qeveritë e Eurozonës renditja minimale e pranuar është BBB<sup>29</sup>). Në emrat e lejuar për investim përfshihen dhe agjenci apo institucione të lidhura me qeveritë, institucione shumëpalëshe apo të tjera subjekte të renditura të paktën AA- (për banka/institucione të tjera financiare renditja minimale e pranuar A-).

Në fund të dhjetorit 2023, stoku i rezervës valutore bruto është 5,846.06 milionë Eur, ku përfshihet edhe ari monetar (rreth 108.59 mijë onz ose 3.38 ton).

### PËRBËRJA E PORTOFOLIT TË REZERVËS SIPAS MONEDHAVE

Në fund të vitit 2023, përbërja sipas monedhave e rezervës valutore bruto është: Usd 16.9%, Eur

Grafik 50. Ecuria e rezervës valutore



Burimi: Banka e Shqipërisë.

<sup>29</sup> Emrat/instrumentet e renditura deri në BBB- përfshihen në kategorinë “Për investim” (investment grade).




68.4%, Gbp 2.0%, Jpy 1.9%, Aud 0.8%, Sdr 4.4%, Ar 3.5%, Rmb 2.2%. Grafiku i mëposhtëm tregon ecurinë e përbërjes sipas monedhave të rezervës valutore bruto, ku monedha Euro në vazhdimësi ka peshën kryesore në portofol.

Ekspozimi në monedhat Aud (dollari australian) dhe Rmb (renminbi kineze) pasqyron vendimin e Këshillit Mbikëqyrës për investimin e një pjese të rezervës sipas shportës së Sdr-së. Pesha e monedhës Rmb shpërndahet në dy monedha, Rmb dhe Aud, sipas një raporti që miratohet nga Komiteti i Investimit.


### PËRBËRJA E PORTOFOLIT TË REZERVËS SIPAS AFATIT TË MATURIMIT

Rezerva valutore e administruar nga Banka e Shqipërisë është e investuar në aktive likuide, kryesisht me afat maturimi 1 - 3 vjet. Pesha e investuar në instrumente të borxhit me afat mbi 5 vjet është rritur kundrejt vitit 2022, duke përfaqësuar rreth 4% të portofolit të rezervës të investuar në tituj në mbyllje të vitit. Kjo lëvizje pasqyron dhe rritjen e kohëzgjatjes së investimit për portofolin strategjik si rrjedhojë e rritjes së normave të interesit. Në kushtet e rritjes së ndjeshme të stokut të rezervës, edhe pjesa e stokut të investuar në instrumente të borxhit është rritur. Pesha kundrejt totalit të stokut të rezervës së investueshme ka një ulje të lehtë krahasuar me vitin 2022. Portofoli i administruar nga administratori i jashtëm (Banka Botërore) vijon të investohet kundrejt një portofoli referencë 1-3 vjet, kryesisht në instrumente borxhi të emetuara nga qeveri dhe agjenci qeveritare.

Grafik 51. Përbërja sipas monedhave e rezervës valutore bruto




Grafik 52. Shpërndarja e rezervës sipas afatit të maturimit të instrumenteve\*




\*Në grafik nuk pasqyrohen fondet e mbajtura në llogari rrjedhëse si dhe pjesa e rezervës në ar monetar dhe Sdr. Gjendja e llogarive rrjedhëse në fund të vitit është rreth 1.1 miliardë Eur.  
Burimi: Banka e Shqipërisë.

### PËRBËRJA E PORTOFOLIT TË REZERVËS SIPAS RENDITJES DHE LLOJIT TË EMETUESVE/KUNDËRPALËVE

Në fund të vitit, rreth 90% e portofolit të rezervës valutore rezulton e investuar me emra me renditje të cilësisë së lartë (klasa AAA dhe AA, duke përfshirë edhe ekspozimet në llogari rrjedhëse). Ekspozimet sipas llojit të emetuesit/kundërpalës përfaqësohen nga qeveri/banka qendrore (70.9%), ndjekur nga banka/institucione të tjera financiare (11.3%), institucione shumëpalëshe (11%), agjenci (4.3%), institucione të garantuara nga qeveritë (2%) dhe autoritete qeveritare/organe publike (0.4%).




Grafik 53. Përbërja e portofolit të rezervës sipas vlerësimit (majtas) dhe kundërpalës (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 54. Kthimi i rezervës valutore\*



\*Në llogaritjen e kthimit të rezervës nuk merret parasysh efekti i kursit të këmbimit.  
Burimi: Banka e Shqipërisë.

### KTHIMI NGA INVESTIMI I PORTOFOLIT TË REZERVËS

Kthimi absolut i rezervës në total për vitin 2023, përfshirë dhe fondin e administruar nga Banka Botërore, ka rezultuar pozitiv 3.43%. Kthimi i krijuar nga administrimi aktiv i portofolit të rezervës ka qenë pozitiv. Për efekt krahasimi, në grafikun e mëposhtëm pasqyrohet ecuria e kthimit të rezervës kundrejt kthimit të tregut.<sup>30</sup>


Kthimi pozitiv i portofolit të rezervës është rezultat i krijuar nga rritja e normave të interesit në tregun ndërkombëtar gjatë vitit 2023. Po ashtu, madhësia dhe ritmi i rritjes së normave të interesit kanë qenë më të ulëta krahasuar me vitin 2022, çka ka mundësuar realizimin e të ardhurave të qëndrueshme, të pacenuara nga humbje kapitale që ndodhin në rastin e rritjeve të mëdha dhe të menjëhershme të normave të interesit, sikurse ndodhi gjatë vitit 2022.

<sup>30</sup> Kthimi i tregut pasqyron ecurinë e agreguar të performancës së tregjeve në vendet e zhvilluara sipas peshës që monedhat kryesore Eur, Usd, Gbp, Jpy dhe Aud kanë në portofolin e rezervës valutore.





Grafik 55. Normat 2-vjecare të interesit për emetimet e qeverive me peshë të rëndësishme në portofolin e rezervës



Burimi: Bloomberg.


### ZHVILLIME TË TJERA NË KUADËR TË FUNKSIONIT TË ADMINISTRIMIT TË REZERVËS VALUTORE

Në kuadër të rivlerësimit periodik të peshës së arit monetar në rezervën valutore, në fillim të muajit shkurt, Këshilli Mbikëqyrës mori vendim për blerjen e 28 lingotave ar (11,200 onz ose rreth 0.35 ton ar). Blerjet e arit monetar u realizuan gjatë periudhës shkurt – mars.

Gjatë vitit 2023 ka vijuar bashkëpunimi i Bankës së Shqipërisë me Bankën Botërore në kuadër të marrëveshjes “Për Administrim dhe Konsulencë në Investimin e Rezervës Valutore” (RAMP). Banka Botërore ka vijuar të ofrojë trajnime dhe programe edukimi të specializuara. Këto kualifikime kanë synuar konsolidimin dhe rritjen e shkallës së profesionalizmit të punonjësve të angazhuar në procesin e administrimit të rezervës valutore, të stafit që mbështet ose monitoron ecurinë e këtij procesi, si dhe të stafit të Bankës në përgjithësi.

Gjithashtu, është realizuar rinovimi apo shtyrja e afatit për disa marrëveshje që i shërbejnë Bankës së Shqipërisë për ruajtjen e disponueshmërisë së likuiditetit të nevojshëm, me synim ruajtjen dhe mbështetjen e stabilitetit financiar të vendit. Marrëveshja e bazuar në Repo me Bankën për Rregullime Ndërkombëtare, për shumën 500 milionë Eur u rinovua. Në mbështetje të nevojave për likuiditet është dhe marrëveshja në Swap me Bankën Popullore të Kinës, për shumën 2 miliardë Rmb.

Sa i takon infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, gjatë vitit 2023 filloi puna për hartimin e Termave të Referencës (kërkesat dhe dokumentet shoqëruese) për marrjen e një sistemi të ri që do të mbështesë aktivitetet që kryhen nga Departamenti i Operacioneve Monetare për qëllime të administrimit të rezervës valutore, zbatimit të politikës monetare, dhe nga Departamenti i Sistemeve të Pagesave dhe Kontabilitetit e Financës për qëllime të shërbimit të pagesave



dhe transfertave. Për hartimin dhe vlerësimin e kërkesave nga sistemi i ri në funksion të administrimit të rezervës valutore, Banka e Shqipërisë mbështetet në asistencën teknike të Bankës Botërore. Për kërkesat nga sistemi i ri për zbatimin e politikës monetare dhe shërbimin e pagesave dhe transfertave, mbështetja kryesore është përvoja e krijuar në kohë nga vetë institucioni.

## HAPËSIRË INFORMUESE 8

### FLUKSET QË NDIKUAN REZERVËN VALUTORE, GJATË VITIT 2023

Faktorët kryesorë që kanë ndikuar rezervën valutore bruto paraqiten të grupuara si më poshtë:

- Veprimet e lidhura me aktivitetin e Ministrisë së Financave kanë pasur ndikim pozitiv në shumën 308.83 milionë Eur, sipas zërave të mëposhtëm:
  - hyrje nga grante dhe lëvrimi i huave të dhëna 448.88 milionë Eur,
  - hyrje nga emetimi i borxhit në tregun e jashtëm në shumën 593.46 milionë Eur,
  - transfertat për shërbimin e borxhit dhe të tjera 733.51 milionë Eur;
- Veprimet e bankave të nivelit të dytë dhe subjekteve të tjera kanë pasur ndikim pozitiv në shumën 192.29 milionë Eur, sipas zërave të mëposhtëm:
  - derdhje nga bankat e nivelit të dytë në llogarinë e tyre pranë Bankës së Shqipërisë për plotësimin e rezervës së detyrueshme, administrimin e ekspozimeve në bilanc etj. 4,580.04 milionë Eur,
  - transfertat nga bankat e nivelit të dytë 4,387.71 milionë Eur,
  - dalje neto për llogari të subjekteve të tjera (ASD, etj.) 0.04 milionë Eur;
- Veprimet e Bankës së Shqipërisë kanë pasur ndikim pozitiv në shumën 317.61 milionë Eur, sipas zërave të mëposhtëm:
  - blerje neto të valutës nga bankat e nivelit të dytë dhe institucione të tjera 262.01 milionë Eur:
    - o nga bankat e nivelit të dytë 251.30 milionë Eur,
    - o nga Ministria e Financave 7.80 milionë Eur,
    - o nga institucione të tjera 2.91 milionë Eur,
    - hyrje nga interesa, kuponë etj. (të llogaritura në bazë cash-i) të krijuara nga investimi i rezervës valutore llogaritet në 65.66 milionë Eur,
    - transfertat 10.06 milionë Eur;
- Faktorët e tregut kanë pasur ndikim pozitiv në shumën 71.38 milionë Eur, sipas zërave të mëposhtëm:
  - luhatjet në kursin e këmbimit të monedhave në përbërje të rezervës valutore kanë ndikuar lehtësisht në mënyrë negative vlerën e rezervës bruto të raportuar në Eur me 41.83 milionë Eur,
  - efekti i rivlerësimit për portofolin, si rrjedhojë e luhatjes së normave të interesit, llogaritet në një vlerë pozitive, rreth 113.21 milionë Eur<sup>1</sup>.

<sup>1</sup> Kjo vlerë ka në përmbajtje dhe efektin e krijuar nga derdhja e kuponëve të titujve dhe është e korrigjuar për veprimet e blerjes/shitjes/maturimit të titujve në baza cash-i.



## 2.9. STATISTIKAT

*Në përputhje me përcaktimet në ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”, Programin Zyrtar të Statistikave dhe Ligjin për Statistikat Zyrtare, funksioni statistikor në Bankën e Shqipërisë synon nxjerrjen e statistikave të paanshme, objektive dhe të besueshme në shërbim dhe në përmbushje të objektivave ligjorë të Bankës, si bankë qendrore e Republikës së Shqipërisë dhe si agjenci statistikore brenda Sistemit Kombëtar Statistikor.*

Banka e Shqipërisë është përdoruese dhe prodhuese e statistikave - kryesisht në lidhje me tregjet financiare, institucionet financiare dhe infrastrukturën financiare. Në këtë kuadër, zhvillimi i statistikave monetare dhe financiare dhe ato të sektorit të jashtëm të ekonomisë është një përgjegjësi themeltare e Bankës së Shqipërisë, jo vetëm në funksion të objektivave të saj, por edhe të rritjes së transparencës dhe komunikimit me publikun. Tërësia e statistikave të prodhuara nga Banka e Shqipërisë, shoqëruar edhe me metodologjinë përkatëse, gjenden në faqen zyrtare të internetit të bankës, në seksionin Statistikat.


Në kuadër të integritimit në BE dhe të anëtarësimit në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore, Banka e Shqipërisë synon krijimin e një kuadri kombëtar statistikor, i cili të mund të integrohet në kuadrin statistikor Evropian dhe të mbështetet në infrastruktura moderne të IT-së dhe specialistë të trajnuar. Në këtë drejtim, është punuar për zhvillimin e treguesve dhe raporteve të reja statistikore, paralelisht me përafrimin e atyre ekzistuese dhe ka filluar publikimi i treguesve të detajuar statistikorë, në përputhje me kornizën kohore të parashikuar në Programin e Transmetimit të të Dhënave pranë Eurostat. Në vlerësimin e tyre të fundit, Komisioni Evropian pohon përputhshmërinë e lartë të transmetimit të statistikave të sektorit të jashtëm me *acquis communautaire*. Banka e Shqipërisë është përzgjedhur për t’iu bashkuar Bordit Këshillimor të Aksesit Financiar të FMN-së. Ky vlerësim pasqyron angazhimin tonë aktiv në iniciativat globale për matjen sasiore dhe identifikimin e mangësive në drejtim të përfshirjes financiare të popullatës.

Për më tepër, në përgjigje të rëndësisë në rritje të financave të gjelbra, përpjekjet tona strategjike në këtë fushë janë evidente përmes hartimit të Strategjisë së Financave të Gjelbra dhe punës për identifikimin e treguesve dhe ndërtimin e Greendashboard. Të dhëna të tilla të lidhura me klimën janë kyçe për mbikëqyrjen mikroprudenciale dhe makroprudenciale.

**Me fokus dhe në funksion të përafrimit metodologjik të statistikave me standardet ndërkombëtare dhe harmonizimin e tyre sipas *acquis communautaire* është bërë:**

1. Zbatimi i strategjisë afatmesme të ESCB (European System Central Banks) dhe organizmave ndërkombëtar për bilancin e pagesave dhe statistikave të pozicionit ndërkombëtar dhe investimeve direkte

Banka e Shqipërisë është pjesëmarrëse aktive në grupet teknike të punës me



përfaqësim të vendeve anëtare dhe në bashkëpunim të ngushtë me FMN-në dhe Eurostat-in, lidhur me vlerësimin e treguesve statistikorë dhe adaptimin e metodologjive të reja, që rrjedhin nga ndryshimet e standardit ndërkombëtar të hartimit të bilancit të pagesave (FMN, BPM6), si dhe plotësimin e kuadrit raportues të të dhënave për vendet anëtare.

2. Raportimi pranë Eurostat-it për raportet e cilësisë për statistikën e bilancit të pagesave/statistikën e pozicionit ndërkombëtar të investimeve, treguesve financiarë dhe monetarë, dhe llogarive financiare

Implementimi i kërkesave të reja për cilësinë e të dhënave vjen në përputhje me angazhimin publik për harmonizimin me standardet e cilësisë dhe strukturën e Statistikave Evropiane nga Sistemi Evropian i Bankave Qendrore, konform përmbajtjes së sugjeruar dhe standardit të BQE/EUROSTAT. Gjatë vitit 2023, detajimi i të dhënave të transmetuara në Eurostat për statistikën e investimeve të huaja direkte dhe llogarive financiare u rrit.

3. Harmonizimi me bazën rregullatore të Bankës Qendrore Evropiane, në lidhje me bilancin e gjendjes së sektorit të institucioneve të tjera financiare

Është përshtatur plotësisht kuadri rregullator i BQE-së në lidhje me raportimin e bilancit të gjendjes së fondeve të pensionit, institucioneve të tjera financiare dhe shoqërive të sigurimit. Në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, për qëllim të zbatimit të këtyre tre rregulloreve, format e raportimit të të dhënave mbledhen nga AMF-ja dhe dërgohen pranë Bankës së Shqipërisë, konform kalendarit të përcaktuar.

Kjo bazë rregullatore, së bashku me rregulloren KM (48/2017) "Për raportimet në Bankën e Shqipërisë të statistikave të normave të interesit", dhe rregulloren KM (73/2021) "Për raportimet në Bankën e Shqipërisë të zërave të bilancit të institucioneve të kreditit dhe të institucioneve monetare financiare", plotësojnë kuadrin bazë për informacion statistikor në funksion të vendimmarrjes për politikën monetare në Bankën e Shqipërisë, konform standardeve të BQE-së.

4. Zbatimi i Udhëzuesit të BQE-së për raportimin në fushën e llogarive financiare tremujore (ECB/2013/24)

Gjatë vitit, janë kryer përmirësime të ndjeshme në drejtim të afateve kohore dhe të cilësisë së llogarive financiare, si pjesë e zbatimit të ESA2010 dhe përcaktimeve të BQE-së. Është finalizuar paraqitja "nga kush te kush" për flukset financiare të çdo sektori të ekonomisë. Në proces, vijon konsolidimi dhe finalizimi i të dhënave tremujore për sektorin e Qeverisë së Përgjithshme – i lidhur ngushtë me ecurinë e hartimit dhe raportimit pranë Eurostat-it të EDP (Procedura e Deficitit të Tejkuluar)<sup>31</sup>.

---

<sup>31</sup> EDP - Procedura e Deficitit të Tejkuluar përfaqëson një bllok të rëndësishëm statistikor për monitorimin e shëndetit të financave publike në vendet anëtare dhe vendet kandidatë në drejtim të respektimit të dy kritereve të Maastricht-it: raportin e deficitit të qeverisë së përgjithshme ndaj PBB-së dhe raportin e borxhit publik ndaj PBB-së, që nuk i kalojnë vlerat e referencës përkatësisht prej 3% dhe 60%.



## 5. Hartimi i statistikave të financave të qeverisë konform standardit ESA2010

Përmirësime cilësore në vitin 2023 janë bërë edhe në fushën e statistikave të financave të qeverisë, me punë të vazhdueshme për përafrimin e treguesve ekzistues statistikorë me standardet metodologjike të Eurostat-it. Hartimi i statistikave të financave të qeverisë konform standardit ESA2010 është produkt i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe mbështet nga FMN-ja përmes projektit “Për statistikave të financave të qeverisë - Procedura e Deficitit të Tejkualuar dhe llogaritë financiare të qeverisë sipas standardeve metodologjike dhe praktikave më të mira ndërkombëtare”.

Procedura e Deficitit të Tejkualuar është instrumenti bazë me anë të së cilës realizohet kuadri i politikës fiskale të BE-së, i cili buron nga Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian.

U punua në mënyrë intensive për hartimin e të dhënave tremujore të qeverisë (tabelat 27 dhe 28 të EDP për Eurostat-in), çka mundësoi plotësimin e detyrimit të transmetimit pranë Eurostat-it, përkatësisht nga Banka e Shqipërisë (llogaritë financiare) dhe INSTAT (llogaritë jofinanciare).

Gjithashtu, për herë të parë, u realizua hartimi dhe transmetimi pranë Eurostat-it i të dhënave vjetore për sektorin e Qeverisë së Përgjithshme përfshirë njësitë ekstrabuxhetore, për periudhën T1 2010 – T2 2023.

## 6. Implementimi i strategjisë për mbikëqyrjen e rreziqeve financiare të lidhura me klimën në sektorin financiar në kuadër të projektit për financat e gjelbra

Gjatë 2023, në kuadër të strategjisë “Për administrimin dhe mbikëqyrjen e rreziqeve financiare të lidhura me klimën në sektorin financiar” për periudhën 2023-2025, përparim është bërë në drejtim të përpilimit të panelit të treguesve që mundësojnë hulumtime dhe analiza më të thelluara mbi rreziqet që lidhen me klimën dhe ekspozimin e sektorit bankar ndaj tyre.

## 7. Mbështetje gjithnjë e më e madhe në burimet e anketave së bashku me pjesëmarrjen në rrejet ndërkombëtare të kërkimit

Anketa e Financave dhe Konsumit të Familjeve dhe Anketa mbi Aksesin në Financat e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme janë grup burimesh alternative informacioni. Anketa e Financave dhe Konsumit të Familjeve kryhet nga shumica e bankave qendrore në shtetet anëtare të BE-së për të vlerësuar efektin e goditjeve financiare tek familjet, për të arritur një kuptim më të mirë të sjelljes dhe vendimmarrjes financiare të tyre, për të vlerësuar efektet e politikave sociale, tatimore, arsimore dhe të tjera, si dhe kërkime mbi varfërinë dhe pabarazinë. Ajo bazohet në një metodologji të standardizuar të zhvilluar në kuadër të Rrejtit të Financave dhe Konsumit të Familjeve të BQE-së. Në



vitin 2023, Banka e Shqipërisë zhvilloi Anketën mbi Aksesin në Financat e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, i cili shqyrton nevojat financiare të këtij segmenti të ekonomisë dhe pengesat me të cilat përballet ai.

8. Harmonizimi me standardet ndërkombëtare (IFRS dhe kontabilitetit bankar) i raportimit rregullator për mbikëqyrjen bankare, në përputhje me ITS të EBA-së për raportimin rregullator

Me një agjendë intensive është punuar për adaptimin e kornizës së përbashkët të raportimit të standardizuar financiar të bankave (FINREP) sipas standardit të EBA-së. Procesi asistohet nga FINSAC.

9. Banka plotësoi gamën e treguesve të qëndrueshmërisë financiare me tregues të rinj për transmetim në FMN, si dhe vijoi pjesëmarrjen në Anketën e Aksesit dhe Përdorimit të Shërbimeve Financiare (FAS) të FMN-së (Access to and Use of Financial Services, FAS)
10. Një nga objektivat më të rëndësishme në fushën e prodhimit statistikor në Bankën e Shqipërisë është zhvillimi i një sistemi të integruar të të dhënave (DWH)

Krijimi i një sistemi të integruar të të dhënave rrit shpejtësinë dhe aksesin në to dhe hedh themelet për analitike të avancuar dhe aplikacione të inteligjencës artificiale.




## 2.10. PUNA KËRKIMORE

*Banka e Shqipërisë synon të mbështesë procesin e saj vendimmarrës në themele të forta dijesh dhe njohurish mbi ekonominë shqiptare. Investimi në krijimin e kapaciteteve të shëndosha kërkimore ndihmon në rritjen cilësore të punës, të reputacionit dhe të besueshmërisë së Bankës së Shqipërisë, si një institucion që zotëron metodologjitë përkatëse dhe njohuritë e nevojshme për të garantuar ekuilibrat makroekonomikë të vendit. Për këto arsye, zhvillimi aktiv i kërkimit shkencor zë një vend parësor në strategjinë e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë.*

Hulumtimi shkencor në Bankën e Shqipërisë, gjatë vitit 2023, u fokusua drejt analizave të fenomeneve ekonomike e financiare në funksion të politikës monetare e të stabilitetit financiar. Projektet e tjera kërkimore u orientuan drejt çështjeve të rëndësishme siç janë financa e gjelbër dhe sfidat e sistemit bankar në përballimin e rreziqeve të papritura natyrore, përmirësimi i edukimit dhe i përfshirjes financiare në vend, si dhe çështjet mbi ekonomiksin ndërkombëtar dhe të zhvillimit. Në përputhje me strategjinë afatmesme të kërkimit shkencor, puna kërkimore ka vijuar të mbështesë procesin vendimmarrës për hartimin dhe zbatimin e politikave të Bankës së Shqipërisë, nëpërmjet krijimit të statistikave të nevojshme dhe pasurimin e portofolit të modeleve ekonomike, duke shfrytëzuar mjetet dhe teknikat e reja kompjuterike që ofron inteligjenca artificiale.

Projektet në funksion të vendimmarrjes së politikës monetare dhe të stabilitetit financiar kanë vazhduar t'i kushtojnë një vëmendje të veçantë analizave ekonomike mbi sfidat që paraqesin pasojat potenciale të ngrohjes globale. Tre studime janë përqendruar në implikimet e tyre makro-financiare në Shqipëri dhe në rajon, si dhe në rolin e institucioneve financiare në kontekstin e menaxhimit të rrezikut të ardhur nga ndryshimet e klimës. Ndërsa ndryshimet klimatike po rrisin frekuencën dhe ashpërsinë e tyre, është thelbësore të kuptohet ndikimi i ekstremeve të motit në rritjen ekonomike, në nivelet e çmimeve dhe në stabilitetin financiar. Studimet tona në këto fusha gjejnë se ngjarjet ekstreme të motit shoqërohen me tkurrje të konsiderueshme të prodhimit, me rritje të ndjeshmërisë së sistemit financiar dhe me presione inflacioniste. Për të zbutur dëmet e mundshme nevojiten transformime të rëndësishme strukturore dhe investime për të pozicionuar ekonominë shqiptare në një rrugë të qëndrueshme. Kjo e fundit arrihet nga një përfshirje dhe koordinim i të gjitha institucioneve private dhe publike.

Projektet kërkimore mbi politikën monetare u përqendruan në analizën e kreditimit, në vlerësimin e marrëdhënies afatgjatë të kërkesës dhe ofertës për kredinë ndaj biznesit dhe në monitorimin e kushteve financiare dhe implikimet e tyre në zinxhirin e transmetimit të politikës monetare. Ato dalin në përfundimin se ekziston një lidhje e fortë afatgjatë midis kredisë së kërkuar e ofruar dhe treguesve makrofinanciarë si besimi ekonomik, kushtet e likuiditetit, kostot oportune, *spread-i*, konkurrenca bankare dhe sjellja e tyre e kujdesshme, si dhe lëvizjet e kursit të këmbimit.



Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit të Bankës së Shqipërisë me Shkollën Ekonomike të Londrës (LSE), është vazhduar të punohet mbi dy projekte që analizojnë brishtësitë financiare të familjeve në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në Shqipëri dhe që kanë implikime mbi stabilitetin financiar. Njëri prej tyre përdor të dhënat e valës së tretë të vërtetimit të EBRD-së (2016), "Life in Transition", për të analizuar shpërndarjen e familjeve të brishta në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor. Rezultatet tregojnë se thujtse gjysma e familjeve në Ballkanin Perëndimor nuk mund të përballonin një ngjarje të papritur shpenzimesh.

Tashmë bëhen disa vite që Banka e Shqipërisë i kushton vëmendje të veçantë sfidave që sjellin edukimi dhe përfshirja financiare e individëve për eficiencën e transmetimit të politikës monetare. Raporti më i fundit prezanton rezultatet e Vërtimit të Kulturës Financiare të rriturve në Shqipëri, të ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2023. Indeksi i kulturës financiare të të rriturve në Shqipëri paraqet përmirësime nga e kaluara, duke arritur nivelin 59 pikë (nga 100 që është maksimumi) në vitin 2023. Ky vlerësim është 4 pikë më i ulët se indeksi mesatar në vendet e OECD-së.

Projektet e tjera kërkimore kanë pasur në fokus ekonominë ndërkombëtare dhe zhvillimin, tendencat demografike dhe efektet e tyre, si dhe ndërtimin e statistikave të reja të nevojshme. Hulumtimet mbi matjen e përfitimeve nga integrimi ekonomik e financiar midis Shqipërisë dhe Kosovës dalin në përfundimin se integrimi më i plotë sjell avantazhe të mëtejshme për të dy vendet. Studimi mbi karakteristikat e migrimit shqiptar dhe efektet negative që shoqërojnë këto tendenca konkludon se politikat publike duhet të adaptohen dhe të synojnë ndryshime strukturore për t'i bërë ballë reduktimit të kapitalit njerëzor në tregun e punës dhe minimizimit të efekteve negative në Shqipëri. Në kuadër të krijimit të statistikave të nevojshme për analizat ekonomike, është punuar për krijimin e një databaze mbi veprimtarinë e bankave në periudhën 1944-1990 dhe për ndërtimin e një indeksi të çmimit të qirave në rang vendi.

Këto dhe studime të tjera janë bërë objekt i diskutimit në aktivitetet dhe konferencat e organizuara nga Banka e Shqipërisë apo institucione të tjera, ku merren komente e vërejtje me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të tyre. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë organizoi "Takimin e 17-të Rajonal të Kërkimeve për Evropën Juglindore", në datat 4-5 dhjetor 2023. Ky aktivitet kërkimor shkencor shërben si një forum diskutimi për punimet kërkimore mbi çështjet aktuale ekonomike dhe financiare, dhe si nxitës i shkëmbimit të pikëpamjeve midis kërkuesve të Bankës së Shqipërisë, bankierëve qendrorë, komunitetit akademik, në rajon dhe më gjerë.

Në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë, nën kategorinë "Botime/Botime kërkimore" gjendet informacion më i detajuar dhe i plotë mbi të gjitha punët kërkimore të Bankës së Shqipërisë. Punë të tjera kërkimore publikohen në formën e artikujve në Revistën Ekonomike të Bankës së Shqipërisë. Revista me frekuencë gjashtëmujore "Të rejtat shkencore në Bankën e Shqipërisë" ka për





qëllim informimin në lidhje me materialet studimore të sapo përfunduara apo ato në proces, materialet e prezantuara në aktivitetin "Seminaret e së Premtes" apo në aktivitete të tjera të organizuara nga Banka e Shqipërisë.



## 2.11. INTEGRIMI EVROPIAN DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

*Banka e Shqipërisë ka vijuar të japë kontributin e saj në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga hapja e procesit të negociatave për anëtarësim në BE, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, progres-raportet e Komisionit Evropian, nënkomitetet e përbashkëta BE-Shqipëri, si dhe Plani Kombëtar për Integrimin Evropian. Ajo është kryesuese në dy grupet pune ndërinstitucionale të integritit evropian për 2 kapituj të acquis.*

Pas hapjes së negociatave më 19 korrik 2022 dhe mbajtjes së Konferencës së Parë Ndërqeveritare midis Shqipërisë dhe BE-së, gjatë vitit 2023 u mbajtën takimet bilaterale screening për çdo kapitull të acquis-it midis delegacioneve shqiptare dhe përfaqësuesve të Komisionit Evropian (KE). Ky proces u përmbyll me evidentimin e hendeqeve ekzistuese ligjore dhe institucionale në krahasim me kuadrin e BE-së për çdo kapitull. Në këto takime u parashtruan planet për përafrim të mëtejshëm me BE-në me anë të përmbushjes së kriterëve në çdo kapitull negociues. Pas përfundimit të takimeve në muajin nëntor 2023, Komisioni Evropian pritet të miratojë në Këshillin e BE-së një raport screening për secilin kapitull. Aktualisht është dorëzuar raporti i parë screening për grup-kapitujt "Thelbësoret".

Banka e Shqipërisë, si institucion lider për kapitullin 4 – Lëvizja e lirë e kapitalit, dhe kapitullin 17 – Politikat Ekonomike dhe Monetare, ka qenë e angazhuar në përgatitjen e takimeve bilaterale të mbajtura në datat 15 shkurt dhe 15 qershor 2023, ku ka koordinuar punën me institucionet kontribuuese, në bashkëpunim me Zyrën e Kryenegociatorit. Banka e Shqipërisë ka kontribuar në takimet bilaterale të kapitujve të tjerë si Kapitulli 9 – Shërbimet Financiare, Kapitulli i Kriterit Ekonomik, Kapitulli 32 – Kontrolli Financiar dhe Kapitulli 18 – Statistikat, Kapitulli 28 – Mbrojtja e konsumatorit, si dhe në kapitujt 24 dhe 20. Banka e Shqipërisë ka angazhuar rreth 35 përfaqësues të saj në këto takime, në rolin e prezantuesve, mbështetësve dhe sekretariatit teknik, të cilët kanë paraqitur mbi 20 prezantime.

Banka e Shqipërisë përfaqësohet rregullisht në takimin vjetor në nivel të lartë të Komitetit të Stabilizim-Asociimit, në takimet e dy Nënkomiteteve: 1) Tregu i brendshëm dhe Konkurrenca, dhe 2) Çështjet Ekonomike, Financiare dhe Statistikat, si dhe në dialogun ekonomik dhe financiar midis BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, ku janë diskutuar në nivel politik e teknik çështje si: zbatimi i politikës monetare, stabiliteti financiar, zhvillimet në sektorin bankar, përfshirja financiare etj.

Në muajin nëntor 2023, Komisioni Evropian dorëzoi pranë autoriteteve shqiptare progres-raportin 2023. Raporti vlerëson punën e Bankës së Shqipërisë në hartimin dhe zbatimin e politikës monetare, e cila konsiderohet e përshtatshme dhe efektive. Aty vlerësohet ruajtja e stabilitetit financiar dhe



përafrimi i legjislacionit në fushën e mbikëqyrjes, ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe të sistemeve të pagesave.

Në Kapitullin 4, Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit. Progresi në këtë kapitull është fokusuar në zbatimin e rekomandimeve të Moneyval dhe të Planit të Veprimit të Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF). Në muajin tetor, Shqipëria doli nga lista gri. Progres ka pasur gjithashtu në përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar të sistemit të pagesave me acquis të BE-së, veçanërisht në fushën e Direktivës së Parasë Elektronike, Direktivës së Llogarisë së Pagesave dhe në edukim financiar.

Në Kapitullin 17, Shqipëria ndodhet midis një niveli të moderuar dhe të mirë përgatitjeje në fushën e politikës ekonomike dhe monetare. Qeverisja dhe politika monetare e Bankës së Shqipërisë u vlerësuan të përshtatshme dhe efektive për të përballuar krizën e shkaktuar nga agresioni i Rusisë kundër Ukrainës. Shqipëria bëri progres në rekomandimet e vitit të kaluar për të përmirësuar mekanizmin e koordinimit të politikave dhe të konsultimit të qeverisë me palët e interesuara joqeveritare, në përafrimin e llogarive qeveritare dhe kombëtare me ESA2010 dhe në njoftimet për procedurën e deficitit të tepërt.

#### **MARRËDHËNIET ME FONDIN MONETAR NDËRKOMBËTAR**

Republika e Shqipërisë vazhdon të qëndrojë në kuotën e 139.3 milionë SDR (0.03 % e totalit) dhe zotëron 2.858 vota ose 0.06% të shumës së përgjithshme të votave të të gjithë anëtarëve të FMN-së. Ajo ndodhet në të njëjtën konstituencë me Italinë, Greqinë, Portugalinë, Maltën dhe San Marinon. Borxhi total i Shqipërisë ndaj FMN-së, i akumuluar ndër vite, deri më 31 dhjetor 2023 është 211.14 milionë SDR.

Marrëdhëniet e Shqipërisë me FMN-në vijojnë të përqendrohen nën konsultimet e Artikullit IV. Më datë 12 janar 2024, Bordi Ekzekutiv i FMN-së përmbylli konsultimet për Artikullin IV me Shqipërinë dhe, në përfundim publikoi vlerësimet mbi ecurinë e ekonomisë shqiptare dhe rekomandimet përkatëse.

#### **MARRËDHËNIET ME GRUPIN E BANKËS BOTËRORE**

Grupi i Bankës Botërore ka filluar punën në Shqipëri në vitin 1991 dhe ka mbështetur projekte në synim të zbutjes së varfërisë dhe sigurimin e mjeteve për zhvillimin të qëndrueshëm e afatgjatë. Shqipëria bën pjesë në konstituencën e përbërë nga Greqia, Italia, Portugalia, Malta dhe Timori Lindor. Totali i kredive të lëvruara nga Grupi i Bankës Botërore është 490 milionë USD dhe ai i granteve 1.6 milionë USD<sup>32</sup>.

Banka Botërore ka mbështetur Bankën e Shqipërisë në fushën e pagesave, administrimit të rezervës valutore, mbikëqyrjes financiare, ndërhyrjes së jashtëzakonshme, statistikave, sigurisë kibernetike, edukimit dhe përfshirjes financiare etj.

<sup>32</sup> Informacion i përfuar nga faqja zyrtare e internetit të Grupit të Bankës Botërore për Shqipërinë, përditësuar në tetor 2023.



### **BASHKËPUNIMI TEKNIK**

Gjatë vitit 2023 ka vazhduar zbatimi i fazës së dytë të programit “Forcimi i kapaciteteve të bankave qendrore të vendeve candidate dhe kandidatëve të mundshëm për anëtarë të BE-së nga Ballkani Perëndimor” të financuar nga BE-ja, nëpërmjet Instrumentit të tij për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA III). Ky program mbështet bankat qendrore dhe agjencitë e mbikëqyrjes në vendet e fokusit të programit për forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve institucionale, përmes përmirësimit të mëtejshëm të instrumenteve të tyre analitike dhe politike bazuar në standardet më të mira ndërkombëtare.

Banka e Shqipërisë ka marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga Bankat Qendrore Evropiane, si dhe ka përfituar nga ekspertiza e tyre në fushat e komunikimit, sistemit të pagesave, politikës monetare, teknologjisë së informacionit, auditit të brendshëm, mbikëqyrjes bankare, financave të gjelbra etj. Gjithashtu është nënshkruar dhe një marrëveshje dypalëshe ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Bankës së Spanjës në fushën e shërbimeve juridike.

### **AKTIVITETE TË TJERA**

- Në datën 28 mars 2023, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mbajti një leksion publik të organizuar nga Shkolla Ekonomike dhe e Shkencave Politike të Londrës (LSE), me temë “Dealing with Shocks at the Gates of EU: New Policy Instruments & The Role of Central Banks”. Ky leksion u organizua në kuadër të bashkëpunimit që Banka e Shqipërisë ka ndër vite me LSE-në në fushën akademike dhe studimore, me pjesëmarrje të ekspertëve ndërkombëtarë në fushën e ekonomisë, të akademikëve të universitetit e të studentëve të huaj e shqiptarë. Guvernatori diskutoi mbi sfidat ekonomike dhe financiare me të cilat përballen ekonomitë e vogla e të hapura të Ballkanit Perëndimor, e në veçanti Shqipërisë, në rrugëtimin drejt Bashkimit Evropian (BE), si dhe implikimet që ky proces ka për politikën monetare dhe financiare të bankave qendrore.
- Në datën 22 qershor 2023, Bordi Drejtues i Qendrës së Ekselencës në Financë (Centre of Excellence in Finance - CEF) zhvilloi mbledhjen e tij vjetore në ambientet e Bankës së Shqipërisë për të analizuar arritjet e deritanishme, diskutuar planet për të ardhmen dhe rritur përpjekjet për fuqizimin e institucioneve publike. Bordi Drejtues është organi më i lartë vendimmarrës i këtij institucioni dhe anëtarë të tij janë ministrat e financave dhe guvernatorët e bankave qendrore të vendeve anëtare.

### **PJESËMARRJE NË AKTIVITETE NDËRKOMBËTARE SI KONFERENCA, FORUME E SEMINARE**

- Në datat 10-11 janar 2023, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mori pjesë në Forumin për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL) – një aktivitet i përvitshëm i “Euromoney” që mbledh së bashku figura të njohura të fushës akademike, ekonomike e financiare nga vendet e EQL-së – për të diskutuar mbi zhvillimet më të fundit



ekonomike në këto vende.

- Në datën 28 shkurt 2023, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë mori pjesë në një takim diskutimi mbi çështjet që prekin aksesin në financa në Shqipëri, të organizuar nga Banka Botërore, me të ftuar drejtuesit e bankave tregtare, përfaqësues nga institucionet financiare dhe ekspertë të sektorit në vend. Ky takim u realizua në kuadër të bashkëpunimit të Bankës Botërore me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për përgatitjen e një projekti mbështetës për financimin e bujqësisë.
- Në datën 10 mars 2023, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, mori pjesë në Mbledhjen e Konstituencës të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe të Grupit të Bankës Botërore (BB), zhvilluar në San Marino. Në këtë mbledhje, guvernatorët dhe ministrat e financave të vendeve anëtare të konstituencës diskutuan mbi zhvillimet në ekonominë botërore dhe ekonominë përkatëse. Në fokus të diskutimeve ishin sfidat e rimëkëmbjes post-COVID dhe tensionet gjeopolitike.
- Në datat 12-15 prill 2023, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë mori pjesë në Mbledhjet e Pranverës të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe të Grupit të Bankës Botërore (BB), në Uashington. Në këto mbledhje marrin pjesë guvernatorë të bankave qendrore dhe ministrat e financave të vendeve anëtare, drejtues të lartë të institucioneve financiare ndërkombëtare, si dhe përfaqësues të botës akademike, biznesit dhe shoqërisë civile.
- Në datat 29-30 maj 2023, Zëvendësguvernatorja e Parë e Bankës së Shqipërisë, zj. Luljeta Minxhozi, ndoqi punimet e samitit vjetor të vendeve të rajonit me temë "Stabiliteti financiar dhe monetar i rajonit në kohë të pasigurta të krizës së zgjatur gjeopolitike dhe ekonomike", të mbajtur në Becic, Mal i Zi, ku merrnin pjesë përfaqësues të lartë të bankave qendrore, ministra të financave dhe drejtorë të tatimeve nga vendet e rajonit.
- Në datën 26 shtator 2023, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, ishte i ftuar të merrte pjesë në Ministerialin e ministrave të ekonomisë të vendeve të rajonit, të mbajtur në Tiranë, në kuadër të procesit të Berlinit. Punimet e Ministerialit u çelën nga Kryeministri i Shqipërisë, z. Edi Rama, për të vijuar me fjalët përshëndetëse të përfaqësuesve të Komisionit Evropian dhe të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik. Guvernatori Sejko ishte pjesë e Panelit të Guvernatorëve në sesionin e tretë, me temë "Integrimi i sistemeve të pagesave të rajonit për të lehtësuar tregtinë dhe përgatitjen e ekonomive të Ballkanit Perëndimor për një integrimin në Eurozonë".
- Në datat 5-6 tetor 2023, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, kreu një vizitë zyrtare në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, në kuadër të pjesëmarrjes së tij në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me temë "Sfidat dhe perspektiva e bashkëpunimit ekonomik Kosovë-Shqipëri dhe rajon", të organizuar në Prishtinë, nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës dhe Akademia e Shkencave të Shqipërisë.
- Në datat 12 -15 tetor 2023, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mori pjesë në Mbledhjet Vjetore të Fondit Monetar



Ndërkombëtar (FMN) dhe të Grupit të Bankës Botërore (BB), të zhvilluara në Marrakesh, Mbretëria e Marokut. Këto mbledhje përfaqësojnë një forum të nivelit të lartë, ku vendimmarrësit më të lartë të FMN-së dhe BB-së, së bashku me guvernatorët dhe ministrat e financave të vendeve anëtare në këto institucione ndërkombëtare financiare, bëhen bashkë për të diskutuar zhvillimet më të fundit të ekonomisë botërore.

- Në datën 30 tetor 2023, Zëvendësguvernatorja e Dytë e Bankës së Shqipërisë, zj. Natasha Ahmetaj, mori pjesë në Workshop-in e gjashtë dedikuar Planifikimit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe përbushjes së kërkesave për MREL-in, organizuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Raiffeisen Bank International. Ky forum i përvitshëm organizohet si pjesë e Iniciativës së Vjenës dhe mbledh autoritetet rregullatore evropiane, ato të vendeve të Ballkanit, si dhe investitorë të angazhuar në financimin e instrumenteve të MREL-it.
- Në datën 8 nëntor 2023, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Bankën Botërore organizoi Forumin e Nivelit të Lartë me temë "Klima, Makroekonomia dhe Financat: Risqet dhe ndikimet që i shoqërojnë". I organizuar nën kujdesin e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga bankat qendrore evropiane e nga institucionet financiare ndërkombëtare, forumi diskutoi sfidat që paraqiten nga ndryshimi i klimës dhe implikimet e saj në makroekonomi dhe financa.
- Në datën 16 nëntor 2023, Zëvendësguvernatorja e Parë e Bankës së Shqipërisë, zj. Luljeta Minxhozi, mori pjesë në workshop-in e nivelit të lartë mbi zhvillimet e sistemeve të pagesave të organizuar nga Banka Qendrore Evropiane (BQE) në Frankfurt, Gjermani, në kuadër të Programit për "Forcimin e kapaciteteve të bankave qendrore në Ballkanin Perëndimor". Në punimet e tij, BQE-ja prezantoi praktikën e bankave të Eurosistem-it lidhur me këtë funksion.
- Në datat 4-5 dhjetor 2023, Banka e Shqipërisë organizoi Workshop-in XVII të Kërkimeve Ekonomike për Evropën Juglindore. Temat e këtij viti mbuluan fusha të ndryshme si politika monetare dhe stabiliteti financiar, ndryshimet klimatike, digjitalizimi, financat dhe përfshirja financiare e familjeve.

### **MEMORANDUME BASHKËPUNIMI**

Në datën 19 qershor 2023, në ambientet e Bankës së Shqipërisë u zhvillua ceremonia e nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit midis Sekretariatit të Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe Bankës së Shqipërisë, lidhur me zbatimin e fazës së tretë të programit të asistencës dypalëshe për zhvillimin e kapaciteteve për bankat qendrore për vitet 2023 – 2028.

Marrëveshja u nënshkrua nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, dhe Ambasadorja e Zvicrës në Shqipëri, SH.S.Zj. Ruth Huber. Kjo fazë e programit fokusohet drejt sfidave të reja makroekonomike e financiare që përcaktohen nga kushtet specifike gjeopolitike, nga zhvillimet e shpejta



në digjitalizimin dhe inovacionin financiar. Këto risi sfidojnë në mënyrë domethënëse si autoritetet, ashtu edhe shoqërinë që duhet t'i njohë, t'i kuptojë e t'i përdorë këto instrumente, por njëkohësisht edhe të mbrohet nga rreziqet që vijnë me zhvillimin e shpejtë e të vrullshëm të teknologjisë.



## 2.12. TRANSPARENCA DHE KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN

*Komunikimi me publikun përbën një hallkë të rëndësishme në aktivitetin e Bankës së Shqipërisë, si në përmbushjen e detyrimit për të ofruar transparencë maksimale të vendimmarrjes ashtu dhe në funksion të rritjes së efektivitetit, nëpërmjet forcimit të besueshmërisë së saj. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë e vlerëson komunikimin ndërveprues me publikun si një çështje parësore dhe me rëndësi strategjike, për të transmetuar tek opinioni publik, sa më drejt dhe kuptueshëm aktivitetet e saj.*

### NJË BANKË QENDRORE E HAPUR DHE TRANSPARENTE

Përtej detyrimeve ligjore, Banka e Shqipërisë i komunikon publikut një informacion të shumëllojshëm lidhur me rolin dhe veprimtarinë e saj, nga vendimmarrja e Këshillit Mbikëqyrës deri te aktiviteti operacional i përditshëm. Ky komunikim transparent, i cili kalon në sërë kanalesh komunikimi, ndihmon në rritjen e efektivitetit të politikave të ndjekura, duke bërë që publiku të kuptojë drejt vendimet e marra prej saj. Komunikimi me publikun gjatë vitit 2023 synoi informimin mbi masat e marra nga Banka e Shqipërisë për normalizimin e politikës monetare dhe kthimin e inflacionit në objektiv.

Vendimmarrja e politikës monetare bazohet në një cikël periodik analizash, parashikimesh dhe vlerësimi, e përcaktuar në një kalendar vjetor prej 8 mbledhjesh të Këshillit Mbikëqyrës. Pas çdo mbledhjeje, zhvillohet konferenca për shtyp e Guvernatorit, gjatë së cilës i shpjegohet publikut vendimi i marrë nga Këshilli Mbikëqyrës dhe analiza mbështetëse e këtij vendimi. Konferencat për shtyp janë shoqëruar me publikimin e fjalimeve të Guvernatorit dhe të zbardhjes së pyetje-përgjigjeve përkatëse, në gjuhën shqipe dhe angleze. Pas çdo mbledhjeje të Këshillit Mbikëqyrës janë publikuar përmbledhje me vendimet kryesore. Vendimet publike të Këshillit Mbikëqyrës, urdhrat dhe aktet e administratorëve, të zbatueshme nga subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë, botohen në Buletinin Zyrtar.

Komunikimi i Bankës së Shqipërisë u plotësua me raporte periodike, vrojtime, analiza, vlerësime e opinione mbi gjendjen makroekonomike të vendit dhe rolin e Bankës në mbështetje të saj. Komunikimi me median ka vijuar me anë të konferencave për shtyp, fjalimeve, prezantimeve dhe kumtesave në aktivitete të organizuara nga Banka e Shqipërisë apo nga institucione të tjera, të intervistave të dedikuara, të pjesëmarrjes në emisione televizive, të shprehjes së qëndrimeve me interes për publikun apo të aktiviteteve të tjera të Guvernatorit dhe të përfaqësuesve të tjerë të Bankës së Shqipërisë. Këto formate komunikimi kanë rezultuar në 170 produkte edhe 7 prezantime “off the record” të raporteve periodike. Për të rritur ndërveprimin me publikun, komunikim digjital ka vijuar në Twitter, Facebook, YouTube, Flickr dhe LinkedIn, duke transmetuar aktivitetin e Bankës së Shqipërisë në një kohë të shpejtë dhe të plotë.





## HAPËSIRË INFORMUESE 9

### AKTIVITETE BRENDA VENDIT

- Më datë 8 shkurt 2023, Banka e Shqipërisë organizoi Konferencën e Katërt të Muzeut të Bankës së Shqipërisë, me temë “Mesjeta, pararendëse e një sistemi monetar të mirorganizuar”. Në fjalën përshëndetëse, Guvernatori Sejko theksoi se organizimi i kësaj konference është një nga aktivitetet më të rëndësishme për Muzeun e Bankës së Shqipërisë, pasi na ndihmon të pasurojmë dhe të vijojmë studimin e koleksioneve të ekspozuara në të. Ajo i shërben studiuesve vendas si një platformë diskutimi për punën e tyre kërkimore.
- Në datën 8 maj 2023, Guvernatori Sejko zhvilloi një takim me përfaqësuesit e shoqatave të bizneseve eksportuese për të diskutuar mbi shqetësimet e ngritura nga ata lidhur me forcimin e kursit të këmbimit të lekut ndaj monedhës euro. Ky takim u zhvillua në frymën e bashkëpunimit dhe tryezës së diskutimit, për t'i informuar ato dhe për të sugjeruar instrumente e alternativa të koordinuara me industrinë financiare.
- Në datë 13 korrik 2023, Banka e Shqipërisë organizoi një tryezë diskutimi me Bordin Drejtues të Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe drejtuesve të bankave tregtare që operojnë në vendin tonë. Takimi u organizua me nismën dhe nën drejtimin e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, në kuadër të ndërtimit të një dialogu të vazhdueshëm dhe të intensifikimit të bashkëpunimit me sistemin bankar.
- Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave zhvilloi mbledhjen e tij të nëntë në datën 13 dhjetor 2023, nën drejtimin e kryetares së tij, zj. Luljeta Minxhozi, Zëvendësguvernatore e Parë e Bankës së Shqipërisë. Në fjalën e saj, ajo theksoi përmbushjen e objektivave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël, ku u arrit përafrimi i kuadrit tonë rregullativ me atë të Bankës Qendrore Evropiane (BQE) për shërbimet e pagesave PSD2.
- Në datën 18 dhjetor 2023, Guvernatori Sejko zhvilloi një takim me publicistë, analistë dhe gazetarë të shtypit të shkruar e medias elektronike, ku u ndanë tre çmimet e konkursit të përvitshëm “Çmimi i Guvernatorit për diplomën më të mirë për vitin 2023”: çmimi i parë zj. Aurora Kapo, studente në Universitetin Van Amsterdam, Holandë, me temën e diplomës: “Narrative economics: Central Bank Communication and Inflation Expectations”; çmimi i dytë z. Virjosin Stafasani, student në Universitetin e Greenwich, Angli, me temën “The relationship between Market Efficiency, Expected Return and Volatility in the Stock Market”; çmimi i tretë zj. Krista Kozmai, studente pranë Universitetit Europian të Tiranës, me temë “"Frika" nga kursi i lirë i këmbimit, rasti i Shqipërisë”.

### NJË BANKË QENDRORE E PËRGJEGJSHME DHE LLOGARIDHËNËSE

Si një institucion i pavarur, Banka e Shqipërisë synon të informojë qytetarët dhe në veçanti Kuvendin e Shqipërisë mbi gjithë veprimtarinë e saj. Marrëdhëniet institucionale me Kuvendin e Shqipërisë zhvillohen në formën e raportimeve sipas kërkesave ligjore në seancat dëgjimore të Guvernatorit në Komisionin Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave (KEF) dhe në seancat plenare të Kuvendit. Në muajin maj 2023, Guvernatori prezantoi Raportin Vjetor të



Bankës së Shqipërisë për vitin 2022 në KEF dhe më pas, në muajin korrik, në Kuvendin e Shqipërisë. Si çdo vit, Guvernatori ka prezantuar në muajin nëntor 2023 në një seancë dëgjimore të dedikuar të KEF-it edhe opinionin e Bankës së Shqipërisë për pikat kryesore të projektbuxhetit të shtetit për vitin pasardhës 2024.

Qytetarët mund të gjejnë informacion të plotë dhe të përditësuar mbi zhvillimet kryesore makroekonomike të vendit dhe rolin e kontributin e Bankës së Shqipërisë në këtë drejtim, në faqen zyrtare të internetit: [www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org). Kjo e fundit pati rreth 3 milionë vizitorë dhe 9.7 milionë faqe shfletime këtë vit. Faqja jonë pasurohet vazhdimisht me një sistem të gjerë statistikash për sektorin bankar, fiskal, real dhe të jashtëm. Ato publikohen sipas një kalendarit të përcaktuar që përditësohet çdo gjashtëmuor. Statistikat e Bankës së Shqipërisë gjenden edhe në raportet mujore statistikore dhe tremujore të politikës monetare. Kjo faqe ofron të gjitha botimet e Bankës së Shqipërisë, me informacion mbi ekonominë shqiptare e botërore; mbi zhvillimet në sistemin bankar dhe financiar; stabilitetin financiar e paranë; ndryshimet e pasurimit e legjislacionit bankar dhe të kuadrit të tij rregullator.

Botimet e realizuara gjatë vitit 2023 janë periodike dhe joperiodike, dhe numërojnë rreth 3100 faqe analiza, statistika dhe studime në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Seti i raporteve periodike edhe gjatë këtij viti ka ruajtur të njëjtën strukturë: Raporti Vjetor (vjetor), Raporti i Politikës Monetare (tremujor), Raporti i Stabilitetit Financiar (gjashtëmuor) dhe Raporti i Mbikëqyrjes (vjetor). Përveç raporteve periodike, publikohet Buletini Zyrtar (në varësi të mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës), Revista "Bankingu Qendror" (gjashtëmuore), Revista Ekonomike (gjashtëmuore), Revista "Të reja shkencore në Bankën e Shqipërisë" (gjashtëmuore), si dhe materialet e ndryshme studimore dhe edukative.

Në funksion të informimit të publikut, Banka e Shqipërisë i përgjigjet edhe kërkesave të shumta për informacion të qytetarëve, në formë të shkruar ose në formë elektronike. Gjatë vitit 2023, i janë kthyer përgjigje 40 kërkesave zyrtare drejtuar koordinatorit për të drejtën e informimit dhe janë trajtuar rreth 1630 korrespondenca me publikun, për marrje informacioni, ankime dhe pyetje në lidhje me sistemin bankar, të mbërritura pranë adresës zyrtare të kontaktit të Bankës në email-in [public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org).



## 2.13. EDUKIMI FINANCIAR

Edukimi financiar i publikut është pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë. Ai realizohet përmes aktiviteteve dhe programeve edukative, vizitave në Muze, ekspozitave, si dhe botimeve të veçanta. Aktiviteti i Bankës së Shqipërisë në këtë drejtim ka dy objektiva kryesorë: prezantimin e rolit dhe funksioneve të Bankës qendrore tek publiku, dhe kultivimin e përforsimit të një kulture financiare në shoqërinë shqiptare.

### **STRATEGJIA E BANKËS SË SHQIPËRISË PËR EDUKIMIN DHE PËRFSHIRJEN FINANCIARE**

Gjatë vitit 2023, u hartua Strategjia e Bankës së Shqipërisë për Edukimin dhe Përfshirjen Financiare (SBSHEPF), si një dokument i parë institucional që promovon edukimin financiar, në nxitje të përfshirjes financiare, mirëqenies dhe qëndrueshmërisë.

Kjo Strategji mbështetet në përpjekjet ekzistuese shumëvjeçare të Bankës së Shqipërisë në fushën e edukimit financiar, në rezultatet e Vrojtimit për Matjen e Kulturës dhe Përfshirjes Financiare dhe në Hartën e Nismave të Edukimit Financiar në Shqipëri. Misioni i SBSHEPF është të ndihmojë individët në Shqipëri të fitojnë njohuritë, të zotërojnë aftësitë, të mbajnë qëndrimet dhe të zhvillojnë sjelljet e duhura, të sakta dhe të zbatueshme që u mundësojnë atyre të marrin vendime financiare të mirinformuara, me synim final përmirësimin e mirëqenies dhe qëndrueshmërisë së tyre financiare.

Objektivat kryesorë të SBSHEPF janë: i) miradministrimi i financave personale dhe huamarrja e shëndetshme; ii) planifikimi dhe kursimi për të ardhmen; iii) parandalimi dhe mbrojtja e konsumatorit. Për t'i realizuar këta objektiva, Banka e Shqipërisë do të bazohet në këto parime strategjike: a) iniciativa për një publik të gjerë; b) rritja e përdorimit të mjeteve dhe burimeve të paanshme të informacionit financiar, drejtuar kryesisht segmenteve vulnerabël të popullsisë; c) ofrimi i udhëzimeve dhe këshillimi i personalizuar dhe me cilësi; d) kërkimi i sinergjive në organizimin e aktiviteteve dhe programeve të përbashkëta me institucione të tjera; e) përmirësimi i monitorimit dhe vlerësimit. SBSHEPF u shqyrtua dhe miratua nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë më 24.1.2024

### **MATJA E KATËRT E KULTURËS DHE PËRFSHIRJES FINANCIARE TË POPULLATËS SHQIPTARE**

Në qershor 2023, bazuar në metodologjinë e krijuar nga OECD/INFE, Banka e Shqipërisë realizoi raundin e katërt<sup>33</sup> të vrojtimit për matjen e kulturës dhe përfshirjes financiare të popullatës shqiptare. Të dhënat e mbledhura, do të shërbejnë për të studiuar ecurinë e treguesve kryesorë përbërës të tij: njohurive, sjelljeve dhe qëndrimeve financiare, por edhe të përfshirjes financiare; për të identifikuar më mirë hapësirat dhe nevojat për ndërhyrje me anë të programeve

<sup>33</sup> Vrojtimi kryhet që nga viti 2011, me periodicitet 4-vjeçar.



të edukimit financiar. Risia e këtij vrojtimi janë të dhënat për kulturën financiare digjitale, qëndrueshmërinë dhe mirëqenien financiare të popullatës.

### *MUZEU I BANKËS SË SHQIPËRISË*

Pas 9 vitesh kontributi të çmuar në lëmin e historisë numizmatike dhe bankare të vendin tonë, në tetor 2023, Këshilli Kombëtar i Muzeve miratoi njohjen dhe regjistrimin e Muzeut të Bankës së Shqipërisë në regjistrin Kombëtar të Muzeve në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2023, Muzeun e kanë vizituar rreth 4600 vizitorë. Vizita në Muzeun e Bankës së Shqipërisë është kthyer në pjesë të kurrikulës mësimore apo edhe orëve të lira për nxënësit e shkollave 9-vjeçare, të mesme, dhe për studentë të universiteteve. Në konferencën IV të Muzeut gjatë muajit shkurt me temë “Mesjeta, pararendëse e një sistemi monetar të mirorganizuar” prezantuan punimet shkencore studiues nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, institutet e arkeologjisë dhe historisë, profesorë të Universitetit të Tiranës, si dhe punonjës muzesh, ekspertë, kërkues në fushën e muzeologjisë dhe edukimit.

Gjatë Ditës Ndërkombëtare të Muzeve në muajin maj, Muzeu i Bankës së Shqipërisë qëndroi i hapur për publikun në orare të zgjatura dhe pa kufizim në numër vizitorësh. Në ambientet e Muzeut u çelën dy ekspozita të përkohshme me tematikat: “Banka e Napolit 85 vite më parë në dokumentet e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, e organizuar në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave (DPA) dhe “Dokumente, prova kartëmonedhash dhe objekte që i përkasin periudhës së viteve 1957-1991” pjesë e fondit të Muzeut të Bankës së Shqipërisë. Në bashkëpunim me Arkivin Shtetëror Qendror të Filmit (ASHQF) u realizua kolazhi filmik, me temë “Fuqia e parasë”, me copëza filmash shqiptarë të para viteve '90 që pasqyrojnë marrëdhënien me paranë. Gjatë muajit tetor, u zhvilluan dy aktivitete si pjesë e ciklit “Netët e Muzeut”. Aktiviteti i parë solli në muze një ekspozitë me foto nga koleksioni i Muzeu Etnografik i Beratit, me temë “Berati i shek. XVII - XX, në fokusin e zhvillimit ekonomik dhe marrëdhënieve tregtare me vendet fqinje”. Aktiviteti i dytë, prezantoi një ekspozitë me foto të sjella nga Muzeu Historik i Shkodrës, me temë “Shkodra e shek. XVII - XX, në fokusin e zhvillimit ekonomik dhe marrëdhënieve tregtare me vendet fqinje”.

### *BOTIMET EDUKATIVE*

Gjatë vitit 2023, ka vijuar shpërndarja e teksteve mësimore “Financat personale në duart tuaja” për shkollat e mesme, që kanë zgjedhur ta zhvillojnë lëndën, si dhe shpërndarja e broshurave dhe materialeve edukative të përgatitura në vitet paraardhëse kryesisht për vizitorët e Muzeut.

### *ORGANIZIMI I AKTIVITETEVE EDUKATIVE*

- Java Globale e Parasë 2023. Në datën 20 mars 2023, në ambientet



e Bankës së Shqipërisë, u organizua ceremonia kremtuese e Javës së Parasë për vitin 2023 nën sloganin “Administro paratë e tua, kultivo të ardhmen tënde!”. Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, organizuan aktivitete edukative dhe ndërgjegjësuese, duke përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi 4000 nxënës dhe studentë të më shumë se 160 shkollave të të gjitha niveleve dhe nga i gjithë vendi. Aktivitetet përfshinë: konkurse shkollore, leksione në auditorët e universiteteve, si dhe orë mësimore në shkolla 9-vjeçare dhe të mesme.

- Dita Ndërkombëtare e Kursimit. Më 31 tetor 2023, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Kursimit dhe të angazhimit të Bankës së Shqipërisë për kultivimin e kulturës financiare, ekspertë të edukimit financiar zhvilluan një orë mësimore me nxënësit e klasave VI të shkollës 9-vjeçare jopublike “Ylber”, në Kashar. Gjatë kësaj bisede, nxënësit u njohën me funksionet e parasë, rëndësinë e kursimit për realizimin e objektivave, si të hartojmë një buxhet personal, si dhe disa metoda të thjeshta për administrimin e të ardhurave.
- Festivali i Aftësive, Punës dhe Karrierës Expo 2023. Në datat 13-15 dhjetor 2023, u zhvillua Festivali i Aftësive, Punës dhe Karrierës Expo 2023, si një platformë komunikimi, rrjetëzimi dhe ndërveprimi, ku institucione e kompani të interesuara të sektorit publik dhe privat kontribuuan në aftësimin e të rinjve, në kuadër të punësimit, këshillimit dhe edukimit në karrierë. Banka e Shqipërisë u bë pjesë e këtij aktiviteti përmes një stende të branduar me botime edukative dhe kërkimore, si dhe zhvillimit të një workshop-i. Aty u prezantua dhe u diskutua me të rinjtë pjesëmarrës mbi fushat e bankingut, ekonomisë, financave, edukimit dhe përfshirjes financiare, si dhe mbi ndikimin që informacioni i publikuar nga Banka e Shqipërisë mund të ketë në suksesin personal dhe profesional. Të pranishmit u njohën dhe me përfitimet që vijnë nga inovacionet në fushën financiare dhe ligjet e reja mbi pagesat.



### 3. BURIMET NJERËZORE DHE KAPACITETET INFRASTRUKTURE

Banka e Shqipërisë synon të zhvillojë burimet e saj njerëzore në përputhje me objektivat dhe strategjinë e saj, si dhe në zbatim të politikave përkatëse. Objektivat tona përfshijnë krijimin e një mjedisi pune që është i përshtatshëm dhe motivues për punonjësit, duke i shërbyer jo vetëm rritjes së profesionalizmit të tyre, por edhe përmirësimit në vazhdimësi të proceseve administrative të institucionit.

#### 3.1. BURIME NJERËZORE


Në përputhje me objektivat strategjikë afatmesëm të institucionit, menaxhimi i burimeve njerëzore ka për qëllim të ndjekë praktikën dhe modelet më të mirë në këtë fushë. Orientimi ynë është drejt rritjes profesionale të stafit, forcimit dhe stimulimit të një mjedisi pune motivues dhe përgjegjës për punonjësit, si dhe përmirësimit të bazës ligjore dhe strukturës organizative të Bankës. Kjo është bërë e mundur përmes përfundimit dhe zbatimit të vazhdueshëm të praktikave më të mira të menaxhimit të burimeve njerëzore, të cilat zbatohen në institucione të ngjashme në Bashkimin Evropian.

Menaxhimi efektiv i burimeve njerëzore kërkon një përditësim dhe adaptim të vazhdueshëm të infrastrukturës rregullatore të institucionit në përputhje me standardet më të mira, duke ofruar mundësi të vazhdueshme për promovim të punonjësve me përvojë profesionale. Përmes politikave që synojnë rritjen e kompetencave profesionale, është synuar ruajtja e stabilitetit të stafit dhe identifikimi i talenteve të reja. Zbatimi i politikave për punësimin, menaxhimin dhe promovimin në karrierë të stafit, kanë si qëllim mbajtjen e një strukture organizative efikase, profesionale dhe të përshtatshme. Gjithashtu,

racionalizimi i strukturës organizative dhe përmirësimi i performancës së institucionit, në përputhje me objektivat e tij strategjikë dhe kuadrin rregullator përkatës, janë në qendër të këtyre politikave.

Raporti i femrave ndaj meshkujve në totalin e punonjësve është rreth 59% - 41%, ndërkohë që ky raport në nivel drejtues është 62% - 38%. Një kujdes i veçantë i është kushtuar edhe kombinimit të stafit profesional me përvojë me stafin e ri. Moshë mesatare e stafit është 45 vjeç, ndërkohë që rreth 88% e punonjësve në Bankë janë me arsim të lartë. Vlen të theksohet se rreth 58% e tyre kanë përfunduar studime pasuniversitare në nivel Master/PhD si dhe kanë përfunduar certifikata profesionale të njohura nga institucione ndërkombëtare.

Grafik 56. Raporti femra/meshkuj në Bankën e Shqipërisë



Një tjetër element i rëndësishëm i politikave të burimeve njerëzore është ofrimi i trajnimeve profesionale cilësore, brenda dhe jashtë vendit, për zbatimin e proceseve të reja të punës. Pjesëmarrja në këto trajnime të specializuara, të organizuara nga banka të ndryshme qendrore dhe institucione financiare ndërkombëtare (IFN), përveç rritjes së njohurive profesionale, ndihmon në shkëmbimin e përvojave profesionale dhe menaxheriale të stafit të Bankës me përfaqësuesit e institucioneve të tjera.

### MARRËVESHJE DHE BASHKËPUNIME

Gjatë vitit 2023, janë organizuar disa aktivitete në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit të Bankës së Shqipërisë me institucione homologe si: State Secretariat for Economic Affairs (SECO), Komisioni Evropian, ECB dhe Banka e Gjermanisë, European Banking Authority (EBA) etj. Me qëllim marrjen e informacionit të targetuar dhe specifik, nga këto marrëveshje janë realizuar 23 aktivitete të formave të ndryshme ku kanë marrë pjesë rreth 81 punonjës të Bankës.

## 3.2. PËRMIRËSIME NË INFRASTRUKTURË

Gjatë vitit 2023, Banka e Shqipërisë ka vijuar me përmirësimet e vazhdueshme në sistemet dhe në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit, duke i dhënë fokus të veçantë sigurisë kibernetike.

**Siguria e informacionit** në përgjithësi dhe **siguria kibernetike** në veçanti kanë qenë gjithnjë në fokus të institucionit. Sulmet kibernetike të targetuara për Shqipërinë ndaj institucioneve publike e private kanë vijuar. Niveli i rrezikut në rang kombëtar vijon të jetë i lartë e në proporcion me të, Banka e Shqipërisë ka shtuar masat mbrojtëse dhe ato të monitorimit, teknike dhe procedurale, të bazuara në standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Ky aktivitet është shoqëruar me një proces të vazhdueshëm e tejet intensiv të **edukimit e të ndërgjegjësimit** të të gjithë punonjësve për rreziqet kibernetike dhe mënyrën e reagimit ndaj tyre.

Banka e Shqipërisë ka pasur komunikime të vazhdueshme me një sërë institucioneve ndërkombëtare e kombëtare. Ato janë fokusuar në përmirësimin e sigurisë dhe përafrimin me standardet ndërkombëtare, si dhe kanë synuar një koordinim sa më të mirë dhe këmbim sa më të shpejtë të informacionit, në funksion të qëndrueshmërisë ndaj sulmeve të mundshme kibernetike për sistemet e Bankës së Shqipërisë dhe për sistemin bankar. Në zbatim të projektit në shkallë globale CSP (Customer Security Programme), të ndërmarrë nga kompania SWIFT për të gjitha institucionet financiare, Banka e Shqipërisë ka përmbushur të gjitha kërkesat teknike dhe procedurale, në përputhje me standardet më të larta të sigurisë mbi të gjithë infrastrukturën e këtij sistemi.

Përveç sa më sipër, ka vijuar puna në lidhje me: **përmirësimin e shërbimeve elektronike** që Banka e Shqipërisë i ofron të tretëve, ku mund të veçojmë disa



projekte të lidhura me sistemet e pagesave; **automatizimin e mëtejshëm të proceseve** të brendshme të Bankës, duke iu përgjigjur nevojave të aktiviteteve operacionale në funksion të rritjes së eficiencës dhe efektivitetit; **zgjerimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së rrjetit**, si një proces i vazhdueshëm që synon optimizimin dhe virtualizimin e pajisjeve qendrore për një administrim më të mirë të tyre, kosto dhe shërbime të përmirësuara e adoptim të teknologjive të reja për mbrojtjen e mjedisit dhe eficiencën në energji.





## 4. AUDITIMI I BRENDSHËM

*Auditimi i brendshëm në Bankën e Shqipërisë realizohet nga Departamenti i Kontrollit. Objektivi kryesor i tij është të sigurojë mbarëvajtjen e zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë. Funkzioni i auditimit të brendshëm u siguron Administratorëve të Bankës, dhe Këshillit Mbikëqyrës, në mënyrë periodike dhe të pavarur, verifikimin dhe vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, duke testuar efektshmërinë e kontrolleve dhe procedurat e vendosura.*

### 4.1. ZHVILLIME TË RËNDËSISHME NË AKTIVITETIN E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

#### A. Vënia në zbatim e politikës së auditimit të brendshëm

Procesi i shqyrtimit dhe miratimit të Planit vjetor të Auditimit të Brendshëm në Bankën e Shqipërisë, u realizua në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Plani vjetor për vitin 2023 u hartua nga Departamenti i Kontrollit dhe Inspektori i Përgjithshëm dhe u paraqit për shqyrtim nga Komiteti i Auditimit. Më tej ky plan i dakordësuar nga Komiteti i Auditimit, u miratua nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr. 54, datë 7.12.2022.

#### B. Programi i vlerësimit të cilësisë së Auditimit të Brendshëm

Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm kërkojnë që një vlerësim i jashtëm i cilësisë (EQA<sup>34</sup>) i aktivitetit të auditimit të brendshëm duhet të kryhet të paktën një herë në pesë vjet nga një vlerësues i kualifikuar, i pavarur ose një ekip vlerësimi nga jashtë institucionit. Standardet gjithashtu kërkojnë kryerjen e një vetëvlerësimi periodik, i cili kryhet çdo 2 vjet.

Gjatë vitit 2023 u realizua procedura e vetëvlerësimit të AB në përputhje me kërkesat e Standardeve. Ky angazhim vjen pas vlerësimit të jashtëm të realizuar nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm të Bankës Qendrore të Republikës së Turqisë (CBRT) në dhjetor 2020.


<sup>34</sup> Shkurtime të termave: IP – Inspektori Përgjithshëm; DKn – Departamenti i Kontrollit; IIA – Instituti i Audituesve të Brendshëm; ARO – Administrimi i Rrezikut Operacional; EQA – External Quality Assessment (Vlerësimi i Jashtëm i Cilësisë); IPPF – International Professional Practice Framework (Korniza e Praktikave Profesionale Ndërkombëtare); ACCA – Association of Chartered Certified Accountants (Shoqata e Audituesve të Çertifikuar); CIA – Certified Internal Auditor (Auditues i Brendshëm i Çertifikuar); CISA – Certified Information Systems Auditor (Auditues i Çertifikuar i Sigurisë së Informacionit); MVV (BCM) – Menaxhimi i Vijueshmërisë së Veprimtarisë (Business Continuity Management); KRI – Tregues Kyç të Rrezikut Operacional; ILDKPKI – Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave



Opinion i përgjithshëm i vetëvlerësimit është që Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm të BSH-së rezulton “Përgjithësisht në Përputhje”<sup>35</sup> si vlerësimi më i lartë me Standardet e Institutit të Audituesve të Brendshëm (IIA) dhe Kodin e Etikës sipas Manualit të Vlerësimit të Cilësisë të IIA. Ky nivel i përputhshmërisë demonstroi një qëllim dhe angazhim të qartë për arritjen e Parimeve Thelbësore për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm dhe Përkufizimin e Auditimit të Brendshëm.

Në vijim evidentohen përmirësimet në praktikën e Auditimit të Brendshëm të Bankës së Shqipërisë sipas vetëvlerësimit të fundit, vlerësimit të EQA 2020 dhe vetëvlerësimit të realizuar në vitin 2017:

Nivelet e përputhshmërisë sipas EQA	Standardet e vlerësuarra gjatë IQA (2023)	Standardet e vlerësuarra gjatë EQA (2020)	Standardet e vlerësuarra gjatë IQA (2017)
Nuk përputhet	0	0	0
Pjesërisht përputhet	0	3	16
Përgjithësisht përputhet	104	101	88
Vlerësimi i përgjithshëm	Përgjithësisht përputhet	Përgjithësisht përputhet	Pjesërisht përputhet
TOTALI	104	104	104



Vëzhgimet e adresuara nga ekipi vlerësues janë ndarë në dy kategori: Praktikën e Suksesshme të Auditimit të Brendshëm dhe Mundësitë për Përmirësim të Vazhdueshëm. Ekipi i vlerësimit identifikoi katër fusha ku AB po operon në një mënyrë të suksesshme praktike të auditimit të brendshëm, dhe katër mundësi për përmirësim të vazhdueshëm në të ardhmen.

## 4.2. TREGUES TË PËRGJITHSHËM MBI DEPARTAMENTIN E KONTROLLIT

Në përputhje me Ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”, Statutin e Bankës së Shqipërisë, politikën dhe rregulloren e Auditimit të Brendshëm, dhe rregulloren e Komitetit të Auditimit, struktura e Departamentit të kontrollit paraqitet sipas organigramës së mëposhtme, me qëllim sigurimin e ruajtjes së objektivitetit,


<sup>35</sup> Manuali i Vlerësimit të Cilësisë së IIA sugjeron një shkallë prej tre vlerësimesh, “Përgjithësisht përputhet”, “Pjesërisht përputhet” dhe “Nuk përputhet”.



pavarësisë, integritetit të informacionit, përdorimit eficient të burimeve dhe efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në Bankën e Shqipërisë.

**A. STRUKTURA ORGANIZATIVE E DEPARTAMENTIT TË KONTROLLIT**

Struktura organizative e drejtuar nga Inspektori i Përgjithshëm jepet në vijim:




**B. Rritja profesionale e stafit dhe trajnimi i vazhdueshëm**

Në funksion të përmbushjes së objektivit strategjik për rritjen profesionale të audituesve të brendshëm, inspektorët e kontrollit janë përfshirë në programe trajnimi për auditimin e brendshëm dhe për menaxhimin e rrezikut të ofruara nga bankat qendrore. Ata gëzojnë tituj në certifikime profesionale si ACCA, CIA, CISA, si dhe kanë ndjekur orët minimale të detyrueshme për mirëmbajtjen e tyre. Gjatë vitit 2023, dy inspektorë të Departamentit të Kontrollit u përfshinë në programin e trajnimit të ofruar nga Ministria e Financave për fitimin e titullit “Auditues i Brendshëm Publik”. Ky titull do të rrisë profesionalisht performancën e audituesve.

**4.3. ANGAZHIMET E KRYERA GJATË VITIT 2023 DHE PROBLEMATIKAT KRYESORE TË EVIDENTUARA**

Angazhimet e auditimeve të kryera gjatë vitit 2023 janë fokusuar në dhënien e opinionit mbi mjaftueshmërinë e kontrolleve të brendshme të vendosura nga Drejtimi për funksionet/proceset e audituara, përfshirë dhe aplikacionet mbështetëse për kryerjen e aktiviteteve.



Gjatë vitit 2023 u adresuan gjithsej **28 rekomandime** të rezultuara nga **11 angazhime** auditimi për dhënie sigurie. Rekomandimet kanë adresuar kryesisht nevojën për përmirësimin e proceseve, sidomos në kuadër të rritjes të sigurisë kibernetike (52%); rishikimin e bazës rregullative (21%) dhe të tjera mbi zbatimin e bazës rregullative (27%).

Gjetjet dhe rekomandimet për secilin prej auditimeve të realizuara gjatë kësaj periudhe janë adresuar fillimisht pranë drejtuesve të njësive për komente dhe më pas pranë Administratorëve të Bankës së Shqipërisë dhe Komitetit të Auditimit.



## 5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT OPERACIONAL

Qëllimi kryesor i Administrimit të Rrezikut Operacional është të mirëadministrojë pasiguritë që shoqërojnë veprimtarinë e Bankës dhe të informojë në çdo kohë Administratorët, duke ndihmuar në procesin vendimmarrës mbi rreziqet e mundshme operationale që pengojnë arritjen e objektivave, apo të kenë ndikime negative financiare dhe/ose reputacionale.

Njësia e Administrimit të Rrezikut Operacional, si një nga linjat e dyta të kontroleve në Bankën e Shqipërisë, ka vijuar aktivitetin e saj në drejtim të forcimit dhe rritjes së rolit të saj. Nga analiza vjetore e raportimeve të njësive të Bankës ka rezultuar që kontrollet e brendshme të vendosura nga njësitet janë përgjithësisht efektive, për minimizimin/shmangien e dëmeve/rreziqeve nga incidentet e ndodhura. Shqyrtimi i mundësisë së lindjes së rreziqeve të reja të lidhura me zhvillimet globale ka qenë fokus i vazhdueshëm i vlerësimeve dhe analizës së ekspozimit të Bankës ndaj rrezikut operacional.

### A. VLERËSIMI I NIVELIT TË ADMINISTRIMIT TË RREZIKUT OPERACIONAL NGA EKSPERTËT NDËRKOMBËTARË

#### Metodologjia e përdorur nga IORWG

Rritja dhe forcimi i aktivitetit të njësive, pasqyrohet në vlerësimin e fundit të kryer nga ekspertët ndërkombëtarë të organizatës IORWG (International Organization Risk Working Group).


Banka e Shqipërisë, si anëtare e organizatës së lartpërmendur, ka marrë pjesë në vlerësimin periodik të kryer nga kjo organizatë e 102 banka qendrore dhe autoritete mbikëqyrëse dhe monetare (siç janë BIS, ECB, FMN). Vlerësimi i fundit është si më poshtë:

**"Vlerësimi 2022, nga IORWG për Bankën e Shqipërisë rezultoi 84.45% me një rritje nga vlerësimi i fundit, i cili ishte 76.1%. Progresi për këto vite ka qenë gjithmonë me ecuri pozitive dhe është aktualisht në nivel plotësisht në përputhje me objektivat afatmesëm të funksionit të ARO në Bankën e Shqipërisë, "i menaxhuar"."**

AD-HOC	BAZIKE	I MENAXHUAR	I AVANCUAR	I MATURUAR
<61%	≥61%	≥69%	≥86%	≥94%

Vlerësimi bëhet periodikisht bazuar në matricën e vlerësimit të IORWG, duke u bazuar në 5 shtylla kryesore:

- nivelin e dizenjimit të proceseve dhe sistemeve të kontrollit që mbulojnë këto procese;
- mënyrën dhe strukturën e organizimit të funksionit të administrimit të



- rrezikut;
- c) nivelin e raportimit të saktë dhe në kohë;
- d) rezultatet pas menaxhimit të rrezikut; dhe
- e) kulturën e rrezikut, e cila është një sfidë që kërkon ndërgjegjësimit dhe trajnim të vazhdueshëm nga njësitë e Bankës.

Ky vlerësim i kryer nga IORWG u realizua për të gjitha bankat qendrore të anëtarësuara për vitin 2022, në vijim të vërtetimit vjetor. Ai certifikon nga një organizatë e pavarur ndërkombëtare nivelin e maturitetit të administrimit të rrezikut operacional në Bankën e Shqipërisë, ndërgjegjësimit dhe edukimit të njerëzve, gjë që ka ndikuar dhe do të ndikojë në mirëfunksionimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të funksioneve bazë dhe mbështetëse në kuadër të menaxhimit të rrezikut.

### B. MENAXHIMI I VIJUESHMËRISË SË VEPRIMTARISË (BCM<sup>36</sup>)

Funksioni “Menaxhimi i Vijueshmërisë së Veprimtarisë” ka për qëllim përmirësimin e aftësisë reaguese të bankës, që, në rast ndërprerjeje operationale të gjatë apo një krize/emergjence, të sigurojë vazhdimësinë e proceseve kritike, si dhe të ndihmojë kthimin në veprimtarinë normale të aktivitetit të Bankës, sa më shpejt të jetë e mundur. Banka ka të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës një kuadër të plotë në lidhje me Menaxhimin e Vijueshmërisë së Veprimtarisë. Pjesë përbërëse e këtij kuadri rregullativ janë edhe planet individuale të vijueshmërisë për çdo departament, strategjitë që ndiqen, si dhe detyrat e përgjegjësitë për çdo pjesëmarrës.

Krizat ekspozojnë pikat e forta dhe të dobëta të qeverisjes së çdo organizate, si dhe aftësinë dhe fleksibilitetin e tyre për të menaxhuar përmes krizës. Gjatë viteve të fundit janë kaluar me sukses disa prova (si pandemia, rreziqet kibernetike, situata e destabilizuar globale) me mësim të mësuara për menaxhimin e rrezikut dhe vijueshmërinë e veprimtarisë në Bankën e Shqipërisë. Parandalimi i rrezikut, planifikimi i vazhdimësisë së veprimtarisë dhe përmirësimi në menaxhimin e incidenteve, janë thelbësorë për të siguruar qëndrueshmërinë e institucionit.

Gjatë vitit 2023 kemi qenë dëshmitarë të rritjes së sulmeve kibernetike, të cilat kanë pasur për objekt institucionet e ndryshme shtetërore dhe bankat e nivelit të dytë. Nga të dhënat e disponuara nga funksionet përgjegjëse për sigurinë kibernetike, në Bankën e Shqipërisë nuk ka pasur sulme të rëndësishme që të kenë cenuar masat mbrojtëse apo të kenë ndikuar sistemet kritike të Bankës.

Mbështetur në këto zhvillime dhe për të përmirësuar aftësinë reaguese të Bankës kundrejt sulmeve kibernetike, u morën masa operationale dhe rregullative.

<sup>36</sup> BCM - Business Continuity Management.



### C. FUNKSIONI I SINJALIZUESIT NË BANKËN E SHQIPËRISË

Në ndihmë të procesit të Administrimit të Rrezikut Operacional ka ardhur edhe konsolidimi i funksionit të sinjalizimit. Bazuar në ligjin nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", kjo strukturë ka për qëllim:

- a) të parandalojë dhe të godasë korrupsionin në Bankën e Shqipërisë;
- b) të nxisë sinjalizimet mbi veprimet ose praktikatat e dyshuara të korrupsionit;
- c) të mbrojë individët që sinjalizojnë veprimet ose praktikatat e dyshuara të korrupsionit në vendin e tyre të punës.

Banka ka funksionuar me bazën rregullative të plotë, me të gjithë udhëzuesit e mjetet e nevojshme për t'u mundësuar punonjësve sinjalizimin e rasteve të dyshimta. Për vitin 2023 nuk është raportuar asnjë rast apo veprim i dyshuar sinjalizimi.



## 6. STRATEGJIA AFATMESME E ZHVILLIMIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË 2024 – 2026

Strategjia afatmesme 2024-2026 përditëson strategjinë ekzistuese, duke zgjatur afatin e zbatimit të saj përtej vitit 2025. Objektivat për periudhën afatmesme shërbejnë si bazë në procesin e buxhetimit, parashikimit të shpenzimeve dhe të ardhurave për përmbushjen e detyrave të ngarkuara nga ligji organik.

Objektivat e Strategjisë përfshijnë edhe rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë.

Në përputhje me detyrat e përcaktuara në ligjin organik, prioritetet në veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë janë:


- a) Forcimi i eficiencës/efektivitetit të politikës monetare dhe e cilësisë së vendimmarrjes, përmes rritjes së saktësisë së parashikimeve e plotësimit të tyre me skenarë alternativë/rreziku, dhe vlerësimin të opsioneve të reagimit të politikës monetare e identifikimin e alternativave më eficiente.
- b) Parandalimi i rreziqeve sistematike dhe rritja e rezistencës së sistemit financiar, duke u përqendruar në: (i) miratimin e metodologjisë për zbatimin e shtesës së kapitalit për rrezikun sistematik; (ii) plotësimin e kuadrit rregullator mbi kërkesat për sektorin bankar për sigurimin e një mbrojtjeje të përshtatshme kibernetike; (iii) hartimin e një metodologjie të ushtrimit të provës së rezistencës ndaj ndikimit të ndryshimit të klimës për sektorin bankar; (iv) përafrimin e Bazel 3; dhe (v) hartimin e manualeve teknike për përgatitjen e planeve të kontigjencës, në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.
- c) Nxitja e funksionimit normal të sistemit të pagesave përmes: (i) përditësimin të sistemeve për akomodimin e zhvillimeve në fushën e pagesave me vlerë të vogël; (ii) mbështetjes së nismave ndërbankare për nxitjen e pagesave elektronike; (iii) pjesëmarrjes së aktorëve të rinj; (iii) pjesëmarrjes në Tregun Unik të Pagesave në EURO; dhe (iv) zhvillimit të projektit Instant Payment me Bankën e Italisë.
- d) Ruajtja e besimit publik të kartëmonedha dhe monedha shqiptare dhe plotësimi i nevojave në rritje të ekonomisë për para të gatshme e të përshtatshme për qarkullim.
- e) Zbatimi i sistemit të ri për administrimin e portofolit të rezervës valutore, në mbështetje të zbatimit të politikës monetare dhe shërbimeve të pagesave dhe të transfertave.
- f) Harmonizimi i statistikave financiare të qeverisë me kërkesat e BE-së dhe përmirësimi i aspekteve ligjore dhe cilësore për raportimin rregullator të të dhënave të mbikëqyrjes bankare.
- g) Përditësimi i kuadrit të përgjithshëm kontabël, i infrastrukturës së rrjetit dhe i mbrojtjes kibernetike, si dhe forcimi i sistemit të kontrollit të brendshëm.





## **BANKA E SHQIPËRISË**

### **PAŠQYRAË FINANCIARE MË DHE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2023** *(SË BASHKU ME RAPORTIN E AUDITUESVE TË PAVARUR)*





**EY**

Building a better  
working world

## RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR

*Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë*

### RAPORT MBI AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE

#### OPINIONI

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bankës së Shqipërisë ("Banka"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2023, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të informacionit materiale të politikave kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Bankës më 31 dhjetor 2023, të performancës së saj financiare dhe flukseve të saj të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

#### BAZA PËR OPINION

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në *seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Banka, në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (që përfshin Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) ("Kodi i BSNEPK") dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri ("Kodi i IEKA"), si dhe me kërkesat etike të ligjit nr. 10091, datë 5 mars 2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar", të ndryshuar, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.



## **INFORMACIONE TË TJERA TË PËRFSHIRA NË RAPORTIN VJETOR 2023 TË BANKËS SË SHQIPËRISË**

Informacionet e tjera përfshijnë informacionin që jepet në Raportin Vjetor, por këto informacione nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesve mbi këto pasqyra. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera.

Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se kanë anomali materiale. Nëse bazuar në punën e kryer, arrijmë në përfundimin se në këto informacione ka një anomali materiale, atëherë ne duhet ta raportojmë këtë fakt. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar.

## **PËRGJEGJËSITË E DREJTIMIT DHE TË PERSONAVE TË NGARKUAR ME QEVERISJEN NË LIDHJE ME PASQYRAT FINANCIARE**


Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi të japë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe për të përdorur parimin kontabël të vijimësisë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

## **PËRGJEGJËSITË E AUDITUESIT PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE**

Objektivat tanë janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin se pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijjnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.



Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme;
- sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionin mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës;
- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi;
- nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Bankës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesve në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit;
- vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e vërtetë dhe të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Bankës së Shqipërisë, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young Certified Auditors

Ernst & Young Ekspertë Kontabël të Autorizuar,  
Dega në Shqipëri

Mario Vangjel  
Auditues Ligjor

Nikolay Garnev  
Partner Drejtues

27 mars 2024  
Tiranë, Shqipëri



## PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Në milionë lekë	Shënime	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
<b>AKTIVET</b>			
Paraja dhe balancat me bankat	9	128,980	90,273
Aktive të tregtueshme	13	13,041	14,313
Ari monetar	10	21,039	18,900
Llogari me Fondin Monetar Ndërkombëtar	11	41,043	47,697
Kredi ndaj bankave	12	44,755	51,088
Investime në tituj borxhi	14	486,787	485,221
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara	15	21,574	21,376
Aktive të tjera	16	3,335	3,502
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>760,554</b>	<b>732,370</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Para në qarkullim	17	407,968	401,129
Detyrime ndaj bankave	18	224,111	217,692
Depozita dhe hua nga palë të treta	19	1,997	2,007
Detyrime ndaj Qeverisë dhe institucioneve shtetërore	20	105,024	63,491
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	11	37,156	41,932
Detyrime të tjera	21	983	1,021
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>777,239</b>	<b>727,272</b>
<b>KAPITALI DHE REZERVAT</b>			
Kapitali themeltar dhe rezerva ligjore të realizuara	22	40,721	40,721
Rezerva rivlerësimi të parealizuara	22	(56,974)	(32,300)
Fitim/(Humbje) të mbartura	20	(432)	(3,323)
<b>Totali i kapitalit të vet dhe rezervat</b>	<b>81</b>	<b>(16,685)</b>	<b>5,098</b>
<b>Totali i detyrimeve, kapitali dhe rezervat</b>		<b>760,554</b>	<b>732,370</b>

Këto pasqyra financiare u miratuan nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë më 20 mars 2024, dhe u nënshkruan në emër të tij nga:

  
 Gent Sejko  
 Guvernator

  
 Ledia Bregu  
 Drejtor, Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës



Shënimet nga faqja 137 deri në 200 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



## PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE

Në milionë lekë	Shënime	2023	2022
Të ardhura nga interesat llogaritur me metodën e interesit efektiv	23	15,716	4,857
Shpenzime për interesa	23	(2,166)	(1,259)
<b>Të ardhura nga interesat, neto</b>		<b>13,550</b>	<b>3,598</b>
Të ardhura nga tarifa dhe komisione		184	150
Shpenzime për tarifa dhe komisione		(47)	(45)
<b>Të ardhura nga tarifat dhe komisionet, neto</b>		<b>137</b>	<b>105</b>
Të ardhura nga tregtimi, neto	24	882	35
Humbje neto nga shitja e aktiveve financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave gjithëpërfshirëse	25	(2,772)	(4,165)
Të ardhura të tjera, neto		130	24
Humbje neto nga ndryshimi në vlerën e drejtë të arit monetar	10	(128)	(98)
Fitim/(humbje) neto nga ndryshimet e kurseve të këmbimit	22	(36,020)	(14,473)
<b>Totali i të ardhurave nga operacionet bankare</b>		<b>(24,221)</b>	<b>(14,974)</b>
Humbje nga zhvlerësimi i instrumenteve financiare, neto		(6)	(18)
Shpenzime për personelin	26	(1,639)	(1,507)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	15	(360)	(356)
Shpenzime të tjera të përgjithshme dhe administrative	27	(826)	(795)
<b>Humbja neto për periudhën</b>		<b>(27,052)</b>	<b>(17,650)</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:</b>			
<i>Zëra që nuk mund të riklasifikohen në fitim ose humbje</i>			
<i>Zëra që mund të riklasifikohen në fitim ose humbje</i>		11,526	(13,567)
Instrumente borxhi me VDATGJ – ndryshimi neto në vlerën e drejtë	22	11,526	(13,567)
<b>Të ardhura/(humbje) të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>11,526</b>	<b>(13,567)</b>
<b>Totali i humbjes gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>(15,526)</b>	<b>(31,217)</b>

Shënimet nga faqja 137 deri në 200 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



## PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

Në milionë lekë	Kapitali themeltar dhe Rezerva Ligjore të realizuara			Rezerva rivlerësimi të perealizuara			Fitim / (Humbje) të mbartura	Totali
	Kapitali	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Rezerva e rivlerësimit	Rezerva për vlerën e drejtë	Rezerva të tjera		
Gjendja më 1 janar 2022	2,500	12,500	19,701	(5,995)	(355)	2,241	(296)	30,296
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>								
Rezultati neto për periudhën	-	-	-	-	-	-	(17,650)	(17,650)
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse</b>	-	-	-	-	-	-	-	-
Rezerva për vlerën e drejtë (instrumente borxhi VDATGJ)	-	-	-	-	(13,567)	-	-	(13,567)
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pas tatimit</b>	-	-	-	-	(13,567)	-	-	(13,567)
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>	-	-	-	-	(13,567)	-	(17,650)	(31,217)
Transferime në rezerva (Shënimi 22)	-	-	-	(14,571)	-	(53)	14,623	-
<b>Kontributet dhe shpërndarjet</b>								
Rezerva për mbulimin e pamjaftueshmërisë së mjeteve (Shënimi 22, 14)	-	-	6,020	-	-	-	-	6,020
Shpërndarë Qeverisë Shqiptare (Shënimi 20)	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Totali i kontributeve dhe shpërndarjeve</b>	-	-	6,020	(14,571)	-	(53)	14,623	6,020
Gjendja më 31 dhjetor 2022	2,500	12,500	25,721	(20,566)	(13,922)	2,188	(3,323)	5,098
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>								
Rezultati neto për periudhën	-	-	-	-	-	-	(27,052)	(27,052)
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse</b>	-	-	-	-	-	-	-	-
Rezerva për vlerën e drejtë (instrumente borxhi VDATGJ)	-	-	-	-	11,526	-	-	11,526
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pas tatimit</b>	-	-	-	-	11,526	-	-	11,526
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>	-	-	-	-	11,526	-	(27,052)	(15,526)
Transferime në rezerva (Shënimi 22)	-	-	-	(36,147)	-	(53)	36,200	-
<b>Kontributet dhe shpërndarjet</b>								
Kompensimi i titullit për pamjaftueshmërinë e mjeteve për vitin 2022 (Shënimi 22, 14)	-	-	-	-	-	-	(6,257)	(6,257)
Shpërndarë Qeverisë Shqiptare (Shënimi 20)	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Totali i kontributeve dhe shpërndarjeve</b>	-	-	-	(36,147)	-	(53)	29,943	(6,257)
Gjendja më 31 dhjetor 2023	2,500	12,500	25,721	(56,713)	(2,396)	2,135	(432)	(16,685)

Shënimet nga faqja 137 deri në 200 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



**PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE**

Në milionë lekë	Shënime	2023	2022
<b>Flukset e parave nga aktivitetet operative</b>			
Fitimi neto për periudhën		(27,052)	(17,650)
Rregullime për:			
Zhvierësim dhe amortizim	15	360	356
Humbja neto nga zhvierësimi i instrumenteve financiare		6	18
Të ardhura nga interesat, neto	23	(13,550)	(3,594)
Të ardhura nga tregtimi, neto	24	901	(131)
Humbje/(Fitimi) neto nga shitja e titujve të borxhit të investimit	25	(2,772)	(4,165)
Humbje/(Fitimi) neto nga ndryshimi në vlerën e drejtë të arit monetar	10	128	98
Humbje neto nga ndryshimet e kurseve të këmbimit	22	34,238	14,566
		<b>(7,741)</b>	<b>(10,502)</b>
Ndryshime në:			
Aktive të tregtueshme		384	582
Ari monetar	10	(2,270)	(1,892)
Llogaritë me Fondin Monetar Ndërkombëtar	11	6,194	10,426
Kredi dhe depozita ndaj/me bankat	12	6,359	(9,471)
Aktive të tjera		166	180
Para në qarkullim		6,838	22,987
Detyrime ndaj bankave		18,431	36,265
Depozita dhe hua ndaj palëve të treta		4	(766)
Detyrime ndaj Qeverisë dhe institucioneve shtetërore		45,205	(40,121)
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar		(4,735)	(1,676)
Detyrime të tjera		66	(310)
Rezerva		(57)	(28)
Të tjera		171	18
		<b>69,015</b>	<b>5,692</b>
Interesa të arkëtuara		14,486	4,125
Interesa të paguara		(2,208)	(1,277)
<b>Para neto gjeneruar nga aktivitetet operative</b>		<b>81,293</b>	<b>8,540</b>
<b>Flukset e parave nga aktivitetet investuese</b>			
Blerje të titujve të borxhit të investimit		(323,294)	(390,008)
Arkëtime nga shitja dhe maturimi i titujve të borxhit të investimit		286,900	200,151
Blerje të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara		(560)	(700)
<b>Para neto të përdorura në aktivitetet investuese</b>		<b>(36,954)</b>	<b>(190,557)</b>
<b>Flukset e parave nga aktivitetet financuese</b>			
Fitimi për t'u shpërndarë Qeverisë Shqiptare	20	-	-
<b>Para neto nga aktivitetet financuese</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Rritja në para dhe ekuivalentet e saj gjatë vitit</b>		<b>44,339</b>	<b>(182,017)</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentet e saj në fillim të vitit</b>		<b>90,273</b>	<b>274,725</b>
<b>Efekt i ndryshimit të kurseve të këmbimit mbi paranë gjendje</b>		<b>(5,632)</b>	<b>(2,435)</b>
<b>Paraja dhe ekuivalentet e saj në fund të vitit</b>	<b>9</b>	<b>128,980</b>	<b>90,273</b>

Shënimet nga faqja 137 deri në 200 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.





## SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE MË DHE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2023

(të gjitha shumat janë në milionë lekë, nëse nuk shprehet ndryshe)

### 1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Banka e Shqipërisë ("Banka") është Banka Qendrore e Republikës së Shqipërisë, që ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Në zbatim të këtij ligji, detyrat kryesore të Bankës së Shqipërisë janë si vijon:

- të hartojë, të miratojë dhe të zbatojë politikën monetare të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me objektivin e saj kryesor;
- të hartojë, të miratojë dhe të zbatojë regjimin e këmbimit valutor, si dhe politikën e kursit të këmbimit të valutave në Republikën e Shqipërisë;
- të licencojë ose të revokojë licencat e bankave dhe të mbikëqyrë veprimtarinë e tyre bankare, me qëllim që të sigurojë stabilitetin e sistemit bankar;
- të disponojë dhe të administrojë rezervat e saj valutore;
- të veprojë me cilësinë e bankierit, këshilltarit dhe të agjentit fiskal për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë; dhe
- të nxisë funksionimin normal të sistemit të pagesave.

Banka i nënshtrohet ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar.

### *Pasiguri makroekonomike dhe gjeopolitike*

#### *Lufta në Ukrainë dhe në Lindjen e Mesme*

Luhatshmëria në tregjet ndërkombëtare për shkak të luftës në Ukrainë është ulur në vitin 2023. Në përgjithësi, çmimet e mallrave u ulën gjatë gjithë vitit dhe si tregjet e letrave me vlerë ashtu edhe ato të këmbimit valutor ishin më pak të luhatshme. Normalizimi i politikës monetare të bankave qendrore kryesore botërore ishte drejtimi kryesor, duke rezultuar në ulje të flukseve të kredisë, ulje të aktivitetit, ngadalësim të konsumit privat dhe të investimeve. Fillimi i konfliktit në Lindjen e Mesme u shoqërua me frikën e rikthimit të luhatshmërisë në tregjet ndërkombëtare, shkëputjen e zinxhirëve globalë të furnizimit dhe valë të reja inflacioniste. Në fund të vitit 2023, këto të fundit nuk u materializuan pjesërisht për shkak të tregjeve financiare globale të shtrënguara, uljes së kërkesës dhe natyrës së lokalizuar të konfliktit. Tregu i brendshëm u karakterizua nga forcimi i monedhës vendase ndaj euros për shkak të prurjeve të larta turistike, rënies së inflacionit dhe rritjes së normave të interesit. Aktiviteti ekonomik ka treguar shenja qëndrueshmërie, ndërkohë që konsumi privat dhe investimet kanë vazhduar të zgjerohen.



### *Inflacioni, normat e interesit, luhatjet e kurseve të këmbimit dhe mjedisi ekonomik aktual*

Banka është institucion i mandatuar nga ligji për të hartuar politika monetare, mbikëqyrëse, rregullatore e makroprudenciale, në mbështetje të stabilitetit të çmimeve dhe stabilitetit financiar. Në interes të përmbushjes më eficiente të këtyre detyrave, Bankës i njihet një nivel i lartë i pavarësisë operacionale dhe financiare. Kjo do të thotë që: (i) Banka ka mundësinë dhe detyrimin të ndjekë ato politika dhe të përdorë ato instrumente, të cilat i gjykon më të përshtatshme për përmbushjen e objektivave të saj, (ii) pa u kufizuar nga ndikimi i tyre në rezultatin financiar të Bankës. Në kushtet e një tregu ndërkombëtar me zhvillime të shpejta dhe të forta, u pa i nevojshëm normalizimi i politikës monetare, për të kontrolluar rritjen e inflacionit dhe për të mbështetur stabilitetin e përgjithshëm ekonomik dhe financiar të vendit. Banka e Shqipërisë vazhdoi lëvizjen e saj të normalizimit të politikës monetare në vitin 2023, me dy herë rritje të normës së politikës monetare me 0.25 pikë përqindje secila. Këto rritje synonin shmangien e zhvlerësimit të pritjeve inflacioniste, uljen e presioneve të brendshme inflacioniste dhe shmangien e spiraleve të mundshme të çmimeve të pagave në dritën e një tregu shumë të shtrënguar të punës dhe rritjes së shpejtë të pagave. Forcimi i kursit të këmbimit, duke reflektuar kryesisht përmirësimet strukturore të pozicionit të jashtëm të ekonomisë, ka sjellë - në tërësi - pasoja pozitive në shëndetin e balancave publike dhe ka ndihmuar në stabilitetin monetar dhe financiar. Kjo ka ndihmuar në zbutjen e presioneve të huaja inflacioniste duke çuar në një normalizim të matur të politikës monetare, rritje të kreditimit në monedhën vendase dhe ulje të mëtejshme të kredive joperformuese. Nga ana tjetër, forcimi i monedhës vendase ka ulur vlerën e rezervave valutore të shprehura në monedhën vendase, ndërsa në valutë origjinale, rezervat valutore janë rritur me 17.9%. Banka nga natyra e saj ka një ekspozim të hapur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit për shkak të detyrimit të saj për mbajtjen e këtyre rezervave dhe një forcim i monedhës vendase do të shkaktojë një ndikim negativ në fitim dhe humbje dhe kapitalin e Bankës (shih Shënimin 8(II)).

## **2. DEKLARATA E PËRPUTSHMËRISË**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"), të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

## **3. MONEDHA FUNKSIONALE DHE E PREZANTIMIT**

Këto pasqyra financiare paraqiten në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Bankës. Nëse nuk është shënuar ndryshe, të gjitha shumat janë rumbullakosur në milionin më të afërt.

## **4. BAZA E MATJES**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç sa më poshtë:



Zëri	Baza e matjes
Ari monetar	Vlerë e drejtë
Instrumente financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes (VDNFH)	Vlerë e drejtë
Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ)	Vlerë e drejtë

## 5. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare, drejtimi i Bankës ka bërë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e informacionit të politikës materiale kontabël të Bankës dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.


### (A) Gjykime

Informacioni për gjykimet e bëra në zbatimin e politikave kontabël, që ka një ndikim domethënës në shumat e njohura në pasqyrat financiare, është i përfshirë në shënimet e mëposhtme.

- E zbatueshme për vitet 2023 dhe 2022:
  - Shënimi 7(A)(ii) dhe Shënimi 8(A) - klasifikimi i aktiveve financiare: vlerësimi i modelit të biznesit sipas të cilit mbahen aktivet dhe vlerësimi nëse kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit mbi shumën e principalit të papaguar;
  - Shënimi 8(E)(vi)(a) - përcaktimi i kriterëve për të vlerësuar nëse rreziku i kredisë nga aktiviteti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, përcaktimi i metodologjisë për përfshirjen e informacionit mbi të ardhmen në matjen e Humbjeve të Pritshme nga Krediti (HPK) dhe përzgjedhja dhe miratimi i modeleve të përdorura për të matur HPK-të;
  - Shënimi 7(B) - Paraja në qarkullim: klasifikimi i parasë në qarkullim si një detyrim financiar; dhe
  - Shënimi 7(G) - Ari monetar: matja e arit monetar me vlerë të drejtë, duke njohur ndryshimet në vlerën e drejtë në fitim ose humbje;
  - Shënimi 7(V) - Banka përcakton afatin e qirasë si afat të paanulueshëm, duke përfshirë dhe periudhën e parashikuar nëpërmjet të drejtës të ndërprerjes së qirasë, nëse në mënyrë të arsyeshme kjo e drejtë nuk mund të ushtrohet.

### B. Supozimet dhe pasiguritë e vlerësimit

Informacioni mbi supozimet dhe pasiguritë e vlerësimit, të cilat kanë rrezik domethënës, të rezultojnë në një rregullim material në periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2023, paraqitet në shënimet e mëposhtme.



- E zbatueshme për vitet 2023 dhe 2022:
  - Shënimi 8(E)(vi)(a) dhe Shënimi 7(A)(vii) - zhvlerësimi i instrumenteve financiare: përcaktimi i të dhënave për modelin e matjes të HPK-ve, përfshirë informacionin mbi të ardhmen dhe supozimet kryesore të përdorura në vlerësimin e flukseve të rikuperueshme monetare;
  - Shënimi 7(A)(vi) - përcaktimi i vlerës së drejtë të instrumenteve financiare mbështetur në të dhëna të rëndësishme të pavrojtueshme, dhe përdorimi i modeleve të vlerës së drejtë;

## 6. NDRYSHIME NË POLITIKAT KONTABËL

### *Standarde dhe interpretime të reja dhe të ndryshuara.*

Banka nuk ka miratuar më herët ndonjë standard të ri, interpretim apo ndryshim që është publikuar, por nuk është ende efektiv për qëllime të këtyre pasqyrave financiare.

**Ndryshimet në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare dhe Deklarata e Praktikës SNRF 2:** Dhënia e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël ofrojnë udhëzime për zbatimin e gjykimeve të materialitetit në dhënien e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël. Në veçanti, ndryshimet në SNK 1 zëvendësojnë kërkesën për të shpalosur politikat kontabël 'të rëndësishme' me një kërkesë për të shpalosur politikat kontabël 'materiale'. Gjithashtu, udhëzime dhe shembuj ilustrues janë shtuar në Deklarimin e Praktikës për të ndihmuar në zbatimin e konceptit të materialitetit kur bëhen gjykime rreth dhënies së informacioneve shpjeguese të politikave kontabël. Si rezultat i këtyre ndryshimeve, Banka ka rivlerësuar dhënien e informacioneve shpjeguese të politikave të saj kontabël dhe ndryshimet nuk kanë pasur ndikim në matjen, njohjen dhe paraqitjen e zërave në pasqyrat financiare.

Ndryshime dhe interpretime të tjera zbatohen për herë të parë në vitin 2023, por nuk kanë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës.

*Ndryshimet e mëposhtme janë efektive për periudhat pas datës 31 dhjetor 2023 dhe nuk pritet të kenë një ndikim material për qëllime të pasqyrave financiare të Bankës.*

- **SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare: Klasifikimi i Detyrimeve si afatshkurtra dhe afatgjata (Ndryshime).** Ndryshimet janë efektive për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024, me aplikim më të hershëm të lejuar dhe do të duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8. Objektivi i ndryshimeve është të qartësojë parimet në SNK 1 për klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata. Ndryshimet sqarojnë kuptimin e një të drejte për të shtyrë shlyerjen, kërkesën që kjo e drejtë të ekzistojë në fund të periudhës raportuese, që qëllimi i drejtimit të mos ndikojë në klasifikimin afatshkurtër dhe afatgjatë, se opsionet nga pala tjetër që mund të



rezultojnë në shlyerje nga transferimi i instrumenteve të kapitalit të vet të njësisë ekonomike nuk ndikojnë në klasifikimin afatshkurtër ose afatgjatë. Gjithashtu, ndryshimet specifikojnë se vetëm marrëveshjet me të cilat një njësi ekonomike duhet të pajtohet në ose përpara datës së raportimit do të ndikojnë në klasifikimin e një pasivi. Gjithashtu kërkohen dhënie informacionesh shpjeguese shtesë për detyrimet afatgjata që rrjedhin nga marrëveshjet e huasë që i nënshtrohen marrëveshjeve që duhet të respektohen brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit. Banka do të analizojë dhe vlerësojë ndikimin e ndryshimeve të reja në pozicionin ose performancën e saj financiare.

- SNK 7 Pasqyra e Flukseve të Parasë dhe SNRF 7 Shpalosja e Instrumenteve Financiare - Marrëveshjet Financiare të Furnizuesit (Ndryshimet).** Ndryshimet plotësojnë kërkesat tashmë në SNRF dhe kërkojnë që një njësi ekonomike të japë informacion shpjegues për termat dhe kushtet e marrëveshjeve financiare të furnizuesit. Njësive ekonomike u kërkohet të japin informacion shpjegues mbi vlerat kontabël të detyrimeve financiare të marrëveshjeve financiare me furnizuesit për fillimin dhe fundin e periudhës së raportimit, si dhe zërat në të cilët paraqiten këto detyrime, për të cilat ofruesit e financave kanë shlyer tashmë të pagueshmet tregtare përkatëse. Njësitë ekonomike duhet gjithashtu të japin informacion shpjegues për llojin dhe efektin e ndryshimeve jo-monetare në vlerat kontabël të detyrimeve financiare të marrëveshjeve financiare të furnizuesit, të cilat parandalojnë që vlerat kontabël të detyrimeve financiare të jenë të krahasueshme. Për më tepër, ndryshimet kërkojnë që një njësi ekonomike të japë informacion shpjegues në fillim dhe në fund të periudhës raportuese, intervalin e datave të pagesës për detyrimet financiare që u detyrohen ofruesve të financave dhe për të pagueshmet tregtare të krahasueshme që nuk janë pjesë e këtyre marrëveshjeve. Banka do të analizojë dhe vlerësojë ndikimin e ndryshimeve të reja në pozicionin ose performancën e saj financiare.
- SNK 21 Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit valutor: Mungesa e këmbueshmërisë (Ndryshime)** Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2025, me aplikim të mëhershëm të lejuar. Ndryshimet përcaktojnë se si një njësi ekonomike duhet të vlerësojë nëse një monedhë është e këmbueshme dhe si duhet të përcaktojë një kurs këmbimi në moment kur këmbueshmëria mungon. Një monedhë konsiderohet e këmbueshme në një monedhë tjetër kur një njësi ekonomike është në gjendje të marrë monedhën tjetër brenda një periudhe kohore që lejon një vonesë normale administrative dhe nëpërmjet një tregu ose mekanizmi këmbimi në të cilin një transaksion këmbimi do të krijonte të drejta dhe detyrime të zbatueshme. Nëse një monedhë nuk është e këmbueshme në një monedhë tjetër, një njësi ekonomike i duhet të vlerësojë kursin e këmbimit në datën e matjes. Objektivi i një njësie ekonomike në vlerësimin e kursit të këmbimit spot është të pasqyrojë kursin me të cilin do të ndodhte një transaksion i rregullt këmbimi në datën e matjes midis



pjesëmarrësve të tregut në kushtet ekonomike mbizotëruese. Ndryshimet nënvizojnë se njësia ekonomike mund të përdorë një kurs këmbimi të vrojtueshëm pa rregullim apo një teknikë tjetër vlerësimi. Nuk pritet asnjë ndikim nga ky ndryshim, pasi Banka rrallë hyn në transaksione valutore në monedha për të cilat mungon kursi i këmbimit.

## 7. POLITIKA KONTABËL

Banka ka zbatuar në mënyrë të vazhdueshme politikat e mëposhtme kontabël në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

Banka mund të njohë një aktiv ose detyrim financiar në pasqyrat financiare vetëm nëse bëhet palë e të dhënave kontraktuale të instrumenteve financiare të përdorura. Banka çregjistron një aktiv financiar nga bilanci i saj:

- kur humbet kontrollin mbi të drejtat kontraktuale që përbëjnë aktivin financiar;
- kur detyrimi i deklaruar në kontratë shuhet, anulohet ose tejkalohet afati.

### A. Instrumentet financiare

#### (i) Njohja dhe matja fillestare

Banka fillimisht njeh huatë, paradhëniet dhe depozitat, në datën në të cilën lindin. Të gjitha instrumentet e tjera financiare (përfshirë blerjet dhe shitjet e zakonshme të aktiveve financiare) njihen në datën e tregtimit, që është data në të cilën Banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Një aktiv ose detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes plus, për një zë që nuk matet me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes, kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit të tij.

Aktivitet dhe detyrimet financiare njihen në llogaritë jashtë bilancit prej datës së tregtimit deri në datën e shlyerjes dhe regjistrohen në bilancin e Bankës së Shqipërisë në datën e shlyerjes. Njohja fillestare është me koston e blerjes, d.m.th. çmimi i paguar në blerje. Kostot e transaksionit janë të përfshira në koston e blerjes së të gjitha aktiveve dhe detyrimeve, me përjashtim të aktiveve dhe detyrimeve financiare të regjistruara me VDFH, ku kostot e transaksionit janë shtuar ose zbritur nga kjo shumë. Që nga ky moment, çdo ndryshim në vlerën e tyre të drejtë njihen nga Banka si e ardhur ose shpenzim.

#### (ii) Klasifikimi

Në njohjen fillestare, një aktiv financiar klasifikohet dhe matet në njëren nga kategoritë e mëposhtme:

- kosto të amortizuar (KA),
- vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), ose
- vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH).

Një aktiv financiar matet me kosto të amortizuar, nëse plotëson të dyja kushtet



e mëposhtme dhe nuk është i përcaktuar të matet me VDNFH:

- aktivi mbahet sipas një modeli biznesi, objektivi i të cilit është mbledhja e flukseve monetare kontraktuale; dhe
- kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar gjenerojnë në datat e caktuara flukse monetare, të cilat përbëjnë vetëm pagesa të principalit dhe interesit (VPPI) mbi principalin e papaguar.

Modeli i biznesit të aktiveve financiare të mbajtura për të mbledhur flukset monetare kontraktuale përfshin të gjitha llogaritë rrjedhëse dhe depozitat e Bankës me korrespondentët e huaj, dhe flukset monetare sipas modelit të përdorur për këto aktive paraqesin vetëm pagesa të principalit dhe interesit.

Këto aktive financiare maten me kosto të amortizuar.

Një instrument borxhi matet me VDATGJ nëse plotëson dy kushtet e mëposhtme dhe nuk është i përcaktuar të matet me VDNFH:

- aktivi mbahet në një model biznesi, objektivi i të cilit arrihet nëpërmjet mbledhjes së flukseve monetare kontraktuale dhe nga shitja e aktiveve financiare; dhe
- kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar shkaktajnë në datat e caktuara flukse monetare, të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit (VPPI) mbi shumën e principalit të papaguar.

Modeli i biznesit të aktiveve financiare të mbajtura për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe për shitje përfshin: tituj borxhi dhe investime. Aktivet në këtë grup maten si më poshtë:

- Titujt e borxhit: me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

Të gjitha aktivet e tjera financiare klasifikohen si të matura me VDNFH.

#### *Vlerësimi i modeleve të biznesit*

Banka vlerëson objektivat e modeleve të biznesit, sipas të cilave menaxhohet një aktiv në nivel portofoli, sepse kjo reflekton mënyrën më të mirë të menaxhimit të biznesit dhe si informacioni i paraqitet drejtimit. Informacioni i vlerësuar përfshin:

- politikat dhe objektivat e përcaktuar të portofolit dhe zbatimin e tyre në praktikë. Në veçanti, nëse strategjia e drejtimit fokusohet në përfitimin e të ardhurave kontraktuale nga interesi, mbajtjen e një profili të veçantë të normës së interesit, përputhjen e kohëzgjatjes së aktiveve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto aktive ose realizimin e flukseve monetare nëpërmjet shitjes së aktiveve;
- si vlerësohet performanca e portofolit dhe si i raportohet kjo performancë drejtimit të Bankës;
- rreziqet që ndikojnë në performancën e modeleve të biznesit (dhe të aktiveve financiare të mbajtura brenda këtij modeli biznesi) dhe si



menaxhohen këto rreziqe; si kompensohen menaxherët e portofoleve - p.sh. nëse kompensimi bazohet në vlerën e drejtë të aktiveve të menaxhuara ose në flukset e mjeteve monetare kontraktuale të mbledhura; dhe

- frekuencën, volumin dhe kohën e shitjeve për periudhat e kaluara, arsyet e të tilla shitjeve dhe pritshmëritë për aktivitetin e ardhshëm të shitjeve. Megjithatë, informacioni mbi shitjet nuk merret parasysh i izoluar, por si pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të mënyrës së arritjes nga Banka të objektivave të përcaktuar për menaxhimin e aktiveve financiare dhe mënyrës së realizimit të flukseve të mjeteve monetare të ardhshme.

Aktivitetet financiare, të cilat mbahen për tregtim dhe performanca e të cilave vlerësohet në bazë të vlerës së drejtë, maten me VDNFH, sepse këto aktive nuk mbahen as për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale, as për mbledhjen e flukseve kontraktuale dhe shitjen e aktiveve financiare.

*Vlerësimi nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit (VPPI)*

Për qëllimet e këtij vlerësimi, "principalit" përcaktohet si vlera e drejtë e aktivitetit financiar në njohjen fillestare. "Interesi" përkufizohet si shpërblim për vlerën në kohë të parasë dhe për rrezikun e kreditit që lidhet me shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe për rreziqet dhe kostot e tjera bazë të huadhënies (p.sh. rreziku i likuiditetit dhe kostot administrative), si dhe marzhin e fitimit.

Për të vlerësuar nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm VPPI, Banka merr në konsideratë kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin vlerësimin nëse aktivi financiar përmban një kusht kontraktual që do të ndryshonte kohën dhe shumën e flukseve monetare kontraktuale, të tillë që nuk do ta përmbushte këtë kusht.

Në kryerjen e vlerësimit, Banka merr në konsideratë:

- ngjarje të kushitëzuara që do të ndryshonin shumën dhe kohën e pagesës së flukseve monetare;
- karakteristikat e borxhit;
- kushtet e parapagesës dhe zgjatjes së kontratës; dhe
- karakteristika që modifikojnë elementin e vlerës në kohë të parasë - p.sh. rishikimi periodik i normave të interesit.

*Riklasifikimet*

Aktivitetet financiare nuk riklasifikohen pas njohjes së tyre fillestare, përveçse në periudhën pasi Banka ndryshon modelin e biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare.

### ***Detyrimet financiare***

Banka i klasifikon detyrimet e veta financiare si të matura me koston e amortizuar. Shih (B), (D) dhe (H).





**(iii) Çregjistrimi****Aktivitet financiar**

Banka çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivi financiar kanë skaduar, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse monetare kontraktuale në një transaksion me anë të të cilit kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitet financiar transferohen, ose me anë të të cilit Banka as nuk transferon dhe as mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mbart kontrollin e aktivitet financiar.

Në çregjistrimin e një aktivi financiar, diferenca mes vlerës kontabël të aktivitet (ose vlerës kontabël të caktuar pjesës së aktivitet të çregjistruar) dhe shumës së: (i) vlerës së arkëtuar (përfshirë çdo aktiv të ri të përfituar minus çdo detyrim të ri të marrë përsipër), dhe (ii) çdo fitimi ose humbjeje të akumuluar që është njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse (ATGJ), njihet në fitim ose humbje.

Çdo interes në aktivitet financiare të transferuara, që kualifikohet për çregjistrim, i mbajtur ose i krijuar nga Banka, njihet si një aktiv apo detyrim i veçantë.

Banka hyn në transaksione nëpërmjet të cilave transferon aktivitet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban të gjithë ose pjesën thelbësore të rreziqeve dhe të përfitimeve të aktiveve të transferuara ose një pjesë të tyre.

Në raste të tilla, aktivitet e transferuara nuk çregjistrohen. Të tilla transaksione janë huadhënia e letrave me vlerë dhe transaksionet e shitjes dhe riblerjes së letrave me vlerë.

Për transaksionet në të cilat Banka nuk mban e as nuk transferon pjesën thelbësore të rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë së një aktivi financiar dhe ruan kontrollin mbi këtë aktiv, Banka vazhdon ta njohë aktivin deri në masën që vijon përfshirjen, e përcaktuar nga niveli i ekspozimit ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivitet të transferuar.


**Detyrimet financiare**

Banka çregjistron një detyrim financiar, kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, anuluar apo kanë skaduar.

**(iv) Modifikimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare****Aktivitet financiar**

Nëse kushtet e një aktivi financiar modifikohen, Banka vlerëson nëse flukset monetare të aktivitet të modifikuar janë thelbësisht të ndryshme.

Nëse flukset monetare janë thelbësisht të ndryshme, atëherë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar fillestar konsiderohen se kanë skaduar. Në këtë rast, aktivi financiar origjinal çregjistrohet (shih (iii)) dhe një aktiv financiar i ri njihet me vlerën e drejtë.



Nëse flukset monetare të aktivitetit të modifikuar, të matur me kosto të amortizuar, nuk janë thelbësisht të ndryshme, atëherë modifikimi nuk rezulton në çregjistrimin e aktivitetit financiar. Në këtë rast, Banka rillogarit vlerën kontabël bruto të aktivitetit financiar dhe një shumën që vjen nga rregullimi i vlerës kontabël bruto si fitim ose humbje nga modifikimi në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Nëse një modifikim i tillë kryhet për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit (shih (vii)), atëherë fitimi ose humbja paraqiten së bashku me humbjet nga zhvlerësimi. Në raste të tjera, ajo paraqitet si e ardhur nga interesi (shih Shënimin 7(L)).

#### ***Detyrimet financiare***

Banka çregjistron një detyrim financiar, kur kushtet e tij janë modifikuar dhe flukset monetare të tyre janë thelbësisht të ndryshme. Në këtë rast, njihet një detyrim i ri financiar me vlerë të drejtë bazuar në kushtet e modifikuara. Diferenca midis vlerës kontabël të aktivitetit që çregjistrohet dhe detyrimit të ri financiar me terma të modifikuar njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Nëse modifikimi i një detyrimi financiar nuk njihet si çregjistrim, atëherë kostoja e amortizuar e detyrimit rillogaritet duke skontuar flukset monetare të modifikuara me normën fillestare të interesit efektiv, dhe fitimi ose humbja që rezultojnë njihet në fitim ose humbje.

#### **(v) Kompensimi (netimi)**

Aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare kompensohen dhe paraqiten për shumën neto në pasqyrën e pozicionit financiar, kur dhe vetëm kur Banka ka të drejtën ligjore për të kompensuar shumat dhe synon t'i shlyejë ato në bazë neto ose të njohë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga SNRF-të, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme, si për shembull ato që lidhen me aktivitetin tregtar të Bankës.

#### **(vi) Matja e vlerës së drejtë**

“Vlera e drejtë” është çmimi që do të arkëtohej nga shitja e një aktivi ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes në një treg kryesor ose, në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm tek i cili Banka ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një pasivi pasqyron rrezikun e tij të mosekzekutimit.

Kur është e mundur, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti, duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg quhet “aktiv”, në qoftë se transaksionet për aktivin ose detyrimin ndodhin me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacion mbi çmimet në vazhdimësi.



Nëse nuk disponohet një kuotim çmimi në një treg aktiv, atëherë Banka përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e të dhënave të vrojtueshme dhe minimizojnë përdorimin e të dhënave jo të vrojtueshme. Teknika e zgjedhur përmbledh të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të marrin në konsideratë për përcaktimin e çmimit të një transaksioni.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare, normalisht, është çmimi i transaksionit – pra vlera e drejtë e shumës së paguar ose të arkëtuar.

Nëse Banka përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk evidentohet as nëpërmjet një çmimi të kuotuar në një treg aktiv, duke iu referuar një aktivi ose detyrimi identik, dhe as nuk bazohet në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregje të vrojtueshme, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, rregulluar për të shtyrë në kohë ndryshimin midis vlerës së drejtë të njohjes fillestare dhe çmimit të transaksionit. Në periudhat në vijim, kjo diferencë njihet si fitim ose humbje, në baza të përshtatshme përgjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se momenti kur vlerësimi është i mbështetur plotësisht nga të dhëna të vrojtueshme në treg ose kur transaksioni mbyllet.

Në qoftë se një aktiv ose detyrim i matur me vlerë të drejtë ka një çmim oferte dhe një çmim kërkese, atëherë Banka vlerëson aktivet dhe pozicionet në blerje sipas çmimit të ofertës, dhe detyrimet dhe pozicionet në shitje sipas çmimit të kërkesës.

Vlera e drejtë e një detyrimi financiar me një tipar kërkese (p.sh. depozitë e kërkuar me të parë) është jo më pak se shuma e pagueshme në të parë, e skontuar prej datës së parë në të cilën shuma mund të kërkohet për t'u paguar.


Banka njih transferimin ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë, në fund të periudhës raportuese në të cilën ka ndodhur ndryshimi.

### **(vii) Zhvlerësimi**

Banka njih provigjion për humbjet e pritshme të kreditit "HPK" për aktivet financiare që janë instrumente borxhi dhe nuk maten me VDNFH.

Banka llogarit provigjionin për humbjet në një shumë të barabartë me HPK-të përgjatë gjithë jetës së instrumentit, përveç rasteve të mëposhtme, për të cilat llogariten me HPK 12-mujore:

- investime në tituj të borxhit që përcaktohen të kenë rrezik të ulët krediti në datën e raportimit; dhe
- instrumente të tjera financiare, për të cilat rreziku i kreditit nuk është rritur konsiderueshëm që nga njohja fillestare.



Banka gjykon se një titull borxhi ka rrezik të ulët krediti kur vlerësimi i rrezikut të kreditit është ekuivalent me përkufizimin e kuptuar globalisht si "niveli i vlerësimit të investimit" ("investment-grade").

HPK-të 12-mujore janë ato pjesë të HPK-ve që rezultojnë nga ngjarjet e dështimit, që janë të mundshme të ndodhin brenda 12 muajve nga data e raportimit. Instrumentet financiare për të cilat njihet HPK 12-mujore referohen si "Instrumente financiare në Fazën 1".

HPK-të përgjatë gjithë jetës së instrumentit janë ato që rezultojnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme të dështimit përgjatë jetës së pritshme të një instrumenti financiar. Instrumentet financiare për të cilat njihet HPK përgjatë gjithë jetës, por që nuk janë me kredit të zhvlerësuar, referohen si "Instrumente financiare në Fazën 2".

### **Matja e HPK-ve**

Humbjet e pritshme nga krediti (HPK) janë vlerësime me probabilitet të peshuar të humbjeve nga krediti dhe maten si më poshtë:

- aktivet financiare që nuk shfaqin kredit të zhvlerësuar në datën e raportimit: si vlera aktuale e të gjithë shumës së munguar (që do të thotë diferenca midis flukseve monetare në favor të Bankës, sipas kontratës dhe fluksit të mjeteve monetare që Banka vlerëson të marrë);
- aktivet financiare me kredit të zhvlerësuar në datën e raportimit: si diferenca midis vlerës kontabël bruto dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të vlerësuar.

Për më tepër detaje, shih Shënimin 8(D)(vi)(b).

### **Aktivitet financiare me kredit të zhvlerësuar**

Në çdo datë raportimi, Banka vlerëson nëse aktivitet financiare të matura me koston e amortizuar dhe aktivitet financiare të borxhit të matura me VDATGJ janë aktive financiare me kredit të zhvlerësuar (referohen si "Instrumente financiare në Fazën 3"). Një aktiv financiar konsiderohet me kredit të zhvlerësuar kur ka ndodhur një ose më shumë ngjarje që kanë një ndikim të dëmshëm në flukset monetare të ardhshme të vlerësuar të aktivitetit financiar. Dëshmia se një aktiv financiar shfaq kredit të zhvlerësuar përfshin të dhënat e mëposhtme të vrojtura:

- vështirësi të konsiderueshme financiare të huamarrësit ose emetuesit;
- shkelje të kontratës si dështimi ose mospagimi në afat;
- ristrukturimi nga Banka i një kredie apo një paradhënieje me kushte të tilla që Banka nuk do ta konsideronte ndryshe;
- mundësinë që huamarrësi të hyjë në falimentim ose ndonjë riorganizim tjetër financiar; dhe
- zhdukjen e një tregu aktiv, për shkak të vështirësive financiare të emetuesit.



Në kryerjen e vlerësimit nëse një investim në tituj të borxhit është me kredit të zhvlerësuar, Banka konsideron faktorët e mëposhtëm:

- vlerësimin e tregut për cilësinë e kreditit, siç pasqyrohet në normat e kthimit të obligacioneve;
- vlerësimet e cilësisë së kreditit nga agjencitë e vlerësimit;
- aftësinë e vendit për të hyrë në tregjet e kapitalit për emetimin e borxhit të ri;
- mundësinë e ristrukturimit të borxhit, duke rezultuar në humbje për mbajtësit, nëpërmjet faljes vullnetare ose të detyrueshme të borxhit; dhe
- mekanizmat ndërkombëtarë të mbështetjes që ekzistojnë për të siguruar mbështetjen e nevojshme si "huadhënës i fundit në radhë" për atë vend, si dhe qëllimin e reflektuar në deklaratat publike të qeverive dhe agjencive të këtyre vendeve për përdorimin e mekanizmave të tillë. Kjo përfshin një vlerësim të thellësisë së këtyre mekanizmave, pavarësisht nga qëllimi politik nëse ka kapacitet për t'i përmbushur kriteret e kërkuara.

### ***Paraqitja e provigjionit për HPK-të në pasqyrën e pozicionit financiar***

Provigjioni për HPK-të paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar si më poshtë:

- për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar: si zbritje nga vlera kontabël bruto e aktiveve;
- për instrumentet e borxhit të matura me VDATGJ: nuk njihet zhvlerësim në pasqyrën e pozicionit financiar, sepse vlera kontabël e këtyre aktiveve është vlera e drejtë e tyre. Megjithatë, zhvlerësimi për humbjet e pritshme nga krediti paraqitet dhe njihet në rezervën e vlerës së drejtë.

### ***Fshirja***

Kreditë dhe letrat me vlerë të borxhit fshihen (pjesërisht ose tërësisht) kur nuk ka një pritshmëri të arsyeshme për rikuperimin e një aktivi financiar në tërësinë e tij ose një pjesë të tij. Kjo zakonisht ndodh kur Banka përcakton se huamarrësi nuk ka aktive ose burime të ardhurash që mund të gjenerojnë flukse të mjaftueshme të mjeteve monetare për të shlyer shumat që i nënshtrohen fshirjes. Ky vlerësim kryhet në nivelin e aktiveve individuale.

Shlyerjet e shumave të shlyera më parë janë përfshirë në "humbjet nga zhvlerësimi i instrumenteve financiare" në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe ATGJ. Aktivet financiare që janë fshirë, mund të jenë akoma subjekt i veprimeve përmbartimore për të qenë në përputhje me procedurat e Bankës për rikuperimin e shumave të pashlyera.

## ***B. Paraja në qarkullim***

Paraja në qarkullim përfshin kartëmonedhat dhe monedhat në qarkullim dhe është paraqitur si detyrim, si shumë neto e vlerës nominale të kartëmonedhave dhe monedhave të emetuara, minus vlerën nominale të kartëmonedhave dhe monedhave ekzistuese në arka, në datën e raportimit.



### C. Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë kartëmonedha dhe monedha të huaja në arkë, dhe aktive financiare shumë likuide me kohëzgjatje fillestare deri në tre muaj nga data e blerjes, që janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimit në vlerën e drejtë, e që përdoren nga Banka për administrimin e angazhimeve afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentet e saj mbahen me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

### D. Aktivet dhe detyrimet me vlerë të drejtë, nëpërmjet fitimit ose humbjes (Aktive dhe detyrime të tregtueshme)

Aktivitet dhe detyrimet financiare të tregtueshme janë ato aktive dhe detyrime që Banka i ka kryesisht për qëllime të shitjes ose riblerjes në periudhën afatshkurtër, ose i mban si pjesë të një portofoli, i cili përdoret për ruajtje pozicioni ose për përfitime afatshkurtra.

Aktivitet dhe detyrimet financiare të tregtueshme njihen fillimisht dhe mbahen më tej me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar, duke i njohur kostot e transaksionit në fitim ose humbje. Çdo ndryshim në vlerën e drejtë njihet në fitim ose humbje, si pjesë e të ardhurave neto nga instrumentet e tregtueshme.

### E. Aktivitet dhe detyrimet me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

Aktivitet dhe detyrimet me VDATGJ përfaqësojnë ato nga të cilat Banka pret të mbledhë flukset kontraktuale të parasë, duke mbajtur apo edhe shitur instrumentin. Investimet në tituj borxhi përfshijnë tituj të borxhit të matur me VDATGJ; fitimet dhe humbjet njihen në ATGJ, përveç sa në vijim, të cilat njihen në fitime ose humbje në të njëjtën mënyrë si për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar:

- të ardhurat nga interesi, duke përdorur metodën e interesit efektiv;
- HPK-të dhe rimarrjet; dhe
- fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit.

Kur një letër me vlerë borxhi e matur me VDATGJ çregjistrohet, fitimi ose humbja e akumuluar e njohur më parë në ATGJ riklasifikohet nga kapitali në fitim ose humbje.

### F. Hua dhe të arkëtueshme

Huatë dhe paradhëniet përfshijnë huatë dhe paradhëniet e matura me koston e amortizuar (referuar Shënimit 7(A)(ii)); ato fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kostot shtesë direkte të transaksionit dhe më tej me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kur Banka blen një aktiv financiar



dhe njëkohësisht hyn në një marrëveshje për të rishitur aktivin (ose një aktiv kryesisht të ngjashëm) me një çmim fiks në një datë të ardhshme (marrëveshje të anasjella riblerjeje), marrëveshja kontabilizohet si një hua apo paradhënie dhe aktivi nuk njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

### **G. Ari monetar**

Banka e Shqipërisë, në rolin e saj si bankë qendrore, mban vëllime të veçanta të arit si pjesë të rezervave ndërkombëtare të Shqipërisë. Në përputhje me kërkesat e ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", Banka mund të ndërmarrë çdo veprim të nevojshëm në lidhje me blerjen, zotërimin dhe shitjen e rezervave ndërkombëtare, përfshirë dhe arin monetar. Rrjedhimisht, ari monetar, si pjesë e rezervës ndërkombëtare, mund të përdoret menjëherë nga Banka, pa kufizime të mëtejshme që e përcaktojnë atë si një aktiv monetar. Në zbatim të kërkesave të "Dispozitave të përgjithshme për përcaktimin e bazave të vlerësimit në pasqyrat financiare" të SNRF-ve, Banka përcakton njohjen dhe vlerësimin e arit monetar si një aktiv të raportuar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, si bazën më të përshtatshme dhe të besueshme për vlerësimin e mëtejshëm të këtij aktivi monetar. Ari matet me vlerën e tregut, duke u bazuar në çmimin e Tregut të Arit në Londër (London Bullion Market) konvertuar në dollarë amerikanë në datën e raportimit. Ari në formë standarde (ari monetar) fillimisht njihet me koston e blerjes.

Ari monetar vlerësohet me vlerën e tij të drejtë që është vlera e tregut bazuar në çmimin zyrtar të Tregut të Arit në Londër (London Bullion Market) në datën e raportimit. Ndryshimet në vlerën e drejtë njihen në fitim dhe humbje dhe akumulohen në "Rezervën e Rivlerësimit" në Kapital dhe Rezervat, në përputhje me nenin 64 (a) të Ligjit "Për Bankën e Shqipërisë". Fitimet dhe humbjet e porealizuara nga rivlerësimi i arit monetar dhe instrumenteve të tjera të arit të Bankës njihen në pasqyrën e të ardhurave.

### **H. Depozita dhe hua**

Depozitat dhe huatë njihen fillimisht me vlerë të drejtë, duke zbritur kostot shtesë që lidhen drejtpërdrejtë me transaksionin dhe në vazhdim maten me kosto të amortizuara, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### **I. Kostot e printimit dhe shtypjes**

Kostot e printimit dhe shtypjes së kartëmonedhave dhe monedhave, të cilat nuk janë hedhur ende në qarkullim, njihen fillimisht si aktive me koston e blerjes dhe më tej amortizohen në mënyrë lineare, përkatësisht përgjatë 5 dhe 10 viteve.

### **J. Aktivitet e patrupëzuara**

Aktivitet e patrupëzuara njihen, nëse është e mundur që përfitimet ekonomike që i atribuohen aktivitet në të ardhmen do t'i përkasin Bankës dhe kostoja e aktivitet



mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme. Aktivet e patrupëzuara përbëhen nga programet kompjuterike dhe licencat.

Aktivitet e patrupëzuara të blera nga Banka njihen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Shpenzimet e mëtejshme për aktivet e patrupëzuara kapitalizohen vetëm kur lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej përdorimit të këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes, kur ndodhin.

Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes, bazuar në metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së dobishme të aktivitetit të patrupëzuar, prej datës kur është i gatshëm për përdorim. Puna në proces nuk amortizohet.

Vlerësimi i jetëgjatësive të dobishme është si më poshtë:

-	programe kompjuterike dhe licenca	4 vite;
-	aktive të tjera të patrupëzuara	6.6 vite.

## K. Aktivitet e trupëzuara

### (i) Njohja dhe matja


Zërat e aktiveve të trupëzuara vlerësohen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Kostoja e disa prej zërave të aktiveve të trupëzuara është përcaktuar mbi bazën e vlerës së drejtë më 31 dhjetor 2014, të cilën Banka zgjodhi ta përdorë si kosto të supozuar si pjesë e kalimit në SNRF (shih shënimin 22). Rregullimet në të dhënat e regjistruara, si dhe regjistrimet përkatëse në rezervën e rivlerësimit janë raportuar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

### (ii) Kostot e mëvonshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një aktivi të qëndrueshëm regjistrohet me vlerën e mbartur të këtij aktivi, nëse është e mundur që Banka të marrë përfitime të ardhshme ekonomike nga ky aktiv dhe kostoja e tij mund të matet në mënyrë të besueshme. Vlera e mbetur e pjesës së zëvendësuar çregjistrohet. Kostot e mirëmbajtjes së aktiveve të qëndrueshme njihen në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

### (iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në fitim ose humbje sipas metodës lineare, bazuar në jetëgjatësinë e vlerësuar të çdo pjese përbërëse të aktivitetit të qëndrueshëm. Toka, puna në proces dhe monedhat e objektet numizmatike nuk zhvlerësohen.





Vlerësimi i jetëgjatësive të dobishme është si më poshtë:

• Ndërtesa	25 - 70 vjet
• Instalime	4 - 20 vjet;
• Mjete transporti	5 - 10 vjet;
• Makineri dhe pajisje	4 - 20 vjet.

Metodat e amortizimit, jetëgjatësitë e dobishme dhe vlerat e mbetura rishikohen në datën e raportimit.

## L. Interesat

### **Norma efektive e interesit**

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen në fitim ose humbje, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton saktësisht pagesat e vlerësuara monetare të ardhshme dhe arkëtimet gjatë jetës së pritshme të aktivit ose detyrimit financiar deri në:

- vlerën kontabël bruto të aktivit financiar; ose
- koston e amortizuar të detyrimit financiar.

Në përlllogaritjen e normës efektive të interesit, për instrumente financiare të ndryshme me kredit të zhvlerësuar, Banka vlerëson flukset monetare të ardhshme, duke konsideruar gjithë kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, me përjashtim të humbjeve të ardhshme që rrjedhin nga rreziku i kreditit.

Për aktivet financiare me kredit të zhvlerësuar, Banka llogarit normën efektive të interesit të rregulluar të kreditit, duke përdorur flukset monetare të ardhshme të vlerësuara që përfshijnë edhe humbjet e pritshme të kreditit.

Përlllogaritja e normës efektive të interesit përfshin kostot e transaksioneve dhe tarifatat e paguara ose të arkëtuara që janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv. Kostot e transaksionit përfshijnë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen ose emetimin e një aktivi ose detyrimi financiar.

### **Kostoja e amortizuar dhe vlera kontabël bruto**

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare, minus pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar, duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet shumës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim dhe për aktivet financiare, rregulluar për çdo zhvlerësim nga humbjet e pritshme të kreditit.

Vlera kontabël bruto e një aktivi financiar është kostoja e amortizuar e aktivit financiar përpara zbritjes së provigjioneve për humbjet e pritshme të kreditit.

### **Llogaritja e të ardhurave dhe shpenzimeve nga interesi**

Në llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve të interesit, norma efektive e



interesit zbatohet mbi vlerën kontabël bruto të aktivit (kur aktivi nuk është me kredit të zhvlerësuar) ose mbi koston e amortizuar të detyrimit.

Megjithatë, për aktivet financiare të cilat janë bërë me kredit të zhvlerësuar pas njohjes fillestare, të ardhurat nga interesi llogariten duke zbatuar normën efektive të interesit në koston e amortizuar të aktivit financiar. Nëse aktivi nuk është më me kredit të zhvlerësuar, atëherë llogaritja e të ardhurave nga interesi kthehet në bazë bruto.

Për aktivet financiare të cilat ishin me kredit të zhvlerësuar në njohjen fillestare, të ardhurat nga interesi llogariten duke zbatuar normën efektive të interesit të kreditit të rregulluar mbi koston e amortizuar të aktivit. Llogaritja e të ardhurave nga interesi nuk kthehet në baza bruto as nëse rreziku i kreditit të aktivit përmirësohet.

Për informacion se kur një aktiv konsiderohet me kredit të zhvlerësuar, referojuni Shënimit 7(A)(vii).

Më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 nuk ka aktive me kredit të zhvlerësuar.

### **Prezantimi**

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit të paraqitura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe ATGJ përfshijnë:

- interesin e aktiveve dhe detyrimeve financiare të matura me kosto të amortizuar, të llogaritur në bazë të normës efektive të interesit; dhe
- interesin e investimeve të matura me VDATGJ, të llogaritur në bazë të normës efektive të interesit.

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit mbi gjithë aktivet dhe detyrimet e tregtueshme konsiderohen si të rastësishme nga operacionet e tregtimit të Bankës, dhe paraqiten së bashku me gjithë ndryshimet e tjera në vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve të tregtueshme tek të ardhurat nga tregtimi neto (shih Shënimin 7(O)). Fitimet dhe humbjet si rezultat i ndryshimit të vlerës së drejtë të instrumenteve financiare të raportuara me VDFH njihen në pasqyrën e të ardhurave.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen mbi bazë përlllogaritjeje, në përputhje me politikën e normave të interesit të Bankës dhe marrëveshjeve të arritura me institucionet financiare ndërkombëtare dhe klientët e Bankës. Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në pasqyrën e të ardhurave. Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi gjithashtu përfshijnë dhe amortizimin e primit të llogaritur mbi bazën e metodës së interesit efektiv.

Të ardhurat nga interesi për titujt e borxhit të huaj të mbajtur në portofolin e Bankës përfshijnë interesin nga kuponat e interesit të letrave të emetuara. Të ardhurat nga interesi i depozitave përfshijnë të ardhurat nga interesi për depozitat në monedhë të huaj dhe në ar.



Të ardhura/shpenzime të tjera financiare përfshijnë të ardhurat dhe shpenzimet nga shitja dhe ndryshimi në vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare të mbajtura për tregtim dhe aktiveve të vlefshme për shitje.

Fitimi/humbja neto nga aktivet dhe detyrimet financiare përfshijnë fitimet neto nga veprimet me letrat me vlerë, fitimet neto nga veprimet në monedhë të huaj, fitimin neto nga rivlerësimi i letrave me vlerë, fitimin neto nga rivlerësimi i arit, fitimin neto nga rivlerësimi i kontratave të së ardhmes dhe fitimin neto nga rivlerësimi i aktiveve dhe detyrimeve në monedha të huaja.

### **M. Tarifa dhe komisione**

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet, të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit të një aktivi ose detyrimi financiar, përfshihen në matjen e normës efektive të interesit.

Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet e tjera, përfshirë tarifat e shërbimit të llogarisë, tarifat e transferimit të fondeve, tarifat e vendosjes dhe tarifat e regjistrimit të kredisë, njihen në momentin që përfitohen shërbimet.

Në përputhje me SNRF 1.5, të ardhurat nga kontratat me klientë njihen kur Banka ka përmbushur detyrimin e saj të performancës, duke transferuar shërbimet e saj te klienti. Të ardhurat njihen në vlerën e pritshme për t'u marrë në shkëmbim. Nuk ka ndryshime në vlerësimin dhe njohjen e tarifave dhe komisioneve, si rezultat i hyrjes në zbatim të SNRF 1.5.


Shpenzimet për tarifa dhe komisione të tjera përbëhen kryesisht nga tarifa veprimesh ose shërbimesh, të cilat njihen si shpenzim në momentin kur përfitohen shërbimet.

### **N. Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin aktual të këmbimit në datat e kryerjes së veprimeve. Kurset e këmbimit për monedhat kryesore të huaja për datat 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 paraqiten në Shënimin 8(F)(ii).

Në datën e raportimit, aktivet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin zyrtar të këmbimit në atë datë.

Fitimi ose humbja në zërat monetare është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të vitit, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë vitit, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të konvertuar me kursin e këmbimit aktual në fund të vitit.



Aktivitet dhe detyrimet jomonetare që maten me vlerë të drejtë në një monedhë të huaj, konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jomonetarë që janë vlerësuar sipas koston historike në monedhë të huaj, konvertohen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi njihen në fitim ose humbje.

Në përputhje me ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", si dhe vendimin nr. 104, datë 27.12.2006, të Këshillit Mbikëqyrës "Për miratimin e një ndryshimi në formën e pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë", të ardhurat/(humbjet) neto nga kurset e këmbimit që njihen në fitim ose humbje në periudhën në të cilën lindin, akumulohen në të njëjtën periudhë tek "Rezerva e rivlerësimit", përfshirë në Kapital dhe Rezerva. Në bazë të nenit 64, pika "b", të ligjit të lartpërmendur, Qeveria e Shqipërisë emeton tituj të borxhit me normë interesi të tregut për të mbuluar çdo vlerë negative të rezervës së rivlerësimit si rezultat i aktivitetit të Bankës.

#### ***O. Të ardhurat nga tregtimi, neto***

Të ardhurat nga tregtimi, neto, përbëhen nga fitimet minus humbjet nga aktivitet dhe detyrimet e tregtueshme, dhe përfshijnë gjithë ndryshimet e realizuara dhe të parealizuara në vlerën e drejtë, interesin dhe diferencat nga kurset e këmbimit.

#### ***P. Tatimi dhe politika e Bankës për shpërndarjen e fitimit***

Në përputhje me ligjin "Për Bankën e Shqipërisë", Banka nuk është subjekt i tatimit mbi fitimin. Politika e shpërndarjes së fitimit të aktivitetit bankar është përcaktuar në ligjin "Për Bankën e Shqipërisë". Sipas nenit 10(2) të këtij ligji, i gjithë fitimi i realizuar kalon në Buxhetin e Shtetit, pas plotësimit të niveleve për fondin rezervë dhe kompensimit të titujve të borxhit sipas nenit 10(1) të ligjit dhe sipas miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës.

Sipas nenit 11 të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", nuk do të bëhet asnjë transferim, shpërndarje apo pagesë sipas neneve 8, 9 ose 10 të këtij ligji, nëse aktivitet e Bankës janë më pak se shuma e detyrimeve dhe fondit të themelimit. Në qoftë se kushte të tilla lindin, në bazë të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", nenit 7, Ministria e Financave i transferon Bankës tituj borxhi të Qeverisë me interesa të negociueshme, në shumën e nevojshme për të mbuluar pamjaftueshmërinë (referojuni Shënimit 14).

#### ***Q. Përfitimet e punonjësve***

##### ***(i) Plan pensioni me kontribute të përcaktuara***

Detyrimet për kontributet ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar njihen në fitim ose humbje pasi ofrohet shërbimi përkatës dhe përfshihet në shpenzimet e personelit.



**(ii) Kontributet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore**

Banka paguan kontribute të detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në një fond që operohet nga Shteti Shqiptar, që ofron përfitime pensioni, shëndetësore dhe përfitime të tjera sociale për punonjësit.

Detyrimet për të tilla kontribute njihen në fitim ose humbje, kur ato janë të detyrueshme, dhe përfshihen në shpenzimet e personelit. Shteti Shqiptar është përgjegjës për përcaktimin e kufirit minimal ligjor për të tilla kontribute.

**(iii) Përfitimet afatshkurtra**

Detyrimet për përfitime afatshkurtra maten në baza të paskontuara dhe njihen si shpenzim në periudhën kur ofrohet shërbimi. Për shumën që pritet të paguhet në lidhje me shpërblimet afatshkurtra në para, regjistrohet një provigjion nëse Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv për ta paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të shkuara të ofruara nga punonjësi dhe kur ky detyrim mund të matet në mënyrë të besueshme.

**R. Qiratë**

Banka vlerëson në fazën fillestare të lidhjes së një kontrate, nëse kontrata është, ose përmban një qira. Kontrata është, ose përmban një qira, nëse kontrata jep të drejtën e kontrollit mbi përdorimin e një aktivi të identifikueshëm për një periudhë kohe në këmbim të një shume.

Banka aplikon një qasje të vetme njohjeje dhe matjeje për të gjitha qiratë, përveç qirave afatshkurtra dhe qirave të aktiveve me vlerë të ulët.

Banka njih detyrimet ndaj qirasë për të bërë pagesa të qirasë dhe të drejtën e përdorimit të aktiveve, e cila paraqet të drejtën për ta përdorur aktivin.

**E drejta e përdorimit të aktivit**

Banka njih të drejtën e përdorimit të aktivit në datën e fillimit të kontratës së qirasë. E drejta e përdorimit të aktivit matet me kosto, më pak se zhvlerësimi ose humbja nga zhvlerësimi dhe e rregulluar për çdo rivlerësim të detyrimeve të qirasë.

Kjo kosto përfshin shumën e detyrimeve të njohura të qirasë, kostot fillestare direkte dhe pagesat e qirasë të bëra në ose para datës së fillimit, pakësuar me çdo pagesë të marrë si nxitës. E drejta e përdorimit të aktiveve zhvlerësohet në mënyrë lineare përgjatë afatit të qirasë.

Të drejtat e përdorimit të aktiveve paraqiten në Shënimin 15 "Ndërtesa, pajisje, të drejta përdorimi të aktiveve dhe aktivitetet e patrupëzuara".



### ***Detyrimet për qira***

Në datën e fillimit të kontratës, Banka njih detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë, të cilat nuk janë paguar ende në atë datë. Pagesat e qirasë përfshijnë pagesat fikse (pakësuar me çdo pagesë stimuluese të arkëtueshme), pagesat variabël të qirasë, të cilat varen nga një indeks ose normë, dhe shumat e pritshme për t'u paguar sipas vlerës së mbetur të garancive. Pagesat e qirasë përfshijnë gjithashtu çmimin e blerjes të parashikuar në rastin kur ka arsye që Banka të ushtrojë opsionin e blerjes, si dhe penalitetet që shoqërojnë mbarimin e qirasë, në rastin kur është ushtruar opsioni i mbylljes para kohe. Pagesat e kryera për qiratë operative njihen në fitim/humbje në mënyrë lineare përgjatë afatit të qirasë. Vlerat e marra si stimuj nxitës të qirasë janë njohur si pjesë përbërëse e shpenzimeve të qirasë, përgjatë afatit të qirasë.

Më 31 dhjetor 2023, Banka nuk ka kontrata të qirasë financiare përveç atyre të qirasë afatshkurtër.

### ***S. Zhvlerësimi i aktiveve jofinanciare***

Vlerat kontabël të aktiveve jofinanciare të Bankës rishikohen në çdo datë raportimi, për të përcaktuar nëse ka tregues për zhvlerësim. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi tejkalon vlerën e rikuperueshme.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi është më e larta mes vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë, minus kostot e shitjes. Në matjen e vlerës në përdorim skontohen flukset e ardhshme monetare në vlerën e tyre aktuale, duke përdorur një normë interesi, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

Humbjet nga zhvlerësimi, të njohura në periudhat e mëparshme, vlerësohen në çdo datë raportimi, për të përcaktuar nëse humbja është zvogëluar apo nuk ekziston më. Humbja nga zhvlerësimi kthehet mbrapsht nëse ka pasur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga zhvlerësimi kthehet mbrapsht deri në masën që vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, në qoftë se nuk do të ishte njohur humbje nga zhvlerësimi.

### ***T. Provigjionet***

Provigjioni njihet si i tillë nëse, kur si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv, i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur të kërkohet një pakësim i përfitimeve ekonomike për ta shlyer këtë detyrim. Shuma e njohur si një provigjion matet si vlerësimi më i mirë i shpenzimeve të kërkuara për të shlyer detyrimin aktual në fund të periudhës raportuese. Kur efekti i vlerës kohore të parasë është material, shumata e një provigjioni është vlera aktuale e shpenzimeve që pritet të kërkohet për të shlyer detyrimin.



## U. Grantet

Grantet njihen fillimisht si të ardhura të shtyra kur ka siguri të arsyeshme se ato do të merren dhe se Banka do të përmbushë kushtet e lidhura me grantin. Grantet që kompensojnë Bankën për shpenzimet e ndodhura njihen në fitim ose humbje, në mënyrë sistematike, gjatë periudhës në të cilën njihen shpenzimet përkatëse. Grantet që kompensojnë Bankën për koston e një aktivi, njihen në fitim ose humbje, në mënyrë sistematike, gjatë jetës së pritshme të aktivitetit.

## 8. INSTRUMENTET FINANCIARE: KLASIFIKIMI, ADMINISTRIMI I RREZIKUT DHE VLERA E DREJTË

### A. Klasifikimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare


Politikat kontabël të Bankës për klasifikimin e instrumenteve financiare sipas SNRF 9, janë paraqitur në Shënimin 7 (A)(ii).

(a) Me aplikimin e SNRF 9, Banka ka klasifikuar ekspozimet me FMN-në si instrumente borxhi të matura me koston e amortizuar, duke pasur parasysh objektivin strategjik afatgjatë të Bankës për t'i mbajtur këto instrumente dhe flukset e tyre kontraktuale të parave që plotësojnë kriteret e VPPI.

(b) Letrat me vlerë të investimeve mbahen nga Banka si portofole të veçanta për të përmbushur nevojat e likuiditetit. Banka kërkon të minimizojë kostot e menaxhimit të nevojave për likuiditet dhe për këtë arsye, menaxhon në mënyrë aktive kthimin e portofolit. Ky kthim konsiston në mbledhjen e pagesave kontraktuale, si dhe fitim/humbjet nga shitja e aktiveve financiare. Strategjia e investimit shpesh rezulton në aktive shitjeje me vlerë të konsiderueshme. Banka konsideron që sipas SNRF9, këta tituj borxhi mbahen sipas modelit të biznesit, objektivi i të cilit realizohet si nga mbledhja e flukseve monetare kontraktuale dhe nga shitja e aktivitetit financiar. Shih politikat kontabël në Shënimin 7(A)(ii).

(c) Aktivitetet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerë të drejtë duke njohur në pasqyrën e fitim humbjes ndryshimet e vlerës së drejtë. Kjo kategori përfshin instrumentet derivative dhe aktivitetet e tregëtueshme të administruara nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD).

Tabela në vijim paraqet ndarjen e zërave në pasqyrën e pozicionit financiar sipas kategorive të instrumenteve financiare.



31 dhjetor 2023	VDNFH	V DATGJ – instrumente borxhi	Kosto e amortizuar	Totali i vlerës kontabël
<b>Aktivët</b>				
Paraja dhe balancat me bankat	-	-	128,980	128,980
Aktive të tregtueshme	13,041	-	-	13,041
Llogari me FMN-në	-	-	41,043	41,043
Kredi ndaj bankave	-	-	44,755	44,755
Investime në letrat me vlerë të matura me vlerë të drejtë	-	486,787	-	486,787
Aktive të tjera	-	-	2,158	2,158
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>13,041</b>	<b>486,787</b>	<b>216,936</b>	<b>716,764</b>
<b>DETYRIMET</b>				
Para në qarkullim	-	-	407,968	407,968
Detyrime ndaj bankave	-	-	224,111	224,111
Depozita dhe hua nga palë të treta	-	-	1,997	1,997
Detyrime ndaj Qeverisë dhe institucioneve shtetërore	-	-	105,024	105,024
Detyrime ndaj FMN-së	-	-	37,156	37,156
Detyrime të tjera	-	-	880	880
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>777,136</b>	<b>777,136</b>

31 dhjetor 2022	VDNFH	V DATGJ – instru- mente borxhi	Kosto e amor- tizuar	Totali i vlerës kontabël
<b>Aktivët</b>				
Paraja dhe balancat me bankat	-	-	90,273	90,273
Aktive të tregtueshme	14,313	-	-	14,313
Llogari me FMN-në	-	-	47,697	47,697
Kredi ndaj bankave	-	-	51,088	51,088
Investime në letrat me vlerë të matura me vlerë të drejtë	-	485,221	-	485,221
Aktive të tjera	-	-	2,298	2,298
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>14,313</b>	<b>485,221</b>	<b>191,356</b>	<b>690,890</b>
<b>DETYRIMET</b>				
Para në qarkullim	-	-	401,129	401,129
Detyrime ndaj bankave	-	-	217,692	217,692
Depozita dhe hua nga palë të treta	-	-	2,007	2,007
Detyrime ndaj Qeverisë dhe institucioneve shtetërore	-	-	63,491	63,491
Detyrime ndaj FMN-së	-	-	41,932	41,932
Detyrime të tjera	-	-	921	921
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>727,172</b>	<b>727,172</b>

## B. Struktura e administrimit të rrezikut

Instrumentet financiare të Bankës përdoren kryesisht për administrimin e rezervës valutore, si dhe për qëllime të zbatimit të politikës monetare. Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të likuiditetit, rrezikut të kreditit, rrezikut të tregut, rrezikut ligjor dhe rrezikut operacional, gjatë investimit në instrumentet financiare.

Ky shënim shpjegues paraqet informacion për ekspozimin e Bankës ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivat e Bankës, politikat dhe proceset për matjen dhe administrimin e rrezikut.

Në përputhje me kërkesat ligjore, Banka e Shqipërisë mban dhe administron rezervat valutore të Republikës së Shqipërisë. Këshilli Mbikëqyrës ka përgjegjësinë për implementimin e strukturës së administrimit të rrezikut dhe të politikave për administrimin e rezervave.





Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar rregulloren “Për funksionet e strukturave drejtuese në procesin e vendimmarrjes për administrimin e rezervës valutore”. Kjo rregullore parashikon përgjegjësitë e strukturave drejtuese, Këshillit Mbikëqyrës, Guvernatorit, Komitetit të Investimit dhe Departamentit të Operacioneve Monetare, gjatë administrimit të rezervës valutore.

Këshilli Mbikëqyrës është përgjegjës për miratimin e rregullores “Për politikën dhe mënyrën e administrimit të rezervës valutore”, Komiteti i Investimit është përgjegjës për miratimin e dokumentit “Procedurat Operacionale të Investimit”, ndërsa Guvernatori miraton akte të tjera udhëzuese për një rregullim sa më të plotë të funksionit të administrimit të rezervës.

Rregullorja “Për politikën dhe mënyrën e administrimit të rezervës valutore”, përcakton objektivat në administrimin e portofolit, të renditura sipas përparësisë, parimet, si dhe kriteret bazë cilësore për administrimin e rreziqeve.

Komiteti i Investimit miraton kriteret sasiore, në përputhje me kufizimet e parashikuara nga Këshilli Mbikëqyrës, dhe monitoron respektimin e kufizimeve për shkallën e lejuar të rrezikut dhe rezultatin e investimit të portofolit të rezervës valutore.

Në përputhje me vendimmarrjen e Këshillit Mbikëqyrës për instrumentet e lejuara, rezerva investohet në tituj me të ardhura konstante, në depozita ose certifikata depozite, si dhe në instrumente derivative të lidhura me këto instrumente.

Pjesa tjetër e rezervës valutore mbahet në SDR dhe ar monetar. Administrimi i arit monetar realizohet në përputhje me rregulloren “Për politikën dhe mënyrën e administrimit të arit”, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës.

Nga rishikimi i politikës kontabël për arin monetar (shih Shënimin 5(A) dhe 7(G)), në vitin 2016, Banka arriti në përfundimin që ari monetar nuk është një instrument financiar.

### C. Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që:

- a) Banka do të hasë vështirësi në bërjen e pagesave për shlyerjen e detyrimeve të veta financiare në kohë, dhe
- b) Banka nuk do të jetë në gjendje të shesë një instrument financiar brenda një kohe të caktuar, pa krijuar humbje të rëndësishme krahasuar me vlerën e tregut.

Likuiditeti renditet ndër objektivat parësorë të administrimit të rezervës valutore dhe përcaktohet si synim për të siguruar disponibilitetin në çdo kohë të fondeve të mjaftueshme për plotësimin e nevojave për likuiditet të lidhura me:



- zbatimin e politikës monetare dhe të politikës së kursit të këmbimit të Bankës; dhe
- ruajtjen e stabilitetit financiar apo mbulimin e nevojave të vendit në periudha krize.

Zbatimi i këtyre objektivave realizohet përmes organizimit të rezervës valutore në disa transhe që, në funksion të një administrimi të kujdesshëm të rrezikut të likuiditetit, i shërbejnë qëllimeve dhe mbartin karakteristika specifike.

Transhi i detyrimeve në valutë përfaqëson investimet në aktive të financuara nga detyrimet në valutë, të përbëra kryesisht nga fondet që derdhin bankat e nivelit të dytë për rezervën e detyrueshme dhe fondet e qeverisë.

Rezerva neto përbëhet nga:

1. transhi i kapitalit qarkullues: shërben për të përmbushur nevojën për likuiditet të krijuar brenda një muaji;
2. transhi i likuiditetit: shërben për të përmbushur nevojën për likuiditet të krijuar brenda një viti;
3. transhi i investimit: përfaqëson gjendjen e mbetur si tepricë dhe shërben për të përmbushur nevojën për likuiditet të krijuar përtej kuadrit kohor të dy transheve të para.

Përzgjedhja e instrumenteve financiare, në të cilat është investuar pjesa kryesore e çdo transhi (portofolet “benchmark”) dhe kohëzgjatja e çdo portofoli benchmark përcaktohet në përputhje me përdorimin e çdo transhi për të përmbushur nevojën për likuiditet të Bankës, si dhe me objektivat e përcaktuar nga Këshilli Mbikëqyrës.

Tabelat e mëposhtme paraqesin maturitetin e mbetur kontraktual të detyrimeve dhe aktiveve financiare të Bankës. Flukset e pritshme të Bankës mbi këto instrumente mund të ndryshojnë nga flukset kontraktuale.



31 dhjetor 2023	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vjet	Mbi 5 vjet	Maturiteti i papërcaktuar	Totali
<b>Aktive financiare</b>								
<b>Aktive joderivative</b>								
Paraqja dhe balancat me bankat	124,898	3,549	267	266	-	-	-	128,980
Aktive të tregtueshme	-	383	428	1,129	11,101	-	-	13,041
Llogari me FMN-në	23,450	-	-	-	-	-	17,593	41,043
Kredi ndaj bankave	37,785	6,970	-	-	-	-	-	44,755
Investime në tituj borxhi	15,974	37,379	52,199	76,864	288,374	15,997	-	486,787
Aktive të tjera (Shënimi 16)	2	2	37	37	2,119	-	-	2,158
<b>Aktive derivative</b>	202,109	48,281	52,894	78,259	299,512	18,116	17,593	716,764
Kontrata forward të kursit të këmbimit	-	-	-	-	-	-	-	-
Kontrata të së ardhmes të normave të interesit	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	202,109	48,281	52,894	78,259	299,512	18,116	17,593	716,764
<b>Detyrimet financiare</b>								
<b>Detyrime joderivative</b>								
Para në qarkullim	-	-	-	-	-	-	407,968	407,968
Detyrime ndaj bankave	213,731	-	10,380	-	-	-	-	224,111
Depozita dhe hua nga palë të treta	1,997	-	-	-	-	-	-	1,997
Detyrime ndaj Geverisë dhe institucioneve shtetërore	104,524	-	-	-	-	-	500	105,024
Detyrime ndaj FMN-së	14,316	-	-	-	-	-	22,840	37,156
Detyrime të tjera	880	-	-	-	-	-	-	880
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	335,448	-	10,380	-	-	-	431,308	777,136
<b>Aktive-Detyrime, mospërpulhja e maturitetit më 31 dhjetor 2023</b>	(133,339)	48,281	42,514	78,259	299,512	18,116	(413,715)	(60,372)



31 dhjetor 2022	Deri në 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 deri në 12 muaj	1 deri në 5 vjet	Mbi 5 vjet	Maturitetet i papërcaktuar	Totali
<b>Aktive financiare</b>								
<b>Aktive joderivative</b>								
Paraja dhe balancat me bankat	90,273	-	-	-	-	-	-	90,273
Aktive të tregtueshme	20	-	969	1,500	11,822	-	-	14,311
Llogari me FMN-në	27,818	-	-	-	-	-	19,879	47,697
Kredi ndaj bankave	40,262	10,826	-	-	-	-	-	51,088
Investime në tituj borxhi	9,167	29,866	65,919	95,381	278,281	6,607	-	485,221
Aktive të tjera (Shënimi 16)	2	-	-	-	27	2,269	-	2,298
<b>Aktive derivivate</b>	<b>167,542</b>	<b>40,692</b>	<b>66,888</b>	<b>96,882</b>	<b>290,130</b>	<b>8,876</b>	<b>19,879</b>	<b>690,888</b>
Kontrata forward të kursit të këmbimit	-	1	-	1	-	-	-	2
Kontrata të së ardhmes të normave të interesit	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>167,542</b>	<b>40,693</b>	<b>66,888</b>	<b>96,882</b>	<b>290,130</b>	<b>8,876</b>	<b>19,879</b>	<b>690,890</b>
<b>Detyrimet financiare</b>								
<b>Detyrime joderivative</b>								
Para në qarkullim	-	-	-	-	-	-	401,129	401,129
Detyrime ndaj bankave	205,252	-	12,440	-	-	-	-	217,692
Depozita dhe hua nga palë të treta	2,007	-	-	-	-	-	-	2,007
Detyrime ndaj Geverisë dhe institucioneve shtetërore	62,991	-	-	-	-	-	500	63,491
Detyrime ndaj FMN-së	16,174	-	-	-	-	-	25,757	41,932
Detyrime të tjera	921	-	-	-	-	-	-	921
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>287,345</b>	<b>-</b>	<b>12,440</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>427,386</b>	<b>727,172</b>
<b>Aktive-Detyrime, mospërpunthja e maturitetit më 31 dhjetor 2022</b>	<b>(119,803)</b>	<b>40,693</b>	<b>54,448</b>	<b>96,882</b>	<b>290,130</b>	<b>8,876</b>	<b>(407,507)</b>	<b>(36,282)</b>



## D. Rreziku i kreditit

Rreziku i kreditit është rreziku i humbjes financiare të Bankës, në qoftë se kundërpartia e një instrumenti financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, dhe lind kryesisht nga huatë dhe paradhëniet e Bankës ndaj bankave të tjera dhe investimet në tituj borxhi. Për qëllime të raportimit mbi administrimin e rrezikut, Banka konsideron dhe konsolidon të gjitha elementet e ekspozimit ndaj rrezikut të kreditit (si rreziku individual i dështimit në shlyerjen e kredisë, rreziku i vendit dhe i sektorit). Rreziku që lidhet me ndryshimet në vlerë të aktiveve të tregtueshme, si rrjedhojë e ndryshimeve në normat e interesit të zbatuara ndaj instrumenteve të borxhit dhe derivativeve, menaxhohet si një komponent i rrezikut të tregut (shih (D) më poshtë).

### (i) Rreziku i shlyerjes

Aktiviteti i administrimit të rezervës valutore mund të shkaktojë rrezik në momentin e shlyerjes së transaksioneve dhe tregtimeve. Rreziku i shlyerjes është rreziku i humbjeve për shkak të dështimit të një njësie ekonomike në përmbushjen e detyrimeve të saj për të dorëzuar mjetet monetare, letrat me vlerë ose aktive të tjera në përputhje me kontratën. Banka e minimizon këtë rrezik përmes zbatimit të praktikave më të mira në mbështetje të njohjes dhe ndjekjes në vazhdimësi të kushteve dhe procedurave të shlyerjes.

### (ii) Rreziku i kujdestarisë

Rreziku i kujdestarisë është rreziku që lidhet me humbje nga mjetet e vendosura në kujdestari në rastin e paafësisë pague, neglizhencës, mashtrimit, keqadministrimit ose praktikave jo të përshtatshme në mirëmbajtjen e portofolit nga kujdestari. Banka e Shqipërisë e minimizon këtë rrezik nëpërmjet përzgjedhjes për ofrimin e shërbimit të kujdestarisë, të institucioneve financiare me reputacion të spikatur, me një minimum aktivesh në ruajtje prej 1,000 miliardë USD.

### (iii) Menaxhimi i rrezikut të kreditit

Tabela e mëposhtme tregon vlerat kontabël të aktiveve financiare që janë të ekspozuara ndaj rrezikut të kreditit më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022.

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
<b>Aktivët</b>		
Paraja dhe balancat me bankat (duke përjashtuar para në arkë- Shënimi 9)	128,956	90,254
Llogari me FMN-në (Shënimi 11)	41,043	47,697
Kredi ndaj bankave (Shënimi 12)	44,755	51,088
Aktive të tregtueshme (Shënimi 13)	13,041	14,313
Investime në tituj borxhi (Shënimi 14)	486,787	485,221
Aktive të tjera (kredi për punonjësit) (Shënimi 16)	2,158	2,298
<b>Totali</b>	<b>716,740</b>	<b>690,871</b>



**Aktivitet e emetuara në valutë të huaj** - Për administrimin e rrezikut të kreditit në lidhje me ekspozimet ndaj rezervës valutore, Këshilli Mbikëqyrës ka përcaktuar kriteret bazë për ekspozimin ndaj palëve dhe në varësi të tipit të investimit, emetuesit, shkallës së vlerësimit të kreditit, likuiditetit të tregut, ku emetimet e qeverive dhe bankave qendrore kanë prioritet. Procesi i vlerësimit dhe monitorimit të cilësisë së kreditit të emetuesve të lejuar për investim bazohet në analizën dhe vlerësimet e përcaktuara nga agjencitë kryesore të vlerësimit të renditjes: Standard&Poor's, Moody's dhe Fitch, si dhe në ndjekjen ditore të ecurisë së disa treguesve të tregut që mbartin informacion mbi cilësinë e kreditit të emetuesve. Në përputhje me kufizimet e vendosura nga Këshilli Mbikëqyrës, Komiteti i Investimit dhe më pas Drejtori i Departamentit të Operacioneve Monetare përcakton kufizime të tjera cilësore dhe/ose sasore mbi ekspozimet e lejuara për emetuesit/institucionet financiare në baza individuale, klasë apo kombinim klasë/instrument. Në varësi të kushteve dhe zhvillimeve në treg, Banka mund të zbatojë kufizime më konservatore për investimin me një emetues/institucion financiar. Aktivitet e emetuara në valutë të huaj, pjesë e rezervës valutore, përfshijnë paratë dhe balancat me bankat (duke përfshirë paratë në arkë), aktivitet e tregtueshme, llogarinë me FMN-në dhe investimet në tituj borxhi në valutë të huaj. Investimi i rezervave valutore kufizohet në investime të emetuara nga qeveri/banka qendrore me vlerësim minimal të kreditit A- (BBB- për qeveri të Eurozonës); agjenci qeveritare, institucione shumëpalëshe dhe entitete publike me vlerësim minimal krediti AA-; si dhe banka dhe institucione të tjera financiare me vlerësim minimal krediti A-.

Vlerësimi i kreditit i referohet një emetuesi/institucioni financiar dhe, në mungesë të tij, përdoret vlerësimi i kreditit të borxhit afatgjatë të institucionit financiar. Për qëllime të realizimit të aktivitetit të administrimit të rezervës valutore dhe të kryerjes së pagesave, Banka mund të operojë përmes llogarive rrjedhëse të hapura me banka të vlerësuara me rrezikun e kreditit minimal BBB.

Në kuadër të administrimit të portofolit të rezervës valutore, si hap i parë, Banka monitoron zhvillimet ekonomike për ekonomitë e vendeve ndaj të cilave ka ekspozime përmes investimit në tituj. Shkalla e monitorimit dhe niveli i të dhënave të menaxhimit ndryshon. Për monedhat kryesore, Banka konsideron se vlerësimet e agjencive të vlerësimit të renditjes dhe informacionet e tjera publike janë reflektuar në çmime dhe në të dhënat për Humbjet e Pritura të Kreditit (HPK). Përveç kësaj, menaxheri i portofolit dhe njëësia e menaxhimit të rrezikut monitorojnë aftësinë paguese të çdo huamarrësi, bazuar në kërkime tregu dhe burime të tjera si pasqyrat financiare të publikuara. Probabilitetet e dështimit (PD) për çdo shkallë vlerësimi përcaktohen në bazë të normave historike afatgjata të ndodhura të dështimit, të përditësuara çdo vit, nga publikimet e agjencive kryesore të vlerësimit të renditjes.

Viti 2023 u shoqërua me shumë pasiguri në ekonominë globale, edhe pse në një shkallë më të ulët krahasuar me vitin 2022. Ngjarje të tilla si konflikti ushtarak midis Rusisë dhe Ukrainës, konflikti në Lindjen e Mesme midis Palestinës dhe Izraelit dhe krizat në sektorin bankar amerikan dhe evropian me falimentimin e Silicon Valley Bank dhe Credit Suisse AG kanë rezultuar në një



paqëndrueshmëri të lartë të normave të interesit në ekonomitë kryesore botërore. Inflacioni pati rënie të ndjeshme gjatë vitit, por ishte ende larg objektivit të bankave qendrore. Kjo ka bërë që shumë banka qendrore të ruajnë në nivele të qëndrueshme normat bazë të interesit gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit për të monitoruar inflacionin, por edhe për të frenuar çdo recesion të mundshëm.

Megjithatë, ndikimi në portofolin shumë cilësor dhe të mirëdiversifikuar të Bankës së Shqipërisë ka qenë neutral, sa i takon humbjeve potenciale nga rreziku i kreditit.

### **Aktivitet në monedhën vendase**

Aktivitet në monedhë vendase përfshijnë huatë ndaj bankave, investimet në tituj borxhi të emetuar nga Qeveria Shqiptare dhe kreditë ndaj punonjësve të përfshira te aktivitetet e tjera financiare.

Banka nuk menaxhon në mënyrë aktive rrezikun e kredisë për aktivitetet e shprehura në monedhën vendase, meqë ato zakonisht krijohen për qëllime të operacioneve të zbatimit të politikës monetare. Për monitorimin e rrezikut të kreditit për këto aktive, Banka përdor analiza dhe informacione të jashtme dhe të zhvilluara nga Banka, të cilat përfshijnë edhe informacionin që Banka ka në dispozicion, për shkak të rolit të saj si rregullator dhe bankë qendrore.

Për huatë ndaj bankave vendase (huatë njëditore dhe marrëveshjet e anasjella të riblerjes), Banka zbut rrezikun e kreditit nëpërmjet kolateralit, i cili përbëhet nga tituj të borxhit të emetuar nga Qeveria Shqiptare. Vlera e kolateralit për çdo transaksion nuk është më e ulët se vlera e kredisë së dhënë plus një diferencë të përcaktuar. Nëse vlera e letrës me vlerë të vendosur si kolateral bie nën një nivel të caktuar, Banka i kërkon bankave tregtare të vendosin kolateral shtesë, bazuar në rivlerësimin e letrave me vlerë.

Modeli i vlerësimit të rrezikut i përdorur nga Banka për vlerësimin e HPK-ve për huatë ndaj bankave vendase bazohet në kritere të ngjashme me ato të përdorura për qëllime mbikëqyrëse, siç janë mjaftueshmëria e kapitalit, rritja e kredisë, likuiditeti dhe përfitueshmëria e kundërpartisë. Shkallët e rrezikut dhe metodologjia i nënshtrohen rishikimeve të rregullta periodike nga Banka. Investimet në tituj borxhi në monedhën vendase përbëhen nga bono thesari të emetuara nga Qeveria Shqiptare, me afat maturimi deri në një vit. Ky portofol krijohet nga Banka për ndërhyrjen në tregun e parasë nëpërmjet transaksioneve me të drejta të plota, me qëllim menaxhimin e strukturës së likuiditetit të sistemit bankar me ndikim të mundshëm në normat afatshkurtra të interesit në këtë treg.

Rreziku i kreditit të portofolit të investimeve në tituj borxhi në monedhën vendase vlerësohet bazuar në të dhënat historike dhe kapacitetin e vlerësuar të Qeverisë Shqiptare për të përmbushur detyrimet kontraktuale afatshkurtra në monedhën vendase. Për kreditë ndaj punonjësve, banka vlerëson HPK-të në bazë të normave historike të humbjeve, të rregulluara për informacionin makroekonomik mbi të ardhmen.



## (iv) Analiza e cilësisë së kreditit

Tabela në vijim paraqet informacion mbi cilësinë e kreditit të aktiveve financiare të matura me kosto të amortizuar dhe investimet e borxhit me VDATGJ. Përveç se kur tregohet në mënyrë specifike, për aktivet financiare, shumat në tabelë përfaqësojnë vlerën kontabël bruto. Shpjegimi i termave "Faza 1", "Faza 2" dhe "Faza 3" është përfshirë në Shënimin 7(A)(vii). Vlerësimet e kreditit tregojnë vlerësimin e dytë më të mirë mes Standard & Poor's, Moody's dhe Fitch.

	2023				2022
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Totali	Totali
<b>Paraja dhe balancat me bankat me kosto të amortizuar</b>					
Vlerësuar AAA	38,947	-	-	38,947	50,946
Vlerësuar nga AA- në AA+	74,833	-	-	74,833	25,616
Vlerësuar nga A- në A+	11,885	-	-	11,885	10,799
Vlerësuar BBB+ dhe më poshtë	-	-	-	-	-
Qeveria Shqiptare B+ *	-	-	-	-	-
BIS Bazel	3,303	-	-	3,303	2,899
	<b>128,968</b>	-	-	<b>128,968</b>	<b>90,260</b>
Provizion për humbjet	(12)	-	-	(12)	(6)
<b>Vlera kontabël</b>	<b>128,956</b>	-	-	<b>128,956</b>	<b>90,254</b>
<b>Llogari me FMN-në **</b>					
Të pavlerësuar	41,043	-	-	41,043	47,697
	<b>41,043</b>	-	-	<b>41,043</b>	<b>47,697</b>
Provizion për humbjet	-	-	-	-	-
<b>Vlera kontabël</b>	<b>41,043</b>	-	-	<b>41,043</b>	<b>47,697</b>
<b>Hua për bankat me kosto të amortizuar</b>					
Shkalla: Rrezik shumë i ulët	-	-	-	-	-
Shkalla: Rrezik i ulët	44,755	-	-	-	51,088
Shkalla: Rrezik mesatar	-	-	-	-	-
Shkalla: Rrezik mesatarisht i lartë	-	-	-	-	-
Shkalla: Rrezik i lartë	-	-	-	-	-
	<b>44,755</b>	-	-	<b>44,755</b>	<b>51,088</b>
Provizion për humbjet	-	-	-	-	-
<b>Vlera kontabël</b>	<b>44,755</b>	-	-	<b>44,755</b>	<b>51,088</b>
<b>Investime në tituj borxhi me VDATGJ</b>					
Vlerësuar AAA	97,236	-	-	97,236	157,025
Vlerësuar nga AA- në AA+	241,969	-	-	241,969	155,931
Vlerësuar nga A- në A+	32,914	-	-	32,914	33,338
Vlerësuar BBB+ dhe më poshtë	17,293	-	-	17,293	8,144
Qeveria Shqiptare (B+)*	68,639	-	-	68,639	74,065
BIS Bazel	28,736	-	-	28,736	56,718
<b>Vlera kontabël – vlera e drejtë</b>	<b>486,787</b>	-	-	<b>486,787</b>	<b>485,221</b>
Provizion për humbjet	(43)	-	-	(43)	(47)
<b>Vlera kontabël – vlera e drejtë</b>	<b>486,787</b>	-	-	<b>486,787</b>	<b>485,221</b>
<b>Aktive të tjera me kosto të amortizuar</b>					
Të pavlerësuar	2,164	-	-	2,164	2,304
	<b>2,164</b>	-	-	<b>2,164</b>	<b>2,304</b>
Provizion për humbjet	(6)	-	-	(6)	(6)
<b>Vlera Kontabël</b>	<b>2,158</b>	-	-	<b>2,158</b>	<b>2,298</b>

\* Qeveria Shqiptare vlerësohet si B+, pozitive, bazuar në vlerësimin e kreditit të Standard & Poor's dhe B1 e qëndrueshme, bazuar në vlerësimin e kreditit të Moody's.

\*\* Vlera e monedhës SDR përcaktohet duke përmblodhur vlerat në dollarin amerikan, bazuar në kurset e këmbimit të tregut, të një shporte monedhash kryesore (dollari amerikan, euro, sterlina, juani kinez dhe jeni japonez). Vlera e monedhës SDR llogaritet çdo ditë dhe shporta e vlerësimit rishikohet dhe përshtatet çdo pesë vjet.





Tabela në vijim paraqet cilësinë e kreditit të letrave me vlerë të tregtueshme të borxhit. Analiza është e bazuar në vlerësimin e dytë më të mirë mes Standard & Poor's, Moody's dhe Fitch.

	2023	2022
<b>Obligacione të agjencive të huaja</b>		
Të vlerësuara AAA	999	776
Të vlerësuara nga AA- në AA+	1,960	2,350
	<b>2,959</b>	<b>3,126</b>
<b>Obligacione të qeverive të huaja dhe institucioneve shumëpalëshe</b>		
Të vlerësuara AAA	447	10,015
Të vlerësuara nga AA- në AA+	9,635	1,170
	<b>10,082</b>	<b>11,185</b>
<b>Totali i titujve të borxhit të tregtueshëm</b>	<b>13,041</b>	<b>14,311</b>

#### (v) Kolaterali i mbajtur dhe zbutja e rrezikut të kreditit

Banka mban kolateral dhe përdor instrumente të tjera për zbutjen e rrezikut të kreditit. Në tabelën në vijim paraqiten llojet kryesore të kolateralit të mbajtura për disa tipa ekspozimesh.

	Shënime	Përqindja e ekspozimit që i nënshtrohet kërkesave të kolateralit		Lloji kryesor i kolateralit të mbajtur
		31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022	
<b>Kredi ndaj bankave</b> Marrëveshjet e anasjella të riblerjes dhe kredi njëditore	12	100	100	Tituj të borxhit të Qeverisë Shqiptare
<b>Aktive të tjera</b> Kredi për punonjësit	16	100	100	Hipotekë ose kontratë garancie

Më 31 dhjetor 2023, Banka ka një ekspozim prej 44,755 milionë lekësh (31 dhjetor 2022: 51,088 milionë lekë) përkundërit bankave tregtare, për të cilin nuk njihet provigjion për humbjet nga krediti për shkak të mbulimit të plotë me kolateral.

#### (vi) Shumat që rrjedhin nga HPK-të

##### (a) Të dhënat, supozimet dhe teknikat e përdorura për përlogaritjen e zhvlerësimit

Shih politikën kontabël në Shënimin 7(A)(vii).

#### Rritje e ndjeshme e rrezikut të kreditit

Për përcaktimin nëse rreziku i mospagimit të vlerës së investuar të një instrumenti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, Banka konsideron informacione të mbështetura dhe të arsyeshme, që janë të disponueshme pa kosto ose përpjekje të panevojshme. Kjo përfshin informacione dhe analiza



sasiore dhe cilësore, bazuar në përvojën historike të Bankës dhe vlerësimet e specialistëve të rrezikut të kreditit, si dhe duke përfshirë informacione mbi të ardhmen.

Qëllimi i vlerësimit është të identifikojë nëse ka ndodhur një rritje e ndjeshme e rrezikut të kreditit për një ekspozim duke krahasuar:

- probabilitetin e dështimit gjatë jetës së mbetur, në datën e raportimit; me
- probabilitetin e dështimit gjatë jetës së mbetur për këtë moment kohor, të vlerësuar në momentin e njohjes fillestare të ekspozimit (korrigjuar sipas nevojës për ndryshimet në pritshmëritë për parapagim).

### **Rreziku i kredisë/renditja**

Për përcaktimin e rrezikut, në njohjen fillestare, Banka i cakton secilit ekspozim në monedhë të huaj si shkallë rreziku, vlerësimin e dytë më të mirë ndërmjet Standard & Poor's, Moody's dhe Fitch për secilën kundërparti.

Në njohjen fillestare, Banka klasifikon çdo ekspozim ndaj bankave në një shkallë të caktuar rreziku krediti, bazuar në një shumëllojshmëri të dhënash që vlerësohen se parashikojnë rrezikun e dështimit dhe në eksperiencën me gjykimet mbi kreditin. Shkallët e rrezikut të kreditit përcaktohen duke përdorur faktorë cilësorë dhe sasiorë që janë tregues të rrezikut të dështimit. Këta faktorë ndryshojnë në varësi të natyrës së ekspozimit dhe të llojit të huamarrësit. Shkallët e rrezikut të kreditit janë përcaktuar dhe kalibruar në mënyrë të tillë që rreziku i dështimit të rritet në mënyrë eksponenciale me rritjen e rrezikut të kreditit. Ekspozimet janë subjekt monitorimi të vazhdueshëm, që mund të rezultojë në lëvizjen e ekspozimit në një shkallë/vlerësim të ndryshëm të rrezikut të kreditit. Monitorimi zakonisht përfshin përdorimin e të dhënave të mëposhtme.

Ekspozime në valutë të huaj	Ekspozime në monedhën vendase	Aktive të tjera
– Të dhëna nga agjencitë e vlerësimit të renditjes, artikujt e shtypit, ndryshimet në vlerësimet e jashtme të kreditit	– Të dhëna të mbledhura nga Banka mbi bankat tregtare dhe treguesit mbikëqyrës	– Historiku i pagesave – kjo përfshin statusin dhe gjendjen financiare të huamarrësit
– Çmimet e obligacioneve të kuotuar për kundërpartinë, aty ku është e mundur	– Ndryshimet ekzistuese dhe të parashikuara në kushtet e biznesit, financiare dhe ekonomike	– Ndryshimet ekzistuese dhe të parashikuara në kushtet financiare dhe ekonomike
– Ndryshimet aktuale dhe të pritshme në mjedisin politik, rregullator dhe teknologjik të kundërpartisë ose në aktivitetet e saj të biznesit	– Matrica të aftësisë paguese	



### ***Përlllogaritja e strukturës kohore të probabilitetit të dështimit "PD"***

Shkallët/vlerësimi i rrezikut të kreditit janë të dhëna parësore në përcaktimin e strukturës kohore të PD-ve për ekspozimet. Banka mbledh informacione mbi performancën dhe dështimet për ekspozimet ndaj rrezikut të kreditit, analizuar sipas kundërpartive dhe shkallëve/vlerësimeve të rrezikut të kreditit.

Banka përdor modele statistikore për të analizuar të dhënat e mbledhura dhe për të kryer vlerësime të PD-së përgjatë jetës së mbetur të ekspozimeve dhe si këto PD priten të ndryshojnë me kohën. Metodologjia e përcaktimit të PD-së për bankat tregtare vendase bazohet në treguesit kryesorë të rrezikut të përdorur për qëllime mbikëqyrëse dhe faktorët e marrë në konsideratë nga ky sistem përfshijnë mjaftueshmërinë e kapitalit, rrezikun e kredisë, likuiditetin dhe përfitueshmërinë e kundërpartisë. Kjo analizë përfshin edhe identifikimin dhe kalibrimin e marrëdhënieve midis ndryshimeve në faktorët kryesorë makroekonomikë të vendit, si dhe qëndrueshmërinë e kapitalit të institucioneve vendase. Treguesit kryesorë makroekonomikë përfshijnë: rritjen e PBB-së, kursin e këmbimit, normat bazë të interesit dhe rritjen e kredisë. PD-të llogariten si mesatare e ponderuar e PD-ve për secilin faktor, ku peshat përcaktohen në bazë të rëndësisë së faktorit.

Për aktivet në valutë të huaj, Banka përdor PD 12-mujore për emetimet qeveritare dhe joqeveritare, bazuar në matricat e tranzicionit, sipas vlerësimeve të publikuara nga S&P, të cilat tregojnë mundësinë e falimentimit përgjatë 12 muajve për emetuesit për çdo kategori përkatëse vlerësimi. Për emetimet qeveritare përdoret një matricë tranzicioni afatgjatë.

Për emetimet joqeveritare, përdoren dy matrica: një matricë tranzicioni afatgjatë e institucioneve financiare (skanari normal), dhe matrica e tranzicionit e një viti krize financiare (skanari alternativ i recensionit), të ponderuara me probabilitetet përkatëse të skenarëve të ndryshëm në të ardhmen.

Për ekspozimet ndaj Qeverisë Shqiptare në monedhën vendase, PD i vlerësuar konsideron maturitetin afatshkurtër të këtyre ekspozimeve, mungesën e dështimeve historike dhe vlerësime të detajuara të aftësisë së Qeverisë Shqiptare për të përmbushur detyrimet e saj monetare kontraktuale në një kohë të shkurtër, duke marrë parasysh edhe treguesit makroekonomikë përgjatë periudhës së vlerësimit.

### ***Përcaktimi nëse rreziku i kreditit është rritur ndjeshëm***

Kriteret për të përcaktuar nëse rreziku i kreditit është rritur ndjeshëm ndryshojnë sipas portofoleve dhe përfshijnë ndryshime sasiore në PD dhe faktorë cilësorë, përfshirë një kriter të bazuar në ditëvonesë.

Rreziku i kreditit i një ekspozimi të caktuar në valutë konsiderohet se është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare nëse:

- vlerësimi i kreditit nga të tre agjencitë e vlerësimit të renditjes (Standard & Poor's, Moody's dhe Fitch) bie nën BBB- (ose ekuivalente me të); ose



- vlerësimi i kreditit nga njëra prej agjencive më sipër bie në BB-; ose
- ka një vonesë në shlyerjen e një detyrimi ndaj Bankës prej 30 ose më shumë ditësh. Në këtë rast, rreziku i kreditit do të konsiderohet që është rritur ndjeshëm për të gjitha ekspozimet ndaj atij emetuesi.

Rreziku i kredisë për një ekspozim të caktuar në monedhën vendase ndaj bankave tregtare konsiderohet të jetë rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, nëse plotësohet njëri nga kriteret më poshtë:

- banka merr kredi ELA (Emergency Liquidity Assistance) dhe PD arrin nivelin mbi 30%; ose
- niveli i treguesit PD është më i madh se 40% në periudhën e raportimit; ose
- PD është më e madhe se 25% dhe është rritur me më shumë se 5 pikë përqindjeje në periudhën e raportimit krahasuar me periudhën e njohjes fillestare; ose
- ka një vonesë në shlyerjen e një detyrimi (duke përfshirë ELA) ndaj Bankës prej 30 ose më shumë ditësh. Në këtë rast, rreziku i kreditit do të konsiderohet që është rritur ndjeshëm për të gjitha ekspozimet ndaj asaj banke tregtare.

Ditëvonesat përcaktohen duke konsideruar numrin e ditëve që nga data më e hershme e afatit për pagesë, në të cilën nuk është kryer pagesa e plotë. Datat e afatit për pagesë përcaktohen pa marrë në konsideratë ndonjë periudhë faljeje që mund të jetë akorduar për huamarrësin.

Rreziku i kreditit i një ekspozimi ndaj Qeverisë Shqiptare në Lek konsiderohet se është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, nëse ka një vonesë në shlyerjen e detyrimit ndaj Bankës prej 30 ose më shumë ditësh.

Banka monitoron efektivitetin e kriterëve të përdorura për të identifikuar rritjen e ndjeshme të rrezikut të kredisë, duke kryer rishikime periodike për të konfirmuar që kriteret janë në gjendje të identifikojnë rritje të ndjeshme në rrezikun e kreditit përpara se një ekspozim të dështojë.

### ***Përkufizimi i dështimit***

Banka konsideron që një aktiv financiar ka dështuar, kur:

- huamarrësi nuk ka gjasa t'i paguajë detyrimet e tij të plota ndaj Bankës për kredinë, pa qenë nevoja për veprime nga Banka, të tilla si realizimi i aktiveve të lëna si kolateral (nëse ka ndonjë të tillë); ose
- huamarrësi është në vonesë prej më shumë se 90 ditësh për ndonjë ekspozim material kredie ndaj Bankës.

Në vlerësimin nëse një huamarrës është në dështim, Banka konsideron tregues:

- cilësorë – p.sh. shkeljet e kushteve financiare të kontratës;
- sasiorë – p.sh. vonesat në pagesë dhe mospagimi i ndonjë detyrimi tjetër nga i njëjti huamarrës; dhe
- bazuar në të dhënat e zhvilluara së brendshmi dhe të marra nga burime



të jashtme, p.sh. matricën e tranzicionit të PD-së 12 mujore në raportim sipas raportit më të fundit të disponueshëm dhe matricës 12 mujore të tranzicionit të PD-së në lidhje me krizën më të fundit financiare të marrë nga S&P, e ponderuar sipas një probabiliteti të caktuar, dhe;

- LGD e specifikuar për borxhin senior të pakolateralizuar të emetuesve sovranë, të korporatave dhe bankave, depozitat dhe llogaritë rrjedhëse në bankat qendrore të marra nga Moody's.

Të dhënat e përdorura në vlerësimin nëse një instrument financiar ka dështuar dhe rëndësia e tyre, mund të ndryshojnë me kalimin e kohës, për të pasqyruar ndryshimet në rrethana.

### ***Përfshirja e informacionit mbi të ardhmen***

Banka përfshin informacion mbi të ardhmen si në vlerësimet e saj nëse rreziku i kreditit të një instrumenti është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare ashtu edhe në matjen e HPK-ve.

Për ekspozimet në monedhën vendase, Banka formulon një "skenar bazë" të parashikimeve të ardhshme të treguesve të rëndësishëm ekonomikë (rritja e PBB-së, kurset e këmbimit, normat referuese të interesit dhe rritja e kredisë), si dhe një gamë përfaqësuese të skenarëve të tjerë të mundshëm të parashikuar "skanari i moderuar", duke marrë parasysh probabilitetet relative të secilit skenar, duke bërë krahasim të rezultateve të stres-testeve të mëparshme me treguesit financiarë të agjentëve ekonomikë, gjatë periudhës së referencës. Skanari bazë paraqet parashikimet më të mundshme dhe është në linjë me informacionin e përdorur nga Banka për qëllime të tjera, si planifikimi strategjik dhe parashikimet. Skanarët e tjerë "skanari i moderuar" paraqesin rezultate më pesimiste. Në mënyrë periodike, Banka kryen "stress testing" të goditjeve më ekstreme për të kalibruar përcaktimin e saj të këtyre skenarëve të tjerë përfaqësues.

Për emetimet joqeveritare në monedhë të huaj, informacioni mbi të ardhmen përfshihet në vlerësimin e PD-së, pasi probabilitetet për skenarin normal dhe skenarin alternativ llogariten në bazë të probabilitetit të rënies në recesion të ekonomive të mëdha (si një nga treguesit kryesorë të rritjes së PD-së për emetuesit joqeveritarë), duke zbatuar edhe faktorë shtesë cilësorë. Për emetimet qeveritare në valutë të huaj, vlerat e ardhshme të treguesve ekonomikë përfshihen në përcaktimin e renditjes dhe për pasojë, në nivelin e PD-së të reflektuar në matricat e tranzicionit të publikuara nga agjencitë e renditjes. Këta tregues rishikohen periodikisht dhe në raste ndryshimesh të rëndësishme në treg nga agjencitë e vlerësimit të renditjes.

### ***Aktivet financiare të modifikuara***

Kushtet kontraktuale të një aktivi financiar mund të modifikohen për arsye të ndryshme, duke përfshirë ndryshimin e kushteve të tregut dhe faktorë të tjerë që nuk lidhen me ndonjë përkeqësim aktual ose potencial të cilësisë së kreditit të kundërpasitë. Një aktiv ekzistues, kushtet e të cilit janë modifikuar, mund



të çregjistrohet dhe aktivi i rinegociuar njihet si aktiv i ri me vlerë të drejtë, në përputhje me politikën kontabël të përcaktuar në Shënimin 7(A)(iv).

Kur kushtet e një aktivi financiar modifikohen dhe modifikimi nuk rezulton në çregjistrim, përcaktimi nëse rreziku i kredisë së aktivit është rritur ndjeshëm reflekton krahasimin e:

- PD-së përgjatë jetës së mbetur në datën e raportimit bazuar në kushtet e modifikuara; me
- PD-në përgjatë jetës së mbetur vlerësuar në bazë të të dhënave në njohjen fillestare dhe kushteve kontraktuale fillestare.

### **Matja e HPK-ve**

Të dhënat kryesore për matjen e HPK-ve janë strukturat kohore të parametrave të mëposhtëm:

- probabiliteti i dështimit (PD),
- humbja nga dështimi (HND),
- ekspozimi në rast dështimi (END).

Këto parametra janë nxjerrë nga modelet statistikore të zhvilluara së brendshmi, modele statistikore të jashtme të njohura globalisht dhe nga të dhëna të tjera historike. Ato janë korrigjuar për të pasqyruar informacionin mbi të ardhmen, siç është përshkruar më sipër.

Vlerësimet e PD-ve janë vlerësime në një datë të caktuar, të cilat llogariten bazuar në modelet statistikore të vlerësimit dhe përcaktohen duke përdorur teknika vlerësimi të përshtatura sipas kategorive të ndryshme të kundërpartive dhe ekspozimeve. Këto modele statistikore bazohen në të dhëna të brendshme dhe të jashtme, duke përfshirë faktorë sasiorë dhe cilësorë. Të dhënat nga matricat e tranzicionit përdoren për të llogaritur PD-të për kundërpartitë e huaja. Nëse një kundërparti ose ekspozim lëviz midis klasave të vlerësimit, atëherë kjo sjell një ndryshim në vlerësimin e PD-së përkatëse.

HND-ja është shkalla e humbjes së mundshme në rast dështimi. Banka vlerëson parametrat e HND-së bazuar në historinë e normave të rikuperimit ose parametra të llogaritur nga agjencitë e renditjes dhe institucionet rregullatore si BIS Bazel të pretendimeve përkundrejt palëve të dështuara. Modelet e HND-së do të konsiderojnë strukturën, kolateralin, prioritetin e pretendimit, industrinë ku bën pjesë kundërpartia dhe kostot e rikuperimit të çdo kolaterali që është i lidhur me aktivin financiar.

END-ja përfaqëson ekspozimin e pritshëm në rast dështimi. Banka llogarit END-në duke u nisur nga ekspozimi aktual ndaj një kundërpartie, si dhe duke konsideruar ndryshimet e mundshme të vlerës aktuale që lejohen sipas kontratës, duke përfshirë amortizimin. END-ja për një aktiv financiar është vlera



e tij kontabël bruto në momentin e dështimit. Vlerësimet e END-së llogariten mbi bazën e flukseve të skontuara monetare, duke përdorur normën efektive të interesit si normë skontimi.

Siç është përshkruar më sipër dhe duke përdorur PD 12-mujore për aktivet financiare për të cilat rreziku i kreditit nuk është rritur ndjeshëm, Banka mat HPK-të, duke marrë parasysh rrezikun e dështimit përgjatë periudhës maksimale kontraktuale gjatë të cilës është e ekspozuar ndaj rrezikut të kreditit, edhe nëse, për qëllime të menaxhimit të rrezikut, Banka konsideron një periudhë më të gjatë. Periudha maksimale kontraktuale zgjat deri në datën në të cilën Banka ka të drejtë të kërkojë kthimin e një parapagimi. Kur modelimi i një parametri kryhet në baza kolektive, instrumentet financiare grupohen në bazë të karakteristikave të përbashkëta të rrezikut të cilat përfshijnë:

- llojin e instrumentit;
- vlerësimet e rrezikut të kreditit;
- llojin e kolateralit;
- datën e njohjes fillestare;
- afatin e mbetur deri në maturim;
- industrinë; dhe
- vendndodhjen gjeografike të huamarrësit.

Grupimet janë subjekt rishikimi të rregullt, për të siguruar që ekspozimet brenda një grupi të caktuar të mbeten homogjene.


Për portfolet për të cilat ka të dhëna historike të kufizuara, Banka përdor informacion të jashtëm si referencë për të plotësuar të dhënat e disponueshme së brendshmi. Për portfolet në valutë bazuar në politikën e investimeve të bankës janë përdorur vlerësimet e tre agjencive kryesore të vlerësimit si një input kyç për vlerësimin e portfoleve.

Ekspozimet për të cilat informacioni i jashtëm i përdorur si referencë përbën një të dhënë të rëndësishme në matjen e HPK-ve, përfshijnë aktive financiare në valutë të huaj si më poshtë:

	Ekspozimi	Referencat e jashtme të përdorura	
		PD	HND
Paraja dhe balancat me bankat (llogarit dhe depozitat)	128,381	Vlerësimi i dytë më i mirë (nga: S&P, Moody's dhe Fitch)	Studimet e rikuperimeve nga Moody's
Investimet në tituj të borxhit në monedhë të huaj	418,148	Vlerësimi i dytë më i mirë (nga: S&P, Moody's dhe Fitch)	Studimet e rikuperimeve nga Moody's

## (b) Provigjioni për humbjet

Tabela e mëposhtme paraqet barazimin midis gjendjes në fillim dhe në fund të provigjionit për humbje sipas klasës së instrumentit financiar. Shpjegimi i



termave "Faza 1", "Faza 2" dhe "Faza 3" dhe aktiv me kredit të zhvlerësuar është përfshirë në Shënimin 7(A)(vii).

	2023				2022
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Totali	Totali
<b>Paraaja dhe balancat me bankat</b>					
Balanca më 1 janar	6	-	-	6	15
Rimatja neto e fondit të humbjeve	6	-	-	6	(9)
<b>Balanca në fund të periudhës</b>	<b>12</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>12</b>	<b>6</b>
<b>Aktive të tjera me kosto të amortizuar</b>					
Balanca në 1 janar	6	-	-	6	6
Rivlerësimi neto i provigjionit për humbje		-	-		-
<b>Balanca në fund të periudhës</b>	<b>6</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>6</b>	<b>6</b>
<b>Tituj të borxhit me VDATGJ</b>					
Balanca më 1 janar	47	-	-	47	22
Rimatja neto e fondit të humbjeve	(4)	-	-	(4)	25
<b>Balanca në fund të periudhës</b>	<b>43</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>43</b>	<b>47</b>
<b>Total</b>					
Balanca më 1 janar	59	-	-	59	43
Rimatja neto e fondit të humbjeve	2	-	-	2	16
<b>Balanca në fund të periudhës</b>	<b>61</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>61</b>	<b>59</b>

Për letrat me vlerë të investimit të borxhit të matura në VDATGJ, provigjioni për HPK nuk e zvogëlon vlerën kontabël në pozicionin e pasqyrave financiare, e cila mbetet me vlerën e drejtë.

### (c) Aktivet financiare me kredit të zhvlerësuar

Për më tepër detaje shih politikën e kontabilitetit në Shënimin 7(A)(vii).  
Më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022, Banka nuk kishte aktive financiare me kredit të zhvlerësuar.

### (vii) Përqendrimi i rrezikut të kredisë

Banka monitoron përqendrimet e rrezikut të kreditit sipas vendndodhjes gjeografike dhe sipas llojit të kundërpartisë. Një analizë e përqendrimit të rrezikut të kreditit është paraqitur më poshtë. Përqendrimi sipas vendndodhjes për investimet në tituj borxhi bazohet në vendin e emetuesit të titullit. Përqendrimi sipas llojit të kundërpartisë bazohet në vendin e klientit.

Një analizë e përqendrimit të rrezikut të kreditit sipas pozicionit gjeografik paraqitet si më poshtë:





31 dhjetor 2023	Gjermani	Francë	Shtete të tjera të BE-së	Zvicër	SHBA	Shqipëri	Të tjera	Totali
Llogari dhe depozita me institucionet financiare (Shënimi 9)	33,108	31,988	1,173	8,565	8,439	-	45,683	128,956
Aktive të tregtueshme	846	887	1,182	57	9,186	-	883	13,041
Llogari me FMN-në	-	-	-	-	-	-	41,043	41,043
Kredi ndaj bankave	-	-	-	-	-	44,755	-	44,755
Investime në tituj	53,243	85,673	155,525	28,736	69,120	68,639	25,851	486,787
Aktive të tjera (Shënimi 16)	-	-	-	-	-	2,158	-	2,158
<b>Totali</b>	<b>87,197</b>	<b>118,548</b>	<b>157,880</b>	<b>37,358</b>	<b>86,745</b>	<b>115,552</b>	<b>113,460</b>	<b>716,740</b>

31 dhjetor 2022	Gjermani	Francë	Shtete të tjera të BE-së	Zvicër	SHBA	Shqipëri	Të tjera	Totali
Llogari dhe depozita me institucionet financiare (Shënimi 9)	40,297	9,064	55	2,899	10,647	-	27,292	90,254
Aktive të tregtueshme	972	1,007	1,361	73	9,428	2	1,470	14,313
Llogari me FMN-në	-	-	-	-	-	-	47,697	47,697
Kredi ndaj bankave	-	-	-	-	-	51,088	-	51,088
Investime në tituj	71,262	57,188	140,861	56,718	56,309	74,064	28,819	485,221
Aktive të tjera (Shënimi 16)	-	-	-	-	-	2,298	-	2,298
<b>Totali</b>	<b>112,531</b>	<b>67,259</b>	<b>142,277</b>	<b>59,690</b>	<b>76,384</b>	<b>127,452</b>	<b>105,278</b>	<b>690,871</b>

Një analizë e përqendrimit të aktiveve financiare sipas llojit të kundërpartisë paraqitet si më poshtë:

31 dhjetor 2023	Llogari dhe depozita me institucionet financiare	Aktive të tregtueshme	Llogari me FMN-në	Kredi ndaj bankave	Investime në tituj	Aktive të tjera	Totali
Banka Qendrore	85,421	9,046	41,043	-	-	-	135,510
BIS Bazel	3,302	-	-	-	28,736	-	32,038
Qeveritë e huaja dhe institucionet shumëpalëshe	-	677	-	-	322,393	-	323,070
Agjencitë e huaja	-	2,885	-	-	34,937	-	37,822
Bankat tregtare	40,233	433	-	44,755	32,082	-	117,503
Qeveria Shqiptare	-	-	-	-	68,639	-	68,639
Të tjera	-	-	-	-	-	2,158	2,158
<b>Totali</b>	<b>128,956</b>	<b>13,041</b>	<b>41,043</b>	<b>44,755</b>	<b>486,787</b>	<b>2,158</b>	<b>716,740</b>

31 dhjetor 2022	Llogari dhe depozita me institucionet financiare	Aktive të tregtueshme	Llogari me FMN-në	Kredi ndaj bankave	Investime në tituj	Aktive të tjera	Totali
Banka Qendrore	70,846	9,461	47,697	-	-	-	128,004
BIS Bazel	2,898	-	-	-	56,718	-	59,616
Qeveritë e huaja dhe institucionet shumëpalëshe	-	667	-	-	280,893	-	281,560
Agjencitë e huaja	-	3,358	-	-	34,502	-	37,860
Bankat tregtare	16,510	825	-	51,088	39,044	-	107,467
Qeveria Shqiptare	-	2	-	-	74,064	-	74,066
Të tjera	-	-	-	-	-	2,298	2,298
<b>Total</b>	<b>90,254</b>	<b>14,313</b>	<b>47,697</b>	<b>51,088</b>	<b>485,221</b>	<b>2,298</b>	<b>690,871</b>

## E. Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut, si normat e interesit, çmimet e kapitalit, kursi i këmbimit dhe normat e kreditit (që nuk lidhen me ndryshimet në cilësinë e kredihënësit apo emetuesit) do të ndikojnë në



të ardhurat e Bankës apo vlerën e instrumenteve financiare të saj. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimin ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin nga rreziku.

Elementet kryesore të rrezikut të çmimit që ndikojnë Bankën janë:

- rreziku i normave të interesit i lidhur me ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve financiare për shkak të ndryshimit të normave të interesit; dhe
- rreziku i kursit të këmbimit i lidhur me ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve financiare për shkak të ndryshimit të kursit të këmbimit.

Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të kursit të këmbimit monitorohet mbi baza të vazhdueshme. Aktivitetet dhe detyrimet financiare në monedhë të huaj paraqiten në shënimet e pasqyrave financiare.

Për qëllime të administrimit të rezervës valutore, funksion i cili realizohet nga Departamenti i Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës ka përcaktuar kritere për përbërjen sipas monedhave të rezervës valutore, në përputhje me objektivat e mbajtjes së rezervave. Kjo shërben si referencë për t'u përdorur në administrimin e rrezikut të kursit të këmbimit. Si rrjedhojë, Banka është pasive në administrimin e rrezikut të kursit të këmbimit. Komiteti i Investimit përcakton disa kufizime për përbërjen sipas monedhave të transheve të rezervës valutore. Kufizimet monitorohen nga Departamenti i Operacioneve Monetare, me qëllim kryerjen e veprimeve të nevojshme balancuese për ruajtjen e peshave të shtuara për përbërjen sipas monedhave.

### **(i) Rreziku i normave të interesit**

Operacionet e Bankës janë të ekspozuara ndaj rrezikut të normave të interesit, i cili ndikon në çmimet e aktiveve interesprurëse (duke përfshirë investimet) dhe të detyrimeve që mbartin interes.

Departamenti i Operacioneve Monetare të Bankës monitoron rrezikun e normave të interesit. Banka i zbut këto rreziqe duke mbajtur një tepriçë të konsiderueshme të aktiveve që mbartin interes në raport me detyrimet. Banka zotëron një portofol të aktiveve dhe detyrimeve financiare që mbartin interes, në mënyrë të tillë që e ardhura neto nga interesi të jetë në mënyrë të konsiderueshme më e lartë se nevojat operacionale, që të minimizojë efektin potencial të kundërt të luhatjeve ndaj normave të interesit. Normat e interesit të zbatuara ndaj aktiveve dhe detyrimeve financiare paraqiten në shënimet e pasqyrave financiare.

Administrimi i rrezikut të normës së interesit, për qëllime të administrimit të rezervës valutore, përmban si aktivitet bazë të tij procesin e përzgjedhjes së një portofoli/kohëzgjatjeje benchmark për secilin nga tregjet (monedhat) në të



cilat mbahet rezerva valutore. Përzgjedhja e realizuar rishikohet periodikisht të paktën një herë në vit ose kurdoherë që ndryshimet e kushteve të tregut kërkojnë një rivlerësim. Krahas përcaktimit të portofoleve benchmark, Komiteti i Investimit, në përputhje me kufizimin e dhënë nga Këshilli Mbikëqyrës, përcakton dhe kufizimet në nivel transhi për faktorët e rrezikut shtesë që mund të ndërmerren nga specialistët e administrimit të portofolit gjatë administrimit aktiv. Kufizimet në nivel portofoli janë përcaktuar nga Drejtori i Departamentit të Operacioneve Monetare.

Treguesit kryesorë të përdorur për të matur nivelin e rrezikut të normave të interesit për portfolet individuale dhe për rezervën valutore janë treguesi i kohëzgjatjes dhe VaR (Vlera në Rrezik).

- Kohëzgjatja mat ndjeshmërinë e çmimit të letrave me vlerë të borxhit me të ardhura fikse kundrejt luhatjes së normave të interesit në treg.
- Treguesi VaR përkufizohet si humbja maksimale e një portofoli bazuar në ekspozimin që ka ndaj faktorëve të rrezikut, me një interval besimi të caktuar dhe për një horizont të caktuar kohor.

Për qëllime të administrimit të rezervës, VaR i përlogaritur përfshin vetëm ekspozimin ndaj faktorit të rrezikut të ndryshimit të normave të interesit për gjithë pozicionet, përfshirë instrumentet benchmark dhe instrumentet jo-benchmark.


Për instrumentet benchmark shfrytëzohen të dhënat për ndryshimet e normave të interesit të emetimeve të thesarit për çdo monedhë, ndërsa për instrumentet jo-benchmark shfrytëzohen të dhënat për emetimet me vlerësim AA, duke qenë se ky vlerësim përbën peshën kryesore të instrumenteve jo-benchmark në portfolet e rezervës.

Më poshtë paraqitet një përmbledhje e VaR (95%) të pozicionit të portofolit të Bankës më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022.

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
VaR (95%) në milionë lekë	(14,191)	(10,592)

Për më tepër, një metodë e rëndësishme për matjen e rrezikut të tregut është analiza e ndjeshmërisë së vlerave të rezervës nga ndryshime hipotetike të faktorëve të tregut. Të dhënat e përdorura në përlogaritjet e analizës së ndjeshmërisë përfshijnë kohëzgjatjen e portofolit dhe peshën e çdo monedhe. Treguesi i kohëzgjatjes së portofolit tregon shkallën e ndryshimit të vlerës së tregut të portofolit, duke supozuar një zhvendosje paralele të kurbës së normave bazë të interesit për të gjitha instrumentet në përmbajtje të portofolit.

Duke supozuar një rritje/(ulje) të menjëhershme paralele të normave të interesit me 50 pikë bazë dhe 100 pikë bazë dhe një korrelacion të barabartë me 1 midis kurbave, si dhe bazuar në kohëzgjatjen e rezervës valutore agregate,



më poshtë paraqiten llogaritjet për humbjen /fitimin në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse nga secili skenar.

Efekti i vlerësuar në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në milionë lekë	2023		2022	
	100 bp	50 bp	100 bp	50 bp
Rritje	(9,828)	(4,914)	(7,859)	(3,930)
Zvogëlim	9,828	4,914	7,859	3,930

Aktivitet dhe detyrimet me norma të ndryshueshme interesi mbartin rrezikun e ndryshimit të bazës që shërben për të përcaktuar normat e interesit.

Pozicioni i ndjeshmërisë së Bankës ndaj normës së interesit, ndarë sipas rëqimit kontraktual, jepet në tabelën pasardhëse, e cila përfshin instrumentet financiare me vlerë të mbartur të klasifikuar sipas rëqimit kontraktual ose datës së maturitetit.

31 dhjetor 2023	Totali	Norma interesi të ndryshueshme	Instrumente me norma fikse interesi			Instrumente që nuk mbartin interes
			Deri në 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Mbi 3 muaj	
<b>Aktive interesprurëse</b>						
Paraja dhe balancat me bankat	128,979	114,349	9,950	3,549	533	598
Aktive të tregtueshme	13,041	241	-	383	12,417	-
Llogari me FMN-në	41,043	23,450	-	-	-	17,593
Kredi ndaj bankave	44,755	-	37,785	6,970	-	-
Investime në tituj	486,787	-	15,973	37,380	433,434	-
Aktive të tjera (Shënimi 16)	2,159	-	2	-	2,157	-
<b>Totali</b>	<b>716,764</b>	<b>138,040</b>	<b>63,710</b>	<b>48,282</b>	<b>448,541</b>	<b>18,191</b>
<b>Detyrime që mbartin interes</b>						
Para në qarkullim	407,968	-	-	-	-	407,968
Detyrime ndaj bankave	224,111	-	213,731	-	10,380	-
Depozita dhe hua nga palë të treta	1,997	-	1,997	-	-	-
Detyrime ndaj Qeverisë dhe institucioneve shtetërore	105,024	500	-	-	-	104,524
Detyrime ndaj FMN-së	37,156	22,840	-	-	-	14,316
Detyrime të tjera	880	-	-	-	-	880
<b>Totali</b>	<b>777,136</b>	<b>23,340</b>	<b>215,728</b>	<b>-</b>	<b>10,380</b>	<b>527,688</b>
<b>Hendeku i instrumenteve që mbartin interes</b>	<b>(60,372)</b>	<b>114,700</b>	<b>(152,018)</b>	<b>48,282</b>	<b>438,161</b>	<b>(509,497)</b>



31 dhjetor 2022	Totali	Norma interesi të ndryshueshme	Instrumente me norma fikse interesi			Instrumente që nuk mbartin interes
			Deri në 1 muaj	Nga 1 deri në 3 muaj	Mbi 3 muaj	
<b>Aktive interesprurëse</b>						
Para dhe balancat me bankat	90,273	79,636	10,054	-	-	583
Aktive të tregtueshme	14,313	-	20	-	14,292	1
Llogari me FMN-në	47,697	27,819	-	-	-	19,879
Kredi ndaj bankave	51,088	-	40,262	10,826	-	-
Investime në tituj	485,221	-	9,167	29,866	446,188	-
Aktive të tjera (Shënimi 16)	2,298	-	2	-	2,296	-
<b>Totali</b>	<b>690,890</b>	<b>107,454</b>	<b>59,505</b>	<b>40,692</b>	<b>462,776</b>	<b>20,463</b>
<b>Detyrime që mbartin interes</b>						
Para në qarkullim	401,129	-	-	-	-	401,129
Detyrime ndaj bankave	217,692	-	205,252	-	12,440	-
Depozita dhe hua nga palë të treta	2,007	-	2,007	-	-	-
Detyrime ndaj Qeverisë dhe institucioneve shtetërore	63,491	500	-	-	-	62,991
Detyrime ndaj FMN-së	41,932	25,757	-	-	-	16,175
Detyrime të tjera	921	-	-	-	-	921
<b>Totali</b>	<b>727,172</b>	<b>26,257</b>	<b>207,259</b>	<b>-</b>	<b>12,440</b>	<b>481,216</b>
<b>Hendeku i instrumenteve që mbartin interes</b>	<b>(36,282)</b>	<b>81,197</b>	<b>(147,754)</b>	<b>40,692</b>	<b>450,336</b>	<b>(460,753)</b>

### Kontratat e ardhshme

Kontratat e ardhshme janë kontrata standarde për blerjen ose shitjen e aktiveve financiare ose jofinanciare, në një datë të caktuar dhe me një çmim tregu të paracaktuar. Për të minimizuar rrezikun e kreditit, në varësi të llojit të instrumentit, investitorët duhet të lënë një marzh pranë zyrës së "clearing"-ut, si garanci financiare. Ky marzh ose bono performance vlerësohet çdo ditë sipas tregut, që do të thotë se çdo ndryshim në vlerë tregohet në llogarinë e investitorit në fund të çdo dite tregtimi deri në skadimin e kontratës.


Vlera e drejtë neto e kontratave të së ardhmes më 31 dhjetor 2023 është 0 milionë lekë (2022: vlera e drejtë neto ishte 0 milionë lekë) (shih Shënimin 13).

Vlera nominale e këtyre kontratave më 31 dhjetor 2023 paraqitet:

- kontratat në blerje janë në vlerën 0 milionë lekë (2022: 0 milionë lekë); dhe
- kontratat në shitje janë në vlerën 0 milionë lekë (2022: 0 milionë lekë).

### (ii) Rreziku i kurseve të këmbimit

Rreziku i kursit të këmbimit vjen si pasojë e diferencës në strukturën e monedhave midis aktiveve dhe detyrimeve. Nga një këndvështrim kontabël, Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të këmbimit, për shkak të realizimit të funksioneve të saj si bankë qendrore.



Ky rrezik mund të ndikojë madhësinë e kapitalit të saj. Për të administruar këtë lloj ekspozimi ndër vite janë ndërmarrë masa për të rritur kapitalin, hyrjen e fondeve dhe, në raste të veçanta, atëherë kur balanca e rezervës së rivlerësimit është negative, janë emetuar instrumente borxhi nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, sikurse parashikohet në ligjin “Për Bankën e Shqipërisë” (Shënimi 7(N), 14 dhe 22). Krijimi i rezervave speciale nga fitimi për t’u shpërndarë është një masë që Banka mund të marrë për të ruajtur kapitalin e saj. Megjithatë, Banka reflekton vetëm luhatjet e kursit të këmbimit dhe kjo për shkak të regjimit të lirë të kursit të këmbimit që ajo ndjek. Banka nuk parashikon të zvogëlojë rezervën e saj valutore dhe si rrjedhojë të materializojë këto humbje. Në rastet kur Banka do të detyrohet të shesë valutë në treg (në kushtet kur tregu i valutës nuk do të funksionojë normalisht), do ta bëjë këtë në kushtet kur do të kemi një dobësim të shpejtë të monedhës Lek. Kjo lëvizje do të ndikojë indirekt në uljen e tepricës së llogarisë së rivlerësimit si dhe në rritjen e kursit të këmbimit me të cilën do të shitet rezerva.

### **Kontrata Forward**

Derivatët e tregtueshëm përfshijnë kontrata të ardhshme të kurseve të këmbimit midis Bankës dhe Qeverisë Shqiptare. Këto instrumente zakonisht nuk mbyllen përpara datës së maturimit.

Vlera e drejtë e kontratave të ardhshme të kurseve të këmbimit më 31 dhjetor 2023 është 0 milionë lekë (2022: 2 milionë lekë) (shih Shënimin 13).

Kurset kryesore të këmbimit të përdorura janë si më poshtë.

Në Lekë	Kursi mesatar		Kursi fiks në fund të vitit	
	2023	2022	2023	2022
Dollari Amerikan (USD)	100.64	113.04	93.94	107.05
Monedha e Bashkimit Evropian (EUR)	108.8	118.98	103.88	114.23
Paundi Britanik (GBP)	125.01	139.6	119.47	128.92
Të drejtat speciale të tërheqjes (SDR)	134.26	151.2	126.04	142.47
Yeni Japonez (JPY)	0.72	0.86	0.66	0.81
Juani Kinez (offshore) (CNH)	14.22	19.79	13.19	15.46

### **Analiza e ndjeshmërisë**

Një forcim (dobësim) i arsyeshëm i EUR, USD, GBP ose valutave të tjera me 10% ndaj Lekut më 31 dhjetor 2023, do të kishte ndikuar në matjen e instrumenteve financiare të shprehura në një monedhë të huaj, si dhe mbi kapitalin dhe fitimin ose humbjen për shumat e treguara më poshtë. Kjo analizë supozon se gjithë treguesit e tjerë, në veçanti normat e interesit, mbeten konstantë dhe injoron çdo ndikim të shitjeve dhe blerjeve të parashikuara.



Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të kurseve të këmbimit më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 është si më poshtë.

31 dhjetor 2023	ALL	USD	EUR	GBP	SDR	Të tjera	Totali
<b>Aktive</b>							
Paraja dhe balancat me bankat	-	9,480	106,524	498	-	12,454	128,956
Aktive të tregtueshme	-	13,041	-	-	-	-	13,041
Llogari me FMN-në	14,316	-	-	-	26,727	-	41,043
Kredi ndaj bankave	44,755	-	-	-	-	-	44,755
Investime në tituj	68,639	80,337	308,828	11,633	-	17,350	486,787
Aktive të tjera	2,158	-	-	-	-	-	2,158
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>129,868</b>	<b>102,858</b>	<b>415,352</b>	<b>12,131</b>	<b>26,727</b>	<b>29,804</b>	<b>716,740</b>
<b>Detyrime</b>							
Para në qarkullim	407,968	-	-	-	-	-	407,968
Detyrime ndaj bankave	71,126	15,901	137,084	-	-	-	224,111
Depozita dhe hua nga palë të treta	1,990	-	7	-	-	-	1,997
Detyrime ndaj Qeverisë dhe institucioneve shtetërore	24,274	125	80,542	-	83	-	105,024
Detyrime ndaj FMN-së	-	-	-	-	37,156	-	37,156
Detyrime të tjera	140	507	233	-	-	-	880
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>505,498</b>	<b>16,533</b>	<b>217,866</b>	<b>-</b>	<b>37,239</b>	<b>-</b>	<b>777,136</b>
<b>Ekspozimi neto në pasqyrën e pozicionit</b>	<b>(375,630)</b>	<b>86,325</b>	<b>197,486</b>	<b>12,131</b>	<b>(10,512)</b>	<b>29,804</b>	<b>(60,396)</b>
<b>Analiza e ndjeshmërisë</b>							
Efeki i Fitimit/(humbjes: Forcim (10%))	-	8,633	19,749	1,213	(1,051)	2,980	-
Dobësim (10%)	-	(8,633)	(19,749)	(1,213)	1,051	(2,980)	-

31 dhjetor 2022	ALL	USD	EUR	GBP	SDR	Të tjera	Total
<b>Aktive</b>							
Paraja dhe balancat me bankat	-	11,312	66,759	764	-	11,438	90,273
Aktive të tregtueshme	2	14,311	-	-	-	-	14,313
Llogari me FMN-në	16,174	-	-	-	31,523	-	47,697
Kredi ndaj bankave	51,088	-	-	-	-	-	51,088
Investime në tituj	74,064	74,483	307,902	11,063	-	17,709	485,221
Aktive të tjera	2,298	-	-	-	-	-	2,298
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>143,626</b>	<b>100,106</b>	<b>374,661</b>	<b>11,827</b>	<b>31,523</b>	<b>29,147</b>	<b>690,890</b>
<b>Detyrime</b>							
Para në qarkullim	401,129	-	-	-	-	-	401,129
Detyrime ndaj bankave	71,231	18,391	128,070	-	-	-	217,692
Depozita dhe hua nga palë të treta	2,000	-	7	-	-	-	2,007
Detyrime ndaj Qeverisë dhe institucioneve shtetërore	28,542	250	33,744	-	955	-	63,491
Detyrime ndaj FMN-së	-	-	-	-	41,932	-	41,932
Detyrime të tjera	259	580	82	-	-	-	921
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>503,161</b>	<b>19,221</b>	<b>161,903</b>	<b>-</b>	<b>42,887</b>	<b>-</b>	<b>727,172</b>
<b>Ekspozimi neto në pasqyrën e pozicionit financiare</b>	<b>(359,535)</b>	<b>80,885</b>	<b>212,758</b>	<b>11,827</b>	<b>(11,364)</b>	<b>29,147</b>	<b>(36,282)</b>
<b>Analiza e ndjeshmërisë</b>							
Efeki i Fitimit/(humbjes: Forcim (10%))	-	8,088	21,276	1,183	(1,136)	2,915	-
Dobësim (10%)	-	(8,088)	(21,276)	(1,183)	1,136	(2,915)	-



## F. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

### i) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare për të cilat nuk ka treg të vrojtueshëm të çmimeve përshkruhet në politikat kontabël. Për instrumentet financiare që tregtohen jo në mënyrë të shpeshtë dhe çmimi i të cilave nuk është transparent, vlera e drejtë është më pak objektive dhe kërkon vlerësimin e një eksperti në varësi të likuiditetit, përqendrimit, pasigurive të faktorëve të tregut, supozimit të çmimeve dhe rreziqeve të tjera, të cilat ndikojnë instrumentin në fjalë.

### ii) Vlerësimi i instrumenteve financiare

Banka mat vlerën e drejtë të instrumenteve financiare, duke përdorur metodat dhe hierarkinë si më poshtë:

- Nivel 1: Çmimi i kuotuar në treg ose çmimi i kuotuar nga tregtarët për pozicionet për të cilat ekziston një treg i besueshëm;
- Nivel 2: Teknika vlerësimi bazuar në informacionin e vrojtueshëm në lidhje me kurbën e rendimentit. Kjo kategori përdoret për matjen e letrave me vlerë për të cilat nuk ka treg të besueshëm;
- Nivel 3: Teknikat e vlerësimit, kur të dhënat e aktiveve dhe detyrimeve financiare nuk bazohen në të dhëna të vrojtuar të tregut.

Vlerat e drejta të aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare që tregtohen në tregjet ndërkombëtare financiare për të cilat ka informacion në dispozicion, janë bazuar në çmimet e kuotuar të tregut ose në çmimet e kuotuar nga tregtarët. Disponibiliteti i çmimeve të vrojtueshme të tregut zvogëlon nevojën për gjykim dhe vlerësim nga drejtimi i Bankës dhe ul pasigurinë e lidhur me përcaktimin e vlerës së drejtë. Disponibiliteti i çmimeve të tregut dhe të dhënave të vrojtueshme, ndryshon sipas produkteve dhe tregjeve, dhe ndikohet prej ngjarjeve të veçanta dhe kushteve të përgjithshme të tregjeve financiare. Banka përcakton vlerën e drejtë për të gjitha instrumentet e tjera financiare për të cilat nuk ekziston treg aktual kuotimi, duke përdorur teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modelet e skontuara të flukseve monetare, krahasimin me instrumente të ngjashme, për të cilat ekzistojnë çmime tregu të vrojtueshme dhe modele të tjera të vlerësimit. Supozimet dhe burimet e përdorura në teknikat vlerësuese përfshijnë norma interesi benchmark dhe norma interesi pa rrezik, shtesat e kreditimit dhe shtesa të tjera të përdorura në vlerësimin e faktorit skontues, çmimet e kapitalit dhe të obligacioneve, kurset e këmbimeve valutore, çmimet e indeksuara të kapitalit dhe pritshmëria e korrelacioneve dhe luhatshmërisë së çmimeve. Vlera aktuale neto llogaritet kur është e nevojshme, për instrumentin përkatës. Qëllimi i teknikave vlerësuese është që të realizohet një matje me vlerë të drejtë që reflekton çmimin që do të arketohet nga shitja e një aktivi ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes.





Banka përdor metoda gjerësisht të njohura vlerësimi për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumenteve të thjeshta financiare, të tilla si kontratat e shkëmbimit të monedhave të huaja dhe të normave të interesit, të cilat përdorin vetëm të dhëna të vrojtueshme në treg dhe që kërkojnë pak gjykim dhe vlerësim. Vlerësimet e vlerës së drejtë të përfuara nga modelet rregullohen për faktorë të tjerë, siç janë rreziku i likuiditetit ose pasiguritë e modeleve, në atë masë që Banka beson që një pjesëmarrës i tretë në treg do t'i marrë ato parasysh në vendosjen e çmimit të një transaksioni. Vlera e drejtë reflekton rrezikun e kreditit të instrumentit dhe përfshin rregullime për të marrë parasysh rrezikun e kreditit të Bankës dhe të kundërpartisë, kur është e përshtatshme. Të dhënat e modeleve dhe vlerat kalibrohen përkundrejt të dhënave historike dhe parashikimeve të publikuara dhe, kur është e mundur, përkundrejt transaksioneve korrente apo të fundit të vëzhguara në instrumente të ndryshme dhe përkundrejt kuotimeve të ndërmjetësuesve. Ky proces kalibrimi është shumë subjektiv dhe jep një bashkësi zgjedhesh të të dhënave të mundshme dhe të vlerësimeve të vlerës së drejtë, dhe gjykimi i menaxhimit është i nevojshëm për të zgjedhur pikën më të përshtatshme në këtë bashkësi. Për të gjitha instrumentet e tjera financiare, Banka përcakton vlerën e drejtë, duke përdorur teknika vlerësimi.

Disponueshmëria e çmimeve të vëzhgueshme të tregut dhe treguesve të modeleve ul nevojën për gjykim dhe vlerësim dhe gjithashtu redukton pasigurinë që shoqëron përcaktimin e vlerës së drejtë. Disponueshmëria e çmimeve të vrojtueshme të tregut dhe të dhënave ndryshon sipas produkteve dhe tregjeve dhe është e prirur që të ndryshojë në bazë të ngjarjeve të veçanta dhe kushteve të përgjithshme të tregjeve financiare.

### ***Instrumentet financiare të matura me vlerën e drejtë - Hierarkia e vlerës së drejtë***

Tabela e mëposhtme analizon instrumentet financiare të matura me vlerën e drejtë në datën e raportimit, nga niveli i hierarkisë në të cilin matja me vlerën e drejtë kategorizohet. Shumat bazohen në vlerën e njohur në pasqyrën e pozicionit financiar.

31 dhjetor 2023	Shënime	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
<b>Aktive financiare</b>					
Aktive të tregtueshme joderivative	13	13,041	-	-	13,041
Aktive të tregtueshme derivative	13	-	-	-	-
Investime në tituj	14	388,176	98,611	-	486,787
<b>Totali</b>		<b>401,217</b>	<b>98,611</b>	<b>-</b>	<b>499,828</b>
31 dhjetor 2022	Shënime	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
<b>Aktive financiare</b>					
Aktive të tregtueshme joderivative	13	14,311	-	-	14,311
Aktive të tregtueshme derivative	13	-	-	2	2
Investime në tituj	14	369,774	115,447	-	485,221
<b>Totali</b>		<b>384,085</b>	<b>115,447</b>	<b>2</b>	<b>499,534</b>

### ***Instrumente financiare që nuk maten me vlerën e drejtë***

Vlera e drejtë e balancave me/ndaj bankave, balancat me/ndaj FMN-së, detyrimet ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare, si dhe detyrimeve ndaj institucioneve qeveritare është afërsisht e barabartë me vlerën e raportuar



për arsye të natyrës së tyre afatshkurtër. Tabela e mëposhtme paraqet vlerën e drejtë të disa instrumenteve financiare që nuk maten me vlerën e drejtë në nivelet e hierarkisë së vlerës së drejtë në të cilën çdo matje e vlerës së drejtë kategorizohet. Aktivet e tjera përbëhen nga kredia dhënë për punonjësit (shih shënimin 16) në bazë të nenit 4 pika (b) të ligjit nr. 8269 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar.

	Shënime	31 dhjetor 2023		31 dhjetor 2022	
		Vlera e drejtë Niveli 2	Vlera Kontabël	Vlera e drejtë Niveli 2	Vlera Kontabël
<b>Aktive</b>					
Balancat me bankat	9	128,980	128,980	90,254	90,254
Kredi ndaj bankave	12	44,755	44,755	51,088	51,088
Llogari me FMN-në	11	41,043	41,043	47,697	47,697
<b>Detyrime</b>					
Detyrime ndaj FMN-së	11	37,156	37,156	41,932	41,932
Detyrime ndaj bankave	18	224,111	224,111	217,692	217,692
Depozita dhe hua nga palët e treta	19	1,997	1,997	2,007	2,007
Detyrime ndaj Qeverisë dhe institucioneve shtetërore	20	105,024	105,024	63,491	63,491
Detyrime të tjera financiare	21	880	880	921	921

### G. Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjes së drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë, si rezultat i një shumëllojshmërie shkaqesh të lidhura me operacionet e Bankës, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën, si dhe me faktorë të jashtëm, përveç rrezikut të kreditit, rreziqeve të tregut dhe të likuiditetit, të lindura nga kërkesat ligjore dhe rregullatore, si dhe standardet përgjithësisht të pranura të sjelljes organizative. Rreziku operacional rrjedh nga të gjitha operacionet e Bankës. Menaxhimi i rrezikut operacional mbështetet në sistemet e kontrollit të brendshëm për një sërë aktivitetesh të Bankës dhe në standardet për menaxhimin e rrezikut operacional, si dhe në një sërë politikash të përgjithshme, rregullore të drejtimit të stafit dhe kërkesa rregullatore.


### H. Struktura e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve

Aktivitet dhe detyrimet e Bankës, të analizuar sipas maturitetit të mbetur nga data e pasqyrës së pozicionit financiar deri në datën e çdo marrëveshjeje vijuese apo maturitetit kontraktual, janë si në vijim.



31 dhjetor 2023	< 12 muaj	> 12 muaj	Maturitet i papërcaktuar	Totali
<b>AKTIVET</b>				
Paraja dhe balancat me bankat	128,980	-	-	128,980
Aktive të tregtueshme	1,940	11,101	-	13,041
Ari monetar	-	-	21,039	21,039
Llogari me Fondin Monetar Ndërkombëtar	23,450	-	17,593	41,043
Kredi ndaj bankave	44,755	-	-	44,755
Investime në tituj	182,416	304,371	-	486,787
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara	-	-	21,574	21,574
Aktive të tjera	2	2,156	1,177	3,335
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>	<b>381,543</b>	<b>317,628</b>	<b>61,383</b>	<b>760,554</b>
<b>DETYRIMET</b>				
Para në qarkullim	-	-	407,968	407,968
Detyrime ndaj bankave	224,111	-	-	224,111
Depozita dhe hua nga palë të treta	1,997	-	-	1,997
Detyrime ndaj Qeverisë dhe institucioneve shtetërore	104,524	-	500	105,024
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	14,316	-	22,840	37,156
Detyrime të tjera	983	-	-	983
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>	<b>345,931</b>	<b>-</b>	<b>431,308</b>	<b>777,239</b>
<b>NETO</b>	<b>35,612</b>	<b>13,257</b>	<b>(65,554)</b>	<b>(16,685)</b>

31 dhjetor 2022	< 12 muaj	> 12 muaj	Maturitet i papërcaktuar	Totali
<b>AKTIVET</b>				
Paraja dhe balancat me bankat	90,273	-	-	90,273
Aktive të tregtueshme	2,491	11,822	-	14,313
Ari monetar	-	-	18,900	18,900
Llogari me Fondin Monetar Ndërkombëtar	27,818	-	19,879	47,697
Kredi ndaj bankave	51,088	-	-	51,088
Investime në tituj	200,333	284,888	-	485,221
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara	-	-	21,376	21,376
Aktive të tjera	2	2,296	1,204	3,502
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>	<b>372,005</b>	<b>299,006</b>	<b>61,359</b>	<b>732,370</b>
<b>DETYRIMET</b>				
Para në qarkullim	-	-	401,129	401,129
Detyrime ndaj bankave	217,692	-	-	217,692
Depozita dhe hua nga palë të treta	2,007	-	-	2,007
Detyrime ndaj Qeverisë dhe institucioneve shtetërore	62,991	-	500	63,491
Detyrime ndaj Fondit Monetar Ndërkombëtar	16,175	-	25,757	41,932
Detyrime të tjera	1,021	-	-	1,021
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>	<b>299,886</b>	<b>-</b>	<b>427,386</b>	<b>727,272</b>
<b>NETO</b>	<b>72,119</b>	<b>299,006</b>	<b>(366,027)</b>	<b>5,098</b>



## I. Administrimi i Kapitalit

Banka e Shqipërisë përgjigjet para Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe fondi i saj i themelimit prej 2,500 milionë lekësh është në pronësi ekskluzive të Shtetit Shqiptar. Fondi i themelimit mund të rritet me propozim të Bankës së Shqipërisë dhe miratim nga Ministria e Financave. I tërë fondi i themelimit akordohet dhe zotërohet ekskluzivisht nga Shteti Shqiptar. Ky fond nuk mund të transferohet apo të jetë subjekt hipotekimi. Politika e shpërndarjes së fitimit përshkruhet në Shënimin 7 G), N), P) dhe Shënimin 22.

Mungesa e vlerës së mjeteve nën shumën e detyrimeve dhe kapitalit themeltar është shkaktuar nga forcimi i ndjeshëm i lekut dhe ndikimi i tij në rezervat valutore të mbajtura nga Banka, të cilat gjithashtu janë rritur ndjeshëm në vëllim, duke rritur kështu ekspozimin ndaj rrezikut nga kursi i këmbimit. Banka synon të mbajë rezervat e saj valutore dhe humbjet e perealizuara, si pasojë e mbiçmimit të lekut nuk pritet të realizohen, siç referuar në shënimin 8E (ii).

Në këto rrethana, Banka nuk ka nevojë për kapital shtesë për të plotësuar nevojat e saj operacionale, për sa kohë që mjetet e saj ndjeshëm tejkalojnë detyrimet e afërta për t'u shlyer. Në veçanti, detyrimet ndaj Qeverisë Shqiptare si dhe FMN-së, nuk pritet të shlyhen plotësisht në një të ardhme të parashikueshme.

Si rezultat, Banka dhe Qeveria Shqiptare e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në konsultime me FMN-në, rishikuan marrëveshjen "Mbi transferimin e fitimit neto të Bankës së Shqipërisë pranë Ministrisë së Financave dhe mbulimin e humbjeve të Bankës së Shqipërisë".

Siç parashikohet në nenin 7 të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", sa herë që në bilancin e Bankës së Shqipërisë vlera e mjeteve të saj bie nën shumën e detyrimeve dhe fondit të themelimit, Ministri i Financave transferon në Bankën e Shqipërisë letra me vlerë të qeverisë të negociueshme, me interes me normat e tregut, në masën e nevojshme për të korigjuar mungesën. Marrëveshja dypalëshe ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e datës 16.1.2015, e ndryshuar më 29.12.2023, përcakton se termi "detyrime", referuar nenit 7 të ligjit, nuk përfshin detyrimet ndaj qeverisë shqiptare ose FMN-së, pasi roli i tyre është të garantojnë ose mbështesin stabilitetin financiar. Për rrjedhojë, këto detyrime nuk pritet të shlyhen në rrethana likuiditeti ose mungese kapitali.

Ndërkohë që Banka e Shqipërisë ka njohur humbje nga rivlerësimi i monedhave të huaja, ajo mbetet e mirëkapitalizuar në bazë të kapitalit të realizuar edhe pse forcimi i monedhës Lek përkundrajt monedhave ku është investuar rezerva valutore, ka gërryer kapitalin e saj. Fitimet (humbjet) nga rivlerësimi janë të luhatshme dhe i nënshtrohen faktorëve ekonomikë jashtë kontrollit të drejtpërdrejtë të Bankës së Shqipërisë dhe mund të kthehen me ndryshimin e kushteve ekonomike botërore. Humbja e akumuluar nga rivlerësimi është si rezultat i mbiçmimit të lekut ndaj euros që nga viti 2019.



## 9. PARAJA DHE BALANCAT ME BANKAT

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Mjete monetare	24	18
Llogari rrjedhëse	114,934	80,206
Depozita me afat maturimi deri në tre muaj	13,500	10,054
Zbritja e humbjeve nga zhvlerësimi	(12)	(6)
<b>Paraja dhe ekuivalentët e saj</b>	<b>128,446</b>	<b>90,273</b>
Depozita me afat maturimi mbi tre muaj	534	-
<b>Totali</b>	<b>128,980</b>	<b>90,273</b>

Normat e interesit për llogaritë rrjedhëse janë si më poshtë:

Në %	EUR	USD	GBP	AUD	JPY	CNY	CNH
31 dhjetor 2023	0.00 – 3.99	0.00 – 5.30	4.50 – 5.10	0.00 – 3.95	(0.35) – 0.00	0.00 – 0.10	0.00 – 0.10
31 dhjetor 2022	0.00 – 2.00	0.00 – 4.30	2.25 – 3.32	0.20 – 2.85	(0.35) – 0.00	0.70 – 1.20	0.30 – 1.80

Normat vjetore të interesit për depozitat afatshkurtra janë si më poshtë:

Në %	EUR	USD	CNH
31 dhjetor 2023	3.90 – 4.02	5.30	2.79 – 3.33
31 dhjetor 2022	-	4.30	-


## 10. ARI MONETAR

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Depozita	-	18,900
Llogari rrjedhëse	21,039	-
<b>Totali</b>	<b>21,039</b>	<b>18,900</b>

Ari monetar është vendosur në llogari rrjedhëse (2022: depozita) pranë bankave korrespondente të huaja. Rritja prej 2,139 milionë lekësh në krahasim me vitin e kaluar vjen si rezultat i blerjes së arit (2,267 milionë lekë) gjatë vitit, si dhe rivlerësimit të arit monetar me vlerë tregu në datën e raportimit (humbje prej 128 milionë lekësh), i cili njihet në fitim ose humbje dhe akumulohet në rezervën e rivlerësimit (Shih Shënimin 22).

## 11. LLOGARI ME/DETYRIME NDAJ FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR (FMN)

Llogari me FMN-në	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Kuota në FMN	17,593	19,879
Të drejta speciale të tërheqjes (SDR) të mbajtura	23,450	27,819
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>41,043</b>	<b>47,697</b>
Dejtime ndaj FMN-së	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Shpërndarjet e SDR-ve	22,682	25,639
Llogaria e letrave me vlerë me FMN-në	12,465	14,083
Llogaria nr. 1 e FMN-së	1,851	2,091
Llogaria nr. 2 e FMN-së	1	1
Interes i përllogaritur	157	118
<b>Totali i deyrimeve</b>	<b>37,156</b>	<b>41,932</b>



Kuotat në FMN prej 17,593 milionë lekësh ose 139 milionë SDR (2022: 19,879 milionë lekë ose 139 milionë SDR) rezultojnë nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në FMN, në përputhje me ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Të drejtat speciale të tërheqjes në shumën prej 23,450 milionë lekësh ose 186 milionë SDR (2022: 27,819 milionë lekë ose 195 milionë SDR) përfaqësojnë depozita të vendosura me FMN-në.

Gjatë vitit 2020, në përgjigje të situatës së shkaktuar nga tërmeti që goditi vendin dhe situatës së pandemisë COVID-19, Qeveria e Shqipërisë kërkoi dhe mori një financim emergjent nga FMN-ja në shumën prej 139 milionë SDR, që korrespondon me blerjen e 100% të kuotës së Shqipërisë nën Instrumentin e Financimit të Shpejtë (RFI). SDR-të e mbajtura sjellin interes, i cili përcaktohet në baza javore. Më 31 dhjetor 2023, norma e interesit ishte 4.103% në vit (2022: 2.916% në vit).

Shpërndarjet e SDR-ve prej 22,682 milionë lekësh ose 180 milionë SDR (2022: 25,639 milionë lekë ose 180 milionë SDR) përfaqësojnë shuma të huazuara nga FMN-ja me dy transhe, në gusht dhe shtator të vitit 2009, qëllimi i të cilave është të sigurojnë një përgjigje të menjëhershme ndaj nevojave afatshkurtra dhe afatgjata për likuiditet të vendeve anëtare. Shpërndarjet e SDR-ve mbartin interes, i cili përcaktohet në baza javore dhe paguhet çdo tre muaj.

FMN-ja paguan shpërblim për anëtarët me pozicion shpërblimi të transhit të rezervës, me 4.103% në vit (2022: 2.916% në vit). Pozicioni i transhit të rezervës llogaritet si diferencë ndërmjet kuotave në FMN dhe gjendjes së llogarive të FMN-së, duke përjashtuar mbajtjet e ardhura si rezultat i përdorimit të kredive të akorduara nga FMN-ja dhe ato në llogarinë nr. 2. Gjatë muajit gusht 2021, FMN-ja vendosi të kryejë një alokim të SDR-ve për të gjitha vendet anëtare për të ndihmuar në mbështetjen e rezervave, zbutjen e rregullimeve duke mitiguar rrezikun e stanjacionit me rritjen ekonomike. Alokimi i SDR-ve iu shpërnda anëtarëve në proporcion me kuotat e paguara të tyre. Shqipërisë iu alokua një shumë prej 133 milionë SDR ose 19,640 milionë lekësh. Bazuar në konceptin e shpërndarjes së SDR-ve, anëtari ka një shkallë të lartë fleksibiliteti në përdorimin e tyre. Nëse anëtari vendos t'i përdorë (Banka e Shqipërisë ose Ministria e Financave), do të paguajë kostot e përdorimit (zakonisht interesi dhe jokryegjësia).

### ***Mbështetja e drejtpërdrejtë e buxhetit nga FMN-ja***

Fondet e siguruara për mbështetje të drejtpërdrejtë të buxhetit nga FMN-ja për Qeverinë Shqiptare, të cilat depozitohen fillimisht në llogaritë e Qeverisë pranë Bankës, nuk njihen si detyrim i Bankës ndaj FMN-së.

Qeveria merr përsipër detyrimin për t'i paguar fondet FMN-së, ndërkohë që Banka i kryen këto pagesa për llogari të Qeverisë. FMN-ja i disbursoi këto fonde në këste gjatë viteve 2014-2017, si pjesë e programit EFF të miratuar



nga FMN-ja në favor të Shqipërisë dhe gjatë vitit 2020 në një pagesë të vetme, si pjesë e Instrumentit të Ndihmës së Shpejtë në përgjigje të situatës së pandemisë të shkaktuar nga COVID-19. Këto transhe janë përdorur për të siguruar financim të drejtpërdrejtë të buxhetit të Qeverisë së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave. Huamarrja është e pagueshme brenda 3 viteve nga Qeveria Shqiptare. Qeveria do të depozitojë në llogaritë e saj pranë Bankës, fonde të mjaftueshme për të paguar principalin, interesat dhe çdo shpenzim tjetër të lidhur me transhet e mësipërme. Në lidhje me këto kredi, Ministria e Financave ka lëshuar nota premtimi në favor të FMN-së. Qeveria filloi ta shlyejë kredinë në tetor 2018 dhe korrik 2023. Më 31 dhjetor 2023, vlera e mbetur e kredisë ishte 26,679 milionë lekë (2022: 42,143 milionë lekë).

## 12. KREDI NDAJ BANKAVE

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Marrëveshjet e anasjella të riblerjes	44,755	51,088
<b>Total</b>	<b>44,755</b>	<b>51,088</b>

Më 31 dhjetor 2023 dhe 2022, marrëveshjet e anasjella të riblerjes ndërmjet Bankës dhe bankave tregtare vendase kanë maturitete origjinale që variojnë nga një javë deri në tre muaj (2022: nga një javë deri në tre muaj). Nuk ka kredi njëditore për bankat më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022.

## 13. AKTIVE TË TREGTUESHME

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Jo-derivativë:		
Obligacione të agjencive të huaja	2,959	3,127
Obligacione të qeverive dhe institucioneve shumëpalëshe	10,082	11,184
Derivativë:		
Kontrata të së ardhmes të normave të interesit	-	-
Kontrata Forward të këmbimit valutor	-	2
<b>Totali</b>	<b>13,041</b>	<b>14,313</b>

Investimet e tregtueshme administrohen nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), në kuadrin e marrëveshjes së Bankës me IBRD-në "Për administrimin dhe asistencën teknike mbi investimin e rezervës valutore të Bankës së Shqipërisë" (Program Menaxhimi për Rezerva dhe Këshillim) të lidhur më 23 shtator 2005. Investimet në këtë portofol mbahen në monedhën USD.

Normat vjetore të interesit për aktivet e tregtueshme joderivative më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 janë si më poshtë.

Në %	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
USD	0.125 – 5.375	0.125 – 4.750



## 14. INVESTIME NË TITUJ BORXHI

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Investime në tituj borxhi të matura me VDATGJ	486,787	485,221
<b>Totali</b>	<b>486,787</b>	<b>485,221</b>
<b>Humbja e Pritshme nga Krediti (HPK)</b>	<b>(43)</b>	<b>(47)</b>

Investimet në tituj borxhi të ndara sipas llojit të kundërpartisë dhe llojit të letrës paraqiten si më poshtë.

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Bono thesari të qeverive të huaja dhe institucioneve shumëpalëshe	-	27,519
Certifikatë depozite	-	6,225
Obligacione të bankave të huaja dhe institucioneve të tjera	32,082	35,953
Obligacione të agjencive të huaja	34,937	33,441
Obligacione të qeverive të huaja dhe institucioneve shumëpalëshe	351,129	308,019
Bono thesari të Qeverisë Shqiptare	68,639	74,064
<b>Totali</b>	<b>486,787</b>	<b>485,221</b>

Humbja e Pritshme nga Krediti (HPK) sipas tipit të emetuesit dhe titullit të borxhit paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Bono thesari të qeverive të huaja dhe institucioneve shumëpalëshe	-	(1)
Certifikatë depozite	-	(17)
Obligacione të bankave të huaja dhe institucioneve të tjera	(17)	(7)
Obligacione të agjencive të huaja	(5)	(5)
Obligacione të qeverive të huaja dhe institucioneve shumëpalëshe	(21)	(17)
Bono thesari të Qeverisë Shqiptare	-	-
<b>Totali</b>	<b>(43)</b>	<b>(47)</b>

Normat vjetore të interesit për çdo monedhë, më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022, janë si më poshtë:

Në %	ALL	USD	GBP	AUD	CNH	EUR	JPY
31 dhjetor 2023	3.25 – 3.36	0.00 – 7.38	3.30 – 5.54	3.61 – 4.71	2.45 – 3.06	1.88 – 4.43	(0.21)
31 dhjetor 2022	2.75 – 5.46	3.86 – 6.09	2.41 – 4.47	3.30 – 4.40	1.67 – 2.81	1.83 – 3.93	

Investimet në tituj borxhi në monedhë vendase më 31 dhjetor 2023, përfaqësohen nga bono thesari të Qeverisë Shqiptare me afat maturimi deri në 12 muaj (2022: deri në 12 muaj).

Në 31 dhjetor 2022, Banka regjistroi titullin e borxhit të emtuar nga Ministria e Financave me vlerë nominale 6,020 milionë lekë, pasi më 31 dhjetor 2022, totali i kapitalit themeltar dhe detyrimeve të Bankës tejkalonte mjetet e saj në vlerën 3,433 milionë lekë.





Regjistrimi është kryer në zbatim të kushteve të parashikuara në nenin 7 të ligjit nr. 8269, dt. 23 dhjetor 1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, duke i kërkuar Bankës dhe Ministrisë së Financave që të transferojnë letra me vlerë shtetërore të tregtueshme në Bankë, sa herë që aktivet e Bankës ulen nën detyrimet dhe kapitalin e saj të paguar.

Bazuar në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 14, datë 6.3.2024, në kushtet që më datën 31 dhjetor 2023, aktivet e Bankës nuk janë më pak se shuma e kapitalit të paguar dhe detyrimeve të saj (detyrimet ndaj palëve të treta, duke përjashtuar detyrimet ndaj Qeverisë dhe FMN-në), titulli i borxhit është kompensuar nga fitimi neto i vitit financiar në zbatim të nenit 10, pika 1, të ligjit «Për Bankën e Shqipërisë», i cili përcakton se pas kalimit të shumës prej 25% të fitimit neto në fondin rezervë të përgjithshme, sipas nenit 9, mbetja nga fitimi neto për vitin financiar do të përdoret për kompensimin e titujve të borxhit që i janë dhënë Bankës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 7 të këtij ligji.



**15. AKTIVE TË QËNDRUESHME TË TRUPËZUARA DHE TË PATRUPËZUARA, TË DREJTA PËRDORIMI TË AKTIVEVE**

	Toka, ndërtesa dhe instalime	Mobilje dhe pajisje	Mjete transporti	Ndërtime në proces	Monedha dhe objekte numizmatike	Totali i ndërtesave dhe pajisjeve	Totali të Drejta Përdorimi	Programë kompjuterike	Punime në proces	Totali i aktiveve të patrupëzuara	Totali
<b>Kosto ose kosto e supozuar</b>											
Më 1 janar 2022	9,416	2,868	291	1,492	10,532	24,599	100	819	-	819	25,518
Shtesa	3	133	-	565	-	701	-	18	-	18	719
Transferime	-	-	-	(18)	-	(18)	-	(139)	-	(139)	(157)
Pakësime	-	(46)	-	-	-	(46)	(100)	-	-	-	(146)
Më 31 dhjetor 2022	9,419	2,955	291	2,039	10,532	25,236	-	698	-	698	25,934
Shtesa	-	69	-	484	-	553	-	3	5	8	561
Transferime	2,497	-	-	(2,497)	-	-	-	-	-	-	-
Pakësime	-	(40)	-	-	-	(40)	-	(1)	-	(1)	(41)
Më 31 dhjetor 2023	11,916	2,984	291	26	10,532	25,749	-	700	5	705	26,454
<b>Zhvlërimi/Amortizimi i akumuluar</b>											
Më 1 janar 2022	1,015	2,378	266	-	-	3,659	100	728	-	728	4,487
Zhvlërimi/Amortizimi	145	158	9	-	-	312	-	44	-	44	356
Pakësime	-	(46)	-	-	-	(46)	(100)	(139)	-	(139)	(285)
Më 31 dhjetor 2022	1,160	2,490	275	-	-	3,925	-	633	-	634	4,558
Zhvlërimi/Amortizimi	151	169	9	-	-	329	-	34	-	34	363
Pakësime	-	(40)	-	-	-	(40)	-	(1)	-	(1)	(41)
Më 31 dhjetor 2023	1,311	2,619	284	-	-	4,214	-	666	-	666	4,880
<b>Vlera kontabël</b>											
Më 31 dhjetor 2022	8,259	465	16	2,039	10,532	21,311	-	65	-	65	21,376
Më 31 dhjetor 2023	10,605	365	7	26	10,532	21,535	-	34	5	39	21,574



## 16. AKTIVE TË TJERA

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
<b>Aktive financiare</b>		
Kredi për punonjësit, neto	2,158	2,298
	<b>2,158</b>	<b>2,298</b>
<b>Aktive jofinanciare</b>		
Numizmatika (monedha dhe kartëmonedha)	347	348
Kosto printimi dhe shtypjeje të shtyra	757	787
Inventarë	21	22
Të tjera	52	47
	<b>1,177</b>	<b>1,204</b>
<b>Totali</b>	<b>3,335</b>	<b>3,502</b>

Më 31 dhjetor 2023, kreditë e punonjësve paraqiten neto nga provigjionet që lidhen me to, në vlerën prej 6 milionë lekë (2022: 6 milionë lekë) (shih Shënimin 8(E)(vi)(b)).

## 17. PARAJA NË QARKULLIM


Banka ka të drejtën ekskluzive të emetimit të monedhës shqiptare. Ky zë përfshin kartëmonedha dhe monedha vendase në qarkullim të emetuara nga Banka. Banka e Shqipërisë ka rritur kapacitetet operacionale për të garantuar furnizimin e pandërprerë të ekonomisë me monedhë dhe kartëmonedhë. Ajo ka marrë të gjitha vendimet e nevojshme dhe ka angazhuar strukturat e saj në plotësimin e kërkesave të tregut për para fizike, duke siguruar njëkohësisht një stok të mjaftueshëm, me qëllim përballimin e nevojave në rritje të ekonomisë.

Më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022, gjendja e kartëmonedhave dhe monedhave në qarkullim është si më poshtë.

Vlera Nominale Lekë	31 dhjetor 2023		31 dhjetor 2022	
	Numri (në mijë copë)	Totali Lekë (milionë)	Numri (në mijë copë)	Totali Lekë (milionë)
Kartëmonedha:				
100	3,396	340	3,399	340
200	16,538	3,308	15,920	3,184
500	19,456	9,727	20,176	10,088
1,000	27,216	27,216	31,261	31,261
2,000	35,943	71,887	38,813	77,626
5,000	49,803	249,013	48,890	244,450
10,000	3,960	39,600	2,774	27,740
Monedha (1-100)		6,877		6,440
		<b>407,968</b>		<b>401,129</b>

## 18. DETYRIME NDAJ BANKAVE

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Rezerva e detyruar dhe llogaritë rrjedhëse	206,731	189,602
Depozita	7,000	15,650
Rezerva e detyruar - para në kujdestari	10,380	12,440
<b>Totali</b>	<b>224,111</b>	<b>217,692</b>



Në përputhje me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 39, datë 25.6.2014, ndryshuar me vendimin nr. 11, datë 7.2.2018, norma e interesit për rezervën e detyruar në Lekë është 100% e normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes, të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, në ditën e fundit të periudhës bazë.

Më 31 dhjetor 2023, norma e interesit rezulton 3.25% (2022: 100% e normës bazë ose 2.75%).

Sipas vendimit nr. 11, datë 7.2.2018, norma e interesit për rezervën e detyruar në Euro është e barabartë me normën e depozitës të përcaktuar nga Banka Qendrore Evropiane (BQE).

Më 31 dhjetor 2023, rezerva e detyruar në USD nuk shpërblehet me interes (2022: nuk shpërblehet me interes). Sipas vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 29, datë 16.5.2012, "Mbi minimumin e rezervës së detyruar mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat", ndryshuar me vendimin nr. 75, datë 6.7.2016, Banka i lejon bankat tregtare të mbajnë rezervën e detyrueshme edhe në formën e parasë në kujdestari.

## 19. DEPOZITA DHE KREDI NGA PALË TË TRETJA

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Depozita nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave	1,872	1,974
Depozitat nga fondi i pensionit	110	18
Depozita nga individët për pjesëmarrjen në ankandet e bonos së thesarit	15	15
<b>Totali</b>	<b>1,997</b>	<b>2,007</b>

Depozitat nga fondi i pensionit lidhen me fondin e pensionit, që bazohet në kontributin e punonjësve, si dhe në kontributin e punëdhënësit. Mbështetur në vendimin nr. 17, datë 26.2.2014, të Këshillit Mbikëqyrës, fondi i pensionit raporton pozicionin e tij financiar më vete nga ai i Bankës.

## 20. DETYRIME NDAJ QEVERISË DHE INSTITUCIONEVE SHTETËRORE

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Fitimi për t'iu shpërndarë Qeverisë	-	-
Llogari dhe depozita në emër të Qeverisë	102,169	59,769
Detyrime ndaj institucioneve shtetërore	2,855	3,722
<b>Totali</b>	<b>105,024</b>	<b>63,491</b>

Bazuar në marrëveshjen ndërmjet Bankës dhe Ministrisë së Financave, Banka e Shqipërisë paguan interes vetëm për vendosjen e depozitave me afat nga ana e Qeverisë Shqiptare, si dhe për një depozitë garancie në shumën 500 milionë lekë (2022: 500 milionë lekë), për të cilën norma e interesit bazohet në vendimet e Këshillit Mbikëqyrës. Për këto dy lloje depozitash, norma e interesit më 31 dhjetor 2023 është 1% (2022: 1%).



Fitimi për t'iu shpërndarë Qeverisë detajuar si më poshtë:

	Shënimi	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
<b>Rezultati neto për periudhën</b>		(27,052)	(17,650)
Transferimi në rezerva	22	36,147	14,571
<b>Fitim(Humbja) e vitit për t'iu shpërndarë</b>		<b>9,095</b>	<b>(3,079)</b>
Shpërndarja nga rezerva të tjera	22	53	53
<b>Totali për t'iu shpërndarë</b>		<b>9,148</b>	<b>-</b>
Totali për t'iu transferuar për kompensimin e titullit të borxhit për pamjaftueshmërinë e mjeteve (neni 10 i Ligjit)	14	(6,257)	
<b>Totali që do t'iu transferohet fitim/(humbjeve të mbartura)</b>		<b>2,891</b>	<b>(3,026)</b>
<b>Totali për t'iu shpërndarë Qeverisë</b>		<b>-</b>	<b>-</b>

## 21. DETYRIME TË TJERA

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
<b>Detyrimet financiare</b>		
Detyrime ndaj institucioneve ndërkombëtare financiare	523	603
Detyrime ndaj të tretëve	324	290
Shpenzime të përlogaritura	33	28
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>880</b>	<b>921</b>
<b>Detyrimet jofinanciare</b>		
Provizjione për pretendime dhe për çështje ligjore	101	97
Grante	2	3
<b>Totali i detyrimeve jofinanciare</b>	<b>103</b>	<b>100</b>
<b>Totali</b>	<b>983</b>	<b>1,021</b>

Në detyrimet ndaj institucioneve ndërkombëtare financiare përfshihen shuma të pagueshme ndaj IBRD-së, Agjencisë Ndërkombëtare të Zhvillimit (IDA), Agjencisë së Garantimit Shumëpalësh të Investimeve (MIGA), dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB).

## 22. REZERVAT

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Fondi i Themelimit	2,500	2,500
Rezerva për Bilancin e Pagesave	7,209	7,209
Rezerva në ar dhe metale të çmuara	7,042	7,042
Rezerva për mbulimin e pamjaftueshmërisë së mjeteve (Shënimi 14)	6,020	6,020
Rezerva ligjore	12,500	12,500
Rezerva si rezultat i zbatimit për herë të parë të SNRF-ve	5,450	5,450
<b>Kapitali themeltar dhe rezerva ligjore të realizuara</b>	<b>40,721</b>	<b>40,721</b>

Rezerva për bilancin e pagesave ka të bëjë me grante të dhëna nga Komuniteti Evropian përgjatë viteve 1992 dhe 1993. Në këtë rezervë nuk ka pasur ndryshime që nga viti 1995.

Rezerva për mbulimin e pamjaftueshmërisë së mjeteve përfaqëson titullin e lëshuar nga Ministria e Financave me vlerë nominale 6,020 milionë lekë,



sepse më 31 dhjetor 2022, totali i fondit themeltar dhe detyrimeve të bankës tejkalon mjetet e saj në vlerën 3,433 milionë lekë.

Rezerva në ar dhe metale të çmuara përfaqëson rezervën e krijuar bazuar në ligjin nr. 9862, datë 24.1.2008, "Për transferimin e pronësisë së arit dhe metaleve të tjera të çmuara nga Këshilli i Ministrave te Banka e Shqipërisë".

Rezerva ligjore është krijuar në zbatim të kërkesave të nenit 9 të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", sipas të cilit Banka mban 25% të fitimit neto të vitit në Rezervën Ligjore deri sa ajo të arrijë në 500% të kapitalit. Banka e ka përbushur këtë kërkesë që nga 31 dhjetori 2011, me rezervat ligjore deri në shumën prej 12,500 milionë lekësh.

Rezerva si rezultat i zbatimit për herë të parë të SNRF-ve në shumën prej 5,450 milionë lekësh (2022: ALL 5,450 milionë lekë) është krijuar bazuar në vendimet e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 19 dhe nr. 20, datë 15.3.2018, si rezultat i rishpërndarjes dhe shpërndarjes së rezervës së tranzicionit.

Rezervat neto të porealizuara përfaqësojnë rezervën e rivlerësimit nga kursi i këmbimit, rezervën e rivlerësimit për vlerën e drejtë të letrave me vlerë dhe rezervën e rivlerësimit për aktivet e qëndrueshme të trupëzuara, në shumën 2,135 milionë lekë (2021: 2,188 milionë lekë), krijuar në zbatim për herë të parë të SNRF-ve. Për vitin 2023, shuma prej 53 milionë lekësh i është shtuar rezultatit të vitit 2023 dhe është transferuar te "Humbjet e mbartura" (2022: shuma prej 53 milionë lekësh është përdorur për pakësimin e humbjes).

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Rezerva e Rivlerësimit nga kurset e këmbimit	(56,713)	(20,566)
Rezerva për vlerën e drejtë (investime në tituj borxhi)	(2,396)	(13,922)
Rezerva e rivlerësimit për aktivet e qëndrueshme të trupëzuara	2,135	2,188
<b>Totali i rezervave të Rivlerësimit të porealizuara</b>	<b>(56,974)</b>	<b>(32,300)</b>

Në zbatim të shkronjave "a" dhe "c", të nenit 64 të ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", lëvizja në rezervën e rivlerësimit nga kurset e këmbimit rezulton nga zërat e mëposhtëm, të cilët fillimisht njihen në fitim ose humbje dhe pastaj transferohen në rezervën e rivlerësimit.

	2023	2022
<b>Gjendja më 1 janar</b>	<b>(20,566)</b>	<b>(5,995)</b>
Humbja neto nga këmbimi (jo nga aktivet dhe detyrimet e tregtueshme)	(34,237)	(14,566)
Humbja neto nga këmbimi për aktivet dhe detyrimet e tregtueshme	(1,783)	93
Humbja neto nga ndryshimet në vlerën e drejtë të arit monetar (Shënimi 10)	(128)	(98)
<b>Gjendje më 31 dhjetor</b>	<b>(56,713)</b>	<b>(20,566)</b>

Rënia e rezervës së rivlerësimit nga kurset e këmbimit me 36,148 milionë lekë (2022: rënie 14,571 milionë lekë) është rezultat i zhvlerësimit të arit monetar



dhe monedhave të huaja EUR, USD, GBP përkundrejt Lekut (Shih Shënimin 8(F) (ii)).

#### *Rezerva negative e rivlerësimit*

Duke pasur parasysh balancën negative të rezervës së rivlerësimit më 31 dhjetor 2023 dhe në përputhje me kërkesat e pikës "b" të nenit 64 të ligjit «Për Bankën e Shqipërisë» (Shënimi 7 (N)) dhe bazuar në një marrëveshje dypalëshe me Qeverinë e Shqipërisë, kjo e fundit do të lëshojë tituj të borxhit për të mbuluar balancën negative të rezervës së rivlerësimit pas lëshimit të raportit të audituesve të jashtëm për këto pasqyra financiare.

Lëvizjet në rezervën për vlerën e drejtë (investime në tituj borxhi) paraqiten si më poshtë.

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Gjendja më 1 janar	(13,922)	(355)
Ndryshimi në vlerën e drejtë të letrave me vlerë	11,526	(13,567)
Gjendja më 31 dhjetor	(2,396)	(13,922)

### 23. TË ARDHURA NGA INTERESA, NETO

	2023	2022
<b>Të ardhurat nga interesat llogariten me metodën e interesit efektiv</b>		
Investime në tituj borxhi	11,147	3,243
Hua ndaj bankave	1,416	565
Depozita dhe llogaritë rrjedhëse me bankat	2,064	268
Llogaritë me FMN-në	1,067	415
Interesa negative për rezervën e detyrueshme	-	46
Interesa negative për tepricën e rezervës së detyrueshme	-	274
Të tjera	22	13
Interesa negative për llogarinë e shlyerjes në AIPS EUR	-	33
<b>Totali</b>	<b>15,716</b>	<b>4,857</b>
<b>Shpenzime për interesa</b>		
Rezerva e detyrueshme	961	375
Llogaritë e FMN-së	898	321
Llogaritë e Qeverisë Shqiptare	77	10
Depozita të palëve të treta	222	99
Interesa negative nga llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me bankat	8	454
<b>Totali</b>	<b>2,166</b>	<b>1,259</b>
<b>Të ardhura nga interesat, neto</b>	<b>13,550</b>	<b>3,598</b>

Të ardhurat nga interesi i investimeve në tituj borxhi përfshijnë shumën 2,758 milionë lekë (2022: 1,307 milionë lekë), si të ardhurat e marra nga letrat me vlerë të emetuara nga Qeveria Shqiptare dhe shumën 8,389 milionë lekë (2022: 1,936 milionë lekë) si të ardhurat nga huadhënia e letrave me vlerë dhe nga investimet në tituj borxhi të rezervës valutore, pas llogaritjes së amortizimit të primit/zbritjes.

Interesat negative nga llogaritë dhe depozitat me bankat në shumën 8 milionë lekë (2022: 454 milionë lekë) përfaqësojnë shpenzime nga normat negative



të depozitave dhe llogarive të vendosura me bankat e huaja.

## 24. TË ARDHURA NGA TREGTIMI, NETO

	2023	2022
Të ardhura nga interesat nga aktivet e tregtueshme	196	145
Fitim nga shitja e aktiveve të tregtueshme	28	12
Humbje nga shitja e aktiveve të tregtueshme	(133)	(372)
Fitim/(Humbje) e perealizuar nga rivlerësimi	508	(335)
Fitimi neto nga kontratat e së ardhmes dhe kontratat forward	283	585
<b>Totali</b>	<b>882</b>	<b>35</b>

## 25. TË ARDHURA NGA SHITJA E AKTIVEVE FINANCIARE ME VLERË TË DREJTË NËPËRMJET TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

Shih politikat kontabël në Shënimet 7(A)(iii) dhe 7(E).

	2023	2022
Fitimi neto nga shitja e titujve të borxhit	278	274
Humbja neto nga shitja e titujve të borxhit	(3,050)	(4,439)
<b>Totali</b>	<b>(2,772)</b>	<b>(4,165)</b>

## 26. SHPENZIME PËR PERSONELIN

	2023	2022
Pagat dhe shpërblimet e personelit	1,354	1,254
Kontribut për sigurimet shëndetësore dhe shoqërore	141	124
Kontribut për fond pensioni (shih Shënimin 19)	144	129
<b>Totali</b>	<b>1,639</b>	<b>1,507</b>

Më 31 dhjetor 2023, Banka punëson 609 punonjës (2022: 609 punonjës).

## 27. SHPENZIME TË TJERA TË PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE

	2023	2022
Shpenzime mirëmbajtjeje dhe riparime	193	205
Amortizimi i kostos për kartëmonedhat e printuara dhe monedhat e shtypura	249	248
Shpenzime informacioni	116	114
Komisione për shërbime nga palë të treta	119	133
Shpenzime të tjera për personelin	61	46
Shpenzime transporti	32	25
Shpenzime për publikime dhe anëtarësime	15	13
Shpenzime të tjera	41	11
<b>Totali</b>	<b>826</b>	<b>795</b>





## 28. ANGAZHIME DHE GARANCI

### (i) *Marrëveshje të anasjella riblerjeje*

Marrëveshjet e anasjella të riblerjes, më 31 dhjetor 2023, përfaqësojnë kredi të kolateralizuara (shih Shënimin 12). Vlera nominale e letrave me vlerë të përdorura si kolateral më 31 dhjetor 2023, ishte 49,800 milionë lekë (2022: 62,000 milionë lekë).

### (ii) *Angazhimet kapitale*

Më 31 dhjetor 2023, Banka ka hyrë në angazhime kapitale në një shumë prej 0 milionë lekësh (2022: 135 milionë lekë) për rikonstrukcionin e njëres prej godinave të saj.

### (iii) *Angazhimet e kredisë dhe kolaterale të marra nga punonjësit*

Më 31 dhjetor 2023, vlera e regjistruar e kolateralit për kreditë afatgjata dhënë punonjësve të Bankës (shih Shënimin 16) arrin shumën 3,059 milionë lekë (2022: 3,164 milionë lekë). Më 31 dhjetor 2023, vlera e angazhimeve të kredive ende të padisbursuara në favor të punonjësve është 92 milionë lekë (2022: 98 milionë lekë).

### (iv) *Çështje ligjore*

Në rrjedhën normale të biznesit mund të ngrihen edhe pretendime ndaj Bankës. Në dy raste të paraqitura nga palët e treta, edhe pse detyrimi nuk pranohet, nëse mbrojtja është e pasuksesshme, atëherë shuma të caktuara dhe shpenzime ligjore do të duhet të paguhet nga Banka. Rezultati i këtyre veprimeve dhe shumat e pretenduara nga palët e treta nuk janë përcaktuar ende. Banka vlerëson se nuk do të ketë humbje materiale në lidhje me pretendimet, përtej provigjioneve që janë krijuar në këto pasqyra financiare (shih Shënimin 21).

## 29. AKTIVE TË ADMINISTRUARA

Më 31 dhjetor 2023, Banka vepron si kujdestare për bono thesari afatshkurtra me afat maturimi nga 3 deri 12 muaj në vlerën nominale 222 miliardë lekë (2022: 242 miliardë lekë), si dhe për obligacione afatgjata me afat maturimi nga 2 deri 15 vjet në vlerën nominale prej 518 miliardë lekësh (2022: 478 miliardë lekë). Këto instrumente financiare përfaqësojnë tituj borxhi të emetuar nga Qeveria Shqiptare.



### 30. PALËT E LIDHURA

Palët konsiderohen si të lidhura në qoftë se njëra palë ka aftësinë të kontrollojë tjetrën apo të ushtrojë një influencë domethënëse mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare apo të tjera vendime.

Duke marrë në konsideratë çdo palë të lidhur të mundshme, vëmendje i kushtohet përmbajtjes së marrëdhënies dhe jo thjesht formës ligjore.

Palët e lidhura të Bankës përfshijnë drejtuesit dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës. Më 31 dhjetor 2023 dhe 2022, transaksionet e realizuara me palët e lidhura përfshijnë:

	2023	2022
<b>Kredi për stafin drejtues</b>		
Staf drejtues	116	123
<b>Totali</b>	<b>116</b>	<b>123</b>

Huatë për drejtorët ndjekin termat dhe kushtet e zbatuara për të gjithë punonjësit e Bankës, bazuar në politikën dhe rregulloret në fuqi. Huatë janë të kolateralizuara.

	2023	2022
<b>Shpenzime administrative</b>		
<i>Drejtorët dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës</i>		
Shpenzime telefoni	5	5
Paga dhe shpërblime	169	154
Dieta	3	3
<i>Drejtorët</i>		
Kompensim karburanti	3	3
Kontributi i Bankës në skemën e fondit të pensionit	16	14
<b>Totali i shpenzimeve administrative për palët e lidhura</b>	<b>196</b>	<b>179</b>

Llogaritë me/(ndaj) Qeverinë Shqiptare dhe institucionet shtetërore janë paraqitur në Shënimet 14 dhe 20, si dhe të ardhurat e interesit nga titujt e borxhit përkatës dhe shpenzimet e interesit janë të përfshira në Shënimin 23. Premtimpagesat e emtuara nga Qeveria Shqiptare në favor të FMN-së janë të detajuara në Shënimin 11, ndërsa titujt e borxhit të emtuara nga Qeveria Shqiptare dhe të menaxhuara nga Banka janë detajuar në Shënimin 28.

### 31. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit, të tilla që mund të ketë nevojë për rregullime ose shënime shpjeguese në këto pasqyra financiare.

